RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "PËR PËRPUTHSHMËRINË E AKTIVITETIT TË INSTITUCIONIT" PËR AUDITITIMIN E USHTRUAR NË ZYRËN VENDORE TË ASHK(ish ZVRPP) BULQIZË

KORRIK 2019

faqe

	***Përmbajtja*.....**	1
I	**PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE**.....	3-10
II	HYRJE(Të dhena për Raportin Përfundimtar)	10-13
a	Objektivat dhe qëllimi.....	
b	Identifikimi i çështjes.....	
c	Pergjegjësia e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	
d	Përgjegjësitë e audituesëve.....	
e	Kriteret e vlerësimit	
f	Standardet e Auditimit	
II	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....**	13
III	**GJETJET DHE REKOMANDIMET.....**	13- 143
1.	Auditim mbi proçedurat e regjistrimit fillestar dhe pranimin e dokumentacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve", Ligji nr. 7699, datë 21.04.1993 "Për Kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës Bujqësore", i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin e Kompensimin e pronës i ndryshuar".	13-16
2.	Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimit të tokës bujqësore të përfituar nga Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën" i ndryshuar; Ligji nr. 8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", Ligji nr. 8312 datë, 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", për periudhën e adutimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona.	16-62
3.	Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga Privatizimi për periudhën e auditimit dhe transaksioneve të kryera me këtë pasuri sipas kontratave të shitblerjes të objekteve shtetërore nga (Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave dhe Pushteti Vendor) dh bazuar në kontratat e shitblerjes nga EKB.	62-69
4.	Auditim mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e objekteve me leje Legalizimi në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, Urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" të ndryshuar dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kritereve, proçedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm për kualifikimin e objekteve", i ndryshuar me VKM nr. 40, datë 11.01.2012. Regjistrimet përfundimtare të ndërtimeve të reja	70-87 87-103
5.	Auditim mbi procedurën e ndjekur për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga vendime gjyqësore të formës së prerë.	103-109
6.	Regjistrimi i pasurive Publike të transferuara dhe Administrimi i tyre.	109-114
7.	Mbi përputhshmërinë e aktivitetit financiar. Përdorimi efektiv i fondeve të buxhetit. Shkaqet e tejkalimeve dhe mosrealizimeve. Shkaqet e tejkalimeve dhe mosrealizimeve. Nxjerrja e përgjegjësive për deviacionet. Rakordimet që janë kryer me degën e thesarit për arkëtimet nga legalizimet. Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës(Pagat dhe shpërblimet). Administrimi, ruajtja, dokumentimi dhe qarkullimi i aseve dhe aktiveve. Prokurimet i fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime	115-120

8.	Të ndryshme dhe trajtimi i indiceve të ardhura nga qytetarë në KLSH	120-123
	Rekomandimet	123-143
IV	**KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT**	144-145
V	**ANEKSE**	146-149
VI	**DOKUMENTE SHOQËRUESE**	- -

I- PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.a. Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës(ZVASHK)(ish ZVRPP) Bulqizë nuk është audituar më parë nga institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, ndërsa është audituar çdo 3 vjet nga auditi i brendshëm i ZQRPP Tiranë, ku janë konstatuar mangësi e shkelje. Gjatë auditimit të kryer me zgjedhje për periudhën nga data 01.01.2017 deri me 31.12.2018 janë konstatuar mangësi e shkelje, që kanë ardhur kryesisht nga ndryshimet e shpeshta të drejtuesve dhe punonjësve të institucionit, shoqëruar me një nivel të ulët profesional dhe mungesë eksperience, si dhe nga një kuadër legjislativë me mangësi. Niveli i menaxhimit të veprimtarisë së subjektit nga strukturat drejtuese konstatohet në nivele jo të mjaftueshme që ka ardhur si rezultat i lëvizjeve të drejtuesve në kohë të ndryshme. Auditimi i përputhshmërisë së aktivitetit të ZVASHK(ish ZVRPP) Bulqizë paraqet një rëndësi në lidhje me informimin dhe evidentimin e shkeljeve për vendosjen e rekomandimeve në lidhje me përmirësimin e punës në të ardhmen.

I.b. Nga auditimi janë konstatuar një sërë shkeljesh e parregullsish, të cilat të ndara sipas fushave përkatëse, i përkasin kryesisht: Regjistrimit të tokës bujqësore të përfituar nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991; Regjistrimi dhe kryerja e transaksioneve për pasuritë e përfituar nga ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për Kthimin e kompensimin e pronave ish pronarëve"; Regjistrimi dhe kryerja e transaksioneve për pasuritë e përfituar nga privatizimi dhe kontratat e shitblerjes së pronave shtetërore(Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, Pushteti vendor); Regjistrimi i pasurive të përfituara me leje legalizimi, në bazë të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006; Regjistrimi i pasurive të përfituara me leje ndërtimi, në bazë të ligjeve të urbanistikës, të përmbledhura si më poshtë:

- Gjetje: ZVRPP Bulqize në **1 rast**, me referencës nr. 3060, ka regjistruar pasuri të paluajtshme *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi* dokumentacioni i origjinës së fitimit të pronësisë ***nuk është origjinal, rezulton fotokopje i panoterizuar*** dhe i pa konfirmuar nga institucioni që e ka lëshuar aktin administrativ(ATP). Gjithashtu regjistrimi i pasurisë ***truall me sipërfaqe 174 m^2***, është kryer në kundërshtim me Vendimin e KKKP-së Bulqizë nr. 7, datë 08.03.1994, i cili shprehet për njohje të pronësisë mbi truallin dhe jo për kthim fizik të tij, ***për rrjedhojë nuk duhet të procedohej me regjistrimin e pasurisë,*** sa vepruar ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë 2/117/3, volum 10, faqe 32, ZK 8612, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **5 raste** që i përkasin ZK 3694, Fshati Vajkal, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme për poseduesit e AMTP-ve përkatëse, me referencat: nr. 0943, nr. 0954, nr. 0840, nr. 0872, nr. 0868, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, lidhur me* regjistrimin e pasurive truall+ndërtesë në zonat urbane të fshatrave, pasi regjistrimi i pasurive truall+ndërtesë, është kryer në mungesë të ***dokumentit ligjor "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", që shërben si Titull Pronësie;*** sa vepruar **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 432, datë 14.08.1995"Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhërin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013.

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për në **5 rastet e**

sipërcitauara dhe në të gjitha rastet e ngjashme, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **4 raste,** që ju përkasin referencave: nr. 504, nr. 687, nr. 0943, ZK 3694 dhe nr. 415, ZK 1763, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme për poseduesit e AMTP-ve përkatëse, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore*, pasi është regjistruar në favor të poseduesve të AMTP-ve një sipërfaqe toke në total prej ***5790 m²,*** më tepër se sipërfaqja takuese sipas AMTP-së përkatëse, sa vepruar **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25 dhe pikën 2 neni 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe VKM nr.994, datë 09.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP).

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **4 rastet e sipërcituara**, të veçojë e regjistrojë "shtet" sipërfaqet e përfituara padrejtësisht, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe zbatimin e procedurave sipas VKM nr.994, datë 09.12.2015

- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në 2 **raste**, ju përkasin referencave: nr. 0840, ZK 3694 dhe nr. 376 ZK 1763, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme për poseduesit e AMTP-ve, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore*, pasi AMTP-të rezultojnë të korrigjuara, ***duke rritur fiktivisht sipërfaqen takuese dhe përfituar më tepër 5520 m²,*** ndërsa punonjësit e ZVRPP nuk duhet të kryenin veprime deri në konfirmimin zyrtar nga institucionet përkatëse, lidhur me vlefshmërinë ligjore të këtyre akteve, sa vepruar **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25 dhe pikën 2 neni 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe VKM nr. 994, datë0 9.12.2015.

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **2 rastet e sipërcituara**, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe zbatimin e procedurave sipas VKM nr.994, datë 09.12.2015.

- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **8 raste**, sipas referencave: nr. 017, 016, nr. 687, nr. 0943, nr. 840, nr. 872, nr. 859, nr. 868, ZK 3694 dhe nr. 0178, nr. 0173, ZK 1532, ka regjistruar pasuri të paluajtshme dhe ka kryer transaksione, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore*, pasi për një trung familjar janë lëshuar 2 e më shumë AMTP, duke shkelur kriterin e ndarjes së tokës sipas normës për frymë të çdo fshati, dhe ndarë tokë në mënyrë të pa barabartë, për rrjedhojë nga regjistrimi i tyre ***kanë përfituar më tepër në total tokë me sipërfaqe 89800 m²,*** se sipërfaqja takuese sipas normës për frymë, bazuar në përbërjen familjare me datë 01.08.1991, sa vepruar **në papajtueshmëri** me pikën 2 neni 3, të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" dhe në pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës", e ndryshuar, përsa i përket regjistrimit të pasurive tokë bujqësore të ndara me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar.

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **8 rastet e sipërcituara** deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipasi VKM nr.994, datë 09.12.2015, si dhe të dërgojë AMTP-të përkatëse, për vlerësim dhe shqyrtim ligjor nga institucionet përkatëse kompetente.

- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në 6 **raste** sipas referencave nr. 0173, nr. 092, nr. 105, nr. 101, nr. 097 dhe nr. 086, ZK 1532, ka regjistruar *pasuri në favor* të poseduesve të AMTP-ve përkatëse, ku konstatohet se në këto raste AMTP-të ***nuk mund të shërbejnë si Titull Pronësie, pasi*** pasuritë e regjistruara nuk janë të llojit "***tokë bujqësore***", për rrjedhojë në kundërshtim me dispozitat ligjore është tjetërsuar pasuria "shtet" me sipërfaqe totale ***18500 m²,*** që në KPP dhe regjistrat përkatës figuron e ***llojit***: ***"pyll", "truall" "livadh" dhe "kullotë",*** për të cilat në të gjitha rastet janë lëshuar certifikata pronësie ***për tokë arë***, ndërsa ZVRPP Bulqizë , nuk duhet të procedonte me

regjistrimin e pasurive përkatëse, deri në konfirmimin zyrtar nga institucionet përkatëse, veprim **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25, nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 2, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore ".

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **6 rastet e sipërcituara** dhe në çdo rast që konstatohet në vijimësi, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM-së nr. 994, datë 9.12.2015, si dhe të dërgojë AMTP-të përkatëse, për vlerësim dhe shqyrtim ligjor nga institucionet përkatëse kompetente.

- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **2 raste**, ka regjistruar pasuri të paluajtshme sipas AMTP nr. 26322, ZK 8612, qyteti Bulqizë dhe AMTP nr. 26640, ZK 1532, Fshati Dragua, të cilat ***janë lëshuar për persona që nuk janë përfitues të tokës,*** pasi nuk janë brenda juridiksionit që ushtron detyrën Komisioni i Ndarjes së Tokës në Fshat, kjo e vërtetuar me certifikatën e përbërjes familjare datë 1.08.1991, veprim **në papajtueshmëri me** pikën 2 neni 3, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, nenin 25/a, të ligjit nr.33/2012, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës".

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë e regjistruara sipas AMTP-ve: AMTP nr. 26322,(lëshuar në Fshatin Vajkal) regjistruar në ZK 8612 dhe AMTP nr. 26640, ZK 1532, Fshati Dragua, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr.994, datë 09.12.2015, si dhe të dërgojë AMTP-të përkatëse, për vlerësim dhe shqyrtim ligjor nga institucionet përkatëse kompetente.

Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **2 raste**, sipas referencave: nr. 016, nr. 017, ZK 3694, ka regjistruar pasuri të paluajtshme nr. 2012/1, *arë me sipërfaqe 5312 m^2*(e tjetërsuar) dhe nr. 2012/2, volum 13, faqe 152, ZK 3694, *arë me sipërfaqe 1856 m^2, në shkelje të dispozitave ligjore*, pasi regjistrimi i pasurive është kryer ***në mungesë të dokumentacionit që shërben si Titull Pronësie,*** **Sa vepruar në papajtueshmëri** me nenin 24, të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999.

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 2012/2, volum 13, faqe 152, ZK 3694, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor që shërben për fitimin e pronësisë.

- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur ***AMTP nr.*** 2641 ***është lëshuar dhe i përket ZK 3694 Vajkal (rurale) dhe është regjistruar në ZK8611 Bulqizë e re (urbane). Gjithashtu është ndryshuar zëri kadastral pronave që i shërbejnë një interesi publik nga Shesh në Arë***. Veprim në papajtueshmëri me shkronjën "e" neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", shkronjën "ç" pika 2.2, të VKM nr.994, datë 09.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr. 2, datë 12.09.2012.

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr.** 1/14/3 **volum 5 faqe 173,** volum 5 faqe 169 pasuria nr. 1/13/3 e llojit shesh me sipërfaqe 1645, volum 5 faqe 171 pasuria nr. 1/14/1 e llojit shesh me sipërfaqe 195, volum 5 faqe 155 pasuria nr.

1/13/2 e llojit shesh, volum 4 faqe 11 pasuria nr. 1/13 e llojit shesh **ZK 8611, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur ***AMTP nr.*** 117 ***është lëshuar dhe i përket ZK 3694 Vajkal (rurale) dhe është regjistruar në ZK8611 Bulqizë e re (urbane).*** Veprim në papajtueshmëri me shkronjën "e" neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", shkronjën "ç" pika 2.2, të VKM nr.994, datë 09.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr. 2, datë 12.09.2012.

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë** volum 5, faqe 209, pasuria nr. 1/191, volum 5 faqe 208 pasuria nr. 1/190 **ZK 8611, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur ***AMTP nr.*** 26723 ***i mungon nënshkrimi i kryetarit të komisionit të tokës në fshat si dhe nënshkrimi i përfituesit, gjithashtu është korrigjuar numri i aktit .*** Veprim në papajtueshmëri me shkronjën "e" neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", shkronjën "ç" pika 2.2, të VKM nr.994, datë 09.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi".

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë** volum 1, faqe 67, pasuria nr. 67, volum 7 faqe 190 nr.67/1 **ZK 1660, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur ***AMTP nr.*** 26729 ***ka korrigjime në përmbajtjen e saj, janë korrigjuar sipërfaqja totale dhe numri i aktit.*** Veprim në papajtueshmëri me shkronjën "e" neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", shkronjën "ç" pika 2.2, të VKM nr.994, datë 09.12.2015.

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë** volum 2, faqe 112, pasuria nr. 357, volum 7 faqe 211 pasuria nr. 357/1 **ZK 1660 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur nuk është bërë bilanci i sipërfaqes totale që përmban ***AMTP nr.*** 26729 ***me sipërfaqen e LN duke përfituar 1708 m^2 më tepër se akti i fitimit të pronësisë.*** Veprim në papajtueshmëri me shkronjën "e" neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", shkronjën "ç" pika 2.2, të VKM nr.994, datë 09.12.2015.

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë** volum 3, faqe 118, nr. 608 **ZK 1660, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

- Gjetje: ***Zyra vendore e ASHK(ish-ZVRPP)Bulqizë*** ka regjistruar pasuri bazuar në bazë të AMTP nr. 6463, pasuritë nr. 1200/4, v. 4, faqe 40 dhe p. 1200/1, v. 4, faqe 37 *në kushtet e mungesës së AMTP në favor të subjektit* privat [redacted] dhe ***në kushtet e mungesës së dokumentacionit ligjor të truallit dhe objekteve***, si dhe ka regjistruar transaksione, duke

regjistruar KSHB nr. 428/176, datë 23.03.1999 me shitës [redacted] etj. dhe Blerës [redacted] në kundërshtim me dispozitat ligjore të përcaktuara nga ligji 7501, datë 19.07.1991, i ndryshuar, me ligjin nr. 33/2012datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurisë së Paluajtshme" dhe rregulloren e ZRPP nr. 184, datë 08.04.1999 si dhe me dispozitat ligjore të përcaktuara nga VKM nr. 994, datë 05.09.2012.

Rekomandim: ***Zyra vendore e ASHK(ish-ZVRP), përgjegjësi i Zyrës*** të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara, të evidentuara sipas referencave ***0003, 0004, 0005, 0007 dhe AMTP nr. 6463, zona Kadastrale 3947*** si pasuri të përfituara padrejtësisht në kushtet e mungesës së dokumentacionit ligjor të truallit dhe objekteve, si dhe në kushtet e regjistrimit të KSHB nr. 428/176, datë 23.03.1999 me shitës [redacted] etj. dhe Blerës [redacted] në mungesë të origjinës së pronësisë duke i kërkuar njëkohësisht OQV, Bashkisë Bulqizë vënien në dispozicion e ***AMTP 6463 Origjinale,*** duke njoftuar subjektet e tjera DAMT e subjektin përfitues të AMTP, ***në zbatim të pikës 2 të VKM nr. 994, datë 09.12.2012 "kur pasuria figuron e regjistruar në ZVRPP", shkronjat a,b,c,ç dhe d.***

- Gjetje: ***Nga Zyra vendore e ASHK(ish-ZVRPP)Bulqizë*** nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes të pasurisë ***nr. 184/6, v. 1, faqe 40,*** regjistruar në emër të [redacted] sipas referencës ***nr. 0085,*** përfituar nga ligji e Privatizimit ***nr. 7512, date 10.08.1991*** me ndryshimet e mëvonshme. Sikurse evidentohet në këtë projektraport auditimi dhe Aktkonstatimin nr. 19, datë 31.05.2019 regjistruar njësia e privatizuar ***për 21.4 m2 pa u përcaktuar më pare marrëdhëniet e pronësisë,*** me kontratë qiraje apo kontratë shitje, si dhe nuk rezulton të jete paguar qira trualli nga koha e privatizimit të objektit dhe pas, në zbatim të rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999, Kreu IV-të pika 7 për regjistrimin e pasurive përfituar nga zbatimi i ligjit nr. 7512, datë 10.08.1991 i ndryshuar dhe VKM në zbatim te tij ku kërkohet KSHB për objektin, ndërmjet AKP dhe blerësit, Kontratë për mardhëniet me truallin, planvendosja dhe akti i dorëzimit të objektit.

Rekomandim: ***<u>Zyra Vendore ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë)</u>, Pergjegjësi i Zyrës*** të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë e regjistruar ***nr. 184/6, v.1, faqe 40,*** evidentuar sipas ***referencës 0085*** deri në përcaktimin e mardhënieve të truallit për objektin e privatizuar me kontratë qiraje apo kontratë shitje, ***në zbatim të rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Per regjistrimin e pasurisë së Paluajtshme".***

- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 4 raste** ka kryer veprime në (KPP) ***duke lëshuar certifikata pronësie mungon origjina e kësaj prone kontrata e shitblerjes, gjithashtu nga ana e specialistit nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***. Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës se regjistrimit te pasurive te paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr. 2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit.

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të marrë masa për të mos kryer veprime** për pasuritë: nr. 2/86+5-66, volum 1, faqe 196, ZK 8611, për pasurinë nr. 2/52+1-3, volum 3, faqe 149, nr. 2/86+4-48, volum 1, faqe 178, pasurinë nr. 2/86+1-7, volum 1, faqe 136, ZK 8611deri në përfundim të rivlerësimit të dokumentacionit, që ka shërbyer për fitimin e pronës.

- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **8 raste** që ju përkasin referencat : nr. 3092 dhe 3070, nr. 3074, nr. 3008, nr. 3011, nr. 2994, nr. 2913, ZK 8612 dhe nr. 887, nr. 913, ZK 3694, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme përfituar me leje legalizimi, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi* legalizimi

është kryer mbi objekte që rezultojnë të regjistruara në KPP, në pronësi "shtet", për të cilat nuk ka ndonjë akt administrativ të lëshuar nga organet përkatëse, apo vendim gjykate të formës së prerë, për tjetërsimin e objektit apo prishjen e tij, për rrjedhojë regjistrimi i pasurive të legalizuara, ka sjellë si pasojë ***fshirjen e të drejtës së pronësisë shtetërore për*** pasuritë ndërtesë me sipërfaqe totale ***1498 m^2, e cila do të konsiderohet si dëm i shkaktuar ndaj shtetit, në mungesë të dokumentacion argumentues,*** sa vepruar **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25 dhe pikën 3 neni 34 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi në 8 raste** për pasuritë sipas referencave të sipërcituara, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor që argumenton fshirjen e pasurive ndërtesë me sipërfaqe totale 1498 m^2 në pronësi "shtet".

- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **6 raste** që ju përkasin referencat : nr. 3092 dhe 3070, nr. 2974, nr. 2979, nr. 3068, nr. 2913, ZK 8612 dhe nr. 0385, ZK 1763, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme përfituar me leje legalizimi, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi lejet e legalizimit kanë miratuar parcela ndërtimore,* me sipërfaqe më tepër se sipërfaqja takuese sa trefishi i sipërfaqes së bazës së objektit, ndërsa *nga ZVRPP Bulqizë, nuk janë verifikuar elementët e formës e përmbajtjes së Aktit Administrativ të Lejes së Legalizimit në lidhje me sipërfaqen e parcelës ndërtimore,* për rrjedhojë është miratuar në favor të poseduesve të lejeve të legalizimit, më tepër ***trualli me sipërfaqe totale prej 524.2 m^2,*** sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën"a" neni 25, nenin 49, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 17 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar.

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi në 6 raste** për pasuritë sipas referencave të sipërcituara, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Gjithashtu në bashkëpunim me Sektorin e ALUIZNI-t, në Drejtorinë e ASHK Dibër, të ndiqen procedurat e lekujdimit me çmimin e tregut, për truallin e tepërt të përfituar padrejtësisht nga poseduesit e lejeve të legalizimit.

- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **1rast** me referencë nr. 0920, ZK 3694, ka regjistruar në volum 15, faqe 89, pasurinë nr. 2309-Nd, ndërtesë 3 kat me sipërfaqe ndërtimi 102.9 m^2, me funksion banimi, përfituar me leje legalizimi, ***e cila është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore****, pasi pasi trualli i miratuar si parcelë ndërtimore mbi të cilin ndodhet objekti i legalizuar, rezulton i shpornësuar më parë me VKM përkatëse*(pretendohet se nuk është objekt shpronësimi), ndërsa Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër nuk duhet të kryente legalizimin e objektit, si dhe nuk duhet të regjistrohej nga punonjësit e ZVRPP Bulqizë, sa vepruar **në kundërshtim me** shkronjën "a" neni 25, me pikën 5 nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar.

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 2309-Nd, volum 15, faqe 89, ZK 3694, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor apo konfirmimin zyrtar nga institucionet kompetente, që trualli nuk është objekt shpronësimi për interesa publike.

- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka ofruar shërbimi e kërkuar subjekti, në kushtet kur; Nga verifikimi i materialit hartografik dhe pozicionimit të pronës rezulton se objekti informal ***është hedhur në hartën e punës me konturet e kuqe dhe prek pjesërisht mbi pasurinë nr. 2/131 e llojit ndërtesë, pra krijohet mbivendosje kur behet azhurnimi në HTR të ZVRPP sipas hartës të***

përfunduar të ALUIZNIT. Veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", pika 5 e Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012.

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr.** 2/20/4-ND2 volum 5, faqe 240**, ZK 8611, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

- **Gjetje:** ZVRPP Bulqizë në 3 **raste** sipas referencave nr. 3114, 2573, 2938 dhe nr. 2935, 2934, ZK 8612, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme bazuar në dokumentacionin urbanistik, rezulton se regjistrimi ***është kryer me parregullsi dhe në mungesë të dokumentacionit urbanistik tekniko ligjor, si dhe në mungesë të marrëdhënieve me truallin***, ***sa vepruar*** në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, me pikën 2 nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012.

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi në 3 raste,** për pasuritë e regjistruara sipas referencave të sipërcituara, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor

- Gjetje: ***Nga Zyra vendore e ASHK(ish-ZVRPP)Bulqizë*** nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes të pasurisë, regjistruar në emër të [redacted] ***sipas referencave 0008 dhe 0094, dhe në emër të*** [redacted] ***sipas referencës nr. 0099, të përfituara nga Ligji i Urbanistikes nr. 8405, datë 17.09.1998 me ndryshimet e mëvonshme*** duke regjistruar Pasuritë në mungesë të dokumentacionit tekniko ligjor dhe pa u përcaktuar mardhëniet e truallit në kundërshtim me piken 12, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 " Për pasuritë e paluajtshme të fituara sipas ligjeve të urbanistikes në varësi të të viteve, veprim në papajtueshmëri me pikën 2-3, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012.

Rekomandim: ***<u>Zyra Vendore ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë),</u> Përgjegjësi i Zyrës*** të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2014 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara sipas ***referencave 0073, 0091, 0090 dhe 0104, sipas referencave 0008 dhe 0094, dhe sipas referencës nr. 0099, të përfituara nga Ligji i Urbanistikes nr. 8405, datë 17.09.1998 me ndryshimet e mëvonshme*** deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor të urbanistikës dhe përcaktimin e marrëdhënieve të pronësisë së truallit (me qira apo shitje), ***në zbatim të pikës 12, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999.***

- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***nuk përputhet sipërfaqja e sheshit të ndërtimit e përcaktuar në formularin nr. 2 e cila është 320 m^2 dhe kontratës së shitblerjes e cila është 152 m^2, duke regjistruar më pakë në kartela një sipërfaqe prej 168 m^2.*** Veprime këto në papajtueshmëri me "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25,pikën 1 neni 48, neni 59 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 "Për Urbanistikën", i ndryshuar.

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr.** 1/196/1 volum 5, faqe 236 **ZK 8611, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

II.c. *Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit*

Nga auditimi i përputhshmërisë mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, (INTOSAI-t), Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualet e Auditimit të Përputhshmërisë, i kryer në Zyrën Vendore ASHK(ish ZVRPP) Bulqizë, rezultuan devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi(kriteret), konkretisht:

- Aktiviteti i institucionit nuk ka qenë plotësisht efektiv në drejtim çështjeve që lidhen me vlerësimin e procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për regjistrim, veçanërisht në vlerësimin e përmbajtjes së dokumentacionit paraqitur për kryerje transaksionesh, regjistrime trojesh, regjistrime me leje legalizimi, regjistrime të ndërtimeve me leje ndërtimi, regjistrime me Aktet e Marrjes së Tokës Në Pronësi(AMTP) dhe transaksione ndryshimi pronësor, etj.
- Pamjaftueshmërinë në përmbushje të funksioneve si një institucion që ka impakt të lartë social dhe ndikon direkt në vlerësimin dhe opinionin e qytetarëve për qeverisjen e vendit. Auditimet më të shpeshtë dhe periodike do të ndikonin direkt në rritjen e mirëmenaxhimit të njësisë publike dhe mangësitë e evidentuara do të ishin minimizuar nga punonjësit e administratës së këtij institucioni.
- Janë regjistruar pasuri të paluajtshme dhe janë kryer transaksione, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore,* pasi është shkelur kriteri i ndarjes së tokës sipas normës për frymë të çdo fshati, për rrjedhojë nga regjistrimi i tyre *kanë përfituar më tepër tokë* se sipërfaqja takuese sipas normës për frymë, bazuar në përbërjen familjare me 1.08.1991, sa vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar.
- *Nuk është bashkëpunuar me Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Dibër, lidhur me konfirmimin zyrtar të statusit të parcelave ndërtimore të miratuara,* ndërsa nga ZVRPP Bulqizë është proceduar duke regjistruar dhe certifikuar pronësinë për poseduesit e lejeve të legalizimit, të cilat janë ndërtuar mbi objekte që figurojnë në pronësi "shtet", të regjistruara në KPP.
- Janë kryer regjistrime me *shkelje të dispozitave ligjore*, pasi *mungon dokumentacioni tekniko ligjor*, konkretisht: mungon akti i fitimit të pronësisë mbi truallin; *mungon konfirmimi* zyrtar nga institucionet përkatëse, lidhur me shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga përdorimi i truallit në pronësi "shtet", gjithashtu marrëdhëniet me truallin nuk janë sipas ligjit, etj.
- Janë kryer regjistrime të pasurive të përfituara me AMTP, me *shkelje të dispozitave ligjore, pasi janë regjistruar pasuri që nuk janë të llojit tokë bujqësore, për të cilat AMTP-ja nuk mund të shërbejë si Titull Pronësie.*

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur të KLSH nuk u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale për të cilin japim Opinion të Pakualifikuar dhe për përmirësimin e gjendjes i janë rekomanduar Zyrën Vendore ASHK(ish ZVRPP) Bulqizë marrja e masave përkatëse.

II-Hyrje

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin ne e Kontrollit të Lartë të Shtetit, (këtu e në vazhdim KLSH) në zbatim të programit të auditimit nr. 207/1, datë 01/04/2019, miratuar nga N/Kryetari i KLSH u krye auditimi në Zyrën Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës(ASHK) Bulqizë(ish ZVRPP), nga data 01.04.2019 deri më datë 31.05.2019 për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datë 31.12.2018 (për probleme të veçanta me indicie, auditimi është shtrirë edhe në periudhat e mëparshme) "Mbi procedurën e pranimit dhe administrimit të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve", nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. L. K. (përgjegjës grupi)
2. A. M. Auditues

3. D. M. Auditues
4. H. K. Auditues

Nga grupi i auditimit u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit mbi përputhmërinë dhe rregullshmërinë e aktivitetit të Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës(ASHK) Bulqizë, *"Mbi procedurën e pranimit dhe administrimit të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme dhe transaksionet e kryera, si dhe vlerësimin zërave kryesorë financiarë"*, në tre kopje nga të cilat, dy kopje i dërgohen Zyrës Vendore të ASHK, Bulqizë dhe një kopje protokollohet në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

a) Objektivat dhe qëllimi:

Objektivat: Vlerësimi i aktivitetit të institucionit lidhur me procedurën e pranimit dhe administrimit të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme dhe evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve, performancën e punës në përmbushje të rritjes së transparencës së zyrës lidhur me shërbimin ndaj pubikut në lidhje zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë apo objektivave të përcaktuara me ndonjë plan strategjik zhvillimi afat shkurtër, apo afat mesëm të shkruar, në zbatim të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 *"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme"*, i ndryshuar.

Qëllimi: KLSH nëpërmjet një pune audituese sistematike dhe me zgjedhje të evidentojë deviacionet nga zbatimi i dispozitave ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 33/2012, datë 21.03.2012 dhe aktet e tjera ligjore apo nënligjore, mangësitë, shkeljet dhe parregullsitë si në drejtim të *procedurave të pranimit dhe administrimit të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme,* ashtu edhe në zbatimin e procedurave ligjore *për transaksionet e kryera,* lidhur me tarifat e aplikimit, përllogaritjes së tatimit të kalimit të pronësisë, nga strukturat e subjektit të audituar me qëllim, që auditimi ti shërbej subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës për të ardhmen, si dhe për të bërë të mundur që menaxherët e ZVASHK-së Bulqizë, të kuptojnë nevojën e domosdoshme të një strukture kompetente e cila do të bënte të mundur evidentimin në kohë të mangësive e shkeljeve me qëllim marrjen e masave në një kohë sa më të shpejtë për përmirësimin e gjendjes.

b) Identifikimi i çështjes.

1. Auditimi mbi procedurat e regjistrimit fillestar dhe pranimin e dokumentacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish- pronarëve", ligji nr. 7699, datë 21.4.1993 "Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore", i ndryshuar, dhe ligji nr. 9235 datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" i ndryshuar, për periudhën e auditimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona.

2. Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimit të tokës bujqësore të përfituar nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën" i ndryshuar; ligji nr. 8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", ligji nr. 8312 datë, 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", për periudhën e auditimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona(bashkëpunimi dhe korrespodenca me KVVTP pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër).

3. Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga privatizimi, për periudhën e auditimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona:

a. Sipas kontratave të shitblerjes të objekteve shtetërore nga (Ministria e Ekonomisë dhe Pushteti Vendor).

b. Sipas kontratave të shitblerjes me EKB-në.

4. Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e objekteve me leje legalizimi në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kritereve , të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm , për të kualifikuar objektet në ndërtim që

legalizohen ose jo , i ndryshuar dhe VKM 40, datë 11.01.2012, për periudhën e auditimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona. Regjistrimet përfundimtare të ndërtimeve të reja.
5. Auditimi mbi procedurën e ndjekur për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga vendime gjyqësore të formës së prerë.
6. Regjistrimi i pasurive publike të transferuara dhe administrimi i tyre.
7. Auditim mbi përputhshmërinë e aktivitetit financiar të institucionit.
Përdorimi efektiv i fondeve të buxhetit. Shkaqet e tejkalimeve dhe mos realizimeve. Nxjerrja e përgjegjësive për deviacionet. Rakordimet që janë kryer në degën e Thesarit për arkëtimet. Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës(pagat, shpërblimet, etj). Administrimi, ruajtja, dokumentimi dhe qarkullimi i aseteve dhe aktiveve. Prokurimi i fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime.
8. Të ndryshme dhe trajtimi i indicieve të ardhura nga qytetarë në KLSH.

c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:
Strukturat drejtuese të subjektit ZVASHK Bulqizë, mbajnë përgjegjësi për shkeljet dhe problematikat e konstatuara sipas çështjeve nën auditim, në lidhje me pranimin, regjistrimin dhe transaksionet e pasurive, kryer me mangësi dhe në shkelje të dispozitave ligjore, të përcaktuara nga ligji nr.33/2012, datë 29.04.2012 dhe të akteve ligjore e nënligjore të tjera, të evidentuara në akt-konstatimet e mbajtura dhe në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.
d) Përgjegjësitë e audituesve:
Për problematikat e trajtuara lidhur me çështjet nën auditim pikat 1,2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, etj në lidhje me pranimin dhe regjistrimin e pasurive dhe transaksionet e kryera, u konstatuan mangësi e shkelje në zbatim të ligjit nr.33/2012, datë 29.04.2012 dhe aktet nën ligjore në zbatim të tij, si dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore, duke ngarkuar me përgjegjësi kryesisht strukturat drejtuese të subjektit. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, në zbatim të këtyre standardeve janë respektuar kërkesat etike, si dhe është planifikuar dhe kryer auditimi, duke arritur nivelin e sigurisë së kërkuar.
e) Kriteret e vlerësimit:
Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit, në referencë me problematikën, është patur si kriter vlerësues në radhë të parë ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ligji nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar me ligjin nr**.** 33/2012 **"**Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve"; ligji nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar; ligji nr. 7699, datë 21.4.1993 "Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore", i ndryshuar, ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën"; ligji nr. 8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore"; ligji nr. 8312 datë, 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara"; udhëzimi i MBU nr. 106, datë 23.02.1996 "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore" dhe VKM nr. 161, datë, 08.04.1993 "Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr. 452, datë 17.10.1992 "Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore"; ligji nr. 7980, datë 27.07.1995 "Për shitblerjen e trojeve"; ligji nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën", i ndryshuar; VKM nr. 315, datë 24.04.2003 dhe nr. 162, datë 07.03.2007 "Për dhënien me qira ose enfiteozë të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore", i ndryshuar; VKM nr. 35, datë 24.01.2007 "Për procedurat dhe format e shitjes së truallit, të pajisur me infrastrukturë për qëllime tregu"; VKM nr. 169, datë 13.03.2003 dhe nr. 703, datë 11.10.2006 "Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore apo të objekteve të veçuara, që i nënshtrohen privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregtare"; VKM nr. 704, datë 11.10.2006 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe për procedurën e shitjes"; VKM nr. 286, datë 2.6.2000 "Për kriteret e blerjes dhe shitjes së apartamenteve nga EKB në tregun e lirë të banesave"; ligji nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të

paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore"; ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat"; ligji nr. 8379, datë 29.07.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit"; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006"Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm , për të kualifikuar objektet në ndërtim që legalizohen ose jo , i ndryshuar dhe VKM 40, datë 11.01.2012, ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"; si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në ndryshim dhe zbatim të tyre.

f) Standardet e auditimit

Auditmi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara, si rrjedhojë edhe Raporti Përfundimtar është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI dhe sigurohet se auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara.

III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT:

1. ZVASHK Bulqizë mbulon me aktivitet një territor *që shtrihet në 65 zona kadastrale,* nga të cilat *2 zona urbane*(qyteti Bulqizë) dhe 63 *zona kadastrale fshat,* nga këto kanë kaluar në sistem regjistrimi fillestar 54 zona kadastrale, ndërsa 3 zona janë në proces regjistrimi, ndërsa 8 zona kadastrale nuk kanë kaluar në sitem regjistrimi. Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk e ka audituar më parë këtë subjekt dhe gjatë auditimit të kryer me zgjedhje për periudhën nga data 01.01.2017 deri me 31.12.2018 janë konstatuar mangësi e shkelje, që kanë ardhur kryesisht nga ndryshimet e shpeshta të drejtuesve dhe punonjësve të institucionit, si dhe nga një kuadër legjislativ me mangësi. Kjo ka sjellë si pasojë edhe një nivel të ulët të menaxhimit të veprimtarisë së subjektit. Auditimi i përputhshmërisë së aktivitetit të ZVASHK Bulqizë paraqet një rëndësi në lidhje me evidentimin e shkeljeve, për vendosjen e rekomandimeve, me qëllim përmirësimin e punës në të ardhmen.

2. Objekti i këtij auditimi është përputhshmëria e veprimeve të ndërmarra nga ZVASHK(ish ZVRPP) Bulqizë, për regjistrimin e pasurive, në zbatim të akteve administrative lëshuar nga organet që e kanë në kompetencë dhe vendimeve të gjykatave të formës së prerë, si dhe përmbushja e detyrave dhe sjellja me integritet e punonjësve të ZVASHK(ish ZVRPP) Bulqizë, për periudhën objekt auditimi, në raste të veçanta edhe para kësaj periudhe.

3. Qëllimi i auditimit***:*** është dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime.

4. Fushëveprimi: Auditimi është shtrirë në masën 20 % të veprimeve të kryera nga ZVRPP duke audituar dokumentacionin me zgjedhje të specifikuar në zona kadastrale dhe sipas regjistrave kadastral, pa u kufizuar gjatë auditimit.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Auditim mbi procedurat e regjistrimit fillestar dhe pranimin e dokumentacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve", Ligji nr. 7699, datë 21.04.1993 "Për Kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës Bujqësore", i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin e Kompensimin e pronës i ndryshuar".

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit **nr.** ***207/1, datë 01.04.2019***, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Kartelat e pasurive të paluajtshme dhe dokumentacioni përkatës që ndodhet në dosjet e audituara me zgjedhje, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet që:

1. Nga ana e ZVRPP Bulqize nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas nenit 25/a, nenit 45, të të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", pasi **në 1 rast** është

regjistruar pasuria ***truall me sipërfaqe 174 m²***, bazuar në Vendimin e KKKP-së Bulqizë, i cili ka prcaktuar njohje të pronësisë mbi truallin dhe jo kthim fizik të tij, për rrejdhojë ky Vendim i KKKP-së Bulqizë, nuk mund të shërbejë si Titull pronësie,
referuar përcaktimeve ligjore, përcaktohet:
Në shkronjën "a" neni 25, përcaktohet:

Regjistruesi, ose çdo grup i ngarkuar, kërkojnë që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen në bazë të kritereve të mëposhtëme:
a)pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtëshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë, sipas nenit 193 të Kodit Civil"

Në pikën 2 të nenit 45, përcaktohet:

"Regjistrimi i fitimit të pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme, sipas këtij neni, bëhet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pas plotësimit të kushteve të regjistrimit, të përcaktuara në shkronjën "h" dhe në paragrafin fundit të nenit 193 të Kodit Civil"

- Referencë nr. 3060; 3012 dhe 2614;

Me aplikim nr. 258, datë 28.02.2018[redacted] ka kërkuar korrigjim gabimesh në kartelë, i cili është në vazhdim të aplikimit nr. 557, datë 13.08.2013, për e pasurinë së përfituar sipas kontratës së shitblerjes së objektit nga Ministria e Financës, për personat si ish pronar të truallit, bazuar në vendimin e vendimit të KKKP-së Bulqizë nr. 7, datë 08.03.1994 dhe pajisjen me certifikatë pronësie.
Në KPP volum 10, faqe 32, është regjistruar pasuria nr. 2/117/3, truall me sipërfaqe 174 m², në pronësi të 6 trashëgimtarëve të [redacted], lëshuar certifikatë pronësie datë 01.03.2018, regjistruar për herë të parë në regjistrat e pasurive.
Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se regjistrimi i pasurisë truall rrjedh nga vendimit të KKKP-së Bulqizë nr. 7, datë 08.03.1994, ku përcaktohet njohje e sipërfaqes prej 5467 m², si truall i zënë nga këto objekte: Banka e Shtetit dega Bulqizë(më pas godinë e ish SHIKUT), Çerdhe e fëmijëve, Banesa familjare dhe një objekt i pa përfunduar dhe ky vendim nuk shprehet as për njohje e as për kompensim të ish pronarëve. Vendimi i KKKP-së Bulqizë nr. 7, datë 08.03.1994, sëbashku me genplanin shoqërues nuk janë origjinal por fotokopje të panoterizuar. Me referencë nr. 2614, datë 19.08.2013, është bërë regjistrimi i objektit me sipërfaqe 174 m², i cili është përfituar me kontratë shitje nr. 4517 Rep, 932 Kol. , datë 26.07.2013, palë shitëse Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së pronave publike, pranë Ministrisë së Financave, me objekt shitje kati parë i godinës së Ish SHIKU-t, ndërsa trualli me vendimin e KKKP-së.
Duke ju referuar dokumentacionit gjendje në dosjet me referenca 3060, 3012 dhe 2614, rezulton se privatizimi i objektit dhe regjistrimi i pasurive truall dhe ndërtesë, është kryer me shkelje dhe parregullsi, pasi:
- Dokumentacioni ligjor që ka shërbyer si origjinë për pronën e fituar, rezulton fotokopje i panoterizuar dhe i pa konfirmuar nga institucioni që e ka lëshuar aktin administrativ, që në këtë rast ka qenë Agjencia e Trajtimit të Pronës.
- Duke ju referuar Vendimit të KKKP-së Bulqizë nr. 7, datë 08.03.1994, rezulton se nuk shprehet për kthim fizik të truallit, por vetëm për njohje si pronar të tij, duke mos përcaktuar saktë se cila sipërfaqe është e lirë, por vetëm ka përcaktuar objektet përkatëse që kanë zënë këtë sipërfaqe që i njihet ish pronarit.
Sa trajtuar arrijmë në konkluzionin se, regjistrimi i pasurisë është kryer më shkelje të dispozitave ligjore, sa vepruar në ***papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe vendimit të KKKP-së Bulqizë nr. 7, datë 08.03.1994.

Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuar më sipër ***ngarkohet me përgjegjësi*** Sh. A., me detyrë Regjistrues dhe D. H., me detyrë specialisti jurist.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
Nenin 25, të Ligjit 33, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme";
Nenin 4, të ligjit nr. 9235, date 29.7.2004 "Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës", i ndryshuar;
UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Nenin 4, të ligjit Nr. 7698, datë 15.4.1993 "Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave ish-Pronarëve", i ndryshuar, shfuqizuar.

Lidhur sa trajtuar në faqet 7-8 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-Konstatimin nr. 13, datë 31.05.2019, janë paraqitur observacionet në rrugë elktronike dhe derguar me shkresen nr. 13.06.2019, të cilat kanë ardhur në KLSH bashkëlidhur me shkresën nr. 737/3, datë 04.07.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 207/3, datë 08.07.2019, të cilat janë përmbledhur nga Përgjegjësi i Zyrës dhe dërguar prej tij, ku sqarohet:
Lidhur me konstatimet që i përkasin referencave nr. 3060, 3012, 2614, ku ju konstatoni se Vendimi KKKP –nr.7 dt.8.3.1994 rezulton se nuk shprehet për kthim fizik te truallit por vetëm për njohje si pronar të tij duke mos përcaktuar saktë se cila sipërfaqe është e lirë,por vetëm ka përcaktuar objektet përkatëse qe kane zëne ketë sipërfaqe qe i njeh ish pronarit", sqarojmë se: ZVRPP nuk ka regjistruar kete vendim qe citoni ne keto referenca, dhe as eshte i regjistruar ky vendim ne asnje kartele ne Zyren tone, sepse ne referencat e sipercituara ZRPP-Bulqize ka regjistruar kontraten nr 4517 Rep. nr. 932 Kol dt.26.7.2013, percjellur per regjistrim nga min e Financave me nr.12030 dt. 29.7.2013 me percaktim "Shitje objekti se bashku me truallin" me sipërfaqe 174 m2 trualli dhe 174 m2 objekti. Këtë ka regjistruar Zyra e regjistrimit kurse Vendimi i KKKP nr. 7 që citoni ka qëne si fotokopje shoqëruese e kontratës se shitjes se Mininistrisë Financave që cituam dhe që mund ti ketë shërbyer këtij institucioni si dokument mbështetës në hartimin e kontrates se mësipërme. Pra ky vendim që ka qenë prezent në këtë dosje nuk është regjistruar dhe ka ndodhur keq kuptim nga ana juaj.(Bashkëlidhur po ju përcjellim dokumentin e regjistrimit që është bërë në këtë rast që siç sqaruam është kontrata e shitjes nga Ministria e Financave nr.4517 Rep. Nr.932 kol dt.26.7.2013.)
Sqarimi i Grupit të auditimit:
Lidhur me observacionet e paraqitur, të sipërcituar, nuk merren në konsideratë pasi, nuk janë paraqitur argumente dhe prova të reja. Lidhur me argumentet e paraqitura nga ana juaj, se ZRPP-Bulqize ka regjistruar kontratën nr 4517 Rep. nr. 932 Kol, dt.26.7.2013, percjellë për regjistrim nga min e Financave, me përcaktim "Shitje objekti se bashku me truallin" me sipërfaqe 174 m^2 trualli dhe 174 m^2 objekti, sqarojmë se pikërisht në këtë kontratë, në nenin 2, "objekti i kontratës", përcaktohet se objekti i kësaj kontrate është kalimi në pronësi i objektit "ish SHIKU", kati i parë në administrim të Bashkisë Bulqizë, me sipërfaqe totale 174 $m^{2,}$ nga e cila nën objekt trualli me sipërfaqe 174 m^2, sipas Vendimit të KKKP-së Bashkia Bulqizë datë 08.03.1994. Gjithashtu tek neni 4, "Çmimi i shitjes", ka përcaktuar çmimin e shitjes së objektit në vlerën 2,112,152 lekë dhe nuk përmendet fare vlera e truallit., duke e konsideruar të përfituar me vendimin e KKKP. Si përfundim, nisur nga faktet dhe dokumentet e disponueshme, grupi i auditimit sqaron se observacioni i paraqitur nuk merret në konsideratë dhe konstatimet tona mbeten të pa ndryshuara.

Gjetje: ZVRPP Bulqize në **1 rast**, me referencës nr. 3060, ka regjistruar pasuri të paluajtshme *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi* dokumentacioni i origjinës së fitimit të pronësisë ***nuk është origjinal, rezulton fotokopje i panoterizuar*** dhe i pa konfirmuar nga institucioni që e ka lëshuar aktin administrativ(ATP). Gjithashtu regjistrimi i pasurisë ***truall me sipërfaqe 174 m^2***, është kryer në kundërshtim me Vendimin e KKKP-së Bulqizë nr. 7, datë 08.03.1994, i cili

shprehet për njohje të pronësisë mbi truallin dhe jo për kthim fizik të tij, ***për rrjedhojë nuk duhet të procedohej me regjistrimin e pasurisë,*** sa vepruar në ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe pikën 3 të vendimit të KKKP-së Bulqizë nr. 7, datë 08.03.1994.
Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë 2/117/3, volum 10, faqe 32, ZK 8612, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

2. Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimit të tokës bujqësore të përfituar nga Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën" i ndryshuar; Ligji nr. 8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", Ligji nr. 8312 datë, 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", për periudhën e adutimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona dhe bashkëpunimi dhe korrespodenca me KVTP pranë institucionit të Prefektit Dibër.

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni përkatës për regjistrimin e tokës bujqësore, si më poshtë:
Kartelat e pasurisë paluajtshme, sipas regjistrave përkatës, nga ku ZK 3694 i përkasin 15 regjistra(volume), ZK 1763, i përkasin 7 regjistra(volume) dhe ZK 1532, i pëerka sin 7 regjistra(volume), libri i ngastrave dhe libri i pronave dhe pronarëve, si dhe LN printimi III;
Dokumentacioni sipas inventarizimit bashkëlidhur referencave përkatëse, deklarata noterale, dëshmi trashëgimnie, kontrata pjesëtimi si shkresat konfirmuese, etj.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit mbi regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituar nga ligji nr. 7501, datë 17.09.1991 "Për tokën", të ndryshuar, u përzgjodhën për auditim rreth *80 referenca*, nga të cilat u konstatua se *20 raste* u konstatuan shkelje e parregullsi, lidhur me regjistrimin dhe transaksionet e kryera me pasuri të përfituara me Aktet të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) , duke lëshuar certifikata pronësie, trajtuar si më poshtë:

1. Nga ana e ZVRPP Bulqizë nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin nr. 33/2012, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme'', neni 25 germa "a" dhe neni 45 pika 2, përsa i përket regjistrimit të pasurive të paluajtshme bazuar në akte pronësie AMTP, pasi ***në 4 raste,*** është regjistruar në favor të poseduesve të AMTP-ve, tokë me sipërfaqe totale **prej 5790 *m²*,** më tepër se sipërfaqja takuese e përcaktuar në AMTP-të përkatëse.
2. Nga ana e ZVRPP Bulqizë nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas nenit 25/a, nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjit 7501, 19.07.1991, i ndryshuar, VKM nr. 432, datë 14.08.1995"Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhërin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013, përsa i përket regjistrimit të trojeve dhe ndërtesave në zonat urbane të fshatrave, pasi **në 5 raste** të konstatuara, ka ndodhur regjistrimi i pasurive truall+ndërtesë, duke kaluar truallin me sipërfaqe totale prej ***1810 m²***, si dhe pasuritë ndërtesë me sipërfaqe totale ***948 m²,*** nga të cilat ***në 3 raste,*** *janë regjistruar për të njëjtën familje 2 e më shumë pasuri truall dhe ndërtesë,* në pronësi të poseduesëve të AMTP-ve dhe ***në mungesë të dokumentit ligjor "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", që shërben si Titull Pronësie;***
3. Nga ana e ZVRPP Bulqizë nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin nr. 33/2012, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme'', neni 25 germa "a" dhe neni 45 pika 2, përsa i përket regjistrimit të pasurive të paluajtëshme bazuar në akte pronësie, që nuk

plotësojnë kërkesat ligjore për të shërbyer si të tillë, pasi në **2 raste** janë korrigjuar AMTP-t, duke rritur fiktivisht sipërfaqen takuese dhe përfituar **më tepër 5520 *m²*,**
Referuar *germa "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ku përcaktohet*:

Regjistruesi, ose çdo grup i ngarkuar, kërkojnë që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen në bazë të kritereve të mëposhtëme:
a)pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë, sipas nenit 193 të Kodit Civil"

Referuar pikës 2 të nenit 45, përcaktohet:

"Regjistrimi i fitimit të pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme, sipas këtij neni, bëhet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pas plotësimit të kushteve të regjistrimit, të përcaktuara në shkronjën "h" dhe në paragrafin fundit të nenit 193 të Kodit Civil"

4. Nga ana e ZVRPP Bulqizë nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore e nën ligjore, të bëra në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, neni 3 pika 2 dhe në pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës", e ndryshuar, përsa i përket regjistrimit të pasurive tokë bujqësore të ndara me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar, pasi për një trung familjar janë lëshuar 2 e më shumë AMTP, duke shkelur kriterin e ndarjes së tokës sipas normës për frymë të çdo fshati dhe ndarë tokë në mënyrë të pa barabartë, për rrejdhojë në **8 raste** të konstatuara, është regjistruar në favor të poseduesve të AMTP-ve, një sipërfaqe toke totale prej ***89830 m²***, më tepër se sipërfaqja takuese e ndarë sipas normës për frymë.
Referuar *pikës 2 neni 3, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008" Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", ku përcaktohet*:

2. Titujt e pronësisë mbi tokën bujqësore janë të vlefshëm vetëm kur janë krijuar në përputhje me:
a) -----";
b) kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 255, datë 2.8.1991 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore", të ndryshuar;

Në pikën 2, të VKM nr. 255, përcaktohet:

2-*Ne te gjitha rastet toka ndahet Përpjesëtimisht Për çdo familje sipas numrit te frymëve te gjendjes civile ne datën 1 gusht 1991.*

5. Nga ana e ZVRPP Bulqizë nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në germën "d" pika 1, të UKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP)", përsa i përket regjistrimit të pasurive të paluajtshme bazuar në akte pronësie AMTP, lidhur me rastet ku zëri kadastral në KPP, ndryshon nga zëri kadastral që përmban AMTP-ja përkatëse, pasi në **2 raste** janë regjistruar pasuri tokë bujqësore, me sipërfaqe totale ***19500 m²***, ku konstatohet se zëri kadastral që përmban AMTP-ja përkatëse, është "moçalishte", duke u regjistruar në KPP tokë arë, ndërsa ZVRPP Bulqizë, nuk duhet të procedonte me regjistrimin e pasurive përkatëse, por duhet ti drejtohej KVVTP pranë Prefekturës së Qarkut Dibër, për të konfirmuar vlefshmërinë ligjore të AMTP-ve(ky konstatim vlen edhe për AMTP-të e tjera që i përkasin Fshatit Dragua).
Referuar *germa "d" pika 1, të UKM 994, ku përcaktohet*:

d) Përputhjen e llojit të pasurisë së disponuar me AMTP-në me ndonjërën nga llojet e pasurive të kadastruara në zërin "Tokë bujqësore", më 1.8.1991, të përcaktuara në shkronjën "a", të nenit 1, të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", të ndryshuar;

6. Nga ana e ZVRPP Bulqizë nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në germën "b" pika 5, të UKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në

Pronësi(AMTP)", përsa i përket regjistrimit të pasurive të paluajtshme bazuar në akte pronësie AMTP, lidhur me rastet ku zëri kadastral në KPP, ndryshon nga zëri kadastral që përmban AMTP-ja përkatëse, pasi në **6 raste** janë regjistruar pasuri tokë bujqësore, me sipërfaqe totale ***18500 m²***, ku rezulton se zëri kadastral që përmban AMTP-ja përkatëse, është i ndryshëm me zërin kadastral që pasqyrohet në KPP, ndërsa ZVRPP Bulqizë , nuk duhet të procedonte me regjistrimin e pasurive përkatëse, deri në konfirmimin zyrtar nga institucionet përkatëse.
Referuar *germa "b" pika 5, të UKM 994, ku përcaktohet*:

5." Në çdo rast, nëse ZVRPP-ja konstaton se lloji i pasurisë "tokë bujqësore" (arë, vreshtë, ullishtë, pemishte), dhënë me AMTP, nuk përputhet me llojin e pasurisë që figuron e regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme, me nismën e vet apo me kërkesë të mbajtësit të titullit të pronësisë, kërkon informacion nga DAMT-i, pranë këshillit të qarkut, për zërin kadastral të ngastrës, sipas regjistrave kadastralë më datë 1.8.1991".

7. Nga ana e ZVRPP Bulqizë nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore e nën ligjore, të bëra në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, neni 3 pika 2, në ligjin nr. 33/2012, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme'', neni 25 germa "a" dhe në pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës", e ndryshuar, përsa i përket regjistrimit të pasurive tokë bujqësore të ndara me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar, pasi në **2 raste,** janë regjistruar AMTP, të cilat janë lëshuar për persona që nuk janë përfitues të tokës, pasi nuk janë brenda juridiksionit që ushtron detyrën Komisioni i Ndarjes së Tokës në Fshat, kjo e vërtetuar me certifikatën e përbërjes familjare datë 1.08.1991.
Referuar *pikës 2 neni 3, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008" Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", ku përcaktohet*:

2. Titujt e pronësisë mbi tokën bujqësore janë të vlefshëm vetëm kur janë krijuar në përputhje me:
a) -----";
b) kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 255, datë 2.8.1991 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore", të ndryshuar;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
- Referencë nr. 0504
Me kërkesë nr. 1163, datë 09.10.2018, [redacted] ka kërkuar lëshimin e certifikatës së pronësisë për pasurinë nr. 317/2, volum 2, faqe 90, pasuri e përfituar sipas Aktit të Marrjes së Tokë në Pronësi(AMTP) nr 26335, pa datë, lëshuar në emër të [redacted], ZK 3694 Fshati Vajkal.
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, sipas regjistrimit fillestar rezultojnë të regjistruara këto pasuri:
Nr. 317/2, vol. 2 faqe 90, pemëtore me sipërfaqe 2343 m²(sipas LN), ndërsa sipas aktit 1304 m², në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], lëshuar certifikatë pronësie me datë 16.10.2018, specialisti që ka kryer veprimet në kartelë nuk ka nënshkruar.
Nr. 296, vol. 2, faqe 68, arë me ***sipërfaqe 1375m²***(sipas LN) , në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], lëshuar certifikatë pronësie me datë 10.06.2013, e cila me referencë nr. 504 datë 14.06.2013, është tjetërsuar me kontratë shitje
Nr. 306, vol. 2, faqe 78, arë me ***sipërfaqe 2170 m²***(sipas LN) , në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], lëshuar certifikatë pronësie me datë 10.06.2013, e cila me referencë nr. 504 datë 14.06.2013, është tjetërsuar me kontratë shitje
Nr. 2540, vol. 11, faqe 99, arë me ***sipërfaqe 625 m²***(sipas LN) , në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], nuk janë kryer veprime.
Nr. 2575, vol. 11, faqe 135, arë me ***sipërfaqe 2412 m²***(sipas LN) , në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], nuk janë kryer veprime.

Duke ju referuar AMTP-së, rezulton se kjo familje bujqësore ka përfituar në total ***6892 m²,*** tokë bujqësore.
Veprimet e më sipërme që lidhen me referencën nr. 504, datë 14.06.2013, janë kryer nga R. Sh., me detyrë specialist hartograf, ndërsa veprimet për lëshimin e certifikatës për pasurinë 317/2, janë kryer nga [redacted], me detyrë specialist jurist..
Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:
- Në dosje mungon certifikata që tregon gjendjen familjare deri me 01.08.1991, siç përcaktohet në UKM Nr. 994, datë 9.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP)",
- Gjithashtu familja bujqësore poseduese e AMTP nr. 26335 ka përfituar më tepër se sa përcaktuar në aktin e pronësisë sipërfaqen prej 2030 m²[8920 m² (sip. e regjistruar në KPP)-6890 m²(sip. në AMTP)], për të cilën mungon akti i fitimit të pronësisë, ndërsa nga punonjësit e ZVRPP-së, janë kryer veprime duke lëshuar certifikatë pronësie, duke mos i dërguar pushtetit vendor relacionin përkatës, siç përcaktuar në UKM Nr. 994, datë 9.12.2015, pikën 2.2/c.
Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", UKM Nr. 2, datë 13.06.2013 "Për Mënyrën e Procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme, të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (amtp)", pikën 2.2, germa b/iii UKM Nr. 994, datë 9.12.2015,
Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** Sh. A. me detyrë ish regjistrues, D. H. me detyrë specialist jurist,
- Referencë nr. 687
Me kërkesë nr. , datë , ka kërkuar lëshimin e certifikatës së pronësisë për pasurinë nr. 689, volum 3, faqe 218, pasuri e përfituar sipas Aktit të Marrjes së Tokë në Pronësi(AMTP) nr 26521, pa datë, lëshuar në emër të [redacted].
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, sipas regjistrimit fillestar rezultojnë të regjistruara këto pasuri:
Nr. 689, vol. 3, faqe 217, arë me sipërfaqe 1320 m²(sipas LN), në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], lëshuar certifikatë pronësie me datë 16.10.2018, specilaisti që ka kryer veprimet në kartelë D. H.
Nr. 634, vol. 3, faqe 160, arë me ***sipërfaqe 5848 m²***(sipas LN) , në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], me referencë nr. 687, datë 05.06.2015, është regjistruar dëshmi trashëgimie, nuk është lëshuar certifikatë pronësie.
Nr. 635, vol. 3, faqe 161, arë me ***sipërfaqe 3625 m²***(sipas LN) , në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], me referencë nr. 687, datë 05.06.2015, është regjistruar dëshmi trashëgimie, nuk është lëshuar certifikatë pronësie.
Nr. 636, vol. 3, faqe 162, arë me ***sipërfaqe 1312 m²***(sipas LN) , në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], me referencë nr. 687, datë 05.06.2015, është regjistruar dëshmi trashëgimie, nuk është lëshuar certifikatë pronësie.
Nr. 637, vol. 3, faqe 163, truall + ndërtesë me ***sipërfaqe (98+98) m²***(sipas LN) , në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], me referencë nr. 687, datë 05.06.2015, është regjistruar dëshmi trashëgimie, nuk është lëshuar certifikatë pronësie.
Nr. 638, vol. 3, faqe 164, arë me ***sipërfaqe 4302 m²***(sipas LN) , në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], me referencë nr. 687, datë 05.06.2015, është regjistruar dëshmi trashëgimie, nuk është lëshuar certifikatë pronësie.
Nr. 677/2, vol. 3, faqe 205, arë me ***sipërfaqe 693 m²***(sipas LN) , në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], është tjetërsuar në vitin 2009;
Nr. 688, vol. 3, faqe 217, arë me ***sipërfaqe 1824 m²***(sipas LN), e cila ndahet: pasuria 688/1, volum 15, faqe 102, **,** arë me ***sipërfaqe 826 m², tjetërsuar***; pasuria 688/2, volum 15, faqe 103, **,** rrugë me ***sipërfaqe 179 m², në pronësi shtet***(shpronësuar me VKM nr. 876, datë 14.12.2011) dhe

: pasuria 688/3, volum 15, faqe 104, **,** arë me ***sipërfaqe 819 m²*,** me referencë nr. 687, datë 05.06.2015, është regjistruar dëshmi trashëgimie, nuk është lëshuar certifikatë pronësie.
Nr. 689, vol. 3, faqe 218, arë me ***sipërfaqe 1320 m²***(sipas LN) , në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], me referencë nr. 687, datë 05.06.2015, është regjistruar dëshmi trashëgimie, nuk është lëshuar certifikatë pronësie.
Nr. 733, vol. 4, faqe 12, arë+truall me ***sipërfaqe 3910 m²***(sipas LN) , nga e cila 150 m² truall dhe 100 m² ndërtesë, në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], me referencë nr. 687, datë 05.06.2015, është regjistruar dëshmi trashëgimie, nuk është lëshuar certifikatë pronësie.
Nr. 728, vol. 4, faqe 7, arë+truall me ***sipërfaqe 2500 m²***(sipas LN) , nga e cila 200 m² truall dhe 140 m² ndërtesë, në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], me referencë nr. 687, datë 05.06.2015, është regjistruar dëshmi trashëgimie, nuk është lëshuar certifikatë pronësie.
Nr. 730, vol. 4, faqe 9, arë me ***sipërfaqe 2000 m²***(sipas LN), në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], me referencë nr. 687, datë 05.06.2015, është regjistruar dëshmi trashëgimie, nuk është lëshuar certifikatë pronësie.
Veprimet e më sipërme që lidhen me regjistrimin e dëshmisë së trashëgimiasë, janë kryer nga R. Sh., me detyrë specialist hartograf, ndërsa veprimet për lëshimin e certifikatës për pasurinë 689, janë kryer nga D. H., me detyrë specialist jurist.
Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:
- familja bujqësore poseduese e AMTP nr. 26521 ka përfituar më tepër se sa përcaktuar në aktin e pronësisë sipërfaqen prej 740 m²[27432 m² (sip. e regjistruar në KPP)-26688 m²(sip. në AMTP)], për të cilën mungon akti i fitimit të pronësisë, ndërsa nga punonjësit e ZVRPP-së, janë kryer veprime duke lëshuar certifikatë pronësie, duke mos i dërguar pushtetit vendor relacionin përkatës, siç përcaktuar në UKM Nr. 994, datë 9.12.2015, pikën 2.2/c.
Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", UKM Nr. 2, datë 13.06.2013 "Për Mënyrën e Procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme, të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (amtp)", pikën 2.2, germa b/iii UKM Nr. 994, datë 9.12.2015,
ZVRPP Bulqizë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, por duhet ti kërkonte pushtetit vendor konfirmimin lidhur me sasinë takuese të tokës për këtë familje.
- Referencë nr. 0943
Me kërkesë nr. 1081, datë 19.09.2018, [redacted] ka kërkuar regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë dhe kalimin e pronësisë për trashëgimtarët për pasuri e përfituar sipas Aktit të Marrjes së Tokë në Pronësi(AMTP) nr 26286, pa datë, lëshuar në emër të [redacted].
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, sipas regjistrimit fillestar rezultojnë të regjistruara këto pasuri:
Nr. 3675/1, vol. 3, faqe 201, arë me sipërfaqe 2218 m²(sipas LN), në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], lëshuar certifikatë pronësie me datë 10.03.2016,
Nr. 676, vol. 3, faqe 203, arë me sipërfaqe 2422 m²(sipas LN), në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], lëshuar certifikatë pronësie me datë 10.03.2016,
Nr. 685, vol. 3, faqe 214, arë me sipërfaqe 3364 m²(sipas LN), në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted], lëshuar certifikatë pronësie me datë 1.12.2014, specilaisti që ka kryer veprimet në kartelë R. Sh.
Nr. 686, vol. 3, faqe 215, arë me sipërfaqe 3260 m²(sipas LN), në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted]., lëshuar certifikatë pronësie në vitin 2007, me referencë 943, datë 22.09.2018, regjistruar dëshmi trashëgimie duke kaluar në pronësi të trashëgimtarëve,
Nr. 699, vol. 3, faqe 228, arë me sipërfaqe 6250 m²(sipas LN), në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted]., nuk janë kryer veprime;

Nr. 703, vol. 3, faqe 232, pemëtore +truall me ***sipërfaqe 1350 m²***(sipas LN) , nga e cila 200 m² truall dhe 136 m² ndërtesë në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted]., lëshuar certifikatë pronësie me datë 10.03.2016,

Nr. 755/1, vol. 4, faqe 37, arë me sipërfaqe 6922 m²(sipas LN), në pronësi të përfaqësuesit të familjes bujqësore [redacted] lëshuar certifikatë pronësie datë 10.03.2016 me referencë 943, datë 22.09.2018, regjistruar dëshmi trashëgimie duke kaluar në pronësi të trashëgimtarëve,

Veprimet e më sipërme që lidhen me lëshimin e certifikatave dhe regjistrimin e dëshmisë trashëgimisë, janë kryer nga D. H., me detyrë specialist jurist..

Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:

- Në dosje mungon certifikata që tregon gjendjen familjare deri me 01.08.1991, siç përcaktohet në UKM Nr. 994, datë 9.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP)",
- Regjistrimi i pasurisë truall me sipërfaqe 200 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 136 m², është kryer bazuar në Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 26286, ndërsa duke ju referuar VKM nr. 432, datë 14.08.1995, si dokument ligjor për regjistrimin e pasurive "truall dhe ndërtesë", në zonat urbane të fshatit, shërben "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", e miratuar nga pushteti vendor, nga ku rezulton se këto dokumente nuk janë hartuar dhe dorëzuar në ZVRPP Bulqizë, nga pushteti vendor, për rrjedhojë ***ZVRPP Bulqizë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme truall me sipërfaqe 200 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 136m² dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, në mungesë të dokumentit ligjor "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", që shërben për regjistrimin e pasurisë.***
- ***Gjithashtu familja bujqësore poseduese e AMTP nr. 26286 ka përfituar më tepër se sa përcaktuar në aktin e pronësisë sipërfaqen prej 2386 m²[23786 m² (sip. e regjistruar në KPP)-21418 m²(sip. në AMTP)], për të cilën mungon akti i fitimit të pronësisë,*** ndërsa nga punonjësit e ZVRPP-së, janë kryer veprime duke lëshuar certifikatë pronësie, duke mos i dërguar pushtetit vendor relacionin përkatës, siç përcaktuar në UKM Nr. 994, datë 9.12.2015, pikën 2.2/c.

Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 2, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore", dhe ligjin 7501, 19.07.1991, i ndryshuar, VKM nr. 432, datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhërin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013, me pikën 2.2, germa b/iii UKM Nr. 994, datë 9.12.2015.

Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** V. H., me detyrë ish regjistrues, Sh. A. me detyrë ish regjistrues, D. H. me detyrë specialist jurist,

- Referencë nr. 954

Me kërkesë nr. 1311, datë 21.11.2018, [redacted] ka kërkuar regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë dhe kalimin e pronësisë për trashëgimtarët për pasuri e përfituar sipas Aktit të Marrjes së Tokë në Pronësi(AMTP) nr. 26395 , pa datë, lëshuar në emër të [redacted]

Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, sipas regjistrimit fillestar rezultojnë të regjistruara këto pasuri:

Nr. 115, vol. 1, faqe 120, arë me sipërfaqe 1000 m²(sipas LN); **Nr. 157, vol. 1, faqe 162**, arë me sipërfaqe 520 m²(sipas LN), **Nr. 192, vol. 1, faqe 192,** arë me sipërfaqe 3250 m²(sipas LN), **Nr. 257 vol. 2, faqe 21**, pemëtore+truall me sipërfaqe 2750 m²(sipas LN), nga e cila 50 m² dhe 50 m² ndërtesë; **Nr. 2347, vol. 10, faqe 153,** arë me sipërfaqe 1285 m²(sipas LN), **Nr. 2349, vol. 10, faqe 2349,** arë me sipërfaqe 1000 m²(sipas LN), **Nr. 2504, vol. 11, faqe 63,** arë me sipërfaqe 1386 m²(sipas LN), **Nr. 2525, vol. 11, faqe 84,** arë me sipërfaqe 1980 m²(sipas LN), **Nr. 2533, vol. 11, faqe 92** arë me sipërfaqe 936 m²(sipas LN), **Nr. 2537, vol. 11, faqe 96,** arë me sipërfaqe 1000 m²(sipas LN). Të gjitha këto pasuri me referencë 954 pas regjistrimit të aktit të trashëgimisë kanë kaluar në pronësi të 7 trashëgimtarëve dhe lëshuar certifikatë pronësie me datë 21.12.2018.

Veprimet e më sipërme që lidhen me lëshimin e certifikatave dhe regjistrimin e dëshmisë trashëgimisë, janë kryer nga D. H., me detyrë specialist jurist..
Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:
- Regjistrimi i pasurisë truall me sipërfaqe 50 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 50 m^2, është kryer bazuar në Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 26286, ndërsa duke ju referuar VKM nr. 432, datë 14.08.1995, si dokument ligjor për regjistrimin e pasurive "truall dhe ndërtesë", në zonat urbane të fshatit, shërben "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", e miratuar nga pushteti vendor, nga ku rezulton se këto dokumente nuk janë hartuar dhe dorëzuar në ZVRPP Bulqizë, nga pushteti vendor, për rrejdhojë ***ZVRPP Bulqizë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme truall me sipërfaqe 50 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 50 m^2 dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, në mungesë të dokumentit ligjor "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", që shërben për regjistrimin e pasurisë.***
Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 432, datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhërin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013.
Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** Sh. A. me detyrë ish regjistrues, D. H. me detyrë specialist jurist,
Duke ju referuar dokumentacionit të ndodhur në dosje, rezulton se për këtë familje, është lëshuar 1 AMTP për 2 anëtarë të trungut familar dhe në total kjo familje ka përfituar tokë bujqësore me sipërfaqe 19150 m^2(regjistruar në KPP 15050 m^2) , ndërsa sipas normës për frymë i takonte 2.462 dyn./pers. , kësaj familje që përbëhej nga 2 persona, i takonte sipërfaqja prej 4924 m^2, nga regjistrimi në KPP është përfituar ***më tepër tokë bujqësore me sipërfaqe 10130*** m^2[15050(sasia e tokës që ka marrë)-4920(sasia takuese)], duke mos plotësuar kërkesat përcaktuar në ligjin 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar, pikën 2 neni 3,të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008" Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" dhe pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës".
ZVRPP Bulqizë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, por duhet ti kërkonte pushtetit vendor konfirmimin lidhur me sasinë takuese të tokës për këtë familje.

- Referencë nr. 840;
Me kërkesë nr. , datë , është kërkuar regjistrimin e dëshmisë s trashëgimisë dhe kalimin e pronësisë për pasuritë e përfituara sipas Aktit të Marrjes së Tokë në Pronësi(AMTP) nr 26417, datë , lëshuar në emër të [redacted].
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, sipas regjistrimit fillestar rezultojnë të regjistruara këto pasuri:
Nr. 767/5, vol. 4, faqe 54, arë me sipërfaqe 1743 m^2, **Nr. 767/6, vol. 4, faqe 55,** arë me sipërfaqe 608 m^2, **Nr. 768/3, vol. 4, faqe 62,** arë me sipërfaqe 2349 m^2, **Nr. 799, vol. 4, faqe 95,** arë me sipërfaqe 1240 m^2, **Nr. 859, vol. 4, faqe 155,** arë me sipërfaqe 1180 m^2 , nga e cila 100 m^2 truall+ 90 m^2 ndërtesë, **Nr. 951, vol. 4, faqe 247,** arë me sipërfaqe 1875 m^2, **Nr. 959, vol. 5, faqe 5,** arë me sipërfaqe 2771 m^2, **Nr. 962, vol. 5, faqe 8,** arë me sipërfaqe 1000 m^2, **Nr. 964, vol. 5, faqe 10,** arë me sipërfaqe 1008 m^2, për këto pasuri me referencë nr. 840, datë 25.01.2017, është regjistruar dëshmia e trashëgimisë dhe kanë kaluar në pronësi të 8 trashëgimtarëve, nuk është lëshuar certifikatë.
Nr. 953, vol. 4, faqe 249, pemëtore+truall me sipërfaqe 2000 m^2 , nga e cila 300 m^2 truall+ 144 m^2 ndërtesë,, me referencë nr. 840, datë 25.01.2017, pas regjistrimit të dëshmisë së trashëgimisë, ka kaluar në pronësi të 8 trashëgimtarëve dhe më pas me referencë nr. , regjistruar kontratë dhurimi duke kaluar në pronësi të [redacted], është lëshuar certifikatë pronësie me datë 08.06.2017. Pasuritë e mësipërme janë regjistruar sipas AMTP-nr. 26417, me sipërfaqe totale

tokë bujqësore 17610 m^2, nga e cila 320 m^2 truall, kjo AMTP rezulton e korrigjuar duke rritur sipërfaqen totale nga 17610 m^2 në 19758 m^2, nga e cila në KPP, rezulton e regjistruar sipërfaqja totale nga 15774 m^2, nga e cila 400 m^2 truall+ 234 m^2 ndërtesë.
Gjithashtu për këtë familje bujqësore, janë lëshuar edhe 3 AMTP të tjera, mbi bazën e të cilave janë regjistruar këto pasuri:
Nr. 1502/4, vol. 14, faqe 42, arë me sipërfaqe 3400 m^2, regjistruar amtp nr. 2, datë 20.12.2013, me referencë nr. 552, datë 05.02.2014, është lëshuar certifikatë pronësie me datë 05.02.2014; **Nr. 1510 vol. 7, faqe 60** arë me sipërfaqe 4350 m^2, regjistruar amtp nr. 3, datë 20.12.2013, regjistruar me referencë nr. 552, datë 05.02.2014, është lëshuar certifikatë pronësie me datë 05.02.2014; **Nr. 2805, vol. 12, faqe 121,** arë me sipërfaqe 3020 m^2, regjistruar amtp nr. 4, datë 20.12.2013, regjistruar me referencë nr. 552, datë 05.02.2014, është lëshuar certifikatë pronësie me datë 05.02.2014; për këto pasuri me referencë nr. 840, datë 25.01.2017, është regjistruar dëshmia e trashëgimisë dhe kanë kaluar në pronësi të 8 trashëgimtarëve, nuk është lëshuar certifikatë.
Veprimet e më sipërme që lidhen me lëshimin e certifikatave dhe regjistrimin e dëshmisë trashëgimisë, janë kryer nga D. H., me detyrë specialist juris dhe R. Sh. me detyrë specialist hartograf.
Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:
- Regjistrimi i pasurive 2 pasurive: truall me sipërfaqe 100 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 90 m^2 dhe truall me sipërfaqe 300 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 144 m^2 është kryer bazuar në Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 26417, ndërsa duke ju referuar VKM nr. 432, datë 14.08.1995, si dokument ligjor për regjistrimin e pasurive "truall dhe ndërtesë", në zonat urbane të fshatit, shërben "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", e miratuar nga pushteti vendor, nga ku rezulton se këto dokumente nuk janë hartuar dhe dorëzuar në ZVRPP Bulqizë, nga pushteti vendor, për rrejdhojë ***ZVRPP Bulqizë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme truall me sipërfaqe 400 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 234 m^2 dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, në mungesë të dokumentit ligjor "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", që shërben për regjistrimin e pasurisë.***
Gjithashtu AMTP nr. 26417, nuk përmbush elementet e formës dhe përmbajtjes, pasi është korrigjuar pasuria që i përket "rreshtit të pestë, nga sipërfaqe 2168 m^2 korrigjuar në 5108 m^2, si dhe është korrigjuar sasia e tokës së përfituar gjithsej,
Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 2, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore", dhe ligjin 7501, 19.07.1991, i ndryshuar, VKM nr. 432, datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhërin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013, me pikën 2.2, germa b/iii UKM Nr. 994, datë 9.12.2015, ku përcaktohet
Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** V. H., me detyrë ish regjistrues, D. H.me detyrë specialist jurist dhe R. Sh. me detyrë hartograf.
Duke ju referuar dokumentacionit të ndodhur në dosje, rezulton se për këtë familje, janë lëshuar 4 AMTP për 7 anëtarë të trungut familjar dhe në total kjo familje ka përfituar tokë bujqësore me sipërfaqe 28060 m^2(regjistruar në KPP 26144 m^2) , ndërsa sipas normës për frymë i takonte 2.462 dyn./pers. , kësaj familje që përbëhej nga 7 persona, i takonte sipërfaqja prej 17234 m^2, nga regjistrimi në KPP është përfituar ***më tepër tokë bujqësore me sipërfaqe 8910*** m^2[26144(sasia e tokës që ka marrë)-17234(sasia takuese)], duke mos plotësuar kërkesat përcaktuar në ligjin 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar, pikën 2 neni 3,të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008" Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" dhe pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës".
ZVRPP Bulqizë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, por duhet ti kërkonte pushtetit vendor konfirmimin lidhur me sasinë

takuese të tokës për këtë familje. Ndërsa 3 AMTP-t, lëshuar në vitin 2013 nga Bashkia Bulqizë, nuk janë në përputhje me kërkesat ligjore, pasi kjo familje bujqësore rezulton e plotësuar me tokë.

- Referencë nr. 016; 017

Me kërkesë nr. , datë , Bashkia Bulqizë, përfaqësuar nga .., ka kërkuar lëshimin e certifikatës së pronësisë dublikatë, pasuri e përfituar me kontratë shitje nga qytetari regjistruar më referencë 017, datë 17.12.2002.

Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme(KPP), rezulton se në volum 13, faqe 151, me referencë 016, datë 11.12.2002, është regjistruar pasuria nr. 2012/1, arë me sipërfaqe 5312 m^2, lëshuar certifikatë datë 11.12.2002 për [redacted], e cila me referencë nr. 017, datë 17.12.2002, është tjetërsuar duke kaluar me kontratë shitje në pronësi të Bashkisë Bulqizë.

Gjithashtu me referencë 016, datë 11.12.2002, është regjistruar pasuria nr. 2012/2, volum 13, faqe 152 arë me sipërfaqe 1856 m^2, lëshuar certifikatë datë 11.12.2002 për [redacted]

Bazuar në Aktin e Marrjes së Tokë në Pronësi(AMTP) datë , lëshuar në emër të [redacted], sipas regjistrimit fillestar rezultojnë të regjistruara këto pasuri:

Nr. 1560, vol.7, faqe 110, arë me sipërfaqe 4312 m^2, **Nr. 1562, vol. 7, faqe 112,** pemëtore+truall, me sipërfaqe 2690 m^2, nga e cila 200 m^2 truall+ 129 m^2 ndërtesë, **Nr. 1555, vol. 7, faqe 105,** arë me sipërfaqe 2884 m^2, **Nr. 1587, vol. 7, faqe 137,** arë me sipërfaqe 2000 m^2, në total sipas AMTP-së është regjistruar sipërfaqja prej 11880 m^2 nga e cila 200 m^2 truall+ 129 m^2 ndërtesë, ndërsa AMTP-ja ka përcaktuar sipërfaqen totale prej m^2.

Sa trajtuar, referuar dokumentacionit gjendje në dosjet me referenca 016 dhe 017, rezulton se regjistrimi i pasurive nr. 2012/1, *arë me sipërfaqe 5312 m^2* dhe nr. 2012/2, volum 13, faqe 152 *arë me sipërfaqe 1856 m^2*, është kryer ***në mungesë të dokumentacionit që shërben si Titull Pronësie,***

Sa vepruar në papajtueshmëri me nenin 24, të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999.

Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** S. B. me detyrë ish regjistrues dhe specialistët që kanë kryer veprimet që lidhen me referencat 016 dhe 017

Duke ju referuar dokumentacionit të ndodhur në dosje, rezulton se për këtë familje, që përbëhet nga 2 anëtarë me datë 01.08.1991 dhe në total kjo familje ka përfituar tokë bujqësore me sipërfaqe 19040 m^2, regjistruar në KPP 26144 m^2, ndërsa sipas normës për frymë i takonte 2.462 dyn./pers. , kësaj familje që përbëhej nga 2 persona, i takonte sipërfaqja prej 4920 m^2, nga regjistrimi në KPP është përfituar ***më tepër tokë bujqësore me sipërfaqe 14120*** m^2[19040(sasia e tokës që ka marrë)-4920(sasia takuese)], duke mos plotësuar kërkesat përcaktuar në ligjin 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar, pikën 2 neni 3,të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008" Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" dhe pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës".

ZVRPP Bulqizë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, por duhet ti kërkonte pushtetit vendor konfirmimin lidhur me sasinë takuese të tokës për këtë familje.

- Referencë nr. 872;

Me kërkesë nr. 569, datë 16.03.2017, [redacted] ka kërkuar regjistrimin e dëshmisë s trashëgimisë dhe kalimin e pronësisë për pasuritë e përfituara sipas Aktit të Marrjes së Tokë në Pronësi(AMTP) nr 26420, datë , lëshuar në emër të [redacted]

Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, sipas regjistrimit fillestar rezultojnë të regjistruara këto pasuri:

Nr. 767/1, vol. 4, faqe 50, arë me sipërfaqe 279 m^2, **Nr. 767/2, vol. 4, faqe 51,** arë me sipërfaqe 7176 m^2, **Nr. 768/1, vol. 4, faqe 60,** arë me sipërfaqe 10005 m^2, e ndarë në 3 pasuri, volum 15,

faqe 67, 68, 69; **Nr. 834, vol. 4, faqe 130,** arë me sipërfaqe 2560 m^2, e ndarë në 3 pasuri, volum 15, faqe 71, 72, 73; **Nr. 835, vol. 4, faqe 131,** arë me sipërfaqe 2875 m^2 , e ndarë në 3 pasuri, volum 15, faqe 74, 75, 76; **Nr. 836, vol. 4, faqe 132,** arë me sipërfaqe 656 m^2 , **Nr.847, vol. 4, faqe 143,** ,pemëtore+truall me sipërfaqe 1000 m^2 nga e cila 150 m^2 truall+ 130 m^2 ndërtesë, ka kaluar volum 15, faqe 83; **Nr. 845, vol. 4, faqe 141,** arë +truall me sipërfaqe 1500 m^2 nga e cila 150 m^2 truall+ 126 m^2 ndërtesë, **Nr. 1928/1 vol. 9, faqe 42,** arë me sipërfaqe 6972 m^2, e ndarë në 3 pasuri, volum 15, faqe 64, 65, 66;
Gjithashtu për këtë familje bujqësore, është lëshuar AMTP nr. 119, datë 05.10.2016, mbi bazën e të cilës është regjistruar pasuria **Nr. 2258/1, vol. 15, faqe 20,** pemëtore me sipërfaqe 700 m^2
Veprimet e më sipërme që lidhen me lëshimin e certifikatave dhe regjistrimin e dëshmisë trashëgimisë, janë kryer nga D. H., me detyrë specialist juris dhe R. Sh. me detyrë specialist hartograf.
Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:
- Regjistrimi i pasurive 2 pasurive: truall me sipërfaqe 150 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 130 m^2 dhe truall me sipërfaqe 150 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 126 m^2 është kryer bazuar në Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 26420, ndërsa duke ju referuar VKM nr. 432, datë 14.08.1995, si dokument ligjor për regjistrimin e pasurive "truall dhe ndërtesë", në zonat urbane të fshatit, shërben "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", e miratuar nga pushteti vendor, nga ku rezulton se këto dokumente nuk janë hartuar dhe dorëzuar në ZVRPP Bulqizë, nga pushteti vendor, për rrejdhojë ***ZVRPP Bulqizë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme 2 troje me sipërfaqe 300 m^2 dhe 2 ndërtesa me sipërfaqe 256 m^2 dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, në mungesë të dokumentit ligjor "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", që shërben për regjistrimin e pasurisë.***
Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe ligjin 7501, datë 19.07.1991, i ndryshuar, VKM nr. 432, datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhërin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013, me pikën 2.2, germa b/iii UKM Nr. 994, datë 9.12.2015.
Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** V. H., me detyrë ish regjistrues, Sh. A., me detyrë ish regjistrues, D. H. me detyrë specialist jurist.
Duke ju referuar dokumentacionit të ndodhur në dosje, rezulton se për këtë familje, janë lëshuar 2 AMTP për 6 anëtarë të trungut familar dhe në total kjo familje ka përfituar tokë bujqësore me sipërfaqe 35200 m^2(regjistruar në KPP 35200 m^2) , ndërsa sipas normës për frymë i takonte 2.462 dyn./pers. , kësaj familje që përbëhej nga 6 persona, i takonte sipërfaqja prej 14770 m^2, nga regjistrimi në KPP është përfituar ***më tepër tokë bujqësore me sipërfaqe 20430*** m^2[35200(sasia e tokës që ka marrë)-14770(sasia takuese)], duke mos plotësuar kërkesat përcaktuar në ligjin 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar, pikën 2 neni 3,të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008" Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" dhe pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës".
ZVRPP Bulqizë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, por duhet ti kërkonte pushtetit vendor konfirmimin lidhur me sasinë takuese të tokës për këtë familje. Ndërsa AMTP-ja, lëshuar në vitin 2016 nga Bashkia Bulqizë, nuk është në përputhje me kërkesat ligjore, pasi kjo familje bujqësore rezulton e plotësuar me tokë.

- Referencë nr. 868; ZK 3694
Me kërkesë nr. , datë [redacted] ka kërkuar kalimin e pronësisë për pasuritë e përfituara sipas Aktit të Marrjes së Tokë në Pronësi(AMTP) nr152, datë 07.02.2017 , lëshuar në emër të familjes [redacted]

Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, sipas regjistrimit fillestar bazuar në AMTP nr. 26379, , lëshuar në emër të familjes [redacted] rezultojnë të regjistruara këto pasuri:
Nr. 532, vol. 3, faqe 56, arë me sipërfaqe 2250 m^2, rezulton e tjetërsuar sipas referencës nr. 527, datë 03.10.2013; **Nr. 542, vol. 3, faqe 66,** pemëtore me sipërfaqe 275 m^2, **Nr. 561, vol. 3, faqe 85,** truall+nd sipërfaqe 250 m^2+ nd. 64 m^2 , **Nr. 562, vol. 3, faqe 86,** truall+nd sipërfaqe 210 m^2+ nd. 64 m^2; **Nr. 563, vol. 3, faqe 87,** pemëtore me sipërfaqe 562 m^2, **Nr. 564, vol. 3, faqe 88,** pemëtore+truall sipërfaqe 810 m^2, nga e cila truall 300 m^2+ nd. 72 m^2, rezulton e tjetërsuar sipas referencës nr. 526, datë 03.10.2013; **Nr. 565, vol. 3, faqe 89,** pemëtore+truall sipërfaqe 1000 m^2, nga e cila truall 100 m^2+ nd. 72 m^2, rezulton e tjetërsuar sipas referencës nr. 526, datë 03.10.2013; **Nr. 585, vol. 3, faqe 109,** arë me sipërfaqe 352 m^2, **Nr. 591, vol. 3, faqe 115,** arë me sipërfaqe 2362 m^2, **Nr. 624, vol. 3, faqe 150,** arë me sipërfaqe 1118 m^2, **Nr. 625, vol. 3, faqe 151,** arë me sipërfaqe 1092 m^2, **Nr. 626, vol. 3, faqe 152,** arë me sipërfaqe 1218 m^2, të tre këto pasuri, sipas referencës nr. 409, datë 23..04.2011, regjistruar akt trashëgimie duke kaluar në pronësi të 5 trashëgimtarëve.
Sipas kësaj AMTP-je, rezulton e regjistruar në KPP sipërfaqja totale nga 11500 m^2, nga e cila 860 m^2 truall+ 272 m^2 ndërtesë.
Gjithashtu për këtë familje bujqësore, është lëshuar edhe AMTP nr. 152, datë 07.02.2017, mbi bazën e të cilës është regjistruar pasuria **Nr. 248/1, vol. 15, faqe 61,** arë me sipërfaqe 1250 m^2, lëshuar certifikatë pronësie datë 24.03.2017.
Veprimet e më sipërme që lidhen me lëshimin e certifikatave dhe regjistrimin e dëshmisë trashëgimisë, janë kryer nga D. H., me detyrë specialist jurist dhe R. Sh. me detyrë specialist hartograf.
Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:
- Regjistrimi i pasurive 4 pasurive: *truall me sipërfaqe 250 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 64 m^2; truall me sipërfaqe 210 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 64 m^2; truall me sipërfaqe 300 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 72 m^2; truall me sipërfaqe 100 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 72 m^2,* është kryer bazuar në Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 26379, ndërsa duke ju referuar VKM nr. 432, datë 14.08.1995, si dokument ligjor për regjistrimin e pasurive "truall dhe ndërtesë", në zonat urbane të fshatit, shërben "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", e miratuar nga pushteti vendor, nga ku rezulton se këto dokumente nuk janë hartuar dhe dorëzuar në ZVRPP Bulqizë, nga pushteti vendor, për rrjedhojë ***ZVRPP Bulqizë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme truall me sipërfaqe totale 860 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe totale 272 m^2 dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, në mungesë të dokumentit ligjor "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", që shërben për regjistrimin e pasurisë.***
Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 2, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore", dhe ligjin 7501, 19.07.1991, i ndryshuar, VKM nr. 432, datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhërin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013, me pikën 2.2, germa b/iii UKM Nr. 994, datë 9.12.2015.
Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** E. K. me detyrë ish regjistrues**,** V. H.me detyrë ish regjistrues, D. H. me detyrë specialist jurist dhe R. Sh. me detyrë hartograf.
Duke ju referuar dokumentacionit të ndodhur në dosje, rezulton se për këtë familje, janë lëshuar 2 AMTP për 4 anëtarë të trungut familar dhe në total kjo familje ka përfituar tokë bujqësore me sipërfaqe 16245 m^2(regjistruar në KPP 12750 m^2) , ndërsa sipas normës për frymë i takonte 2.462 dyn./pers. , kësaj familje që përbëhej nga 4 persona, i takonte sipërfaqja prej 9848 m^2, nga regjistrimi në KPP është përfituar ***më tepër tokë bujqësore me sipërfaqe 3260*** m^2[12750(sasia e tokës që ka marrë)-9848(sasia takuese)], duke mos plotësuar kërkesat përcaktuar në ligjin 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar, pikën 2 neni 3,të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008" Për

Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" dhe pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës".
ZVRPP Bulqizë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, por duhet ti kërkonte pushtetit vendor konfirmimin lidhur me sasinë takuese të tokës për këtë familje. Ndërsa AMTP nr. 152, datë 07.02.2017, lëshuar nga Bashkia Bulqizë, nuk është në përputhje me kërkesat ligjore, pasi kjo familje bujqësore rezulton e pajisur me AMTP dhe e plotësuar me tokë.

- Referencë nr. 854; 859; 858; 856; 857;
Me kërkesë nr. 283 , datë 02.02.2017, është kërkuar regjistrimi fillestar dhe kalimin e pronësisë për pasuritë e përfituara sipas 5 Akteve të Marrjes së Tokë në Pronësi(AMTP), lëshuar në emër të familjes bujqësore [redacted]
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, sipas regjistrimit fillestar bazuar në AMTP nr. 26322, rezultojnë të regjistruara këto pasuri:
Nr. 1611 vol. 7, faqe 161, pemëtore+truall me sipërfaqe 1060 m^2, nga e cila 150 m^2 truall+ 150 m^2 ndërtesë; **Nr. 1630, vol. 7, faqe 180,** pemëtore+truall me sipërfaqe 750 m^2, nga e cila 100 m^2 truall+ 84 m^2 ndërtesë; **Nr. 1631, vol. 7, faqe 181,** arë me sipërfaqe 1625 m^2; **Nr. 1819, vol. 8, faqe 121,** arë me sipërfaqe 5150 m^2; **Nr. 1943, vol. 8, faqe 246,** arë me sipërfaqe 1271 m^2; **Nr. 1944, vol. 8, faqe 247,** arë me sipërfaqe 2380 m^2; për këto pasuri nuk janë kryer veprime dhe as lëshuar certifikata pronësie.
Gjithashtu për këtë familje bujqësore, janë lëshuar edhe 6 AMTP të tjera, mbi bazën e të cilave janë regjistruar këto pasuri:
Nr. 2085/8, vol. 15, faqe 53, arë me sipërfaqe 362 m^2, regjistruar amtp nr. 135, datë 30.10.2016, me referencë nr. 859, datë 20.02.2017, është regjistruar dhe lëshuar certifikatë pronësie me datë 28.02.2017; **Nr. 2084/91, vol. 15, faqe 55,** arë me sipërfaqe 412 m^2, regjistruar amtp nr. 134, datë 3.10.2016, me referencë nr. 856, datë 20.02.2017, është regjistruar dhe lëshuar certifikatë pronësie me datë 28.02.2017; **Nr. 1504/10, vol. 15, faqe 56,** arë me sipërfaqe 1755 m^2, regjistruar amtp nr. , datë 30.10.2016, me referencë nr. 854, datë 2.02.2017, është regjistruar dhe lëshuar certifikatë pronësie me datë 28.02.2017; **Nr. 1504/11, vol. 15, faqe 57,** pemëtore me sipërfaqe 1755 m^2, regjistruar amtp nr. , datë , me referencë nr. 858, datë 20.02.2017, është regjistruar dhe lëshuar certifikatë pronësie me datë 28.02.2017; **Nr. 1504/12, vol. 15, faqe 58,** pemëtore me sipërfaqe 1715 m^2, regjistruar amtp nr. , datë 30.10.2016, me referencë nr. 857, datë 20.02.2017, është regjistruar dhe lëshuar certifikatë pronësie me datë 28.02.2017; **Nr. 2085/13, vol. 15, faqe 59,** pemëtore me sipërfaqe 1715 m^2, regjistruar amtp nr. , datë 30.10.2016, me referencë nr. 855, datë 20.02.2017, është regjistruar dhe lëshuar certifikatë pronësie me datë 28.02.2017;
Veprimet e më sipërme që lidhen me lëshimin e certifikatave dhe regjistrimin e dëshmisë trashëgimisë, janë kryer nga D. H. me detyrë specialist juris dhe R. Sh. me detyrë hartograf.
Duke ju referuar dokumentacionit të ndodhur në dosje, rezulton se për këtë familje, janë lëshuar 7 AMTP për 5 anëtarë të trungut familar dhe në total kjo familje ka përfituar tokë bujqësore me sipërfaqe 19950 m^2(regjistruar në KPP 19950 m^2) , ndërsa sipas normës për frymë i takonte 2.462 dyn./pers. , kësaj familje që përbëhej nga 5 persona, i takonte sipërfaqja prej 12310 m^2, nga regjistrimi në KPP është përfituar ***më tepër tokë bujqësore me sipërfaqe 7640***m^2[19950(sasia e tokës që ka marrë)-12310(sasia takuese)], duke mos plotësuar kërkesat përcaktuar në ligjin 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar, pikën 2 neni 3,të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008" Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" dhe pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës".
ZVRPP Bulqizë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, por duhet ti kërkonte pushtetit vendor konfirmimin lidhur me sasinë takuese të tokës për këtë familje. Ndërsa 6 AMTP-t, lëshuar në vitin 2016 nga Bashkia Bulqizë, nuk janë në përputhje me kërkesat ligjore, pasi kjo familje bujqësore rezulton e pajisur me AMTP dhe e plotësuar me tokë.

- Referencë nr. ; ZK 8612;
Me kërkesë nr. , datë , është kërkuar lëshimi i certifikatave të pronësisë për pasuritë e përfituara sipas Aktit të Marrjes së Tokë në Pronësi(AMTP), lëshuar në emër të familjes bujqësore [redacted]
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, sipas regjistrimit fillestar bazuar në AMTP nr. 26322, rezultojnë të regjistruara këto pasuri:
Nr. 3/4 vol. 7, faqe 63, arë me sipërfaqe 734 m^2; **Nr. 3/9 vol. 7, faqe 68,** arë me sipërfaqe 123 m^2; **Nr. 3/88 vol. 7, faqe 149** arë me sipërfaqe 747 m^2; **Nr. 3/92 vol. 7, faqe 153,** arë me sipërfaqe 356 m^2; **Nr. 3/93 vol. 7, faqe 154,** pemëtore+truall me sipërfaqe 1510 m^2, nga e cila truall 200 m^2+ndërtesë 155 m^2; për këto pasuri janë kryer veprime lëshuar certifikata pronësie me datë 04.12.2017, në mungesë të kërkesës së qytetarit.
Veprimet e më sipërme që lidhen me lëshimin e certifikatave dhe regjistrimin e dëshmisë trashëgimisë, janë kryer nga D. H., me detyrë ish regjistrues.
Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:
- Mungon kërkesa e qytetarit për shërbimin e kryer dhe pajisjen me ceretfikatë pronësie;
- AMTP-ja nr. 26338, lëshuar në emër të poseduesit është lëshuar në fshatin Vajkal, ndërsa regjistrimi i pasurive është bërë në ZK 8612, që i përket qytetit Bulqizë, ku referuar vijjës kufizuese të qytetit Bulqizë, ekziston vetëm zëri kadastral truall, për rrejedhojë nuk mund të regjistrohen pasuritë bazuar në AMTP, lidhur me këtë parregullsi, mungon dokumentacioni përkatës dhe konfirmimi nga pushteti vendor.
Në këto kushte, *ZVRPP Bulqizë nuk duhet të kryente shërbimin duke lëshuar certifikata pronësie, bazuar në AMTP,* ***e cila në këtë rast nuk mund të shërbejë si Titull Pronësie, s*****a vepruar në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25, pikën 1 neni 32 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 2, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore", dhe ligjin 7501, 19.07.1991, i ndryshuar, VKM nr. 432, datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhërin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013, me pikën 2.2, germa b/iii UKM Nr. 994, datë 9.12.2015.
Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi**, D. H. me detyrë ish regjistrues dhe specialist jurist.

- Referencë nr. 415 ; ZK 1763; Fshati Gjoricë e Sipërme
Me kërkesë nr. 1553 , datë 06.09.2017, është kërkuar regjistrimi i pasurisë e përfituar sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP), lëshuar në emër të familjes bujqësore [redacted] lëshimi i certifikatave të pronësisë për pasuritë
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, sipas regjistrimit fillestar bazuar në AMTP nr. 27578/226, rezultojnë të regjistruara këto pasuri:
Nr. 147/2, vol. 6, faqe 37, arë me sipërfaqe 4600 m^2(sipas LN), e cila mbyllet kalon volum 8, faqe 79, 80; **Nr. 157/1, vol. 6, faqe 102**, arë+truall me sipërfaqe 2850 m^2(sipas LN), nga e cila truall 300 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 84 m^2; **Nr. 215/3, vol.7, faqe 61**, arë me sipërfaqe 750 m^2(sipas LN), **Nr. 370/3, vol. 7, faqe 224**, arë me sipërfaqe 8500 m^2(sipas LN);
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme(KPP), rezulton se me referencë nr. 415, datë 12.01.2018, është regjistruar pasuria nr. 147/33, volum 8, faqe 299, arë me sipërfaqe 870.5 m^2, lëshuar certifikatë pronësie datë 22.01.2018, kjo pasuri vjen ngas ndarja e pasurisë "shtet" nr. 147/1, volum 6, faqe 36, arë+truall me sipërfaqe 1250 m^2(sipas LN), nga e cila truall 250 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 100 m^2, e cila ndahet volum 8, faqe 229(pasuria e sipër trajtuar) dhe volum 8, faqe 230, arë+truall me sipërfaqe 379.5 m^2, nga e cila truall 250 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 100 m^2;
Veprimet që lidhen me referencën 415, janë kryer nga D. H., me detyrë specialist jurist.

Regjistrimi i këtyre pasurive dhe kryerja e veprimeve, është kryer më të meta dhe shkelje ligjore, pasi:

- familja bujqësore ka përfituar më tepër se sa përcaktuar në aktin e pronësisë sipërfaqen prej 630 m²[17370 m² (sip. e regjistruar në KPP)-16740 m²(sip. në AMTP)], për të cilën mungon akti i fitimit të pronësisë, ndërsa nga punonjësit e ZVRPP-së, janë kryer veprime duke lëshuar certifikatë pronësie, duke mos i dërguar pushtetit vendor relacionin përkatës, siç përcaktuar në UKM Nr. 994, datë 9.12.2015, pikën 2.2/c.

Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, nenin 34, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjin 7501, 19.07.1991, i ndryshuar, me pikën 2.2, germa b/iii UKM Nr. 994, datë 9.12.2015, ku përcaktohet

Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** Sh. A. me detyrë ish regjistrues, D. H. me detyrë specialist jurist,

- Referencë nr. 376; ZK 1763, Fshati Gjoricë e sipërme

Me kërkesë nr. 386 , datë 21.02.2017, është kërkuar regjistrimi fillestar i pasurisë së përfituar sipas Aktit të Marrjes së Tokë në Pronësi(AMTP) nr. 41, datë 01.02.2017, lëshuar në emër të familjes [redacted]

Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, rezulton se me referencë nr. 376, datë 11.03.2017, është regjistruar pasuria nr. 81/37/4, volum 9, faqe 210, lëshuar certifikatë pronësie datë 16.03.2017.

Gjithashtu në KPP rezultojnë të regjistruara sipas AMTP-ve të lëshuara më parë edhe edhe këto pasuri:

Nr. 79/4/2, vol. 5, faqe 42 arë me sipërfaqe 3725 m²; **Nr. 174/3/22, vol. 6, faqe 192** pemëtore me sipërfaqe 3000 m²; **Nr. 174/4, vol. 6, faqe 193,** arë me sipërfaqe 3825 m²; **Nr. 177/1, vol. 6, faqe 201,** arë+trual me sipërfaqe 1180 m² , nga e cila 300 m² truall+ 120 m² ndërtesë, për këto pasuri nuk janë kryer veprime dhe janë regjistruar në bazë ***të AMTP nr. 7578/243,*** lëshuar në emër të Shahin Shaban Lika;

Nr. 91/37/2, vol. 5, faqe 134 arë me sipërfaqe 6700 m²; **Nr. 174/5, vol. 6, faqe 194** arë me sipërfaqe 3750m²; **Nr. 176/1, vol. 6, faqe 197,** arë me sipërfaqe 3000 m²; **Nr. 176/3, vol. 6, faqe 199,** pemëtore+truall me sipërfaqe 375 m², nga e cila 200 m² truall+ 105 m² ndërtesë, për këto pasuri janë lëshuar certifikata pronësie me datë 28.09.2011, të regjistruara në bazë ***të AMTP nr. 7578/126,*** lëshuar në emër të Tush Shahin Lika;

Nr. 177/2, vol. 6, faqe 202, arë+truall me sipërfaqe 500 m², nga e cila 300 m² truall+ 120 m² ndërtesë, regjistruara në bazë ***të AMTP nr. 7578/128,*** lëshuar në emër të Mehmet Shahin Lika;

Veprimet e më sipërme që lidhen me referencën nr. 376, janë kryer nga D. H., me detyrë specialist jurist dhe R. Sh. me detyrë specialist hartograf.

Sa trajtuar, rezulton se për këtë familje bujqësore, janë lëshuar 4 AMTP, me sipërfaqe totale ***27670 m²·, ndërsa*** në KPP, në total është regjistruar tokë më sipërfaqe ***30250 m;²***

- Kjo familje bujqësore ka përfituar më tepër se sa përcaktuar në aktin e pronësisë sipërfaqen prej 2580 m²[30250 m² (sip. e regjistruar në KPP)-27670 m²(sip. në AMTP)], për të cilën mungon akti i fitimit të pronësisë, ndërsa nga punonjësit e ZVRPP-së, janë kryer veprime duke lëshuar certifikatë pronësie, duke mos bërë bilancin total të pasurive të regjistruara, me ato që ka përfituar me AMTP, për ti dërguar pushtetit vendor relacionin përkatës, siç përcaktuar në UKM Nr. 994, datë 9.12.2015, pikën 2.2/c.

Gjithashtu AMTP nr. 7578/126, rezulton e korrigjuar në shifrat e sipërfaqeve të parcelave, ndërsa nga punonjësit e ZVRPP, nuk duhet të kryhej shërbimi dhe lëshimi i certifikatave përkatëse me datë 28.09.2011, vepruar në kundërshtim me përcaktimet ligjore në UKM nr. 2, datë 08.04.2009.

Sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me pikën 2.2, germa b/iii UKM Nr. 994, datë 9.12.2015.

Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** V. H. me detyrë ish regjistrues, E. K. , me detyrë ish regjistrues, D. H. me detyrë specialist jurist dhe R. Sh. me detyrë hartograf.

- Referencë nr. 0166; ZK 1532, Fshati Dragua;
Me kërkesë nr. 1723, datë 07.12.2016, [redacted] ka kërkuar regjistrimin e pasurisë dhe pajisjen me certifikatë pronësie për pasurinë e përfituar me AMTP.
Origjina e kësaj pasurie rrjedh sipas AMTP-së nr. 26640, datë , lëshuar në emër të [redacted], nga e cila kjo familja bujqësore ka përfituar tokë bujqësore me sipërfaqe totale 2520 m^2.
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme, rezulton se në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP), vol. 4, faqe 141, është regjistruar pasuria nr. 279/14, arë me sipërfaqe 2520 m^2, lëshuar certifikatë pronësie me datë 25.01.2017.

Nga kontrolli i dokumentacionit ligjorë gjendje në dosje rezulton se regjistrimi i pasurive, është kryer me shkelje dhe parregullsi, si më poshtë vijon:
Nga verifikimi i dokumentacionit pjesë e dosjes me këtë referencë rezulton se, *Akti i Marrjes së Tokë në Pronësi, është lëshuar nga Komisioni i Tokës së Fshatit Dragua, ndërsa poseduesi i AMTP-së, sipas certifikatës familjare më 1.08.1991, rezulton banor i Fshatit Vajkal, ku rezulton se ka përfituar tokë AMTP të lëshuar nga Komisioni i Tokës së Fshatit Vajkal, si dhe me AMTP të lëshuar nga Bashkia Bulqizë*, për rrjedhojë AMTP nr. 26640, datë , është lëshuar në kundërshtim me nenin 5 dhe nenin 6, të ligjit 7501, datë 19.07.1991 " Për Tokat", i ndryshuar dhe VKM nr. 255, datë 02.08.1991 "Për Kriteret e Ndarje së Tokës Bujqësore", i ndryshuar.
ZVRPP Bulqizë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, por duhet ti kërkonte Komisionit vendorë të vlerësimit të titujve të pronësisë (KV) pranë Prefektit të Qarkut Dibër, vlefshmërinë ligjore të kësaj AMTP-je, lëshuar në emër të [redacted]
Si përfundim regjistrimi i pasurisë nr. 279/14, arë me sipërfaqe 2520 m^2, duke lëshuar certifikatë pronësie, *është kryer në shkelje të dispozitave ligjore*, pasi AMTP-së nr. 26640, lëshuar nga Komisioni i ndarjes së tokës, Fshati Dragua, ***nuk mund të shërbejë si Titull Pronësie,*** sa vepruar **në kundërshtim** me shkronjën a, neni 25, me pikën 5 nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe UKM Nr. 994, datë 9.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP)".
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** V. H. me detyrë ish Regjistrues, D. H., me detyrë specialist jurist.

- Referencë nr. 0178; ZK 1532, Fshati Dragua
Me kërkesë nr. 706, datë 13.06.2018, [redacted] ka kërkuar korrigjim gabimesh në HTR dhe pajisjen me certifikatë pronësie, për pasuri të regjistruar bazuar në AMTP përkatëse.
Origjina e pasurive rrjedh sipas AMTP-së nr. 25684, datë 24.04.1993, lëshuar në emër të [redacted], nga e cila kjo familje bujqësore ka përfituar tokë bujqësore me sipërfaqe totale 10800 m^2.
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme ZK 1532, rezulton se në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP), janë regjistruar këto ***pasuria nr. 274/3,*** vol. 1, faqe 133, me arë me sipërfaqe 1328 m^2(sipas LN); për këtë pasuri nuk janë kryer veprime; ***pasuria nr. 279/9,*** vol. 1, faqe 134, me arë me sipërfaqe 3220 m^2(sipas LN), pas përmirësim përditësimit kjo sipërfaqe është korrigjuar në **2518 m^2**; *për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie;* ***pasuri: nr. 278/2,*** vol. 1, faqe 135, me arë me sipërfaqe 7182 m^2(sipas LN), pas përmirësim përditësimit kjo sipërfaqe është korrigjuar në **6893 m^2**; mbyllet dhe kalon: vol. 4, faqe 146, nr.278/8, arë me sipërfaqe 139 m^2, kalon në pronësi shtet; vol. 4, faqe 147, nr. 278/9, arë me sipërfaqe **6254 m^2**,

kalon në pronësi të [redacted], *lëshuar certifikatë pronësie datë 02.08.2018;* , nr. 278/10, arë me sipërfaqe **500 m²**, rezulton e tjetërsuar me kontratë shitje.
Nga kontrolli i dokumentacionit ligjorë gjendje në dosje rezulton se regjistrimi i pasurisë, është kryer me shkelje dhe parregullsi, pasi në AMTP NR. 25684, pasuria që i përket rreshtit të dytë me sipërfaqe 9700 m², rezulton zëri kadastral "moçalishte", ndërsa në KPP është regjistruar në tokë "arë", për rrjedhojë arrijmë në përfundimin se, AMTP shërben si Titull Pronësie për të regjistruar pasuri të **llojit "Tokë Bujqësore",** që figuron si e tillë në regjistrat përkatës deri 1.08.1991, për rrjedhojë ZVRPP Bulqizë nuk duhet të regjistronte, duke lëshuar certifikatë pronësie për tokë arë **me sipërfaqe totale prej 9700 m², e cila** rezulton zëri kadastral **"moçalishte",** por duhet të kërkonte konfirmim nga institucionet përkatëse, veprim **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25, nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 2, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore ", me nenin 2, të ligjit nr. 8337, datë 30.04.1998 '"Për Kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave" dhe ligjin 7501, 19.07.1991, i ndryshuar.
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** Sh. A. me detyrë ish-Regjistrues, D. H. me detyrë specialist jurist.
Duke ju referuar dokumentacionit të ndodhur në dosje, rezulton se kjo familje, përbëhet nga 4 anëtarë me datë 01.08.1991 dhe në total kjo familje ka përfituar tokë bujqësore me sipërfaqe 10600 m²(regjistruar në KPP 10600 m²), ndërsa sipas normës për frymë i takonte 1.361 dyn./pers. , kësaj familje i takonte sipërfaqja prej 5444 m², nga regjistrimi në KPP është përfituar ***më tepër tokë bujqësore me sipërfaqe 5160*** m²[10600(sasia e tokës që ka marrë)-5444(sasia takuese)], duke mos plotësuar kërkesat përcaktuar në ligjin 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar, pikën 2 neni 3,të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008" Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" dhe pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës".
ZVRPP Bulqizë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, por duhet ti kërkonte pushtetit vendor konfirmimin lidhur me sasinë takuese të tokës për këtë familje.

- Referencë nr. 00173; 088; ZK 1532, Fshati Dragua
Me Urdhërin e regjistruesit nr. 16, datë 31.01.2017, është kërkuar vendosja e kufizimit për pasuri të regjistruar bazuar në AMTP përkatëse, regjistrim i kryer me parregullsi.
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme ZK 1532, rezulton se në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP), me referencën nr. 088, datë 28.05.2014, rezulton se në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP), janë regjistruar këto ***pasuri: nr. 599/6,*** vol. 4, faqe 98, truall me sipërfaqe 590.5 m²; ***nr. 599/9,*** vol. 4, faqe 112, arë me sipërfaqe 5441.5 m²; këto pasuri janë lëshuar certifikata pronësie me datë 28.05.2014. Origjina e pasurive rrjedh sipas AMTP-së nr. 106 datë 06.01.2014, lëshuar nga ish Kryetari i Komunës Fushë Bulqizë në emër të familjes [redacted] të përbërë nga 6 anëtarë, këto pasuri më pas janë kufizuar më referencë nr. 173, datë 07.02.2017, në bazë të urdhrit të regjistruesit të ZVRPP Bulqizë.
Duke ju referuar të dhënave në KPP dhe dokumentacionit pjesë e dosjes së audituar, rezulton se këto pasuri rrjedhin nga ndarjet e pasurive volum 4, faqe 90 dhe volum 4, faqe 97, që rezultojnë zëri kadastral "Pyll", ***për rrejdhojë AMTP nr. 106 datë 06.01.2014, është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore***, pasi ky akt është i vlefshëm vetëm për toka bujqësore, në rastin konkret është lëshuar për "truall" dhe "Pyll".
Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit dhe KPP, rezulton se kjo familje bujqësore ka regjistruar këto pasuri:
pasuria nr. 270/1, vol. 1, faqe 139, me arë+truall me sipërfaqe 1240 m²(sipas LN); ***pasuria nr. 912/7,*** vol. 1, faqe 143, me arë me sipërfaqe 1708 m²(sipas LN), ***pasuria nr. 279/5,*** vol. 1, faqe 144, me arë me sipërfaqe 4750 m²(sipas LN), pas përmirësim përditësimit kjo sipërfaqe është

korrigjuar në **5940 m²**; ***pasuria nr. 278/6,*** vol. 1, faqe 145, me arë me sipërfaqe 4350 m²(sipas LN), *për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikatë pronësie;*
Origjina e pasurive rrjedh sipas AMTP-së nr. 25687, datë 24.04.1993, lëshuar në emër të [redacted], nga e cila kjo familje bujqësore ka përfituar tokë bujqësore me sipërfaqe totale 11500 m².
Nga kontrolli i dokumentacionit ligjorë gjendje në dosje rezulton se regjistrimi i pasurisë, është kryer me shkelje dhe parregullsi, pasi në AMTP nr. 25687, pasuria që i përket rreshtit të trete me sipërfaqe 10300 m², nga e cila rezulton 500 m² arë, ndërsa 9800 m² zëri kadastral "moçalishte", ndërsa në KPP është regjistruar në tokë "arë", për këtë pasuri nuk janë kryer veprime(nuk duhet të veprohet pa marrë konfirmim zyrtar nga organet përkatëse).
Sa trajtuar, arrijmë në përfundimin se ***AMTP nr. 106 datë 06.01.2014, është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore*** dhe regjistrimi i pasuriveqë rrjedhin prej janë regjistruar ne kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi *AMTP shërben si Titull Pronësie për të regjistruar pasuri* të **llojit "Tokë Bujqësore",** që figuron si e tillë në regjistrat përkatës deri 1.08.1991, për rrjedhojë ZVRPP Bulqizë nuk duhet të regjistronte, duke lëshuar certifikatë pronësie për tokë arë **me sipërfaqe 5444.5 m² dhe truall me sipërfaqe 590.5 m2,** të cilat rezultojnë zëri kadastral **"Pyll",** veprim **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25, nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 2, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore ", me nenin 2, të ligjit nr. 8337, datë 30.04.1998 '"Për Kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave" dhe ligjin 7501, 19.07.1991, i ndryshuar.
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** V. H. me detyrë ish-Regjistrues, R. Sh. me detyrë specialist hartograf.
Duke ju referuar dokumentacionit të ndodhur në dosje, rezulton se kjo familje, përbëhet nga 6 anëtarë me datë 01.08.1991 dhe në total kjo familje ka përfituar tokë bujqësore me sipërfaqe 18440m²(regjistruar në KPP 18440 m²), ndërsa sipas normës për frymë i takonte 1.361 dyn./pers. , kësaj familje i takonte sipërfaqja prej 8200 m², nga regjistrimi në KPP është përfituar ***më tepër tokë bujqësore me sipërfaqe 10240*** m²[18440(sasia e tokës që ka marrë)-8200(sasia takuese)], duke mos plotësuar kërkesat përcaktuar në ligjin 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar, pikën 2 neni 3,të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008" Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" dhe pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës".
Në pikën 2 neni 3, të ligjit nr. 9948, përcaktohet:

> *2. Titujt e pronësisë mbi tokën bujqësore janë të vlefshëm vetëm kur janë krijuar në përputhje me:*
> *a) -----";*
> *b) kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 255, datë 2.8.1991 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore", të ndryshuar;*

Në pikën 2 të VKM 255, përcaktohet:

> 2-*Ne te gjitha rastet toka ndahet përpjesëtimisht per çdo familje sipas numrit te frymëve te gjendjes civile ne datën 1 gusht 1991.*

ZVRPP Bulqizë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, por duhet ti kërkonte pushtetit vendor konfirmimin lidhur me sasinë takuese të tokës për këtë familje.

- Referencë nr. 0092; ZK 1532, Fshati Dragua

Me Urdhrin e regjistruesit nr. 16, datë 31.01.2017, është kërkuar vendosja e kufizimit për pasuri të regjistruar bazuar në AMTP përkatëse, regjistrim i kryer me parregullsi.
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme ZK 1532, rezulton se në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP), me referencën nr. 092, datë 16.04.2014, është regjistruar ***pasuria nr.***

554/7, vol. 4, faqe 130, arë me sipërfaqe 2750 m^2, lëshuar certifikata pronësie me datë 16.06.2014, për familjen bujqësore [redacted] me 5 bashkëpronarë të tjerë. kjo pasuri më pas është kufizuar më referencë nr. 173, datë 07.02.2017, në bazë të urdhrit të regjistruesit të ZVRPP Bulqizë. Regjistrimi i kësaj paurie është bërë në bazë të AMTP –së nr. 90, datë 06.01.2014, lëshuar nga ish Kryetari i Komunës Fushë Bulqizë.
Duke ju referuar të dhënave në KPP dhe dokumentacionit pjesë e dosjes së audituar, rezulton se këto pasuri rrjedhin nga ndarjet e pasurisë, që rezulton zëri kadastral "livadh", ***për rrejdhojë AMTP nr. 90 datë 06.01.2014, është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore***, pasi ky akt është i vlefshëm vetëm për toka bujqësore, në rastin konkret është lëshuar për "livadh"
Sa trajtuar, arrijmë në përfundimin se ***AMTP nr. 90, datë 06.01.2014, është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore*** dhe regjistrimi i pasurive që rrjedhin prej janë regjistruar ne kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi *AMTP shërben si Titull Pronësie për të regjistruar pasuri* të **llojit "Tokë Bujqësore",** që figuron si e tillë në regjistrat përkatës deri 1.08.1991, për rrjedhojë ZVRPP Bulqizë nuk duhet të regjistronte, duke lëshuar certifikatë pronësie për tokë arë **me sipërfaqe 2720 m^2,** të cilat rezultojnë zëri kadastral **"livadh",** veprim **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25, nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 2, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore ", me nenin 2, të ligjit nr. 8337, datë 30.04.1998 '"Për Kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave" dhe ligjin 7501, 19.07.1991, i ndryshuar,
Veprimet e mësipërme janë kryer nga V. H. me detyrë ish-Regjistrues, R. Sh. me detyrë specialist hartograf.

- Referencë nr. 105; ZK 1532, Fshati Dragua
Me Urdhërin e regjistruesit nr. 16, datë 31.01.2017, është kërkuar vendosja e kufizimit për pasuri të regjistruar bazuar në AMTP përkatëse, regjistrim i kryer me parregullsi.
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme ZK 1532, rezulton se në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP), me referencën nr. 105, datë 16.04.2014, është regjistruar ***pasuria nr. 554/5,*** vol. 4, faqe 128, arë me sipërfaqe 3310 m^2, lëshuar certifikata pronësie me datë 16.06.2014, për familjen bujqësore [redacted] me 8 bashkëpronarë të tjerë. kjo pasuri më pas është kufizuar më referencë nr. 173, datë 07.02.2017, në bazë të urdhrit të regjistruesit të ZVRPP Bulqizë. Regjistrimi i kësaj pasurie është bërë në bazë të AMTP –së nr. 93, datë 06.01.2014, lëshuar nga ish Kryetari i Komunës Fushë Bulqizë.
Duke ju referuar të dhënave në KPP dhe dokumentacionit pjesë e dosjes së audituar, rezulton se këto pasuri rrjedhin nga ndarjet e pasurisë volum 4, faqe 106, që rezulton zëri kadastral "livadh", ***për rrejdhojë AMTP nr. 93 datë 06.01.2014, është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore***, pasi ky akt është i vlefshëm vetëm për toka bujqësore, në rastin konkret është lëshuar për "livadh"
Sa trajtuar, arrijmë në përfundimin se ***AMTP nr. 93, datë 06.01.2014, është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore*** dhe regjistrimi i pasurive që rrjedhin prej saj, janë regjistruar ne kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi *AMTP shërben si Titull Pronësie për të regjistruar pasuri* të **llojit "Tokë Bujqësore",** që figuron si e tillë në regjistrat përkatës deri 1.08.1991, për rrjedhojë ZVRPP Bulqizë nuk duhet të regjistronte dhe lëshonte certifikatë pronësie për tokë arë **me sipërfaqe 3310 m^2,** të cilat rezultojnë zëri kadastral **"livadh",** veprim **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25, nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 2, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore ", me nenin 2, të ligjit nr. 8337, datë 30.04.1998 '"Për Kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave" dhe ligjin 7501, 19.07.1991, i ndryshuar,
Veprimet e mësipërme janë kryer nga V. H. me detyrë ish-Regjistrues, R. Sh. me detyrë specialist hartograf.

- Referencë nr. 101; ZK 1532, Fshati Dragua

Me Urdhërin e regjistruesit nr. 16, datë 31.01.2017, është kërkuar vendosja e kufizimit për pasuri të regjistruar bazuar në AMTP përkatëse, regjistrim i kryer me parregullsi.

Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme ZK 1532, rezulton se në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP), me referencën nr. 101, datë 16.04.2014, është regjistruar ***pasuria nr. 478/2*** vol. 4, faqe 135, arë me sipërfaqe 3029 m^2, lëshuar certifikata pronësie me datë 16.06.2014, për familjen bujqësore [redacted] me 4 bashkëpronarë të tjerë. kjo pasuri më pas është kufizuar më referencë nr. 173, datë 07.02.2017, në bazë të urdhërit të regjistruesit të ZVRPP Bulqizë. Regjistrimi i kësaj paurie është bërë në bazë të AMTP –së nr. 56, datë 06.01.2014, lëshuar nga ish Kryetari i Komunës Fushë Bulqizë.

Duke ju referuar të dhënave në KPP dhe dokumentacionit pjesë e dosjes së audituar, rezulton se këto pasuri rrjedhin nga ndarjet e pasurisë volum 3, faqe 200, që rezulton zëri kadastral "kullotë", ***për rrjedhojë AMTP nr. 56 datë 06.01.2014, është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore***, pasi ky akt është i vlefshëm vetëm për toka bujqësore, në rastin konkret është lëshuar për "kullotë"

Sa trajtuar, arrijmë në përfundimin se ***AMTP nr. 56, datë 06.01.2014, është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore*** dhe regjistrimi i pasurive që rrjedhin prej saj, janë regjistruar ne kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi *AMTP shërben si Titull Pronësie për të regjistruar pasuri* të **llojit "Tokë Bujqësore",** që figuron si e tillë në regjistrat përkatës deri 1.08.1991, për rrjedhojë ZVRPP Bulqizë nuk duhet të regjstronte dhe lëshonte certifikatë pronësie për tokë arë **me sipërfaqe 3029 m^2,** të cilat rezultojnë zëri kadastral **"kullotë",** veprim **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25, nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 2, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore ", me nenin 2, të ligjit nr. 8337, datë 30.04.1998 '"Për Kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave" dhe ligjin 7501, 19.07.1991, i ndryshuar.

Veprimet e mësipërme janë kryer nga V. H. me detyrë ish-Regjistrues, R. Sh. me detyrë specialist hartograf.

- Referencë nr. 097; ZK 1532, Fshati Dragua

Me Urdhërin e regjistruesit nr. 16, datë 31.01.2017, është kërkuar vendosja e kufizimit për pasuri të regjistruar bazuar në AMTP përkatëse, regjistrim i kryer me parregullsi.

Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme ZK 1532, rezulton se në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP), me referencën nr. 98, datë 16.04.2014, është regjistruar ***pasuria nr. 554/6,*** vol. 4, faqe 129, arë me sipërfaqe 2500 m^2, Regjistrimi i kësaj pasurie është bërë në bazë të AMTP –së nr. 96, datë 06.01.2014, lëshuar nga ish Kryetari i Komunës Fushë Bulqizë, për familjen bujqësore [redacted] me 4 bashkëpronarë të tjerë, kjo pasuri më pas është kufizuar më referencë nr. 173, datë 07.02.2017, në bazë të urdhërit të regjistruesit të ZVRPP Bulqizë.

Duke ju referuar të dhënave në KPP dhe dokumentacionit pjesë e dosjes së audituar, rezulton se këto pasuri rrjedhin nga ndarjet e pasurisë volum 4, faqe 106, që rezulton zëri kadastral "livadh", ***për rrejdhojë AMTP nr. 96 datë 06.01.2014, është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore***, pasi ky akt është i vlefshëm vetëm për toka bujqësore, në rastin konkret është lëshuar për "livadh"

Sa trajtuar, arrijmë në përfundimin se ***AMTP nr. 96, datë 06.01.2014, është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore*** dhe regjistrimi i pasurive që rrjedhin prej saj, janë regjistruar ne kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi *AMTP shërben si Titull Pronësie për të regjistruar pasuri* të **llojit "Tokë Bujqësore",** që figuron si e tillë në regjistrat përkatës deri 1.08.1991, për rrjedhojë ZVRPP Bulqizë nuk duhet të regjstronte dhe lëshonte certifikatë pronësie për tokë arë **me sipërfaqe 2500 m^2,** të cilat rezultojnë zëri kadastral **"livadh",** veprim **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25, nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të

paluajtshme", nenin 2, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore ", me nenin 2, të ligjit nr. 8337, datë 30.04.1998 '"Për Kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave" dhe ligjin 7501, 19.07.1991, i ndryshuar,
Veprimet e mësipërme janë kryer nga V. H. me detyrë ish-Regjistrues, R. Sh. me detyrë specialist hartograf.

- Referencë nr. 086; ZK 1532, Fshati Dragua
Me Urdhërin e regjistruesit nr. 16, datë 31.01.2017, është kërkuar vendosja e kufizimit për pasuri të regjistruar bazuar në AMTP përkatëse, regjistrim i kryer me parregullsi.
Nga auditimi i kartelave të pasurive të paluajtshme ZK 1532, rezulton se në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP), me referencën nr. 086, datë 16.04.2014, është regjistruar ***pasuria nr. 554/1,*** vol. 4, faqe 103, arë me sipërfaqe 1800 m^2, lëshuar certefikatë pronësie datë 13.05.2014. Regjistrimi i kësaj pasurie është bërë në bazë të AMTP –së nr. 48, datë 06.01.2014, lëshuar nga ish Kryetari i Komunës Fushë Bulqizë, për familjen bujqësore [redacted] kjo pasuri më pas është kufizuar më referencë nr. 173, datë 07.02.2017, në bazë të urdhërit të regjistruesit të ZVRPP Bulqizë.
Duke ju referuar të dhënave në KPP dhe dokumentacionit pjesë e dosjes së audituar, rezulton se këto pasuri rrjedhin nga ndarjet e pasurisë volum 3, faqe 232, që rezulton zëri kadastral "livadh", ***për rrejdhojë AMTP nr. 48 datë 06.01.2014, është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore***, pasi ky akt është i vlefshëm vetëm për toka bujqësore, në rastin konkret është lëshuar për "livadh"
Sa trajtuar, arrijmë në përfundimin se ***AMTP nr. 48, datë 06.01.2014, është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore*** dhe regjistrimi i pasurive që rrjedhin prej saj, janë regjistruar ne kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi *AMTP shërben si Titull Pronësie për të regjistruar pasuri* të **llojit "Tokë Bujqësore",** që figuron si e tillë në regjistrat përkatës deri 1.08.1991, për rrjedhojë ZVRPP Bulqizë nuk duhet të regjstronte dhe lëshonte certifikatë pronësie për tokë arë **me sipërfaqe 1500 m^2,** të cilat rezultojnë zëri kadastral **"livadh",** veprim **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25, nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 2, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore ", me nenin 2, të ligjit nr. 8337, datë 30.04.1998 '"Për Kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave" dhe ligjin 7501, 19.07.1991, i ndryshuar.
Veprimet e mësipërme janë kryer nga V. H. me detyrë ish-Regjistrues, R. Sh. me detyrë specialist hartograf.

Lidhur sa sipër trajtuar është mbajtur Akt-Konstatimi nr. 9, datë 31.05.2019, për të cilin ne fazën e hartimit të projekt raportit, nuk janë paraqitur observacione nga personat e atakuar të cilësuar si përgjegjës.
Lidhur sa trajtuar në faqet 8-40 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-Konstatimin nr. 9, datë 31.05.2019, janë paraqitur observacionet në rrugë elktronike dhe derguar me shkresen nr. 13.06.2019, dhe me shkresën nr. 737/3, datë 04.07.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 207/3, datë 08.07.2019, të cilat janë përmbledhur nga Përgjegjësi i Zyrës dhe dërguar prej tij, ku sqarohet:
Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 504, ZK 3694, ku ju konstatoni se se në këtë referencë familja bujqësore ka perfituar më tepër siperfaqen 2030 m2 dhe cilesohet se është lëshuar certifik pronësie pa dërguar relacion pushtetit vendor siç përcaktohet ne VKM nr.994 dt.9.12.2015. pika 2.2/c. Ndërsa veprimi i kryer për pajisje me certifikate pronesie vetëm tek njera kartelë konkretisht tek vol.2 fq. 90, veprim i kryer me datë 16.10.2018, është arsyetuar se pronarja ka kërkuar dokument vetëm për këtë pasuri për arsye se për dy tjerat do të japë dorheqje për arsye se janë tepër nga Akti.aplikimi dhe ndryshimet në kartele janë kryer nga

juristja D. H.. Lidhur me këtë veprim te kryer në mirëbesim përpara se të kryhej saktësimi,deri në paraqitjen e dorheqjes per dy pasuritë e tjera që plotësojnë sipërfaqen e tepërt nga Akti,ne nuk kemi lëshuar dokument pronesie (Kartelat bashkelidhur) pikerisht për këtë fakt,por edhe meqenëse pronarja aktualisht nuk kishte mundësi ekonomike në mirëbesim është lënë që ky veprim të kryhej me vonë..... .
Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 687, lidhur me veprimin e kryer për regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë datë 05.06.2016, sqarojmë se këtu nuk është shkelur VKM-se nr.994 dt.9.12.2015, pasi kjo VKM ka dalë pasi janë kryer regjistrimet e pasurive.
Në lidhje me regjistrimet e trashëgimise ligjore duke vazhduar me tej arsyetimet tona vlen te permendim edhe faktin se regjistrimi i ketyre akteve per pasurite me probleme mosperputhje me Aktin edhe pas daljes se VKM-se nr.994 dt.9.12.2015, nuk mendojme se perben ndonje shkelje regjistrimi i tyre para saktesimit te siperfaqes per arsye se:
***-se pari**,regjistrimi i aktit të trashegimise nuk është tjetërsim prone,siç jane kontratat e shitjes ,dhurimit,etj., por kalim tek trashegimtaret e ligjshem... .*
***se dyti**, në analogji me në rastin e mësiperm, ku sqaruam se për të bërë saktësimin e pronës ajo do të dorëhiqet për dy pasuri.Por noteri nuk bën akte noteriale pa patur certifikaten e pronësise se pronarit të regjistruar në seksionin "C" të KPP, ...*
Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 943, ku keni konstatuar mungesën e certefilkatës familjare dhe regjistrimin e truallit me sipërfaqe 200 m^2, ne mungese te dokumentit ligjor,"Lista e pronareve të trojeve dhe shtëpive". Lidhur me këtë sqarojmë se: sikurse vini në dukje nuk është hartuar dhe dorzuar pranë ZVRPP nga pushteti vendor,për pasojë dhe regjistrimi i sipërfaqes se mësipërme të truallit nuk është i rregullt. Në fakt ky regjistrim është bërë nga kompania që ka kryer regjistrimin fillestar dhe nuk është përgjegjësia e punonjësve aktualë.... .
Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 954, ku keni konstatuar regjistrimin e truallit me sipërfaqe 50 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 50 m^2, ne mungese te dokumentit ligjor,"Lista e pronareve të trojeve dhe shtëpive", siç sqaruam më sipër ky regjistrim është bërë nga kompania që ka kryer regjistrimin fillestar dhe nuk është përgjegjësia e punonjësve aktualë.... .
I njëjti problem konstatohet edhe në dosjen me referencë nr. 840, ndërsa lidhur me regjistrimin e 3 AMTP-ve te reja që ka lëshuar Bashkia për këtë pronar në ushtrim të kopetencave të saj, nuk mendojmë se është përgjegjëse Zrpp, per Akte të lëshuara nga institucione jo në varësi të saj,pasi siç përmendëm me lart... .
Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 868, ZK 3694, ku keni konstatuar regjistrimin e truallit me sipërfaqe 860 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 272 m^2, ne mungese te dokumentit ligjor,"Lista e pronareve të trojeve dhe shtëpive", siç sqaruam më sipër ky regjistrim është bërë nga kompania që ka kryer regjistrimin fillestar dhe nuk është përgjegjësia e punonjësve aktualë.... .
Lidhur me konstatimet që i përkasin referncave nr. 854, 856, 857, 858, 859, ZK 3694, ku keni konstatuar se Bashkia Bulqize ka leshuar pas AMTP-së se parë të regjistruara nga regjistrimi fillestar ne vitin 1999 edhe 7 AMTP te reja për këtë familje bujqësore,dhe sipas Konstatimit ZRPP,meqenese 7 AMTP-të e reja kanë shkaktuar,tejkalimin e normës për frymë,nuk duhet ti kishte regjistruar. Në lidhje me sa shtroni,mendojme se nuk është ekskluzivitet i ZRPP të bëjë llogaritjen e sasisë së tokës për frymë.... . Ne lidhje me këtë kuadër, Zyra e Regjistrimit verifikon elementet e formës dhe përmbajtjes së Aktit,si nr. Aktit,data e hartimit,titullari i institucionit,vula dhe firma e titullarit,vendi i hartimit etj..... .
Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 868, ZK 3694(në akt konstatimi i përket refernca nr, 415, ZK 1763), ku keni konstatuar se është ndarë pasuria are +truall nr.147/1 vol.6 fq.36 në dy pasuri, por nga kjo ndarje rezulton se ështe fshirë pasuria shtet ndërtese me siperfaqe 100 m2. Lidhur me këtë sqarojmë se kjo ka ardhur si rezultat i një gabimi njerëzor gjatë ndarjes së pasurisë dhe siperfaqja 250 m2 truall dhe ndërtesë 100 m2 pa dashje është harruar të transmetohet tek kartela e ndarë.... . Lidhur me këtë gabim njerëzor që me të drejtë është konstatuar, u rregullua në momentin e përgatitjes së ketij observacioni. Bashkëlidhur keni

kartelën mëmë vol.6 fq.36,dhe dy kartelat e ndara në momentin e audimit,si dhe po të njejtën kartelë vol.8 fq.230,të rregulluar tashmë,problem i krijuar siç përmendëm me sipër si rezultat i nje gabimi njerezor., i cili nuk ka shkaktuar pasoja, pasi kjo pasuri vazhdon të jetë në pronësi shtet.
Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 376, ZK 1763, ku keni konstatuar se është bërë regjistrimi i një AMTP-je të re nr.41 dt.1.2.2017,e cila ka sjellë si pasoje shtimin e siperfaqes totale që i takon sipas numrit për frymë duke e mbledhur me sasinë qe ka patur në tapine e pare që është regjistruar nga regjistrimi fillestar i këtij fshati në vitin 1998. Lidhur me regjistrimin e aktit të ri që ju thoni se ka shkaktuar rritjen e sasisë se tokës, që i takon totalisht sipas numrit të frymeve, ësgtë rast anlog që e trajtuam pak më sipër..... . Gjithashtu lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 166, ZK 1532, problemi që konstatohet është i ngjashem me rastet që trajtuam me sipër.
Lidhur me konstatimet që i përkasin referncave nr. 173, 0178, etj. ZK 1532, ku keni konstatuar; ***1.konstatimi i parë*** *ka të bëjë me regjistrimin jo të rregullt të AMTP-së nr.25687 dt.24.4.1993 pasi pasuria që i perket rrjeshtit të tretë në Akt është me zërin kadastral "moçalishte", kurse në kartelë është regjistruar "Are" dhe sipas percaktimit tuaj me këtë pasuri nuk janë kryer veprime pas regjistrimit fillestar. Lidhur me faktin e parë gjykojme se regjistrimi që ju thoni i rastit të "moçalishtes' i përket regjistrimit fillestar sistematik të ketij fshati, kryer ne vitin 1995 për të cilin rezultojnë të kryera të gjitha procedurat në atë kohe nga kompania e kontraktuar,si dhe afishimi publik i këtij fshati,dhe deri në këtë moment pronari nuk ka paraqitur kërkesë për pajisje me dokumenta pronesie që ne të kishim konstatuar problemin që shtroni. Në qoftë se në të ardhmen do të paraqisë kerkesë,do të proçedojmë me moslëshimin e çertifikates se pronësise dhe vendosjen e ndalimit të veprimeve me këtë pasuri.*
2. Konstatimi i dytë *në këtë referencë është se ZVRPP nuk duhet te regjistronte dhe të lëshonte çertifikate pronësie për një siperfaqe "tokë bujqësore" 5444,5 m2 dhe truall me sipërf.590,5 m2 të cilat rezultojne me zërin kad "Pyll". Lidhur me këtë konstatim sqarojmë se regjistrimi është kryer me datë 28.5.2014 dhe akoma nuk kishte dalë VKM nr.994 dt.9.12.2015,prandaj në këto kushte kur në akt jepej Zeri kad,"Are" që ndryshonte me Zerin në kartelë, ZVRPP i është drejtuar të gjitha institucioneve, si ZQRPP Tiranë e cila ka sqaruar se: "zërin kad nuk e përcakton kartela,kur nuk ka asnjë dokument sepse sipas kësaj llogjike ne duhet ti referohemi vetëm kartelës dhe të mos bazohemi në dokumente tekniko-ligjore"..dhe përfundon: "Ju duhet të vazhdoni sipas dokumentave". (Emailin e mësipërm po e bashkëlidhim observacionit)..... . Gjithashtu jemi drejtuar edhe në institucionet e tjera si DAMT-qark dhe KV, të cilat nuk kanë dhënë përgjigje konkrete lidhur me konfirmimin e zërit kadastral.* ***Në keto kushte,kur asnjë institucion nuk konfirmon, ZVRPP e pa te arsyeshme që Zeri kad.të shkruhet siç është ne AMTP, por të vendoset ndalim veprimesh për tjetërsim. (****Bashkelidhur janë të gjitha korespondencat shkresore që permendëm).*
I njëjti argumentim vlen edhe për konstatimet analoge që ju përkasin referncave: nr.105, nr. 101, nr. 97, nr. 86 e këtij fshati.

Sqarimi i Grupit të auditimit:
Lidhur me observacionet e paraqitur, të sipërcituar, nuk merren në konsideratë pasi, nuk janë paraqitur argumente dhe prova të reja, konkretisht:
Lidhur me argumentet e paraqitura nga ana juaj, që i përkasin referencës nr. 0504, se veprimi është kryer në mirëbesim përpara se të kryhej saktësimi,deri në paraqitjen e dorëheqjes per dy pasuritë e tjera që plotësojnë sipërfaqen e tepërt nga Akti, etj....., sqarojmë se këto argumente nuk janë ligjore dhe janë të pabazuara
Lidhur me argumentet e paraqitura nga ana juaj, që i përkasin referencës nr. 687, ku pretendoni se veprimet janë kryer datë 05.06.2016, duke aluduar se këtu nuk është shkelur VKM-se nr. 994 dt.9.12.2015, pasi kjo VKM ka dalë pasi janë kryer regjistrimet e pasurive. Pretendimi juaj nuk qëndron pasi siç kemi sqaruar në konstatimet tona, veprimet e kryera nga ama juaj duke lëshuar

certifikatë pronësie i përkasin datës 16.10.2018,(është e habitshme që në observacionin tuaj paraqisni këto lloj pretendimesh, të cilat janë plotësisht të qartësuara në materialin tonë), për rrjedhojë pretendimi juaj nuk pranohet.
Lidhur me argumentet e paraqitura nga ana juaj, që i përkasin referencave nr. 0943, nr. 368, nr. 954, 868, etj, të cilat përmbajnë të njëjtën problematike, regjistrimin e truallit dhe ndërtesës në zonat urbane të fshatrave, ne mungese te dokumentit ligjor,"Lista e pronareve të trojeve dhe shtëpive", përsëri konstatimet tona mbeten të pandryshuara, pasi edhe ju e keni pranuar që qëndron konstatimi ynë... .
Lidhur me argumentet e paraqitura nga ana juaj, që i përkasin referencave nr. 854, 856, 857, 858, 859, ZK 3694, dhe për të gjitha rastet që kanë të njëjtën problematikë që ka të bëjë me regjistrimin e 2 apo më shumë AMTP-ve të lëshuara për një familje bujqësore, nga pushteti vendor, sqarojmë se në materialin tonë nuk kemi ngarkuar me përgjegjësi punonjësit e ZVRPP-së, por e kemi trajtuar këtë si shkelje që ka sjellë pasoja të përfitimit të tokës më tepër se sipërfaqja takuese sipas ligjit, për të cilat ZVRPP duhet ti kërkojë konfirmim ligjshmërie nga institucionet përkatëse.
Lidhur me argumentet e paraqitura nga ana juaj, që i përkasin referencave *nr. 173, 0178, etj. ZK 1532*, për të gjitha rastet që kanë të njëjtën problematikë që ka të bëjë me ndryshimin e zërit kadastral, duke regjistruar me AMTP pasuri që nuk janë toka bujqësore, sqarojmë se argumentet tona mbeten të pandryshuara, pasi edhe në observacionin tuaj pranohet që është një regjistrim i gabuar(për të cilët keni vendosur kufizime).
Lidhur me argumentet e paraqitura nga ana juaj, që i përkasin referencës nr. *415, ZK 1763, për të cilën ju pretendoni se ka qenë një gabim njerzor dhe keni bërë korigjimet përkatëse duke regjistruar në KPP pasurinë ndërtesë me sipërfae 100 m^2 në pronësi shtet, bashkëlidhur keni paraqitur kopje të kartelës së PP, grupi i auditimit e pranon dhe e mërr në konsideratë, duke e reflektuar në Raportin përfundimtar të auditimit.*

Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **5 raste** që i përkasin ZK 3694, Fshati Vajkal, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme për poseduesit e AMTP-ve përkatëse, me referencat: nr. 0943, nr. 0954, nr. 0840, nr. 0872, nr. 0868, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, lidhur me* regjistrimin e pasurive truall+ndërtesë në zonat urbane të fshatrave, pasi ka ndodhur regjistrimi i pasurive trual+ndërtesë, duke kaluar truallin me sipërfaqe totale prej ***1810 m^2***, si dhe pasuritë ndërtesë me sipërfaqe totale ***948 m^2,*** nga të cilat ***në 3 raste,*** *janë regjistruar për të njëjtën familje 2 e më shumë pasuri truall dhe ndërtesë,* në pronësi të posedues ëve të AMTP-ve, ku rezulton se ***mungon dokumentit ligjor "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", që shërben si Titull Pronësie;*** sa vepruar **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr. 432, datë 14.08.1995"Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhërin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013.
Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për në **5 rastet e sipërcitauara dhe në të gjitha rastet e ngjashme**, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.
Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **4 raste,** që ju përkasin referencave: nr. 504, nr. 687, nr. 0943, ZK 3694 dhe nr. 415, ZK 1763, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme për poseduesit e AMTP-ve përkatëse, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore*, pasi është regjistruar në favor të posedues ëve të AMTP-ve një sipërfaqe toke në total prej ***5790 m^2,*** më tepër se sipërfaqja takuese sipas AMTP-së përkatëse, sa vepruar **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25 dhe pikën 2 neni 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe VKM nr. 994, datë 09.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP);

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **4 rastet e sipërcitauara**, të veçojë e regjistrojë "shtet" sipërfaqet e perfituara padrejtësisht, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe zbatimin e procedurave sipas VKM nr.994, datë 09.12.2015

Gjetje: ZVRPP Bulqizë në 2 **raste**, ju përkasin referencave: nr. 0840, ZK 3694 dhe nr. 376 ZK 1763, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme për poseduesit e AMTP-ve, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore*, pasi AMTP-të rezultojnë të korrigjuara, ***duke rritur fiktivisht sipërfaqen takuese dhe përfituar më tepër 5520 m²,*** ndërsa punonjësit e ZVRPP nuk duhet të kryenin veprime deri në kofirmimin zyrtar nga institucionet përkatëse, lidhur me vlefshmërinë ligjore të këtyre akteve, sa vepruar **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25 dhe pikën 2 neni 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe VKM nr.994, datë 09.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP);

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **2 rastet e sipërcitauara**, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe zbatimin e procedurave sipas VKM nr.994, datë 09.12.2015.

Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **8 raste**, sipas referencave: nr. 017, 016, nr. 687, nr. 0943, nr. 840, nr. 872, nr. 859, nr. 868, ZK 3694 dhe nr. 0178, nr. 0173, ZK 1532, ka regjistruar pasuri të paluajtshme dhe ka kryer transaksione, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore*, pasi për një trung familjar janë lëshuar 2 e më shumë AMTP, duke shkelur kriterin e ndarjes së tokës sipas normës për frymë të çdo fshati, dhe ndarë tokë në mënyrë të pa barabartë, për rrejdhojë nga regjistrimi i tyre ***kanë përfituar më tepër në total tokë me sipërfaqe 89800 m²,*** se sipërfaqja takuese sipas normës për frymë, bazuar në përbërjen familjare me datë 01.08.1991, sa vepruar **në papajtueshmëri** me pikën 2 neni 3, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" dhe në pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës", e ndryshuar, përsa i përket regjistrimit të pasurive tokë bujqësore të ndara me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar.

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **8 rastet e sipërcitauara** deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipasi VKM nr.994, datë 09.12.2015, si dhe të dërgojë AMTP-të përkatëse, për vlerësim dhe shqyrtim ligjor nga institucionet përkatëse kompetente.

Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **2 raste**, sipas referencave nr. 0166 dhe nr. 0178, ZK 1532, ka regjistruar pasuri të paluajtshme dhe ka kryer transaksione, *në favor* të poseduesit të AMTP-së me referercë nr. 2020, zk 1081, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi rezulton* se ***zëri kadastral që përmban AMTP-ja përkatëse, është "moçalishte", duke u regjistruar në KPP tokë arë*** me sipërfaqe totale ***19500 m²***, ndërsa ZVRPP Bulqizë, nuk duhet të procedonte me regjistrimin e pasurive përkatëse, por duhet ti drejtohej KVVTP pranë pranë Prefekturës së Qarkut Dibër, për të konfirmuar vlefshmërinë ligjore të AMTP-ve(ky konstatim vlen edhe për AMTP-të e tjera që i përkasin Fshatit Dragua), veprim **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25, nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 2, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore " dhe me germën "d" pika 1, të VKM nr.994, datë 09.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP)".

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **2**

rastet e sipërcitauara dhe në çdo rast që konstatpohet në vijimësi, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipasi VKM nr.994, datë 09.12.2015, si dhe të dërgojë AMTP-të përkatëse, për vlerësim dhe shqyrtim ligjor nga institucionet përkatëse kompetente.

Gjetje: ZVRPP Bulqizë në 6 **raste** sipas referencave nr. 0173, nr. 092, nr. 105, nr. 101, nr. 097 dhe nr. 086, ZK 1532, ka regjistruar *pasuri në favor* të poseduesëve të AMTP-ve përkatëse, ku konstatohet se në këto raste AMTP-të ***nuk mund të shërbejnë si Titull Pronësie, pasi*** pasuritë e regjistruara nuk janë të llojit "***tokë bujqësore***", për rrjedhojë në kundërshtim me dispozitat ligjore është tjetërsuar pasuria "shtet" me sipërfaqe totale ***18500 m²,*** që në KPP dhe regjistrat përkatës figuron e ***llojit***: ***"pyll", "truall" "livadh" dhe "kullotë",*** për të cilat në të gjitha rastet janë lëshuar certifikata pronësie ***për tokë arë***, ndërsa ZVRPP Bulqizë , nuk duhet të procedonte me regjistrimin e pasurive përkatëse, deri në kofirmimin zyrtar nga institucionet përkatëse.

veprim **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25, nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 2, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore ", nenin 3, të ligjit nr. 8337, datë 30.04.1998 '"Për Kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave" dhe nenin 3, të ligjit nr. 7501, datë 17.09.1991 "Për tokën", të ndryshuar dhe germën "b" pika 5, të UKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP)".

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **6 rastet e sipërcitauara** dhe në çdo rast që konstatpohet në vijimësi, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipasi VKM nr.994, datë 09.12.2015, si dhe të dërgojë AMTP-të përkatëse, për vlerësim dhe shqyrtim ligjor nga institucionet përkatëse kompetente.

Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **2 raste**, ka regjistruar pasuri të paluajtshme sipas AMTP nr. 26322, ZK 8612, qyteti Bulqizë dhe AMTP nr. 26640, ZK 1532, Fshati Dragua, të cilat ***janë lëshuar për persona që nuk janë përfitues të tokës,*** pasi nuk janë brenda juridiksionit që ushtron detyrën Komisioni i Ndarjes së Tokës në Fshat, kjo e vërtetuar me certifikatën e përbërjes familjare datë 1.08.1991, veprim **në papajtueshmëri me** pikën 2 neni 3, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, nenin 25/a, të ligjit nr.33/2012, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës", e ndryshuar, përsa i përket regjistrimit të pasurive tokë bujqësore të ndara me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar *(Trajtuar në faqet xx, të Projektraportit të Auditimit).*

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë e rëgjiatruara sipas AMTP-ve: AMTP nr. 26322,(lëshuar në Fshatin Vajkal) regjistruar në ZK 8612 dhe AMTP nr. 26640, ZK 1532, Fshati Dragua, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipasi VKM nr.994, datë 09.12.2015, si dhe të dërgojë AMTP-të përkatëse, për vlerësim dhe shqyrtim ligjor nga institucionet përkatëse kompetente.

Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **2 raste**, sipas referncave: nr. 504, nr. 0943, ZK 3694, ka regjistruar pasuri të paluajtshme sipas AMTP-ve, ***në mungesë të dokumentacionit teknik ligjor,*** pasi mungon certifikata e përbërjes së trungut familjar me datë 01.08.1991, veprim në papajtueshmëri me germën "d" pika 1, të UKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP) *(Trajtuar në faqet xx, të Projektraportit të Auditimit).*

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë e

rëgjiatruara sipas AMTP-ve, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr.994, datë 09.12.2015.
Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **2 raste**, sipas referncave: nr. 016, nr. 017, ZK 3694, ka regjistruar pasuri të paluajtshme nr. 2012/1, *arë me sipërfaqe 5312 m^2*(e tjetërsuar) dhe nr. 2012/2, volum 13, faqe 152, ZK 3694, *arë me sipërfaqe 1856 m^2, në shkelje të dipoziatve ligjore*, pasi rgjistrimi i pasurive është kryer ***në mungesë të dokumentacionit që shërben si Titull Pronësie,*** **Sa vepruar në papajtueshmëri** me nenin 24, të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999.
Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 2012/2, volum 13, faqe 152, ZK 3694, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor që shërben për fitimin e pronësisë.

Pika 3/1. **Bashkëpunimi dhe korrespodenca me KVTP pranë institucionit të Prefektit Qarkut Dibër**
Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:
Nga Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore(KVVTP) Prefekti Qarkut Dibër gjatë viteve ***2016 , 2017, 2018 deri 30.09.2018,*** ka marrë 6 vendime, ***të cilat administrohen nga ZVRPP Bulqize, si më poshtë:***

1- Vendimi me nr133 date 10.07.2017 prot.614/9 date 12.07.2017 ku i dërgohet Avokaturës së Shtetit, Z. [redacted] , fshati Homezh, Njësia Administrative Shupenzë , Bashkisë Bulqizë dhe ZVRPP Bulqizë, protokolluar ne Zvrpp Bulqize me nr 2515 prot dt.19.07.2017, KVVTP ka vendosur:
-Pavlefshmërinë ligjore dhe shfuqizimin e plote te aktit te marrjes se tokës bujqësore ne pronësi nr. 9, dt.12/05/2015, në emër te familjes së Z.[redacted] , ***me sip te përgjithshme 1977 m^2,*** regjistruar ne Zvrpp Bulqize me referencë nr. 344, Vol 5, Faq 40, me nr Pas 78, Lëshuar certifikatë me datë 07.08.2015 me shënim ne seksioni D me ref LN 2013 date 23.01.2013 përshkrimi: Okupuar nga [redacted] , ne seksionin E pa shënim.

- Pavlefshmërinë ligjore dhe shfuqizimin e plotë të AMTP-së nr. 9/1,dt.12/05/2015, në emër të familjes së Z. [redacted] , me sip të përgjithshme 4215 m^2, regjistruar në Zvrpp Bulqizë me referencë nr. 343, Vol 5, Faq 111, me nr Pas 84.
Lëshuar certifikatë me date 07.08.2015 me shënim ne seksioni D, me ref LN 2013 date 23.01.2013 pershkrimi: Okupuar nga [redacted] , ne seksionin E pa shënim.
- Pavlefshmerine ligjore dhe shfuqizimin e plote të AMTP-së nr. 9/2,dt.12/05/2015, ne emër te familjes se Z.[redacted] , me sip te pergjithshme 3830 m^2 regjistruar ne Zvrpp Bulqize ne Vol 2 Faq 136 me nr Pas. 96 referencë 342.
Lëshuar certifikatë me datë 07.08.2015 me shenim ne seksioni D, me ref LN 2013 date 23.01.2013, përshkrimi: Okupuar nga [redacted] , në seksionin E pa shenim.
-Kthimin e siperfaqes te tokes Bujqeseore prej 9922 m^2 , te cilat jane pasuri te akteve te marjes se tokes ne pronesi nr. 9, dt.12.05.2015, nr. 9/1, dt.12.05.2015, nr. 9/2, dt.12.05.2015 rezulton në pronësi të shtetit .
2- Vendim nr 141 date 28.02.2018
Mbi kerkesen e Zvrpp Bulqize me objekt : Verifikim te a.m.t.p nr 7019 dt.15.10.2000 në emër të familjes bujqësore të perfaqësuar nga [redacted] .
KVVTP ka vendosur:
- Pavlefshmerinë ligjore dhe shfuqizimin e pjesshëm te aktit te marjes se tokes ne pronesi nr . 7019 ne emer të [redacted] me sip.te përgjithshme 5450 m^2, duke hequr pjesen prej 700 m^2

në ngastren me emrin popullor "troja" me nr pas 293/6 , dhe kthimin e siperfaqes se tokes prej 700 m^2 në pronësi "shtet" .
-Pavlefshmeirn ligjore te dhe shfuqizimin e pjeshem te AMT në përdorim/pronësi me nr. 7189/91 dt.20.02.1999 në emër të [redacted] me sip. të përgjithshme 9700 m^2, duke hequr pjesen 5826 m^2, nga të cilat 5000 m^2 në ngastrën me emertimin popullor "Ormani" me nr. pas 427/15 figuron e regjistruar në Zk 1958, Vol. 9, F. 9 dhe 5, *rezulton se nuk është bërë shënim në seksionin "E" të kartelës* .
-Pavlefshmërinë ligjore dhe shfuqizimin e pjesshëm të AMTP në perdorim/pronësi, me nr. 69-49 dt.20.01.1999 në emër të [redacted] me sip. të pergjithshme 10200 m^2, duke hequr pjesën 4000 m^2 me emertimin popullor "Ormani" me nr pas 427/21 dhe kthimin e sipërfaqes në peonësi "shtet", figuron e regjistruar në Zk. 1958, Vol.9, F.101 me sip 4000 m2, rezulton e vendosur kufizim në seksionin E, me referencë nr. 598.
Me kerkesë nr. 2222, prot dt.05.07.2018, ZVRPP Bulqizë, i ka kërkuar KVVTP-së Prefekti i Qarkut Dibër, verifikimin e disa AMTP-ve .
KVVTP Prefektura e Qarku Dibër, me shkresën nr. 1054/1 prot. , datë 17.07.2018, "kthim përgjigje", drejtuar ZVRPP Bulqizë, sqaron:
Prefekti i Qarkut Dibër, ka bërë kërkesë padi nr. 770, datë 28.12.2018, drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, kundër vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka rrëzuar vendimet e KVVTP Prefektura e Qarkut Dibër.
Me shkresën e KVVTP Prefektura e Qarku Dibër, nr. 20107 prot. , datë 28.12.2018, "kthim përgjigje", drejtuar ZVRPP Bulqizë, ku sqarphet:
-Vendim nr.152, dt. 27.12.2018, për shqyrtimin e vlefshmerisë ligjore të AMTP-së nr. 7189/204, datë 15.04.2000, në emër të [redacted] ka vendosur rikonfirmimin e vlefshmerisë ligjore të AMTP-së.
Vendim nr.151, dt. 27.12.2018, për shqyrtimin e vlefshmerisë ligjore të AMTP-së nr. 7032, datë 02.02.2000, në emër të [redacted], ka vendosur rikonfirmimin e vlefshmerisë ligjore të AMTP-së, për 2 pasuritë e regjistruara në volumin 1, faqe 53 dhe volum 3, faqe 34, Fshati Homesh..
Vendim nr.150, dt. 27.12.2018, për shqyrtimin e vlefshmerisë ligjore të AMTP-së nr. 6972, datë 15.05.1999, në emër të [redacted] ka vendosur rikonfirmimin e vlefshmerisë ligjore të AMTP-së, Fshati Homesh..
Nga auditimi i zbatimit këtyre vendimeve si gjatë procedurës dhe pas dërgimit të tyre rezulton se:
-Masë kufizimi nuk është vendosur në asnjë rast për pasuritë e regjistruara me amtp, për të cilat vendimet shprehen për gjendjen në proces shqyrtimi deri në marrjen e formës së prere të vendimeve gjyqësore dhe ato që ka marrë KVVTP Prefekti Qarkut Dibër dhe dërguar në ZVRPP Bulqizë, *pra nuk është vendosur kufizim në KPP(seksionin "E")***,** *gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit.*
veprime këto ***në kundërshtim me*** *ligjin nr.* ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", neni 74 dhe nenet 45, 59 neni 60, me vetë Vendimet e Gjykatave dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", të ndryshuar, që ka sjellë si pasojë lënien në gjendje juridike me pronësi të mbajtësit të paligjshëm dhe për vendimet e gjykatës që kanë marrë formë të prerë, mos kalimin e titujve të pronësisë "Shtet",
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, sipas periudhave që kanë ushtruar detyrën e Regjistruesit të ZVRPP Bulqizë, mbahet me këto persona:
Z. Sh. A., me detyrë, Përgjegjës i Zyrës Vendore të ASHK Bulqizë, periudha nga 18.01.2018 e në vazhdim
Z. V. H., me detyrë, ish Regjistrues i ZVRPP Bulqizë, periudha 08.11.2013 deri 23.08.2017;
Z. D. H., me detyrë, ish Regjistrues i ZVRPP Bulqizë, periudha 31.08.2017 deri 18.01.2018;

***Lidhur sa trajtuar në faqet 43-45 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-Konstatimin nr. 14, datë 31.05.2019, janë paraqitur observacionet në rrugë elktronike dhe derguar me shkresen nr. 13.06.2019, të cilat kanë ardhur në KLSH bashkëlidhur me shkresën nr. 737/3, datë 04.07.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 207/3, datë 08.07.2019, të cilat* janë përmbledhur nga Përgjegjësi i Zyrës dhe dërguar prej tij, ku sqarohet:**
Konstatimi se për Vendimet e KV nuk është vendosur urdhër kufizimi nëpër kartela ku thoni se jane shkelur nenet 74,45,59,60 te ligjit 33/2012,gjykojmë se për këto vendime nuk ka asnje vendim gjykate të formës së prerë që na detyron të kryejmë veprime në seksionet përkatese te KPP..... .
Kurse neni 45 gjithashtu nuk zbatohet sepse siç thamë nuk disponohet ndonjë vendim gjykate.
Neni 59 citon se "Regjistruesi lëshon urdhër për regjistrimin e kufizimit me ose pa kërkesën e personit të interesuar" Në rastin konkret KV-ja ka dërguar nje vendim te sajin me karakter njoftimi ose vënie ne dijeni por nuk ka kërkuar vendosje kufizimi.
Neni 60 "Njoftimi dhe efekti i kufizimit". Në këtë rast arsyetimi ynë ka të bëjë me faktin se në qoftë se në bazë të neneve të mësipërme nuk mund të vendoset kufizim,atëhere nuk ka arsye per të bërë njoftim pronarit.
Nga arsyetimet e mësiperme nuk gjykojmë se është ezauruar shkelje e ndonjerit nga nenet që keni cituar,kur në asnje nga këto nene nuk cilësohet ndonje fjalë se kur apo si do të veprohet kur KV sjell një vendim pa u vleresuar nga gjykata dhe nuk shprehet se çfar kërkon nga Zyra e Regjistrimit.
Sqarimi i Grupit të auditimit:
Lidhur me observacionet e paraqitur, të sipërcituar, nuk merren në konsideratë pasi, nuk janë paraqitur argumente dhe prova të reja. Lidhur me argumentet e paraqitura nga ana juaj, sqarojmë ne i kemi diskutuar gjatë auditimit në subjekt, në mungesë të fakteve dhe dokumenteve të reja, konstatimet tona mbeten të pandryshuara.

Gjetje: ZVRPP Bulqizë, nuk ka krijuar një bashkëpunim dhe komunikim të vazhdueshëm ndërmjet ZVRPP Bulqize dhe Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Dibër, për rrjedhojë nuk ka informacion të plotë, lidhur me procedurën e ndjekur për shqyrtimin e vlerësimin e ligjshmërisë së AMTP-ve, deri në përfundim të procesit. Gjithashtu *nuk është vendosur masë kufizimi në asnjë rast, për pasuritë e regjistruara me amtp, për të cilat vendimet shprehen për gjendjen në proces shqyrtimi, deri në marrjen e formës së prerë të vendimeve gjyqësore dhe për ato që* KVVTP Prefekti Qarkut Dibër ka dërguar në ZVRPP Bulqizë, *pra nuk është vendosur kufizim në KPP(seksionin "E"), gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit, veprime këto* ***në kundërshtim me*** *ligjin nr.* ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", neni 74 dhe nenet 45, 59 neni 60, me vetë Vendimet e Gjykatave dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", të ndryshuar.
Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të rrisë bashkëpunimin dhe të kërkojë informacion të vazhdueshëm, nga institucionet përkatëse që kanë në kompetencë shqyrtimin e vlerësimin e ligjshmërisë së AMTP-ve, si dhe të kufizohen veprimet për pasuritë e përfituara me AMTP, *të cilat janë në proces shqyrtimi, deri në përfundimin e këtij procesi.*

Zona Kadastrale 2155 (Klenjë) dhe Zona Kadastrale 3947- Zogaj
Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit në lidhje me regjistrimin e pasurive të perfituara e perfituara nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 "Per Tokën", i ndryshuar, ligji 8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", ligji nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për toka buqësore të pandara" Zona Kadastrale 2155 (Klenjë) dhe Zona Kadastrale 3947- Zogjaj për periudhën nga data 01.01.2017 deri me datë 31.12.2018, në bazë të ***pikës 2, të programit të auditimit nr. 207/1, datë 01/04/2019*** u auditua dokumentacioni me zgjedhje i

regjistruar sipas ***AMTP-6463 dhe refencave 0003, 0004, 0005, 007 sipas regjistrit nr.4, zona Kadastrale 3947 dhe sipas refencave nr. 0007, 0008, 0009, 0010, 0011, 0012 dhe AMTP 1217, datë 10.08.1994 sipas regjistrave nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe*** 7, ***zona Kadastrale 2155-Klenje-Bulqizë*** dhe rezultoi se nga ***ZVRPP Bulqizë*** nuk rezulton të jenë zbatuar përcaktimet ligjore evidentuar në ligjin ***nr. 7501, datë 19.07.1991, i ndryshuar dhe VKM nr.994, datë datë 09.12.2015 bazuar në kërkesat e neneve 24-25 të ligjit 33/2012*** për regjistrimin e pasurive përfituar me me AMTP deri me datë 15.08. 2000 dhe regjistrimi i tyre në zbatim të ***VKM nr. 994, datë 09.12.2015*** e më pas sipas ***VKM nr. 253, datë 06.03.2013***, referuar pikës 1, shkronjat a,b,c,ç,d,dh, pikës 2, shkronjat a,b,c,ç,d, pikës 3, 3/1, 3/2,3/3,3/4, pikës 4 dhe 5 të ***VKM nr. 994, datë 09/12/2015"Regjistrimi i Akteve të Marjes në Pronësi"***, ku përcaktohet që:

"ZVRPP Regjistron AMTP në perputhje me nenet 24,25 të ligjit 33.2012 sipas pikës 1, pas verifikimit nëse nëse AMTP permban elementet e formes e permbajtjes sipas shkronjave a,b,c,ç,d,dh. Kur pasuria figuron e regjistruar në ZVRPP sipas pikës 2, verifikohet ligjshmëria dhe vepron sipas shkronjat a,b,c,ç,d të kësaj pike. Kur pasuria nuk figuron e regjistruar në ZVRPP sipas pikës 3, në pronësi të përfituesit me AMTP regjistrimi do të bëhet sipas pikës 3/1, shkronjat a,b,c dhe ç, pikës 3/2, shkronjat a,b dhe c, pikës 3/3, shkronjat a,b dhe c, pika ¾, shkronjat a,b dhe c. Kur pasuria figuron e regjistruar si pasuri shteterore sipas pikës 4 dhe AMTP ndodhet në ZVRPP atëhere veprohet sipas shkronjave a dhe b të kësaj pike. Kur lloji pasurisë me AMTP nuk perputhet me llojin e pasurisë regjistruar në KPP sipas pikës 5, ZVRPP kerkon informacion nga DAMT pranë KQ për zërin kadastral datë 01.08.1991. Planvendosjet e ngastrave duhet detyrimisht të jenë të konfirmuara nga Bashkia sipas pikës 6 e VKM nr. 994.

Zona Kadastrale nr. 3947, fshati Zogjaj-Bashkia Bulqizë

Bazuar në kërkesat e neneve 24-25 të ligjit 33/2012, "Për regjistrimin e pasurisë së palujtshme" u auditua dokumentacioni për pasuritë e regjistruara sipas ***refencave 0003, 0004, 0005, 0007 dhe AMTP 6463- ZK 3947(pasqyra nr 1 bashkëlidhur)*** dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi si më poshtë:

1. Sipas AMTP nr. 6463, datë 27.03.1997, Aplikim nr. 173-175, datë 23.03.1999 regjistruar në KPP provizore seksioni C, pasuria nr. ***1201/4, v. 4, faqe 40 zk 3947 fshati Zogjaj,*** një sipërfaqe për ***1100 m2, nga e cila truall 250 m2 dhe ndërtim 160 m2,*** në emër të [redacted] dhe ***lëshuar çertifikatë me datë 23.03.1999,*** duke nënshkruar në KPP vetë përfituesi [redacted] ***dhe jo juristi i ish-ZVRPP,*** ndërsa Çertifikata është lëshuar dhe nëshkruar nga ***ish-Regjistruesi A. R..***

-***Me refencën nr. 0003, datë 23.03.1999*** në KPP seksioni C regjistruar pasuria ***1201/4, v. 4, faqe 40 zk 3947*** fshati Zogjaj, në emër të [redacted] ***me*** Akt-Noterial nr. 429/177, datë 23.03.1999 kontratës së shitblerjes me shitës [redacted] dhe ka nëshkruar në KPP ***vetë përfituesi pasurisë*** [redacted] ***dhe jo Juristi i ish-ZVRPP,*** ndërsa çertifika nëshkruar nga ish-Regjisttruesi ***A. R..***

-***Me refencën nr. 0002, datë 15.04.2003,*** në seksionin C të KPP regjistruar pasuria ***1201/4, v. 4, faqe 40 zk 3947*** në emër të shoqërisë [redacted] ***shpk*** me seli ***Pallati Kulturës Tiranë*** dhe nënshkruar në KPP ***A. H. ish-specialist në ZVRPP,*** pa u verifikuar dokumentacioni në origjinë.

2. Sipas refencës 0003, datë 23.0-3.1999, Aplikim nr. 178-180, datë 23.03.1999 [redacted] regjistruar pasuria ***nr. 1201/4, v. 4, faqe 40 zk 3947*** në emër të [redacted] ***me*** Akt-Noterial nr. 429/177, datë 23.03.1999 sipas kontratës së shitblerjes me shitës [redacted] dhe ***nëshkruar KPP nga vetë perfituesi pasurisë*** [redacted] ***dhe jo Juristi i ish-ZVRPP,*** ndërsa çertifika nëshkruar nga ish-Regjisttruesi ***A. R..***

-Nuk ka inventar për praktikën e plotësuar.

Në dosje gjenden:

a.Kerkesë pa datë [redacted] për shitjen e pasurisë ***1201/4, v.4, faqe 40 zk 3947*** regjistruar në eër të tij për ***1100 m2*** sipërfaqe nga e cila ***250 m2 truall*** dhe ndërtim ***160 m2*** sipas ***AMTP 6463.***

b.Kërkesë nga [redacted] për blerjen e pasurisë ***1201/4, v.4, faqe 40 zk 3947*** regjistruar në emër të [redacted] me ***AMTP 6463*** dhe lëshuar certifikatë nga ***ish-Regjistruesi A. R..***

c.Me Akt-noterial KSHB nr. 429/177, datë 23.03.1999 me shitës [redacted] ***etj. dhe Blerës*** [redacted]

-Nga ish-ZVRPP në ***fletën 29, datë 23.03.1999 evidentohen kufizimet e pasurisë blerë*** nga ***Esat*** [redacted] nëshklruar nga Topografi ZVRPP [redacted].

-KPP regjistruar ***pasuria nr. 1201/4, v.4, faqe 40*** për sipërfaqen ***1100 m2, nga e cila 250 m2 truall dhe ndërtim 160 m2, ndërsa*** nëshkruar në seksionin C të Pronësisë [redacted] per leshimin e certifikatës sipas ***AMTP 6463*** dhe [redacted] për lëshimin e certifikatës sipas ***KSHB nr. 429/177, datë 23.03.1999 me shitës*** [redacted] ***etj. dhe Blerës*** [redacted]***, dhe nëshkruar KPP ish Regjistruesi A. R..***

-Plan rilevimi shka;lla 1:2500 pergatitur nga Rivlerësues [redacted] dhe miratuar nga Kordinatori ***G. H. datë 23.03.1999.***

-Çertifikata gjendjes Familjare për [redacted] ***datë 10.08.1991 për 8 persona,*** ndërsa në KSHB evidentohen ***6 persona*** dhe nuk evidentohen [redacted] të cilet evidentohen në çertifikatën e gjendjes familjare të datës 10.08.1991.

-Çertifika gjendjes familjare për [redacted] është me 3 persona.

-Vërtetim nga K/plaku [redacted] i ka shitur tokë [redacted] duke zbatuar gjithë proçedurat në zbatim të ligjit për shitblerjen e tokës Bujqësore.

3.Sipas refencës nr.0002, datë 23.03.1999, Aplikim 177-199, datë 23.03.1999 [redacted] regjistruar në KPP pasuria ***1201/1, v.4, faqe 37 zk 3947, për sipërfaqem 8050 m2 sipas Ln, nga e cila truall 750 m2 dhe ndërtim 750 m2*** në emër të [redacted] me Akt-Noterial nr. 428/176, datë 23.03.1999 sipas KSHB me shitës [redacted] dhe nëshkruar KPP nga vetë perfituesi pasurisë [redacted] ***dhe jo Juristi i ZVRPP,*** ndërsa çertifika nëshkruar nga ish-Regjisttruesi ***A. R..***

Praktika e regjistrimit nuk ka inventar.

Në dosje gjenden:

d.Kerkesë dattë 23.03.1999 e z. [redacted] për shitjen e pasurisë ***1201/1, v.4, faqe 37 zk 3947*** regjistruar në emer të tij per ***8050 m2*** siperfaqe nga e cila ***750 m2 truall*** dhe ndërtim ***750 m2*** sipas ***AMTP 6463.***

d.Kerkesë datë 23.03.1999 e z. [redacted] per Blerjen e pasurisë ***1201/1, v.4, faqe 37 zk 3947*** regjistruar në emer [redacted] per ***8050 m2*** siperfaqe nga e cila ***750 m2 truall*** dhe ndërtim ***750 m2*** sipas ***AMTP 6463.***

c.Me Akt-nterial KSHB nr. 428/176, datë 23.03.1999 me shitës [redacted] ***etj. dhe Blerës*** [redacted]

-Nga ZVRPP në ***fletën 29, datë 23.03.1999 evidentohen kufizimet e pasurisë blerë*** nga [redacted] nëshkruar nga Topografi ZVRPP [redacted].

-KPP e ***p. 1201/1, v.4, faqe 37 per siperfaqen 8050 m2, nga e cila 750 m2 truall dhe ndertim 750 m2*** nëshkruar në seksionin C të Pronësisë [redacted] për lëshimin e certifikatës sipas ***AMTP 6463*** dhe [redacted] për lëshimin e certifikatës sipas ***KSHB nr. 428/176, datë***

23.03.1999 me shitës [redacted] dhe ***Blerës*** [redacted] dhe nëshkruar KPP ish Regjistruesi A. R..
-Plan rilevimi shkalla 1:2500 përgatitur nga ***Rivlerësues*** [redacted] ***dhe miratuar nga Kordinatori G. H. datë 23.03.1999.***
-Çertifikata gjendjes Familjare për [redacted] datë 10.08.1991 per ***8 persona,*** ndersa në KSHB evidentohen ***6 persona dhe nuk evidentohen*** [redacted] të cilet evidentohen në çertifikatënre të datës 10.08.1991.
-Çertifika gjendjes familjare për [redacted] është me ***3 persona.***
-Vërtetim nga K/plaku [redacted] i ka shitur tokë [redacted] duke zbatuar gjithë proçedurat në zbatim të ligjit për shitblerjen e tokës Bujqësore.
4. Sipas refencës nr. 0004-0005, Aplikim nr. 627,629,630, datë 24.11.1999 vendosur hipotekë ligjore p.1201/4, v.4, faqe 40 me pronar [redacted] sipas kontratës së kredisë nr. 882/445, datë 16.11.1999 Banka Italo Shqiptare dhe Kredimares subjekti [redacted] regjistruaer në seksionin E të KPP me datë leshimi certifikate datë 24.11.1999 me perfaqësuar me prokure [redacted] nr. 368/123, datë 10.06.1999.
5. Sipas refencës nr. 0006-0007, Aplikim nr. 473-474-475, datë 11.05.2000 vendosur hipotekë ligjore p.1201/4, v.4, faqe 40 me pronar [redacted] sipas kontratës së kredisë nr. 991/140, datë 03.05.2000 [redacted] dhe Kredimares ***subjekti*** [redacted] me përfaqësues [redacted] regjistruar në seksionin E të KPP me datë leshimi certifikate datë 11.05.2000 me përfaqeeëues me prokure [redacted] ***nr. 368/123, datë 10.06.1999.***
6. Shoqëria [redacted] rezulton të jete regjistruar si person juridik ***me refencën nr. 0002, sipas vendimit e gjykates rrethit Tiranë nr. 20203, dattë 27.10.1998 dhe me vendimin nr. 20203/2/7436, datë 15.04.2003*** [redacted] ***bëhen ortak në shoqeri.***
Për sa evidentuar si më sipër arrihet në konkluzionin se:
ZVRPP Bulqizë ka regjistruar pasuri bazuar në bazë të ***AMTP nr.6463, pasuritë nr. 1200/4, v. 4, faqe 40 dhe p. 1200/1, v. 4, faqe 37 në kushtet e mungesës së AMTP në favor të subjektit privat*** [redacted] ***dhe në kushtet e mungesës së dokumenmntacionit ligjor të truallit dhe objekteve,*** në kundërshtim me dispozitat ligjore të percaktuara nga ligji 7501, datë 19.07.1991, i ndryshuar, me ligjin nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurisë së Palujtshme" dhe rregulloren e ZRPP nr. 184, datë 08.04.1999 si dhe me dispozitat ligjore të percaktuara nga VKM nr. 994, datë 05.09.2012.
Nga krahasimi i regjistrimeve të kryera në KPP volumi 4, në tërësi shkrimi evidentuar në regjistër nuk përputhet me shkrimin në fletet e KPP të pasurive ***nr. 1200/4, v. 4, faqe 40 dhe p. 1200/1, v. 4, faqe 37.*** Ndryshon shkrimi dhe ngjyra e kartelave të pasurive ***nr. 1200/4, v. 4, faqe 40 dhe p. 1200/1, v. 4, faqe 3*** me fletet e tjera të regjistrit dhe rezultojnë të nëshklruara nga ***ish-Regjisttruesi A. R., ndërsa të tjerat nuk rezultojnë të nëshkruara nga regjistruesi.***
Në KPP janë regjistruar pasuritë përfituar sipas ***AMTP nr . 6463*** (në kushtet e mungesës së saj), në emër të [redacted] i cili ka marë dhe certifikatë të nëshkruar nga ish- regjistrues ***A. R.***dhe me KSHB i janë kaluar në pronësi [redacted] dhe në KPP pasuritë nr. 1200/4, v. 4, faqe 40 dhe 1200/1, v. 4, faqe 37 rezultojnë të jenë regjistruar në seksionin "C" të pronësisë dhe në kolonën ku është shënuar data e lëshimit çertifikatës kanë nëshkruar ***vetë subjektet përfitues*** [redacted] ***në mënyrë abuzive dhe jo specilisti i ZVRPP, ndërsa Çertifikatat***

janë nëshkruar nga ish-Regjistruesi A. R. duke ligjëruar pasuri përfituar në mënyre abuzime nga subjektet private.

Kjo pasuri e regjistgruar në mënyre abuzive sipas regjistrimit në favor të [redacted] ***me AMTP*** dhe ***me KSHB në favor të*** [redacted] është vendosur hipotekë për garanci kredie në shumën prej 250,000 dollarë etj. dhe në vlera më të mëdha për kryerjen e aktivitetit [redacted]

Për këto pasuri janë bërë transaksione shitje në favor të personave të tretë duke bërë kontrata shitje në favor të subjektit [redacted] ***pa pasur origjinë pronësie e përfituar nga subjekti*** [redacted]**.** Eshtë regjistruar pasuri me AMTP në kushtet e mungesës dhe regjistruar dhe truall dhe ndërtime pa pasur dokumentacionin përkatës ligjor duke përfituar pronësinë në mënyre abuzive dhe duke e vënë hipotekë ligjore si garanci kredie në shumat 250,000 e 600,000 dollare e në favor të subjektit [redacted] e regjistruar dhe nëshkruar KPP nga ***ish-specilaist A. H.***për regjistrinmin e saj.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. ***A. R. me detyrë ish-Regjistrues***
2. ***A. H. ish specialist në ZVRPP***
3. ***T. H. me detyrë ish-specialiste***
4. ***N. L.me detyrë hartograf.***
5. ***G. H. me detyrë kordinator***

(Trajtuar më hollësisht në aktkonstatimin nr. 21, datë 31.05.2018 zona kadastrale 3947 dhe Projektraportin e auditmit dërguar me shkresën nr.737/1, datë.04.07.2019 dhe protokolluar në KLSH me nr. 207/3, datë 08.07.2019).

Kundrejt aktkonstatimit ***nr. 21, datë 31.05.2018 zona kadastrale 3947*** *dhe* ***Projektraportit të auditmit dërguar me shkresën nr.737/1, datë.04.07.2019 dhe protokolluar në KLSH me nr. 207/3, datë 08.07.2019*** *nuk rezulton të jenë dërguar* ***komente dhe shpjegime nga subjekti i Audituar.***

Gjetje nga auditimi pika 2: (Aktkonstatimi 21, datë 31.05.2019.)

Gjetje nga auditimi 1: Zyra Vendore ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë ka regjistruar pasuri bazuar në bazë të ***AMTP nr. 6463, pasuritë nr. 1200/4, v. 4, faqe 40 dhe p. 1200/1, v. 4, faqe 37 në kushtet e mungesës së AMTP në favor të subjektit privat Nurçe Leka dhe në kushtet e mungesës së dokumenmntacionit ligjor të truallit dhe objekteve,*** si dhe ka regjistruar transaksione, duke regjistruar ***KSHB nr. 428/176, datë 23.03.1999 me shitës*** [redacted], në kundërshtim me dispozitat ligjore të percaktuara nga ligji 7501, datë 19.07.1991, i ndryshuar, me ligjin nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurisë së Palujtshme" dhe rregulloren e ZRPP nr. 184, datë 08.04.1999 si dhe me dispozitat ligjore të përcaktuara nga VKM nr. 994, datë 05.09.2012.

Rekomandim: Zyra Vendore ASHK(ish-ZVRP Bulqizë), Përgjegjesi i Zyrës të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2014 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara, të evidentuara sipas refencave ***0003, 0004, 0005, 0007 dhe AMTP nr. 6463, zona Kadastrale 3947*** si pasuri të përfituara padrejtësisht në kushtet e mungesës së dokumenmntacionit ligjor të truallit dhe objekteve, si dhe në kushtet e regjistrimit të KSHB nr. 428/176, datë 23.03.1999 me shitës [redacted] etj. dhe Blerës [redacted] në mungesë të origjinës së pronësisë duke i kërkuar njëkohësisht OQV, Bashkisë Bulqizë vënien në dispozicion e ***AMTP 6463 Origjinale,*** duke njoftuar subjektet e tjera DAMT e subjektin përfitues të AMTP, ***në zbatim të pikës 2 të VKM nr. 994, datë 09.12.2012 "kur pasuria figuron e regjistruar në ZVRPP", shkronjat a,b,c,ç dhe d..***

Zona Kadstrale 2155 fshati Klenje.

Bazuar në kërkesat e neneve 24-25 të ligjit 33/2012, "Për regjistrimin e pasurisë së palujtshme" u auditua dokumentacioni për pasuritë e regjistruara ***sipas refencave nr. 0007, 0008, 0009, 0010, 0011, 0012 dhe AMTP 12117, datë 10.08.1994 dhe AMTP 12151 zona Kadastrale 2155-Klenje(pasqyra nr 2, Bashkëlidhur) regjistrimi i dokumentacionit sipas refencave paraqitet si më poshtë:***

Regjistrimi i pasurive në emër të [redacted] rezultoi të jete bërë pa u saktësuar më pasuritë sipas AMTP- dhe sipas LN dhe pa pasur çertifikatë të gjendjes familjare, ***në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.1995, pikat 1, 2 shkronjat a,b,c,ç, d dhe pika 3. Sipas AMTP nr. 12117, datë 10.08.1994*** regjistruar ***pasuria nr. 1338 Arë+truall në v.6, faqe 88,*** në emër të [redacted] me një sipërfaqe gjithsej ***1135 m2, nga e cila truall 250 m2 dhe ndërtim 83 m2,*** pa u bërë më parë saktësim, ***në kundërshtim me dispozitat ligjore e percaktuara nga VKM nr. 159, datë 21.03.2006 (fletore zyrtare nr. 26, faqe 871), nenin 193 të kodit civil dhe shkresën nr. 3191, datë 11.05.2012,*** mbasi nuk dokumentohet fakti i paraqitjes dhe i miratimit të listës emërore të pronareve të trojeve dhe shtëpive" para hyrjes në fuqi të VKM nr. 159, datë 21.03.2006 dhe mbas hyrjes në fuqi. Regjistrimi i truallit në zonat urbane është trajtuar sipas VKM nr. 432, datë 14.08.1995 në funksion të një ndërtimi ekzistues para datës 01.08.1991 dhe jo truall pa ndërtim, apo arë, bazuar në pikën 7 të shkresës nr. 3192/2, datë 14.05.2012 dërguar 35 ZVRPP nga ZQPP. Sipas AMTP ***nr, 12117, datë 10.08.1994*** pasuria nr. ***1338, v.6,faqe 88*** *evidentohet tokë arë+ truall me siperfaqe gjithsej* ***1135 m2, nga e cila truall 250 m2 dhe ndërtim 83 m2*** dhe ***nuk është bërë ndarje pasurie sipas zërave kadastral tokë arë dhe tokë truall***, në kundërshtimn me udhëzimin nr. 77, datë 08.05.2003 për plotësimin e KPP. Nuk rezulton të ketë dokumetacionin justifikues e vërtetues (listat e 0001), dhe dokumente të tjera që vertetojnë pronësinë, ***në kundështim me dispozitat ligjore e percaktuara nga VKM nr. 159, datë 21.03.2006(fletore zyrtare nr. 26, faqe 871), nenin 193 të kodit civil dhe shkresën nr. 3191, datë 11.05.2012,*** mbasi nuk dokumentohet fakti i paraqitjes dhe i miratimit të listës emerore të pronareve të trojeve dhe shtëpive" para hyrjes në fuqi të VKM nr. 159, datë 21.03.2006 dhe mbas hyrjes në fuqi.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjin_7501, dattë 19.07.1991 me ndryshime
Ligjin nr.33/2012, datë 29.04.2012, nenet 24-25
VKM nr.994, datë datë 09.12.2015 sipas kërkesave të nenit 24-25 të ligjit 33/2012
VKM nr. 159, datë 21.03.2006 dhe shkresën nr. nr. 3192/2, datë 14.05.2012 të ZQRPP.
Rregulloren 184, datë 08.04.1999.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

D. H. me detyrë Ish-regjistruese-Juriste.
R. Sh. me detyrë Hartograf

<u>2.Me refencën nr. 0012,</u> aplikim nr.1529, datë 15.09.2017 regjistruar ***pasuria nr. 81, v.1, faqe 81 sipas LN 2001 ZK 2155(fshati Klenjë) një sipërfaqe tokë Arë prej 1135*** në emër të [redacted] dhe në KPP nuk ka datë lëshimi certifikate nëshkruar nga ***D. H.. Nga auditmi i dokluimentacionit të regjistruar sipas refencës nr. 0012, për pasurinë nr. 81, v.1, faqe 81në emer*** [redacted] ***rezultoi se*** nga ana ***ish-ZVRPP Bulqizë*** ka regjistruar titullin e pronnësisë sipas ***aktit nr. 1,*** sipas dokumentacionit të paraqitur pa pasur relacion nga juristi dhe hartografi për verifikimin dhe pa vendim e urdhër të ish-regjistruesit, duke mosplotësuar shtojcat 1,2,3, ***në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elemeteve të akteve që verifikohen nga ZVRPP dhe proçedurës per nxjerrjen e urdhrit të Regjistruesit.***

AMTP dërguar pranë ZVRPP nga Bashkia rezulton nëshkruar nga punonjës të tjerë në emër të K/Bashkisë dhe jo nga vetë kryetari, në kapërcim të kopetencave në lidhje me dhënien e një titulli pronësie.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjin_7501, dattë 19.07.1991 me ndryshime
Ligjin nr.33/2012, datë 29.04.2012, nenet 24-25

VKM nr.994, datë datë 09.12.2015 sipas kërkesave të nenit 24-25 të ligjit 33/2012
VKM nr. 159, datë 21.03.2006 dhe shkresën nr. nr. 3192/2, datë 14.05.2012 të ZQRPP.
Rregulloren 184, datë 08.04.1999.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

D. H. me detyrë Ish-regjistruese-Juriste.
R. Sh. me detyrë Hartograf.

3.*Me refencën nr. 0009,* aplikim nr.1529, datë 05.09.2017 regjistruar pasuria ***nr. 92/1, v.6, faqe 250 sipas LN 2001 ZK 2155(fshati Klenjë) një sipërfaqe tokë Arë prej 2000 m2*** në emër të [redacted] dhe në KPP nuk ka datë lëshimi certifikate nëshkruar ***nga D. H..***

-Me shkresën nr. 4395, datë 07.08.2017 ZVRPP Bulqizë ka dërguar për verifikim ndër të tjere dhe AMTP-të me ***nr.1-6 ZK 2155 fshati Klenjë***, nëshkruar nga ***ish-Regjistruesi V. H.***

-KPP për pasurinë 92/1, v. 6, faqe 250 hapur për sipërfaqe tokë arë në emër ***të*** [redacted]

Sikurse evidentohet sipas dokumentacionit të vënënë dispozicion rezulton se nga ish-ZVRPP Bulqizë është regjistruar titulli i pronësisë sipas ***aktit nr. 2,*** pa pasur relacion nga juristi dhe hartografi për verifikimin e dokumentacionit dhe pa vendim e urdhër të ish-regjistruesit, duke mosplotësuar shtojcat 1,2,3, ***në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "për përcaktimin e elementeve të akteve që verifikohen nga ZVRPP dhe proçedurës per nxjerrjen e urdhrit të Regjistruesit.*** AMTP-të dërguar pranë ZVRPP nga Bashkia rezulton të nëshkruara nga punonjes të tjerë në emër të K/Bashkisë me siglen p/[redacted], në kapërcim të kopetencave në lidhje me dhënien e një titulli pronësie.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjin_7501, dattë 19.07.1991 me ndryshime
Ligjin nr.33/2012, datë 29.04.2012, nenet 24-25
VKM nr.994, datë datë 09.12.2015 sipas kërkesave të nenit 24-25 të ligjit 33/2012
VKM nr. 159, datë 21.03.2006 dhe shkresën nr. nr. 3192/2, datë 14.05.2012 të ZQRPP.
Rregulloren 184, datë 08.04.1999.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

D. H. me detyrë Ish-regjistruese-Juriste.
R. Sh. me detyrë Hartograf.

4.Me refencën nr. 0011, aplikim nr.1526, datë 05.09.2017 regjistruar pasuria ***nr. 136/1, v.7, faqe 5 sipas LN 2001-ZK 2155(fshati Klenjë) një sipërfaqe tokë Arë prej 1312 m2*** në emër të [redacted] dhe në KPP nuk ka datë lëshimi certifikate nëshkruar nga ***D. H..***

-Me shkresën nr. 4395, datë 07.08.2017 -ZVRPP Bulqizë ka dërguar për verifikim ndër të tjere dhe AMTP-të ***nr.1-6 ZK 2155 fshati Klenjë,*** nëshkruar nga ***ish-Regjistruesi V. H.***

-KPP për pasurinë 136/1, v. 7, faqe 5 evidenton një sipërfaqe tokë arë në emër të [redacted]

Sikurse evidentohet sipas dokumentacionit të vënënë dispozicion nga ish-ZVRPP Bulqizë është regjistruar titulli i pronësisë sipas ***aktit nr. 4,*** pa pasur relacion nga juristi dhe hartografi për verifikimin e dokumentacionit dhe pa vendim e urdhër të ish-regjistruesit, duke mosplotësuar shtojcat 1,2,3, ***në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "për përcaktimin e elementeve të akteve që verifikohen nga ZVRPP dhe proçedurës per nxjerrjen e urdhrit të Regjistruesit.*** AMTP e derguara në ZVRPP nga Bashkia rezulttojnë të nëshkruara nga punonjes të tjerë në emër të K/Bashkisë me siglen p/[redacted], në kapërcim të kopetencave në lidhje me dhënien e një titulli pronësie.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjin_7501, dattë 19.07.1991 me ndryshime
Ligjin nr.33/2012, datë 29.04.2012, nenet 24-25
VKM nr.994, datë datë 09.12.2015 sipas kërkesave të nenit 24-25 të ligjit 33/2012
Rregulloren 184, datë 08.04.1999.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

D. H. me detyrë Ish-regjistruese-Juriste.
R. Sh. me detyrë Hartograf.
5.Me refencën nr. 0010, aplikim nr.1525, datë 05.09.2017 regjistruar pasuria nr. 137/1, v.7, faqe 3 sipas LN 2001 ZK 2155(fshati Klenjë) një sipërfaqe tokë Arë prej 550 m2 në emër të [redacted] dhe në KPP nuk ka datë lëshimi certifikate nëshkruar nga D. H..
-Me shkresën nr. 4395, datë 07.08.2017 ZVRPP Bulqizë ka dërguar për verifikim ndër të tjerë dhe AMTP-të ***nr.1-6 ZK 2155 fshati Klenjë,*** nëshkruar nga ***ish-Regjistruesi V. H.***
-KPP për pasurinë 137/1, v. 7, faqe 3 evidenton një sipërfaqe tokë arë në emër ***të*** [redacted]
Sikurse evidentohet sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ish-ZVRPP Bulqizë është regjistruar titulli i pronësisë sipas ***aktit nr. 5,*** pa pasur relacion nga juristi dhe hartografi për verifikimin e dokumentacionit dhe pa vendim e urdhër të ish-regjistruesit, duke mosplotësuar shtojcat 1,2,3, ***në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "për përcaktimin e elementeve të akteve që verifikohen nga ZVRPP dhe proçedurës për nxjerrjen e urdhrit të Regjistruesit.***
AMTP e dërguara pranë ZVRPP nga Bashkia rezultojnë nëshkruar nga punonjës të tjerë në emër të K/Bashkisë me siglen p/[redacted] në kapërcim të kopetencave në lidhje me dhënien e një titulli pronësie.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
Ligjin_7501, dattë 19.07.1991 me ndryshime
Ligjin nr.33/2012, datë 29.04.2012, nenet 24-25
VKM nr.994, datë datë 09.12.2015 sipas kërkesave të nenit 24-25 të ligjit 33/2012
Rregulloren 184, datë 08.04.1999.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
D. H. me detyrë Ish-regjistruese-Juriste.
R. Sh. me detyrë hartograf
5.Me refencën nr. 0008, aplikim nr.1527, datë 05.09.2017 regjistruar pasuria ***nr. 122/3, v.6, faqe 248 sipas LN 2001 ZK 2155(fshati Klenjë) një sipërfaqe tokë Arë prej 2800 m2*** në emër ***të*** [redacted] dhe në KPP nuk ka datë lëshimi certifikate ***nëshkruar nga D. H.***
-Me shkresën nr. 4395, datë 07.08.2017 nga ZVRPP Bulqizë janë dërguar për verifikim ndër të tjere dhe AMTP nr.1-6 ZK 2155 fshati Klenjë, nëshkruar nga ***ish-Regjistruesi V. H.***
-KPP për pasurinë 122/3, v. 6, faqe 248 evidenton një sipërfaqe tokë arë në emër të [redacted]
Sikurse evidentohet sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ish-ZVRPP Bulqizë është regjistruar titulli i pronësisë sipas ***aktit nr. 3, datë 24.10.2016***, pa pasur relacion nga juristi dhe hartografi per verifikimin e dokumentacionit dhe pa vendim e urdhër të ish-regjistruesit, duke mosplotësuar shtojcat 1,2,3, ***në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "për përcaktimin e elementeve të akteve që verifikohen nga ZVRPP dhe proçedurës per nxjerrjen e urdhrit të Regjistruesit.***
AMTP e dërguara pranë ZVRPP nga Bashkia rezultojnë të nëshkruara nga punonjës të tjerë në emër të K/Bashkisë, me siglen p/[redacted], ndërsa në AMTP evidentohet ***pasuria 122/1,*** sipas inventarit dhe KPP evidentohet ***pasuria nr. 122/3*** me mosperputhje në nr., në kapërcim të kopetencave në lidhje me dhënien e një titulli pronësie.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
Ligjin_7501, dattë 19.07.1991 me ndryshime
Ligjin nr.33/2012, datë 29.04.2012, nenet 24-25
VKM nr.994, datë datë 09.12.2015 sipas kërkesave të nenit 24-25 të ligjit 33/2012
Rregulloren 184, datë 08.04.1999.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
D. H. me detyrë Ish-regjistruese-Juriste.

R. Sh. me detyrë Hartograf.

6. *Me refencën nr. 0007,* *aplikim nr.1519, datë 31.08.2017* regjistruar pasuria ***nr. 122/1, v.6, faqe 246 sipas LN 2001 ZK 2155(fshati Klenjë) një sipërfaqe tokë Arë prej 5000 m2*** në emër të [redacted] dhe në KPP nuk ka datë lëshimi certifikate ***nëshkruar nga D. H.***

-Me shkresën nr. 4395, datë 07.08.2017 nga ZVRPP Bulqizë janë dërguar për verifikim ndër të tjerea dhe ***AMTP nr.1-6 ZK 2155 fshati Klenjë,*** nëshkruar nga ***ish-Regjistruesi V. H.***

-KPP për pasurinë 122/1, v. 6, faqe 246 evidenton një sipërfaqe tokë arë në emër të [redacted]

Sikurse evidentohet sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ish-ZVRPP Bulqizë është regjistruar titulli i pronnësisë sipas ***aktit nr. 6,*** pa pasur relacion nga juristi dhe hartografi për verifikimin e dokumentacionit dhe pa vendim e urdhër të ish-regjistruesit, duke mosplotësuar shtojcat 1,2,3, ***në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve që verifikohen nga ZVRPP dhe proçedurës per nxjerrjen e urdhrit të Regjistruesit.***

AMTP-të e dërguara pranë ZVRPP nga Bashkia rezultojnë të nëshkruara nga punonjës të tjerë në emër të K/Bashkisë dhe në AMTP evidentohet ***pasuria 122/3,*** ndërsa sipas invenarit dhe KPP evidentohet ***p. 122/1,*** me mosperputhje në nr., në kapërcim të kopetencave në lidhje me dhënien e një titulli pronësie.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjin_7501, dattë 19.07.1991 me ndryshime
Ligjin nr.33/2012, datë 29.04.2012, nenet 24-25
VKM nr.994, datë datë 09.12.2015 sipas kërkesave të nenit 24-25 të ligjit 33/2012
Rregulloren 184, datë 08.04.1999.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
D. H. me detyrë Ish-regjistruese-Juriste.
R. Sh. me detyrë Hartograf.

7. Sipas AMTP 12151, datë 10.8.1994 në favor të [redacted] sipas regjistrimit fillestar regjistruar pasuritë 83 v.1, faqe 83-Arë 2531m2, p. 152, v.1, p. f.152-1861 m2, p.187, v.1, faqe 187-1848 m2, p.355, v.2, f. 105-1152 m2, p.451, v.2, f.201-2874 m2, p.961, v.4, f.211-2370 m2, p.988,v. 4,f.238- 898 m2, truall 250 m2 dhe ndërtesë 192 m2, p. 990, v.4, faqe 240-324 m2 gjithsej 13,858 m2, nga e cila truall 250 m2, dhe ndërtesë 192 m2, ndërsa sipas AMTP evidentohet 9050 m2, nga e cila truall 250 m2 dhe jo ndërtesë në emër të [redacted]

ZK 2155 Klenjë ***Pasqyra 3***

1	**Femi Ramadan Rapa**							
	Pasuria 83 v.1, faqe 83	12151	Arë	1500	2531	1031		
	Pasuria 152, v.1, faqe 152			1000	1861	861		
	Pasuria 187,v.1, faqe 187			1500	1848	348		
	Pasuria 961,v.4, faqe 211			2400	2370	970		
	Pasuria 988,v.4, faqe 238		Pemt.Tr		898		250	**192**
	Pasuria 990,v.4, faqe 240		Arë	-	324	324		

Sikuruse evidentohet në ***pasqyrën 3, ZK 2155 Klenjë*** bashkëlidhur këtij Raporti Perfundimtar auditimi rezulton të regjistruar pasuria ***988, v.4, faqe 238, Pemtore -Truall gjithsej 898 m2, nga e cila truall 250 m2 dhe ndërtesë 192 m2 regjistruar sipas AMTP nr. 1251, datë 10.8.1994.*** Nuk rezulton të jenë ndjekur proçedurat për saktësimin e sipërfaqeve të pasurive dhe nuk janë bërë shënimet në KPP. Nuk ka deklaratë noteriale për zbritjen e sipërfaqes më tepër sipas LN ***për 4808 m2, se kujt siperfaqe do ti zbritet.*** Nuk rezulton të jete kërkuar nga ZVRPP apo të jetë dërguar nga Bashkia Bulqizë dokumentacioni i saktësimit pasurisë nr. ***988, v. 4, faqe 238 Pemtore -Truall gjithsej 898 m2, nga e cila truall 250 m2 dhe ndërtesë 192 m2 regjistruar***

sipas AMTP nr. 1251, datë 10.8.1994, duke vepruar në kundërshtim me ***pikën 6 të VKM nr. 994, datë 09.12.2012.*** Nuk rezulton të ketë urdhra për korigjimin e pasurive sipas saktësimeve të kryera dërguar në ZVRPP. Regjistrimi i kësaj pasurie sipas ***AMTP 1251, datë 10.08.1994*** është bërë ***në kundërshtim me dispozitat ligjore të përcaktuara nga VKM nr. 159, datë 21.03.2006, fletore zyrtare nr. 26, faqe 871), nenin 193 të kodit civil, shkresën nr. 3191, datë 11.05.2012,*** mbasi nuk dokumentohet fakti i paraqitjes dhe i miratimit të listës emerore të pronareve të trojeve dhe shtëpive" para hyrjes në fuqi të VKM nr. 159, datë 21.03.2006 dhe mbas hyrjes në fuqi dhe regjistrimi i truallit në zonat urbane është trajtuar në funksion të një ndërtimi ekzistues para datës 01.08.11991 dhe jo truall pa ndërtim, apo arë, bazuar në pikën 7 të shkresës nr. 3192/2, datë 14.05.2012 dërguar 35 ZVRPP.

Sikurse evidentohet në dokumentacionin e vënë në dispozion rezulton se nga [redacted] ***është përfituar njëherë tokë bujqesore me AMTP nr. 1251, datë 10.8.1994 në siperfaqe 9050 m2, njekohësisht sipas regjistrimit fillestar 13,585 m2 dhe në vijim ka përfituar tokë me një sipërfaqe 7797 m2 bazuar në VKM nr. 253, datë 06.03.2013, pika 1 dhe 3 per perdoruesit faktik të tokës bujqesore që nuk janë pajisur me AMTP, duke vepruar në kundershtim me ligjin Nr. 10/2019 'Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008,"Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, neni 1, duke ndryshuar nenin 17, pika 1/1. Në Rastin konkret*** [redacted] ***është trajtuar njeherë si subjekt i përfitimit me tokë dhe është plotësuar me AMTP dhe njëkohësisht ka perfituar tokë me tepër gjithsej se sa regjistrimi fillestar 2989 m2(7797 + 9050)-13585 m2.***

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjin_7501, dattë 19.07.1991 me ndryshime
Ligjin nr.33/2012, datë 29.04.2012, nenet 24-25
VKM nr.994, datë datë 09.12.2015 sipas kërkesave të nenit 24-25 të ligjit 33/2012
Rregulloren 184, datë 08.04.1999.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
D. H. me detyrë Ish-regjistruese-Juriste.
R. Sh. me detyrë Hartograf.
(Trajtuar më hollesisht në aktkonstatimin nr. 17, date 31.05.2018 zona kadastrale 2155 dhe Projektraportin ne auditimit derguar me shkresën nr.737/1, datë 04.07.2019 dhe protokolluar në KLSH me nr. 207/3, datë 08.07.2019).

Komente dhe shpjegime nga subjekti i Audituar: *Subjekti i Audituar* ***Sh. A.(me detyrë pergjegjës sektori) sipas shkresës nr. 661, datë 13.06.2019*** *ka bërë komente dhe shpjegime në lidhje me problematikat e trajtuara në akt konstatimin nr. 17, datë 31.05.2019 per pasuritë e regjistruara sipas* ***refencave 0007, 0008, 0009, 0010, 0011 dhe sipas AMTP nr. 1217, datë 10.08.1994,*** *me pretendimin se pasuritë e regjistruara nga pronari Ramazan Sherif Baba nuk janë regjistruar nga ish-ZVRPP Bulqizë por nga kompania me regjistrim fillestar dhe sipas konstatimit rezulton se më pak sipas LN 1206 m2. Ndersa per pasurinë regjistruar në v. 6, faqe 88 per truall +arë subjekti shpjegon se është sipas regjistrimit fillestar dhe mungesa e listave të 0001 nuk është përgjegjësi e punonjësve aktual. Ndërsa fakti që lëshimi i certifikatës është bëre pa saktësim nuk perbën shkelje të VKM nr. 994, datë 09.12.2015. Kurse regjistrimi pasurive sipas refencave 0012, 0008, 0007, 0009, 0010, 0011 ka të bëjë me regjistrimn e pasurive sipas shkresave të bashkisë në zbatim të VKM nr. 253,datë* datë datë 06.03.2013, *pika 1 dhe 3* për përdoruesit faktik të tokës bujqësore. Për sa konstatuar në lidhje me hartimin e relacionit per regjistruesin dhe marjen e vendimit nga Regjistruesi nuk është e qartë se përse duhet relacioni. Ndërsa fakti që në emër të K/Bashkisë ka firmosur punonjës tjetër nuk perbën shkak per refuzimin e regjistrimit të aktit përderisa ka vulën e institucionit.

Qëndrimi i grupit të auditimit *në lidhje me komentin dhe shpjegimet e subjektit të Audituar* ***Sh. A.(me detyrë pergjegjës sektori) sipas shkresës nr. 661, datë 13.06.2019*** *në lidhje me problematikat e trajtuara në akt konstatimin nr. 17, datë 31.05.2019 për pasuritë e regjistruara sipas* ***refencave 0007, 0008, 0009, 0010, 0011. 0012, sipas AMTP 12117, dhe AMTP nr. 12151,***

datë 10.08.1994, *në emër* ***të*** [redacted] *është se sikur edhe një pasuri të regjistrohet sipas AMTP duhet më parë bërë saktësimi LN-AMTP(përcaktohet ndryshimi) pastaj vijohet me regjistrim. Sikurse evidentohet në aktkonstatimin dhe këtë Raport përfundimtar auditmi rezulton se* [redacted] *ka perfituar padrejtësisht mbi norme nje siperfaqe* ***prej 2989 m2, në kundërshtim me dispozitat ligjore të percaktuara nga ligji 7501, datë 19.07.1991 dhe me dispozitat ligjore të përcaktuara nga VKM nr. 994, datë 05.09.2012, në ligjin Nr. 10/2019 'Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008,"Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, neni 1, duke ndryshuar nenin 17, pika 1/1. Përsa pretendohet nga subjekti audituar nuk meren në konsideratë edhe*** pretendimet e paraqitura per regjistrimin sipas akteve ***1,2,3,4,5 dhe 6 në zbatim të VKM nr. 253, datë 06.03.2013 pika 1 dhe 3*** për përdoruesit faktik të tokës bujqësore sipas ***refencave nr. 0007, 0008, 0009, 0010, 0011, 0012*** dhe aktet rezultojnë të nëshkruara nga punonjës të tjere ***në kapërcim të kopetencave që jep ligji për nënshkrimin e titujve të pronësisë, në emër të kryetarit të Bashkisë.***

Gjetje nga auditimi pika 2: (Aktkonstatimi 17, datë 31.05.2019).

Gjetje nga auditimi 2: Zyra Vendore e ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë ka regjistruar në emër të ***Fehmi Rapa 9050 m2*** bazuar në AMTP nr. 12151, datë 10.08.1994 dhe një sipërfaqe prej ***7797 m2*** përfituar në zbatim të VKM nr. 253, datë 06.03.2013, pika 1 dhe 3 për përdoruesit faktik të tokës bujqësore, duke përfituar [redacted] një sipërfaqe ***mbi normë 2989 m2, në kundërshtim me dispozitat ligjore të percaktuara nga ligji 7501, datë 19.07.1991 dhe me dispozitat ligjore të përcaktuara nga VKM nr. 994, datë 05.09.2012, në ligjin Nr. 10/2019 'Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008,"Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, neni 1, duke ndryshuar nenin 17, pika 1/1.***

Regjistruar p. 988, v.4, faqe 238 Pemtore -Truall gjithsej 898 m2, nga e cila truall 250 m2 dhe ndërtesë 192 m2 sipas AMTP nr. 1251, datë 10.8.1994 në favor të [redacted], në kundërshtim me dispozitat ligjore e percaktuara nga ***VKM nr. 159, datë 21.03.2006(fletore zyrtare nr. 26, faqe 871), nenin 193 të kodit civil, shkresën e ZQRPP nr. 3191, datë 11.05.2012, VKM nr. 159, datë 21.03.2006 dhe mbas hyrjes në fuqi.*** Regjistruar pasuri në emë emër të Ramadan, Katana dhe Femi Rapa pasuri Tokë Bujqësore sipas akteve ***1,2,3,4,5 dhe 6 në zbatim të VKM nr. 253, datë 06.03.2013 pika 1 dhe 3*** për përdoruesit faktik të tokës bujqësore sipas ***refencave nr. 0007, 0008, 0009, 0010, 0011, 0012*** dhe aktet rezultojnë të nëshkruara nga punonjës të tjere ***në kapërcim të kopetencave që jep ligji për nënshkrimin e titujve të pronësisë, në emër të kryetarit të Bashkisë.*** Nga ana e ZVRPP Bulqizë nuk rezulton të jenë kryer saktësimet për pasuritë e regjistruara, për mospërputhjen e sipërfaqes përcaktuar në AMTP dhe sipërfaqes sipas LN. Nuk ka deklaratë noteriale per zbritjen e sipërfaqes më tepër sipas LN për ***4808 m2(13,858 m2 -.9050 m2)***, se kujt siperfaqe do ti zbritet duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2012 "kur pasuria figuron e regjistruar në ZVRPP", shkronjat a,b,c,ç dhe d.

Rekomandim: Zyra Vendore e ASHK(ish ZVRPP) Bulqizë), Përgjegjësi i Zyrës të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara, të evidentuara sipas refencave ***nr. 0007, 0008, 0009, 0010, 0011, 0012 si pasuri të nëshkruara nga punonjës të tjerë për aktet 1,2,3,4,5,6 dhe jo nga vete kryetari i Bashkisë dhe të kufizohet per siperfaqen 2989 m2, e perfituar më teper si siperfaqe mbi normë, në kundershtim me Nr. 10/2019"Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008,"Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, neni 1, për ndryshime në nenin nenin 17, pika 1/1, njëkohësisht ti kërkohet bashkisë*** saktësimi i pasurive të regjistruara, për mospërputhjen e sipërfaqes përcaktuar në AMTP dhe sipërfaqes sipas LN, diferencës ***4808 m2(13,858 m2-9050 m2)***, duke njoftuar subjektet e tjera DAMT e subjektin përfitues të AMTP, ***në zbatim të pikës 2 të VKM nr. 994, datë 09.12.2012 "kur pasuria figuron e regjistruar në ZVRPP", shkronjat a,b,c,ç për pasuritë evidentuar me AMTP dhe LN***

referencat për pasuritë sipas AMTP nr. 12151, datë 10.08.1994, evidentuar sipas regjistrave nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7, ***zona Kadastrale 2155-Klenje-Bulqizë.***

ZK 8611

Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit mbi regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituar nga ligji nr. 7501, datë 17.09.1991 "Për tokën", të ndryshuar, u konstatua se pasuritë e paluajtshme, janë ndarë dhe janë regjistruar në kartelat e pasurisë së paluajtshme duke lëshuar certifikata pronësi me të meta e mangësi sipas pasqyrës më poshtë:

- Referencë nr. 00632/02122 , ZK 8611;
Me kërkesë nr. 340, datë 11.03.2019, z. [redacted] ka kërkuar kopje kartele, fragment harte dhe dublikat certifikate.
Në KPP volum 5, faqe 1173, është regjistruar pasuria nr. 1/14/3, arë me sipërfaqe 5350 m^2 arë dhe 1840 m2 sipas referencë 632 në pronësi të, z. Hajredin Adem Shehu, pasuri e regjistruar sipas AMTP nr. 2641, kaluar si pas referencë nr. 2122 me kontratë shitblerje tek [redacted], kjo pasuri rrjedh nga volum 5 faqe 169 pasuria nr. 1/13/3 e llojit shesh me sipërfaqe 1645, volum 5 faqe 171 pasuria nr. 1/14/1 e llojit shesh me sipërfaqe 195, volum 5 faqe 155 pasuria nr. 1/13/2 e llojit shesh, volum 4 faqe 11 pasuria nr. 1/13 e llojit shesh.
ZVRPP Bulqizë ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur ***AMTP nr.*** 2641 ***është lëshuar dhe i përket ZK 3694 Vajkal (rurale) dhe është regjistruar në ZK8611 Bulqizë e re (urbane). Gjithashtu është ndryshuar zëri kadastral pronave që i shërbejnë një interesi publik nga Shesh në Arë***.
Veprim në papajtueshmëri me shkronjën "e" neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", shkronjën "ç" pika 2.2, të VKM nr.994, datë 09.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Për veprime te mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z. V. H. me detyrë ish/regjistrues.

- Referencë nr. 002280/02200/02201 , ZK 8611;
Me kërkesë nr. 105, datë 16.01.2017, z. [redacted] ka kërkuar kopje kartele, fragment harte dhe certifikate regjistrim kalim të pronësisë me anë të ligjit etj.
Në KPP volum 5, faqe 209, është regjistruar pasuria nr. 1/191, truall me sipërfaqe 300 m^2 objekt 156 m2 pasuri e cila vjen nga volum 4 faqe 53 pasuri e cila mbyllet dhe shkon volum 5 faqe 208 faqe 209. Në volum 5 faqe 208 është regjistruar sipas referencë nr. 02201 pasuria nr. 1/190 arë me sipërfaqe 1842 m2 në pronësi [redacted] etj, regjistruar sipas AMTP nr. 117 datë 18.05.2015 dërguar për regjistrim sipas shkresës nr. 784 prot datë 03.06.2015 nga Bashkia Bulqizë për fshatin Vajkal.
ZVRPP Bulqizë ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur ***AMTP nr.*** 117 ***është lëshuar dhe i përket ZK 3694 Vajkal (rurale) dhe është regjistruar në ZK8611 Bulqizë e re (urbane).***
Veprim në papajtueshmëri me shkronjën "e" neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", shkronjën "ç" pika 2.2, të VKM nr.994, datë 09.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Për veprime te mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z. V. H. me detyrë ish/regjistrues.

- Referencë nr. 00167/0168, ZK 1660;
Me kërkesë nr. 57, datë 13.01.2017, z. [redacted] ka kërkuar regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë etj.
Në KPP volum 1, faqe 67, është regjistruar pasuria nr. 67, pemtore+truall me sipërfaqe 700 m^2 truall 200 m2 sipas AMTP nr.26723 pasuri e cila shkon volum 7 faqe 190 nr.67/1 në pronësi E. K. etje.
ZVRPP Bulqizë ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur ***AMTP nr.*** 26723 ***i mungon nënshkrimi i kryetarit të komisionit të tokës në fshat si dhe nënshkrimi i përfituesit, gjithashtu është korrigjuar numri i aktit .***
Veprim në papajtueshmëri me shkronjën "e" neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", shkronjën "ç" pika 2.2, të VKM nr.994, datë 09.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Për veprime te mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z. V. H. me detyrë ish/regjistrues dhe znj. D. H. me detyrë juriste.

- Referencë nr. 000439/0440, ZK 1660;
Me kërkesë nr. 926, datë 13.08.2018, z. [redacted] ka kërkuar regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë etj.
Në KPP volum 2, faqe 112, është regjistruar pasuria nr. 357, arë me sipërfaqe 1250 m^2 , kartela mbyllet shkon volum 7 faqe 211 pasuria nr. 357/1 me sipërfaqe 1100 m2, regjistruar sipas AMTP nr. 26729 datë 01.08.1995.
ZVRPP Bulqizë ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur ***AMTP nr.*** 26729 ***ka korrigjime në përmbajtjen e saj, janë korrigjuar sipërfaqja totale dhe numri i aktit.***
Veprim në papajtueshmëri me shkronjën "e" neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", shkronjën "ç" pika 2.2, të VKM nr.994, datë 09.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Për veprime te mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z. Sh. A. me detyrë ish/regjistrues dhe znj. D. H. me detyrë juriste.

- Referencë nr. 000393/0398, ZK 1660;
Me kërkesë nr. 266, datë 02.02.2017 dhe 02.02.2017 z. [redacted] ka kërkuar regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë etj.
Në KPP volum 3, faqe 118, është regjistruar pasuria nr. 608, arë me sipërfaqe 2600 m^2 sipas AMTP dhe 4083 sipas LN, pasuria nr. 620, pemtore+truall me sipërfaqe 1900 m^2 sipas AMTP dhe 2125 sipas LN, regjistruar sipas AMTP nr. 26756 datë 01.10.1995 kryer veprime në regjistrat e pasurive të paluajtshme datë 10.02.2017.
ZVRPP Bulqizë ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur nuk është bërë bilanci i sipërfaqes totale që përmban ***AMTP nr.*** 26729 ***me sipërfaqen e LN duke përfituar 1708 m2 më tepër se akti i fitimit të pronësisë.***
Veprim në papajtueshmëri me shkronjën "e" neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", shkronjën "ç" pika 2.2, të VKM nr.994, datë 09.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

Për veprime te mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z. V. H. me detyrë ish/regjistrues dhe znj. D. H. me detyrë juriste.

- Referencë nr. 000401/0336, ZK 1660;
Me kërkesë nr. 523, datë 02.02.2017 dhe 08.03.2017 z. [redacted] ka kërkuar regjistrimin e kontrat dhurimi etj.
Në KPP volum 6, faqe 4, është regjistruar pasuria nr. 1220, arë me sipërfaqe 7220 m^2 , volum 5 faqe 222 pasuria nr. 1190, volum 5 faqe 224 pasuria nr. 1192, volum 5 faqe 249 nr. 1215, sipas AMTP dhe 26798 paisur me certifikatë pronësie 27.02.2017.
ZVRPP Bulqizë ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur nuk është bërë bilanci i sipërfaqes totale që përmban ***AMTP nr.*** 26798 ***duke regjistruar me tepër nëpër kartela se akti sipërfaqen prej 7312 m^2 më tepër se akti i fitimit të pronësisë. Gjithashtu më datë 01.08.1991 sipas certigikatës familja ka qën e përbërë nga 2 pjestar dhe norma përfrym për fshtin Fush-Bulqizë ka qënë 2220 m2 që i takonte në total 4440 m2, ndërsa AMTP është plotësuar me 16546 m2.***
Veprim në papajtueshmëri me shkronjën "e" neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", shkronjën "ç" pika 2.2, të VKM nr.994, datë 09.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Për veprime te mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z. V. H. me detyrë ish/regjistrues dhe znj. D. H. me detyrë juriste.
Lidhur sa sipër trajtuar është mbajtur Akt-Konstatimi nr. 6, datë 31.05.2019, për të cilin në fazën e hartimit të projekt raportit, nuk janë paraqitur observacione nga personat e atakuar të cilësuar si përgjegjës.

Observacioni i paraqitur nga ZVASHK Bulqizë nr. 661 prot datë 13.06.2019, përgjegjësi sektorit Sh. A. në lidhje me aktkonstatimin dhe projektraportin e auditimit

Ref. 632,2122 , Zk.8611,konstatohet se Amtp nr.26491 i përket Zonës kad.3694 Vajkal dhe është regjistruar në ZU, ZK.8611 .Lidhur me këtë fakt akti i mësiperm është lëshuar në kohën kur Kjo ZK nuk ka qenë azhornuar (ZK.3694) dhe nuk ka patur nje material hartografik me vijë kufizuese të qartë midis ZU të qytetit dhe fshatit Vajkal,per arsye se Qyteti i ri bulqize është krijuar si qytet afer viteve 90 dhe më përpara kjo zonë ka qenë fermë..ZK.8611 (qyteti bulqizë) është bërë regjistrimimi fillestar në vitin 1996,dhe projekti i asaj kohe ka vendosur gabim kufirin duke e futur nje pjesë të tij në Zonën e fshatit vajkal që eshte bere regj.fillestar ne vitin 2001 pra 5 vjet më vonë . Gjithashtu kjo AMTP ka dhe formularin 6 në DAMT,si dhe skicen e vjeter kadastrale të reformes se asaj kohe. Por jo vetem ky Akt ,por edhe akte te tjera pavaresisht se jane leshuar ne fshatin Vajkal nga projekti jane zbardhur ne kete ZK(8611),qe siç thame ka rezultuar qe projekti ka azhornuar me gabime kufirin ndares midis qytetit dhe fshatit Vajkal. Pra kjo Zone pavaresisht azhornimit gabim te kufirit në HTR, quhet Vajkal.Keto gabime nuk u takojne punonjesve aktuale të audituar në këtë Zyre,por ish projektit NMPSRPP- me seli në Laprakë.Sa i perket faktit se është ndryshuar Zëri kad. Nga shesh ne "are" dhe sipas percaktimit tuaj eshte shkelur VKM nr.994 dt.9.12.2015 dhe ligji 33/2012,sjellim faktin se regjistrimi i ketij Akti në origjine (ref e mësiperme 632 që kemi në shqyrtim)është bërë me dt.28.04.2014, pra para daljes se VKM-së nr.994 dt.9.12.2015, që ju citoni se është shkelur,dhe për zerin kadastral veprimet e kryera jane bazuar ne Udhezimin nr.2 dt.13.6.2013 te Keshillit te Ministrave ku ne piken 6 citohet se :
*"**Në cdo rast,në se ZRPP konstaton se lloji i pasurisë të dhënë me Amtp nuk përputhet me llojin e pasurisë që figuron i regjistruar në kartelën e pasurisë se paluajtshme me kerkesë të***

mbajtësit të titullit të pronësisë pas konfirmimit të marrë nga komuna/bashkia,procedon me korigjimin e llojit të pasurisë,duke e saktësuar atë sipas llojit të percaktuar ne Amtp"
Në arsyetim të kuadrit të lartpermendur pas konfirmimit të marrë nga bashkia Zrpp-ja Bulqizë ka korrigjuar zërin kadastral.Bashkëlidhur shkresa nr.446 e Bashkisë Bulqize,AMTP nr.26491,dhe plan rilevimi ku është konfirmuar edhe Zëri kad,"Are" .
Ref.2280,2200,2201 Zk.8611,për Z.[redacted],problemi që konstatohet është si rasti më sipër,pra që parcela sipas Amtp ndodhet në ZU.,problem të cilin e shtjelluam në fillim të observacionit të këtij akt konstatimi.
Ref 167,168;konstatoni se ZRPP ka ofruar shërbimin e regjistrimit të trashëgimise ne kushtet kur ne AMTP mungon nënshkrimi i kryetarit të kom të nd,tokës në fshat,sqarojme se Akti në fjale është dërguar per konfirmim bashkise dhe me shkresen e saj nr.131//1 dt.17.01.2017, ka sjellur konfirmimin e AMTP-se dhe planit te rilevimit dhe me pas është bërë regjistrimi i trashëgimisë.(bashkelidhur po ju percjellim Shkresen nr.131/1 Prot dt.17.01.2017 "Kthim pergjigje" të bashkise Bulqize si dhe planim e rilevimit të konfirmuar nga kryetari i fshatit dhe kryetari i bashkise Bulqizë [redacted]
Ref. 393, 398,Zk.1660 [redacted] në këtë dosje sikurse përshkruani është ofruar shërbimi (në këtë rast trashegimi ligjore) në kushtet kur sipas AMTP-se nr.26729 ka 1708 m2 ne LN me shume se Akti.Lidhur me këtë gjykojmë se :
regjistrimi i aktit të trashegimise nuk është tjetërsim prone,siç jane kontratat e shitjes ,dhurimit,etj.,por kalim tek trashëgimtaret e ligjshëm. Që ky veprim nuk ështe kalim prone e vërteton edhe fakti që regjistrimi i këtyre akteve nuk ka efekte fiskale.
Për të bërësaktësimin e pronës pra për tëbërë dorëheqjeper një pasuri apo pjesëtësaj,veprimiet noteriale dhe cdo veprim tjeter qofte per kompletimin e dokumentacionit ligjor dhe teknik,qofte per veprimet qe do te kryhen tek noteri doreheqja ne kete rast bëhet nëpërmjet trashëgimtareve. Noteri nuk bën akte noteriale pa patur certifikaten e pronësise se pronarit të regjistruar në seksionin "C" të KPP,që në këtë rast është person i vdekur.Kështu që detyrimisht duhet të regjistrohet më perpara trashëgimia që të hapet rruga kryerjes se veprimeve të saktësimit,nëpërmjet trashëgimtarëve.Këtë qëllim ka patur dhe regjistrimi i Aktit të trashegimise të regjistruar. Ne këtë rast trashegimtaret nuk janë pajisur me certifikate pronësie.
Sqarimi i grupit të auditimit. Observacioni juaj nuk meret në konsideratë pasi:
Në të gjitha rastet kemi të bëjmë me kryerjen e veprimeve nër regjistrat e pasurive të paluajtshme të cilat kërkojnë verifikim teknik dhe ligjor për cdo rast, gjithashtu janë amtp të cilat janë lëshuar për zonën rurale dhe jan regjistruar në zonën urbane, ndryshimi i kategorisë së tokës dhe zërin kadastral bëhet nga ministria e linjës dhe Vendim të Këshillit të Ministrave.

1. <u>Referenca 00332, ZK 2898 ''Peladhi".</u>
Sipas referencës 00332, datë 20.07.2017, është kryer regjistrimi në emër të [redacted] kontratë dhurimi nr. 1218, datë 10.07.2017, destinacioni "Arë", pasuria nr. 11/4, vol. 6, f. 36, lëshuar certifikatë datë 27.07.2017, sipërfaqe e parcelës arë 2.467.0 m^2,. Regjistrues V. H..
Përfituesi i tokës bujqësore me AMTP nr 9406 datë 20.12.1993 rezulton shtetasi [redacted] Kjo pasuri është e regjistruar në emrin e [redacted] në zonën kadastrale nr 2898, me nr pasurie 11/4, në volumin nr 6, faqe 36 dhe certifikatë pronësie nr 873 datë 23.05.2017. Pronësia e tokës bujqësore e llojit "Arë" është përfituar sipas ligjit nr 7501 datë 19.07.1991 "Për tokën".

Në kontratën noteriale me nr. 1218, datë 10.07.2017, thuhet se shtetasi [redacted] dhurojnë sipërfaqen e tokës prej 2467 m2 shtetases gjermane [redacted] me kombësi shqiptare. Shtetësja gjermane [redacted] ka hequr dorë nga nënshtetësia shqiptare si kusht i domosdoshëm për të përfituar atë gjermane dhe rrjehimisht ka humbur cdo të drejtë juridike që i takon shtetasve shqiptarë.

ZRPP Bulqizë ka vazhduar me procedurën e regjistrimit të parcelës "Arë" në favor të shtetases gjermane [redacted], në kundërshtim me Ligjin Nr. 8337, datë 30.4.1998 "*Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave*", **Neni 4** "*Kalimi i së drejtës së pronësisë të tokës Bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave nuk iu njihet personave fizikë dhe* ***juridikë të huaj****"*. Personat fizikë dhe juridikë të huaj gëzojnë të drejtën e marrjes së saj me qira deri në 99 vjet.

2. <u>Referenca 00340, ZK 2898 ''Peladhi".</u>

1- **Në emër të** [redacted] sipas AMTP nr. 9400, datë regjistrimi 20.12.1993, janë regjistruar pasuritë si vijon nr. 125/5, vol. 2, fq. 44, zk. 2898, me sip. 1500 m2, e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 123/2, vol. 2, fq. 37, zk. 2898, me sip. 320 m2 e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 108/9, vol. 2, fq. 1, zk. 2898, me sip. 50 m2 e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 9/20, vol. 1, fq. 32, zk. 2898, me sip. 2750 m2, e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 16/1, vol. 1, fq. 53, zk. 2898, me sip. 900 m2 e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 229/4, vol. 3, fq. 161, zk. 2898, me sip. 963 m2 e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 362/1, vol. 5, fq. 129, zk. 2898, me sip. 310 m2, e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 349/1, vol. 5, fq. 96, zk. 2898, me sip. 640 m2 e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 326/4, vol. 5, fq. 49, zk. 2898, me sip. 740 m2 e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie. hedhur veprimet në kartela gjatë vitit 2012 nga z. S. V., me detyrë ish-Juriste, miratuar nga z. B. S. me me detyrë ish-Regjistrues. Pra në total sipas AMTP nr 9400 [redacted] ka përfituar **8143 m2** tokë bujqësore, **720** m2 tokë pemëtore dhe **200** m2 truall.

Referuar shkresës së Komunës Fush-Bulqizë datë 01.08.1991 lëshuar nga përgjegjësi i zyrës së administrimit të tokës [redacted] norma për frymë për fshatin Peladhi është 1813 m2. Sipas certifikatës familjare që tregon gjëndjen familjare të datës 01.08.1991, përbehet nga 3 pjestarë, pra i takon gjithësej **5439 m2** *(3*1813 m2)* tokë bujqësore, ndërkohë figuron nga regjistrimet në KPP është përfituar 8863 *m2* tokë bujqësore referuar AMTP 9400. Ka një diferencë prej 3424 *m2 të përfituar më shumë se norma për frymë nga familja bujqësore.*

Nga verifikimet e mëtejshme të dokumentacionit të komunës Fush-Bulqizë , zona Peladhi rezulton se në emër të [redacted] është lëshuar **AMTP me nr 25** datë 23.08.2018 me vendim të këshillit të bashkisë Bulqizë nr 67 me pronësi toke gjithsej 1747 m2 firmosur nga kryetari i Bashkisë Bulqizë [redacted]**.** Kjo tokë mban nr pasurie 325/15, vol. 5, fq. 28, zk. 2898, me sip. 1747.0 m2 e llojit arë, lëshuar certifikatë pronësie datë 27.09.2019. Gjendja familiare e përfituesit rezulton e pandryshuar, me përbërjen familjare prej 3 pjestarë,

ZVRPP Bulqizë pa saktësuar numërin e AMTP-ve të arkivuara në ZVRPP Bulqizë dhe sipërfaqen totale të regjistruar në KPP për [redacted] ka vazhduar procedurën e regjistrimit të pasurisë dhe pajisjes së subjektit Zenel Ali Disha me certifikatë pronësie sipas kërkesës së bërë në datë 11.09,2018 Kërkesat janë firmosur nga ish-regjistruesja D. H..

Zrpp ka vazhduar me regjistrimin e pasurisë së subjektit [redacted] duke tjetërsuar pasurinë shtet sipas LN 2012 me nr pasurie 325/15, vol. 5, fq. 28, zk. 2898, me sip. 1747.0 m2 e llojit arë. Këtë pasuri e ka kaluar plotësisht në favor të subjektit [redacted] Ky subjekt ka përfituar në total **5171 m2** tokë arë më shumë se norma për frymë. (3424 + 1747)

ZVRPP Bulqizë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, por duhet të saktësonte numërin e AMTP-ve të arkivuara në ZVRPP Bulqizë dhe sipërfaqen totale të regjistruar në KPP dhe më pas ti kërkonte Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KV) pranë Prefektit të Qarkut Dibër, vlefshmërinë ligjore të AMTP-ve, lëshuar në emër të subjektit [redacted]

Kjo pasuri e subjektit [redacted] është përfituar padrejtësisht mbi normën për frymë me dokumentacion të pakonfirmuar nga Prefektura Dibër, veprime këto në kundërshtim me Nenit 23,

45, 59, 74 të Ligjit 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme", Ligjin nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", të ndryshuar, pikën 3 dhe 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

3. Referencat 00342 dhe 00343, ZK 2898 ''Peladhi".

1- **Në emër** [redacted] që i përkasin të njejtit trung të familje bujqësore sipas certifikatës familiare të vitit 1991 sipas AMTP-ve nr 9698 dhe nr 9419 datë regjistrimi 20.12.1993, janë regjistruar pasuritë si vijon nr. 348/2, vol. 5, fq. 93, zk. 2898, me sip. 2300 m2, e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 347/6, vol. 5, fq. 90, zk. 2898, me sip. 700 m2 e llojit arë, lëshuar certifikatë pronësie datë 29.03.2018, pasuria nr. 326/3, vol. 5, fq. 48, zk. 2898, me sip. 1220 m2 e llojit arë, lëshuar certifikatë pronësie datë 29.03.2018 , pasuria nr. 326/2, vol. 5, fq. 47, zk. 2898, me sip. 640 m2 e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 326/1, vol. 5, fq. 46, zk. 2898, me sip. 330 m2 e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 315/3, vol. 4, fq. 216, zk. 2898, me sip. 700 m2, e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 229/9, vol. 3, fq. 166, zk. 2898, me sip. 960 m2 e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 251/2, vol. 3, fq. 243, zk. 2898, me sip. 350 m2 e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 251/4, vol. 3, fq. 245, zk. 2898, me sip. 3820 m2, e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 211/3, vol 3, fq. 50, zk. 2898, me sip. 820 m2 e llojit pemëtore, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 215/1, vol. 3, fq. 60, zk. 2898, me sip. 3240 m2 e llojit arë, lëshuar certifikatë pronësie datë 13.06.2017, pasuria nr. 249/1, vol. 3, fq. 231, zk. 2898, me sip. 900 m2 e llojit arë, lëshuar certifikatë pronësie datë 29.03.2018, pasuria nr. 220/3, vol. 3, fq. 66, zk. 2898, me sip. 3000 m2, e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 229/8, vol 3, fq. 165, zk. 2898, me sip. 870 m2 e llojit arë, lëshuar certifikatë pronësie datë 29.03.2018, pasuria nr. 250, vol. 3, fq. 241, zk. 2898, me sip. 2970 m2 e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 150/3, vol 2, fq. 103, zk. 2898, me sip. 900 m2 e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 125/3, vol. 2, fq. 42, zk. 2898, me sip. 1850 m2 e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 150/2, vol 2, fq. 102, zk. 2898, me sip. 2220 m2 e llojit arë,pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 149/2, vol. 2, fq. 97, zk. 2898, me sip. 800 m2 e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 154/2, vol 2, fq. 119, zk. 2898, me sip. 400 m2 e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie, pasuria nr. 50/1, vol. 1, fq. 116, zk. 2898, me sip. 2000 m2 e llojit arë, pa lëshuar certifikatë pronësie. Veprimet janë hedhur në kartela gjatë viteve 2012-2018 nga z. S. V.me detyrë ish-Juriste, miratuar nga z. B. S. me me detyrë ish-Regjistrues. Pra në total sipas sipas AMTP-ve nr 9698 dhe nr 9419 datë regjistrimi 20.12.1993 [redacted] kanë përfituar **35090** (5680 +29410) **m2** tokë bujqësore dhe pemëtore.

Referuar shkresës së Komunës Fush-Bulqizë datë 01.08.1991 lëshuar nga përgjegjësi i zyrës së administrimit të tokës [redacted] norma për frymë për fshatin Peladhi është 1813 m2. Sipas certifikatës familjare që tregon gjëndjen familjare të datës 01.08.1991, përbehet nga 7 pjestarë, pra i takon gjithësej **12691 m2** *(7*1813 m2)* tokë bujqësore, ndërkohë figuron nga regjistrimet në KPP është përfituar 35090 *m2* tokë bujqësore referuar AMTP-ve nr 9698 dhe nr 9419. Ka një diferencë prej 22399 *m2 të përfituar më shumë se norma për frymë nga familja bujqësore.*

Nga verifikimet e mëtejshme të dokumentacionit të komunës Fush-Bulqizë , zona Peladhi rezulton se në emër të [redacted] janë lëshuar **AMTP me nr 26 dhe nr 27** datë 23.08.2018 me vendim të këshillit të bashkisë Bulqizë nr 67 me pronësi toke gjithsej 1334 (550+784) m2 firmosur nga kryetari i Bashkisë Bulqizë [redacted] Këto parcela mbajnë nr pasurie 49/8, vol. 6, fq. 47, zk. 2898, me sip. 550 m2 e llojit arë dhe nr pasurie 236/10, vol. 6, fq. 49, zk. 2898, me sip. 784 m2 e llojit arë lëshuar certifikatë pronësie datë 03.10.2018. Gjendja familiare e përfituesit rezulton e pandryshuar, me përbërjen familjare prej 7 pjestarë,

ZVRPP Bulqizë pa saktësuar numërin e AMTP-ve të arkivuara në ZVRPP Bulqizë dhe sipërfaqen totale të regjistruar në KPP për subjektin [redacted] ka vazhduar procedurën e regjistrimit të pasurisë dhe pajisjes së subjektit [redacted] me certifikatë pronësie sipas kërkesës së bërë në datë 03.10.2018 Kërkesat janë firmosur nga ish-regjistrues Sh. A.
Zrpp ka vazhduar me regjistrimin e pasurisë së subjektit [redacted] duke tjetërsuar pasurinë shtet sipas LN 2012 me nr pasurie 236/7, vol. 3, fq. 201, zk. 2898, me sip. 4459 m2 e llojit arë. Këtë pasuri e ka ndarë mbi bazë të urdhrave nr 76 dhe 77 datë 02.10.2018 të ish-regjistruesit Sh. A. duke kaluar pjesën prej 1334 m2 në favor të subjektit [redacted]. Ky subjekt ka përfituar në total **23733 m2** tokë arë më shumë se norma për frymë. (22399 + 1334)

ZVRPP Bulqizë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, por duhet të saktësonte numërin e AMTP-ve të arkivuara në ZVRPP Bulqizë dhe sipërfaqen totale të regjistruar në KPP dhe më pas ti kërkonte Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KV) pranë Prefektit të Qarkut Dibër, vlefshmërinë ligjore të AMTP-ve, lëshuar në emër të subjektit [redacted]

Kjo pasuri e subjektit Hysen Mehmet Kamberi është përfituar padrejtësisht mbi normën për frymë me dokumentacion të pakonfirmuar nga Prefektura Dibër, veprime këto në kundërshtim me Nenit 23, 45, 59, 74 të Ligjit 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme", Ligjin nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", të ndryshuar, pikën 3 dhe 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

4. <u>Referencat 00319, 200 dhe 00328, ZK 2898 ''Peladhi".</u>
1- **Në emër të** [redacted] sipas certifikatës familiare të vitit 1991 sipas AMTP nr 9419 datë regjistrimi 20.12.1993, është regjistruar pasuria si vijon, pasuria nr. 215/1, vol. 3, fq. 60, zk. 2898, me sip. 3240 m2 e llojit arë,pa lëshuar certifikatë pronësie. Veprimet janë hedhur në kartelë në datën 01.11.2012 nga z. S. V., me detyrë ish-Juriste, miratuar nga z. B. S. me me detyrë ish-Regjistrues.
Referuar shkresës me nr 1161 së ZRPP Bulqizë datë 14.12.2012 lëshuar nga ish-regjistruesi B. S. mbi këtë pasuri është lëshuar një urdhër për kufizimin e sajë. Ky urdhër pasqyrohet në regjistrin hipotekor në seksionin e kufizimeve dhe në të është shënuar me kryq shenja "***Ndalim***". Arsyeja e kufizimit është se AMTP nr 9419 është e "*korrigjuar dhe me shtesa*". Për këtë urdhër njoftohet me shkrim pronari.
Sipas referencës hipotekore me nr 0319 mbi këtë pasuri të kufizuar janë kryer veprime të mëtejshme. Me aktin noterial nr 1919 të datës 24.10.2016 është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore nga noter [redacted] favor të trashëgimtarëve ligjorë [redacted] etj. Mbi bazë të kërkesës me nr 1593 datë 24.11.2016 të bërë nga trashëgimtarët pranë ZRPP Bulqizë është regjistruar pasuria e kufizuar në regjistrin hipotekor. Kjo pasuri me referencë 0319 është regjistruar në datën 25.11.2016. Veprimet janë kryer nga D. H., me detyrë ish-Juriste, miratuar nga z. V. H. me me detyrë ish-Regjistrues.
ZRPP Bulqizë ka vazhduar me procedurën e regjistrimit të parcelës së **kufizuar** "Arë" në favor të trashëgimtarëve ligjorë, në kundërshtim me Ligjin Nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" Neni 59 **"Regjistrimi i kufizimeve",** pika 1. "*Regjistruesi lëshon urdhër për regjistrimin e kufizimit në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë së paluajtshme, me ose pa kërkesën e personit të interesuar"* dhe pika 2. "*Ky urdhër ndalon veprimet me këtë pasuri të paluajtshme".*

Sipas referencës hipotekore me nr 0328 datë 25.05.2017 mbi këtë pasuri është hequr kufizimi dhe janë kryer veprime të mëtejshme. Heqja e kufizimit është bërë me urdhrin nr 48 të datës 25.05.2017 nga ish-regjistruesi V. H.. Heqja e kufizimit justifikohet pas përgjigjes së dhënë nga Bashkia Bulqizë me shkresën me nr 1200/1 datë 12.04.2017 ku konfirmohet saktësia e parcelave të AMTP nr 9419

5. <u>Referencat 00306, 223 dhe 00321, ZK 2898 ''Peladhi".</u>

1- **Në emër të** [redacted] sipas certifikatës familiare të vitit 1991 sipas AMTP nr 9431 datë regjistrimi 20.12.1993, është regjistruar pasuria si vijon, pasuria nr. 59/5, vol. 1, fq. 162, zk. 2898, me sip. 200 m2 e llojit arë,pa lëshuar certifikatë pronësie. Veprimet janë hedhur në kartelë në datën 01.11.2012 nga z. S. V. me detyrë ish-Juriste, miratuar nga z. B. S. me me detyrë ish-Regjistrues.

Referuar shkresës me nr 1191 së ZRPP Bulqizë datë 14.12.2012 lëshuar nga ish-regjistruesi B. S. mbi këtë pasuri është lëshuar një urdhër për kufizimin e sajë. Ky urdhër pasqyrohet në regjistrin hipotekor në seksionin e kufizimeve dhe në të është shënuar me kryq shenja "***Ndalim***". Arsyeja e kufizimit është se AMTP nr 9431 është e "*korrigjuar dhe me shtesa*". Për këtë urdhër njoftohet me shkrim pronari.

Sipas referencës hipotekore me nr 0306 mbi këtë pasuri të kufizuar janë kryer veprime të mëtejshme. Me aktin noterial nr 1322 të datës 25.08.2016 është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore nga noter [redacted] në favor të trashëgimtarëve ligjorë [redacted] etj. Mbi bazë të kërkesës me nr 1299 datë 23.09.2016 të bërë nga trashëgimtarët pranë ZRPP Bulqizë është regjistruar pasuria e kufizuar në regjistrin hipotekor. Kjo pasuri me referencë 0306 është regjistruar në datën 29.09.2016. Veprimet janë kryer nga D. H., me detyrë ish-Juriste, miratuar nga z. V. H. me me detyrë ish-Regjistrues.

ZRPP Bulqizë ka vazhduar me procedurën e regjistrimit të parcelës së **kufizuar** "Arë" në favor të trashëgimtarëve ligjorë, në kundërshtim me Ligjin Nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" Neni 59 **"Regjistrimi i kufizimeve",** pika 1. "*Regjistruesi lëshon urdhër për regjistrimin e kufizimit në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë së paluajtshme, me ose pa kërkesën e personit të interesuar"* dhe pika 2. "*Ky urdhër ndalon veprimet me këtë pasuri të paluajtshme".*

Sipas referencës hipotekore me nr 0113 datë 21.10.2016 mbi këtë pasuri ka dalë urdhri i regjistruesit për "Ndalim Veprimesh"dhe nuk janë kryer veprime të mëtejshme. Nga verifikimi i kartelave ka rezultuar se pasuritë janë me urdhër kufizim pasi AMTP është me korrigjime dhe shtesa. AMTP është dërguar për konfirmim në Bashkinë Bulqizë.

Sipas referencës hipotekore me nr 0321 datë 11.01.2017 mbi këtë pasuri është hequr kufizimi dhe janë kryer veprime të mëtejshme. Heqja e kufizimit është bërë me urdhrin nr 04 të datës 11.001.2017 nga ish-regjistruesi V. H.. Heqja e kufizimit justifikohet pas përgjigjes së dhënë nga Bashkia Bulqizë me shkresën me nr 4894 datë 30.011.2016 ku konfirmohet saktësia e parcelave të AMTP nr 9431.

6. <u>Referenca 00654, ZK 2267 ''Krastë.</u>

Sipas referencës 00654, datë 23.06.2014, është kryer regjistrimi fillestar në emër të [redacted] pasuria nr. 1/260, vol. 4, f. 83, lëshuar certifikatë datë 23.06.2014, sipërfaqe e parcelës pemëtore 550.0 m^2. Regjistrues Sh. A.. Kjo pasuri është shitur në datën 30.01.2018 sipas referencës nr 00673 vol. 4, f. 83.

Nga verifikimet e mëtejshme të dokumentacionit të komunës Krastë , zona Mat rezulton se në emër të [redacted] është lëshuar AMTP me nr 29083, pa datë, me pronësi toke gjithsej 8056 m2 firmosur nga kryetari i komisionit të tokës në fshat [redacted] dhe përfaqësuesi i rrethit [redacted] Kjo pasuri mban nr. 1/260, vol. 4, f. 83, lëshuar certifikatë datë 23.06.2014, me sip. 550 m2 e llojit pemëtore. Gjendja familiare e përfituesit rezulton me përbërjen familjare prej 7 pjestarë, me certifikatën familiare sipas gjendjes familiare të families bujqësore referuar vitit 1991.

ZVRPP Bulqizë pa saktësuar sipërfaqen e llojit pemëtore të përfituar me AMTP e cila rezulton 300 m2 ka regjistruar 550 m2 sipërfaqe të llojit pemëtore në favor të familjes bujqësore. Ky ndryshim është bërë pa pasur plan rilevimi të nënshkruar dhe konfirmuar nga Administratori i Komunës, në kundërshtim me nenin 11/1 , pika 4, 4/1, 4/2 **të ligjit nr 8752 datë 26.03.2011, "Për krijimin dhe funksionet e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës".**
Referuar AMTP me nr 29083, pa datë, me pronësi toke të llojit "Truall" në favor të përfituesit të families bujqësore të [redacted], janë regjistruar dy parcela përkatësisht 260 m2 dhe 350 m2. Nuk ka dokumentacion shoqërues nga komuna (pasqyra nr 1) që të vërtetojë se këto dy parcela janë të zërit kadastral "Truall".
Lidhur sa sipër trajtuar është mbajtur Akt-Konstatimi nr. 7, datë 31.05.2019, për të cilin në fazën e hartimit të projekt raportit, nuk janë paraqitur observacione nga personat e atakuar të cilësuar si përgjegjës.

3. Auditimi mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga Privatizimi për periudhën e auditimit dhe transaksioneve të kryera me këtë pasuri. Sipas kontratave të shitblerjes të objekteve shtetërore nga (Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave dhe Pushteti Vendor) dhe sipas kontratave të shitblerjes me EKB.

- Referencë nr. 2993;
Me aplikim nr. 1410, datë 08.08.2017, [redacted] ka kërkuar regjistrimin e kalimit të pronësisë për pasurinë e përfituar me privatizim nga Bashkia Bulqizë dhe pajisjen me certefikatë pronësie.
Në KPP volum 10, faqe 14, është regjistruar pasuria nr. 2/129+1-14, apartament me sipërfaqe 56 m^2, në pronësi të [redacted] lëshuar certifikatë pronësie datë 08.08.2017.
Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se me shkresën nr. 1312, datë 11.04.2017, Bashkia Bulqizë ka dërguar në ZVRPP, dokumentacioni e mëposhtëm:
- Formularët nr. 1 dhe nr. 2, ku përcaktohen treguesit tekniko ekonomik, të apartamentit, hartuar nga komisioni i privatizimit të Bashkisë Bulqizë; ku përcaktohen të dhënat për apartamentin 14, shkalla 1, pallati '"blloku 12"
- Kontrata e privatizimit të banesës(formulari nr. 3), datë 15.05.2017, ndërmjet Bashkisë Bulqizë, përfaqësuar nga Kryetari dhe qytetarit që përfiton apartamentin;
- Dokumentacioni hartografik(planimentri, plan vendosja);
- Autorizim datë 27.09.1990, i lëshuar nga Këshilli Popullor i Lagjes "Gjeologu", Bulqizë, që autorizon qytetarin që të banojë në pallatin nr. 20, shkalla nr. 1, apartamenti nr. 14;
-Vërtetim kontrate për privatizim banese, nr.835/2, rep, datë 15.05.2017, me anë të cilës vërtetohet kontrata e privatizimit e lidhur jashtë zyrës së noterit;
- Fatura e pagesës me bankë në vlerën 49,900 lekë;
Duke ju referuar dokumentacionit gjendje në dosjen me referenca 02993, rezulton se privatizimi i objektit apartament, është kryer me shkelje dhe parregullsi, pasi:
- Të dhënat e apartamentit për të cilin qytetari është pajisur me autorizim nga Këshilli Popullor i Lagjes "Gjeologu", Bulqizë, nuk përputhen me të dhënat e apartamentit të privatizuar .
- Baza ligjore mbi të cilën është mbështetur privatizimi i objektit, i mohon të drejtat dhe kompetencat që Bashkia, të kryejë procesin e privatizimit të apartamentit, pasi objekti në fjalë nuk është në fondin e banesave sociale, gjithashtu Bashkia Bulqizë nuk e zotëron me dokument pronësie pronën për të bërë të mundur tjetërsimin e saj;
- Mungon kontrata e qirasë që duhet të lidhej para vitit 1992, ndërmjet ndërmarrjes komunale dhe qytetarit si qiramarrës, mbi bazën e të cilës realizohej kontrata e privatizimit, siç përcaktuar në 1, VKM nr. 97, datë 03.02.2008"Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992", i ndryshuar;
Sa trajtuar arrijmë në konkluzionin se, regjistrimi i pasurisë është kryer më shkelje të dispozitave ligjore, sa vepruar ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012

"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjin nr. 9321, datë 05.11.2004 "Për privatizimin e objekteve shtetërore e banesave", UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit", VKM nr. 97, datë 03.02.2008 "Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992".
Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuar më sipër ***ngarkohet me përgjegjësi*** V. H. me detyrë Regjistrues dhe D. H., me detyrë specialisti jurist.

- Referencë nr. 2956; 0815, zk 8612;
Me aplikim nr. 720 , datë 06.04.2017, ka kërkuar regjistrimin e kalimit të pronësisë me trashëgimi ligjore dhe pajisjen me certefikaatë pronësie.
Në KPP volum 3, faqe 236, është regjistruar pasuria nr. 2/129+1-6, apartament me sipërfaqe 60 m^2, në pronësi të [redacted], nuk lëshuar certifikatë pronësie , regjistrimi është bërë me referencë nr. 0736, datë 17.12.1996, më pas me referencë nr. 2956, datë 13.04.2017, me akt trashëgimi ka kaluar në pronësi të [redacted] dhe 5 bashkëpronarëve të tjerë, lëshuar certifikatë pronësie datë 18.04.2017.
Origjina e kësaj pasurie rrjedh nga privatizimi, në bazë të dokumentacionit gjendje në dosjen me referencë nr. 0736, sipas këtij dokumentacioni:
- Formularët nr. 2, ku përcaktohen treguesit tekniko ekonomik, të apartamentit, hartuar nga komisioni i privatizimit që mban datën 30.12.1993;
- Dokumentacioni hartografik(planimentri, plan vendosja);
- Autorizim datë 09.06.1990, i lëshuar nga Këshilli Popullor i Lagjes "Gjeologu", Bulqizë, që autorizon qytetarin që të banojë në pallatin nr. 20, shkalla nr. 1, apartamenti nr. 7;
- Kontrata e qirasë datë 05.08.1993, lidhur ndërmjet Ndërmarrjes Komunale Banesa dhe qytetarit si qiramarrës,

Rezulton se privatizimi i objektit apartament, është kryer me shkelje dhe parregullsi, pasi, mungon kontrata e privatizimit të apartamentit(formulari nr. 3) dhe mandat pagesa e shlyerjes së detyrimit financiar, si dokumente bazë që shërbejnë për fitimin e pronësisë.
Sa trajtuar arrijmë në konkluzionin se, regjistrimi i pasurisë është kryer më shkelje të dispozitave ligjore, ***pasi mungon dokumentacioni që shërben si Titull Pronësie,*** ndërsa nga punonjësit e ZVRPP-së nuk duhet të kryhej regjistrimi i aktit të trashëgimisë, duke lëshuar certifikatë pronësie, sa vepruar në ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjin 7652, datë 23.12.1992", "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar, UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit",
Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuar më sipër ***ngarkohet me përgjegjësi*** V. H. me detyrë Regjistrues dhe D. H., me detyrë specialisti jurist.

- Referencë nr. 3048;0319, ZK 8612;
Me aplikim nr. 1899 , datë 16.11.2017, ka kërkuar regjistrimin e kalimit të pronësisë me trashëgimi ligjore dhe pajisjen me certefikatë pronësie.
Në KPP volum 2, faqe 69, është regjistruar pasuria nr. 1/161+2-8, apartament me sipërfaqe 83 m^2, në pronësi të 3 bashkëpronarëve; [redacted] nuk lëshuar certifikatë pronësie, regjistrimi është bërë me referencë nr. 0319, datë 17.12.1996, më pas me referencë nr. 3048, datë 17.11.2017, me akt trashëgimi ka kaluar në pronësi të [redacted], lëshuar certifikatë pronësie datë 16.12.2017.
Veprimet për regjistrimin e aktit të trashëgimisë janë kryer nga D. H., me detyrë ish regjistruese.
Origjina e kësaj pasurie rrjedh nga privatizimi, në bazë të dokumentacionit gjendje në dosjen me referencë nr. 0319, sipas këtij dokumentacioni:

- Formularët nr. 2, ku përcaktohen treguesit tekniko ekonomik, të apartamentit, hartuar nga komisioni i privatizimit që mban datën 26.08.1993;
- Dokumentacioni hartografik(planimentri, plan vendosja);
- Kontrata e qirasë pa datë, lidhur ndërmjet Ndërmarrjes Komunale Banesa dhe qytetarit si qiramarrës, rezulton fotokopje;

Kontrata e privatizimit të apartamentit(formulari nr. 3), ***rezulton e panënshkruar*** nga Përgjegjësi i Sektorit të Privatizimit dhe e pa vulosur;
Mungon Autorizimi i lëshuar nga Këshilli Popullor i Lagjes, që autorizon qytetarin që të banojë në këtë apartament
Sa trajtuar arrijmë në konkluzionin se, regjistrimi i pasurisë është kryer më shkelje të dispozitave ligjore, ***pas dokumentacioni që shërben si Titull Pronësie, nuk plotëson elementët e formës dhe përmbajtjes,*** ndërsa nga punonjësit e ZVRPP-së nuk duhet të kryhej regjistrimi i aktit të trashëgimisë, duke lëshuar certifikatë pronësie, sa vepruar në ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjin 7652, datë 23.12.1992", "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar, UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit",
Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuar më sipër ***ngarkohet me përgjegjësi*** D. H. me detyrë Regjistrues.
Lidhur sa trajtuar në faqet 67-70 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-Konstatimin nr. 12, datë 31.05.2019, janë paraqitur observacionet në rrugë elktronike dhe derguar me shkresen nr. 13.06.2019, të cilat kanë ardhur në KLSH bashkëlidhur me shkresën nr. 737/3, datë 04.07.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 207/3, datë 08.07.2019, të cilat janë përmbledhur nga Përgjegjësi i Zyrës dhe dërguar prej tij, ku sqarohet:
Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 2993, ku konstatoni se është bere regjistrimi i nje apartamenti te privatizuar dhe të dhënat e apartamentit për të cilin qytetari eshte pajisur me autorizim nga keshilli popullor nuk perputhen me te dhënat e apartamentit të privatizuar. Ne kete rast gjykojme se te dhenat Zyra e regjistrimit gjate perpunimit te dokumentacionit i ka marre nga dokumenti kryesor kontrata me bashkine, formularet 1,2.3, plani i rilevimit dhe planimetria qe jane pergatitur ne momentin e privatizimit nga bashkia. Në qoftë se Qytetari do te kishte dokumenta të vjetra privatizimi,nuk do ti ishte drejtuar bashkise për ta privatizuar,.... .
Dokumentet që verifikon ZRPP në këtë rast janë :Kontrata e privatizimit,formularet 1,2,3, Planimetria e Apartamentit,plan vendosja e Pallatit si dhe Certifikata familjare e datës 01.12.1992 ..... .
Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 2956 Zk.8612: konstatohet se është bërë regjistrimi i trashëgimisë për pasurine "Apartament" vol. 3 fq. 236, në kushtet e mungesës se formularit nr. 3. Lidhur me këtë veprim sqarojmë se regjistrimi i trashegimisë nuk përben kalim pronësie sepse ashtu si kemi vleresuar me siper ky veprim nuk shoqerohet me efekte fiskale dhe leshimi i certifikates ne kete rast është bërë me qëllim që trashëgimtarët të kenë mundësite juridike të mjaftueshme për të siguruar dokumentin e munguar. Ajo që mendojme se mungon ne këte rast është urdhëri i regjistruesit për kufizim veprimesh në momentin e regjistrimit të trashegimisë që ndoshta mund të jetë bere por nuk është kryer veprimi në kartelë,si rezultat i nje gabimi njerzor ,por gjithsesi per kete rast do te procedohet me ndalim veprimesh duke kerkuar urdherin e leshuar nga regjistruesi,ose duke bere urdher te ri ne qofte se nuk do te gjendet.
Ref. Nr.3048 Zk.8612:Konstatimet dhe observacioni janë të njejta me ref. më sipër.
Sqarimi i Grupit të auditimit:
Lidhur me observacionet e paraqitur, të sipërcituar, nuk merren në konsideratë pasi, nuk janë paraqitur argumente dhe prova të reja. Lidhur me argumentet e paraqitura nga ana juaj, sqarojmë ne i kemi diskutuar gjatë auditimit në subjekt, në mungesë të fakteve dhe dokumenteve të reja, konsatimet tona mbeten të pandryshuara.

Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **1 rast**, ka regjistruar pasurinë nr. 2/129+1-14, apartament me sipërfaqe 56 m^2, volum 10, faqe 14, ZK 8612, të përfituar nga privatizimi si palë shitëse Bashkia Bulqizë, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi* regjistrimi është kryer ***në mungesë të dokumentacionit që shërben si titull pronësie,*** sa vepruar në ***papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" ligjin nr. 9321, datë 05.11.2004 "Për privatizimin e objekteve shtetërore e banesave", UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit", VKM nr. 97, datë 03.02.2008 "Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992".

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 2/129+1-14, volum 10, faqe 14, ZK 8612, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor që shërben për fitimin e pronësisë.

Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **2 raste**, ka regjistruar pasuritë: nr. 2/129+1-6, apartament me sipërfaqe 60 m^2, volum 3, faqe 236 dhe nr. 1/161+2-8, apartament me sipërfaqe 83 m^2, volum 2, faqe 69, ZK 8612, të përfituar nga privatizimi, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi* regjistrimi është kryer ***në mungesë kontratës së privatizimit(formulari nr. 3), që shërben si dokument bazë për fitimin e pronësisë,*** sa vepruar në ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjin 7652, datë 23.12.1992", "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar, UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** në **2 raste**, për pasuritë: nr. 2/129+1-6, volum 3, faqe 236 dhe nr. 1/161+2-8, volum 2, faqe 69, ZK 8612, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor që shërben për fitimin e pronësisë.

Zona Kadastrale 3444 –Shupenzë u konstatua :

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me proçedurën e ndjekur për regjistrimin e pasurisë të paluajtshme përfituar nga ***ligji Privatizimit nr. 7512, datë 10.08.1991 me ndryshimet*** e mëvonshme, dhe ***ligji i Privatizimit të Banesave nr. 7652, datë 01.12.1992 me ndryshimet*** e mëvonshme, Sipas kontratave të shitblerjes të objekteve shtetërore nga (Ministria e Ekonomisë dhe Pushteti Vendor) dhe sipas kontratave të shitblerjes me Entin Kombëtar të Banesave, Zona Kadastrale 3444 –Shupenzë u konstatua :

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit ***nr. 207/1, datë 01.04.2019,*** u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion sipas refencave të përcaktuara nga përzgjedhja e tyre në KPP provizore me nr, regjistri 1, faqet 1, 2, 3, 5, 8, 9 dhe 34, 36, 37, 38 dhe 40 për Zonën Kadastrale 3444, fshati Shupenzë, Bulqizë ***rezultoi :***

Zona kadastrale 3444 Shupenzë nuk është në sistem regjistrimi, ndërsa kartelat e plotësuara sipas sipas pasurive janë provizore sip[as regjistrimeve sporadike..

Nga ana e ZVRPP Bulqizë nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra përsa i përket regjistrimit të pasurive të përfituara nga ligji Privatizimit nr. 7512, datë 10.08.1991 me ndryshimet e mëvonshme, dhe ligji i Privatizimit të Banesave nr. 7652, datë 01.12.1992 me ndryshimet e mëvonshme, bazuar në kontratat e shitblerjes të objekteve shtetërore, në zbatim të pikës 5 të programit të auditimit me zgjedhje ***Zona Kadastrale 3444, Shupenzë Bulqizë*** në zbatim të neneve 44-45, pika 5 të Ligjit nr. 33, , datë 21.03.2012" dhe pikës 2 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 ku percaktohet që:

"Regjistrimi i fitimit apo kalimit të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme të njohura apo të fituara me anë të ligjit , vendim gjyqësor, aktit administrativ ose me parashkrim fitues, në zbatim të neneve 44-45 te ligjit 33, datë 21.03.3012 "Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme" behet nga ZVRPP pas verifikimit të plotë të elementëve të aktit që njeh ose përmban fitimin e të drejtën e pronësisë për efekt të plotësimit të kushteve të regjistrimit të përcaktuara në nenin 193 të Kodit civil të RSH.

Sikurse evidentohet nga dokumentacioni i vënë dispozicion nga ish ZVRPP Bulqizë u konstatua:
1. Me referencën nr. 0085. Aplikim nr. 727, date 07.04.2017, nga [redacted] regjistruar pasuria ***nr 184/6 në v. 1, faqe 34 ndërtesë me siperfaqe 21.4 m2,*** perfituar nga ligji i privatizimit sipas KSHB nga AKP Bulqizë datë 26.04.1996, nënshkruar ***KPP D. H..***
Në dosje gjenden dokumente për privatizimin e objektit si më poshtë:
-Kontrata e shitblerjes së objektit e datës 26.04.1996 dhe regjistruar në Regj. Hioptekor me nr. 31, datë 30.07.1996.
-Plan-vendosja e pronës p.r 21.4 m2.
-Akti i dorëzimit Aktdorezimi datë 25.04.1996 nga BTSHU Bulqizë [redacted]
-Dokumente të tjera shtesë per privatizimin e objektit.
-Mungon kontrata per mardhëet me truallin.
Sikurse evidentohet rezulton se kjo pasuri me nr. 184/6, v.1, faqe 40 në kartelë provizore është regjistrur në emër të [redacted] për sipërfaqen prej ***21.4 m2 sipas refencës 0085, datë 25.04.2017,*** por nuk ka asnje shënim per mardhënien me truallin dhe nuk rezulton të ketë kontratë qiraje apo shitje, dhe rezulton të mos jenë kryer pagesa të qirasë për truallin e perdorur apo funksional i objektit të privatuar, ***në kundershtim me rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999, Kreu IV-të pika 7. 7.2 per regjistrimin e pasurive perfituar nga zbatimi i ligjit nr. 7512, datë 10.08.1991 i ndryshuar, ku kerkohet KSHB per objektin*** [redacted] ***Kontratë per mardhëniet me truallin, planvendosja dhe akti i dorezimit të objektit.***
Nga ZVRPP Bulqizë nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes të pasurisë shtojca 1, përfituar nga ligji e Privatizimit nr. 7512, date 10.08.1991 me ndryshimet e mëvonshme, duke vepruar në kundërshtim me ***rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999, Kreu IV-të pika 7, duke regjistruar pasurinë njësi si pa u përcaktuar më parë mardhëniet e pronësisë.***
Nuk është plotësuar shtojca 1, në papajtueshmeri me pikën 2-3, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
Nenin 44-45 pika 5 të Ligjit nr.33, datë 29.04.2012
Pikën 2-3 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012
Kreun e IV-të të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999
Në ligjin nr.7512, datë 03.04.2006 me ndryshimet.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me pergjegjesi:
D. H. me detyrë ish-regjistruese
R. Sh. me detyrë hartograf.
(Trajtuar më hollësisht në Aktkonstatimin nr. 19, datë 31.05.2019, zona kadastrale 3444 dhe Projektraportin e auditimit dërguar me nr 207/3, datë 08.07.2019).737/1, datë 04.07.2019 dhe protokolluar në KLSH me nr 207/3, datë 08.07.2019).
Komente dhe shpjegime nga subjekti i Audituar: *Subjekti i Audituar* ***Sh. A.(me detyrë pergjegjës sektori) sipas shkresës nr. 661, datë 13.06.2019*** *ka bërë komente dhe shpjegime në lidhje me problematikat e trajtuara në akt konstatimin nr. 19, datë 31.05.2019 për pasurinë e regjistruara sipas* ***refencës 0085*** *me pretendimin se sqarimet janë të njejta sipas aktkonstatimit nr 18, datë 31.05.2019 në lidhje me mardhëniet me truallin. Ndërsa për pasuritë e regjistruara pa mardhëniet me truallin subjekti shpjegon se regjistrimet janë bërë në kuadrin e sistemit hipotekor, sipas kërkesave sporadike dhe do të zbardhen në kohën e kontraktimit me kmpaninë*

private për hedhjen në sistem. Duke sqaruar për mardhëniet me truallin ju kemi përcjellë shkresën e zyrës qëndrore nr. 754/2, datë 21.02.2009(urdhri nr. 606, datë21.08.2009) "Për regjistrimin e objekteve me leje ndertimi të dhëna pas datës 10.08.1991 duke hapur KPP per truallin dhe duke vendosur kufizim deri në krijimin e mardhënieve me truallin.
Qëndrimi i grupit të auditimit *në lidhje me komentin dhe shpjegimet e Subjekti i Audituar* ***Sh. A.(me detyrë pergjegjës sektori) sipas shkresës nr. 661, datë 13.06.2019*** *për problematikat e trajtuara në akt konstatimin nr. 19, datë 31.05.2019 per pasuritë e regjistruara sipas* ***refencës 0085*** *është se mardhëniet me truallit percaktohen në rregulloren nr, 184, datë 08.04.1999 dhe nuk ka lidhje me regjistrimet në kuadrin e regjistrimeve hipotekore. Duke sqaruar për mardhëniet me truallin edhe sipas me shkresës derguar nga ZQRPP nr. 754/2, datë 21.02.2009(urdhri nr. 606, datë21.08.2009, saktësoj se Regullorja bazë 184, datë 08.04.1999, për pasuritë e përfituara me lejeve të ndertimit sipas viteve edhe nga privatizimi përcakton dhe mardhëniet me truallin. Për rrjedhojë përsa komentohet e shpjegohet nga subjekti nuk ka argumentim dhe mbështetje ligjore, per rjedhojë nuk meren në konsideratë.*
Gjetje nga auditimi pika 3: (Aktkonstatimi 19, datë 31.05.2019).
Gjetje nga Auditimi 3*:* ***Nga Zyra Vendore e ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë*** nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes të pasurisë ***nr. 184/6, v.1, faqe 40,*** regjistruar në emër të [redacted] sipas refencës ***nr. 0085,*** përfituar nga ligji e Privatizimit ***nr. 7512, date 10.08.1991*** me ndryshimet e mëvonshme. Sikurse evidentohet në këtë projektraport auditimi dhe ***Aktkonstatimin nr. 19, datë 31.05.2019*** ***regjistruar njesia e privatizuar per 21.4 m2 pa u përcaktuar më pare mardhëniet e pronësisë,*** me kontratë qiraje apo kontratë shitje, si dhe nuk rezulton të jete paguar qira trualli nga koha e privatimit të objektit dhe pas, në zbatim të rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999, Kreu IV-të pika 7 per regjistrimin e pasurive perfituar nga zbatimi i ligjit nr. 7512, datë 10.08.1991 i ndryshuar dhe VKM në zbatim te tij ku kerkohet KSHB për objektin AKP-Bleres, Kontratë për mardhëniet me truallin, planvendosja dhe akti i dorezimit të objektit.
Rekomandim: Zyra Vendore ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë), Përgjegjësi i Zyrës të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2014 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë e regjistruar ***nr. 184/6, v.1, faqe 40,*** evidentuar sipas ***referencës 0085*** deri në përcaktimin e mardhënieve të truallit për objektin e privatizuar me kontratë qiraje apo kontratë shitje, ***në zbatim të rregulores nr. 184, datë 08.04.1999 "Per regjistrimin e pasurisë së Palujtshme".***

ZK 8611**; Qyteti Bulqizë;**
Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit **nr. 207/1, datë 01.04.2019**, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
Regjistrat e pasurive të pa luajtshme

Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit mbi pranimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituar sipas ligjit Nr. 7652 date 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore Pasuritë e paluajtshme "Pallat" dhe "Apartament", të ndryshuar, rezultoi se pranimi i dokumentacionit dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme është bërë me të meta dhe mangësi si më poshtë:

- Referencë nr. 0136, ZK 8611**;**
Me kërkesë nr. 863, datë 26.04.2017, [redacted] ka kërkuar për tu pajisur me fragment harte, kopje kartele dhe certifikatë pronësie.
Në KPP volum 1, faqe 136, është regjistruar pasuria nr. 2/86+1-7, apartament me sipërfaqe 56 m^2, në pronësi të [redacted] lëshuar certifikatë pronësie datë 01.05.2017.
ZVRPP Bulqizë ka kryer veprime në (KPP) ***duke lëshuar certifikata pronësie mungon origjina e kësaj prone kontrata e shitblerjes, gjithashtu nga ana e specialistit nuk është bërë verifikimi***

nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër.
Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës se regjistrimit te pasurive te paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr. 2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit.
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. V. H. me detyrë ish/Regjistrues dhe zj. D. H. me detyrë specialiste e regjistrimi fillestar.

- Referencë nr. 0178, ZK 8611**;**
Me kërkesë nr. 877, datë 03.05.2017, [redacted] ka kërkuar për tu pajisur me fragment harte, kopje kartele dhe certifikatë pronësie.
Në KPP volum 1, faqe 178, është regjistruar pasuria nr. 2/86+4-48, apartament me sipërfaqe 58 m^2, në pronësi të [redacted] lëshuar certifikatë pronësie datë 10.05.2017.
ZVRPP Bulqizë ka kryer veprime në (KPP) ***duke lëshuar certifikata pronësie mungon origjina e kësaj prone kontrata e shitblerjes, gjithashtu nga ana e specialistit nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***.
Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës se regjistrimit te pasurive te paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr. 2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit.
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. V. H. me detyrë ish/Regjistrues dhe zj. D. H. me detyrë specialiste e regjistrimi fillestar.

- Referencë nr. 0196, ZK 8611**;**
Me kërkesë nr. 1189, datë 05.06.2017, [redacted] ka kërkuar për tu pajisur me fragment harte, kopje kartele dhe certifikatë pronësie.
Në KPP volum 1, faqe 196, është regjistruar pasuria nr. 2/86+5-66, apartament me sipërfaqe 58 m^2, në pronësi të [redacted] lëshuar certifikatë pronësie datë 12.06.2017.
ZVRPP Bulqizë ka kryer veprime në (KPP) ***duke lëshuar certifikata pronësie mungon origjina e kësaj prone kontrata e shitblerjes, gjithashtu nga ana e specialistit nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***.
Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës se regjistrimit te pasurive te paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr. 2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit.
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. V. H. me detyrë ish/Regjistrues dhe zj. D. H. me detyrë specialiste e regjistrimi fillestar.

- Referencë nr. 02403, 0649ZK 8611**;**
Me kërkesë nr. 1757, datë 16.10.2017, [redacted] ka kërkuar për tu pajisur me fragment harte, kopje kartele, korrigjime gabimesh dhe certifikatë pronësie.
Në KPP volum 3, faqe 149, është regjistruar pasuria nr. 2/52+1-3, apartament me sipërfaqe 54 m^2, në pronësi të [redacted] lëshuar certifikatë pronësie datë 18.10.2017.
ZVRPP Bulqizë ka kryer veprime në (KPP) ***duke lëshuar certifikata pronësie mungon origjina e kësaj prone kontrata e shitblerjes, gjithashtu nga ana e specialistit nuk është bërë verifikimi***

nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër.
Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës se regjistrimit te pasurive te paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr. 2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit.
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. V. H. me detyrë ish/Regjistrues dhe zj. D. H. me detyrë specialiste e regjistrimi fillestar.
Lidhur sa sipër trajtuar është mbajtur Akt-Konstatimi nr. 2, datë 31.05.2019, për të cilin në fazën e hartimit të projekt raportit, nuk janë paraqitur observacione nga personat e atakuar të cilësuar si përgjegjës.

Observacioni i paraqitur nga ZVASHK Bulqizë nr. 661 prot datë 13.06.2019, përgjegjësi sektorit Sh. A. në lidhje me aktkonstatimin dhe projektraportin e auditimit
-ref .136 ZK.8611,pas.2/86+1-7,apart me sip.56 m2 pronar [redacted]
-ref .178 ZK.8611,pas.2/86+4-48,apart me sip.58 m2 pronar [redacted]
-ref .196 ZK.8611,pas.2/86+5-66,apart me sip.58 m2 pronar [redacted]
-ref .649 ZK.8611,pas.2/52+1-3,apart me sip.54 m2 pronar [redacted]
Në lidhje me konstatimin se mungon origjina e këtyre pronave,pas verifikimeve në arkive për këto referenca rezulton se dosjet përkatese të origjinës për keto prona janë të disponueshme.
Bashkëlidhur do të gjeni kopje të dokumentave të referencave të sipercituara.
Sqarimi i grupit të auditimit. Observacioni juaj nuk meret në konsideratë pasi:
Në të gjitha rastet e mësipërme specifikojmë se bëhet fjalë për kontratën e kalimit të pronësisë me të dy emrat e kryefamiljarëve dhe jo kontratën e qerasë apo aktin e dorzimit etj.

4. Auditim mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e objekteve me leje Legalizimi në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, Urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" të ndryshuar dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kritereve, proçedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm për kualifikimin e objekteve", i ndryshuar me VKM nr. 40, datë 11.01.2012.

Në zbatim të kësaj pike të programit të auditimit, u kontrolluan veprimet në KPP dhe u përzgjodhën në bazë rrisku për auditim rreth *70 referenca*, nga të cilat u konstatua se *14 raste* u konstatuan shkelje e parregullsi, lidhur me regjstrimin dhe transaksionet e kryera me pasuri të përfituara me Leje Legalizimi, duke lëshuar certifikata pronësie, trajtuar si më poshtë:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
- Referencë nr. 3092, referencë nr. 3070; referencë nr. 2955; ZK 8612
Me aplikim nr. 765, datë 02.07.2018, me aplikim nr. 765, datë 02.07.2018 dhe nr. 196, datë 12.02.2018, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi i pasurisë truall me sipërfaqe 500 m^2 të përfituar me Leje legalizimi nr. 986774, datë 10.06.2017.
Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 10, faqe 44, është regjistruar me datë 11.07.2018, pasuria nr. 2/304/2, truall me sipërfaqe 500 m^2 lëshuar certifikatë pronësie datë 24.07.2018, ndërsa në volum 10, faqe 13, është regjistruar me referencë nr. 2955, datë 26.04.2017, pasuria nr. 2/304/1-Nd, ndërtesë 3 kat me sipërfaqe 207 m^2, lëshuar certifikatë pronësie datë 29.05.2017, duke kaluar në pronësi të [redacted]. Në fakt leje e legalizimit shprehet për shtesë anësore + shtesë kati në objektin ekzistues 2 kat me sipërfaqe ndërtimi të shtesës 87 m^2, me funksion të kombinuar.

Gjithashtu është kërkuar regjistrimi i pasurisë sëpërfituar me leje legalizimi nr 986672, datë 09.01.2018, ndërtesë 1 kat me sipërfaqe 87 m^2, me funksion social ekonomik përfituar me Leje Legalizimi dhe Leje Legalizimi nr. 986672, datë 09.01.2018.
Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor, rezulton se pasuria nr. 398/9, formohet nga ndarja e pasurisë volum 6, faqe 161, "terren sportiv" me sipërfaqe 6158 m^2, e cila sipas referencës 2623, datë 118.09.2013, ndahet në 2 pasuri: nr. , volum 9 faqe 170, "terren sportiv" me sipërfaqe 5088 m^2 në pronësi shtet dhe pasuria nr. . , volum 9 faqe 169, "truall" me sipërfaqe 1070 m^2 në pronësi shtet, e cila pas bashkimit me pasurinë nr. , volum 7, faqe 38, truall me sipërfaqe 180 m^2, formojnë pasurinë nr. , volum 9, faqe 171, truall me sipërfaqe 1250 m^2, e cila ndahet në pasuritë: nr. , volum 10, faqe 45, "truall" me sipërfaqe 750 m^2 në pronësi shtet dhe nr. . , volum 9 faqe 169, "truall" me sipërfaqe 500 m^2, me referencë nr. 30792, datë 11.07.2018, kalon në pronësi të poseduesit të Lejes së legalizimit.
Me Urdhërin e Regjistruesit pa numër, datë 12.04.2018, është bërë ndarja e pasurisë në pasurinë nr. 2/306, vol. 7, faqe 38, truall me sipërfaqe 185 m^2+ ndërtesë me sipërfaqe ndërtimi 170 m^2, duke kaluar truallin në pronësi të shtetasit [redacted], ndërsa ndërtesa me sipërfaqe 170 m^2, është çregjistruar nga kartela e pasurisë, duke e hequr nga pronësia "shtet".
Gjithashtu volum 10, faqe 36, është regjistruar pasuria nr. 2/305-Nd, ndërtesë me sipërfaqe 87 m^2, lëshuar certifikatë pronësie datë 28.03.2018.
Kjo ndërtesë ndodhet mbi truallin vol. 7, faqe 37, truall me sipërfaqe 115 m^2+ ndërtesë me sipërfaqe ndërtimi 87 m^2, e cila është mbyllur, duke kaluar truallin në pronësi të [redacted] ndërsa ndërtesa me sipërfaqe 87 m^2, është çregjistruar nga kartela e pasurisë, duke e hequr nga pronësia "shtet".
Nga ZVRPP Bulqizë, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
- Duke ju referuar të dhënave në KPP, rezulton se parcela ndërtimore e miratruar në funksion të objektit të lëgalizuar, shtrihet mbi pasurinë nr. 9/962, vo;um 6, faqe 161, "terren sportiv", ndërsa pas ndarjes në volum 9, faqe 169, është kthyer në truall, për rrjedhojë leje e legalizimit është miratuar në kundërshtim me pikën 1/a neni17 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar.
- Sipërfaqja e parcelës ndërtimore që është miratuar, që ka kaluar në pronësi me vkm përkatëse, rezulton se është përcaktuar më madhe se ajo takuese referuar 3 fishit të bazës së objektit, duke miratuar **më tepër 239 m^2**[500(sipërfaqja e miratuar)-261(3*87)(sipërfaqja takuese për shtesën me sipërfaqe 87 m^2)], sa vepruar në kundërshtim me pikën 1/a neni17 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar.
Sa trajtuar, rezulton se lidhur me prishjen e pasurisë ndërtesë me sipërfaqe 87 m^2, që në KPP figuron në pronësi shtet, rezulton se nuk ka ndonjë akt administrativ të lëshuar nga organet përkatëse, apo vendim gjykate të formës së prerë, për tjetërsimin e objektit apo prishjen e tij, për rrejdhojë ***fshirja e të drejtës së pronësisë shtetërore, për objektin ndërtesë me sipërfaqe 87 m^2, nqs nuk paraqitet dokumentacion argumentues do të konsiderohet si dëm i shkatuar ndaj shtetit.***
Sa vepruar në kundërshtim me pikën 3 neni 34, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ku përcaktohet:

"*Në asnjë rast regjistruesi nuk lejon ndryshimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme, që fshin të drejtat reale mbi të."*

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** Sh. A. me detyrë Regjistrues, D. H., me detyrë specialist jurist dhe R. Sh. me detyrë specialist hartograf.

- Referencë nr. 3074;

Me aplikim nr. , datë 10.04.2018, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi i pasurisë ndërtesë me sipërfaqe 87 m^2 të përfituar me Leje Legalizimi nr. 987071, datë 09.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër dhe pajisja me certifikatë pronësie.
Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 10, faqe 40, është regjistruar me datë 24.04.2018, pasuria nr, 2/307-Nd, ndërtesë 1 kat me sipërfaqe 87 m^2 me funksion të social ekonomik, lëshuar certifikatë pronësie datë 02.05.2018,, , duke kaluar në pronësi të [redacted]
Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor, rezulton se me shkresën nr. 565, datë 28.03.2018, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër ka dërguar për regjistrim në ZVRPP Bulqizë, Lejen e legalizimit nr. 987071, datë 09.01.2018, sëbashku me dokumentacionin shoqërues. Sipas kësaj leje legalizimi rezulton se parcela ndërtimore e miratuar në funksion të objektit të legalizuar, me sipërfaqe 250 m^2 (kalimi i pronësisë do të miratohet me VKM përkatëse),
Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor rezulton se mbi truallin që është ngritur objerkti i legalizuar rezultojnë të regjistruar në KPP, 2 objekte ekzistues në pronësi shtet: volum 7 , faqe 38, ndërtesë me sipërfaqe 170 m^2, si dhe volum 7 , faqe 39, objekti ekzistues në pronësi shtet, ndërtesë me sipërfaqe 77 m^2 dhe mbi këto objekte është ndërtuar objekti i legalizuar, për prishjen e të cilëve nuk disponohet ndonjë akt administrativ të lëshuar nga organet përkatëse, apo vendim gjykate të formës së prerë.
Nga ZVRPP Bulqizë, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Sa trajtuar, rezulton se lidhur me prishjen e 2 pasurive: ndërtesë me sipërfaqe 170 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 77 m^2, që në KPP figurojnë në pronësi shtet, rezulton se nuk ka ndonjë akt administrativ të lëshuar nga organet përkatëse, apo vendim gjykate të formës së prerë, për tjetërsimin e objektit apo prishjen e tij, për rrejdhojë ***fshirja e të drejtës së pronësisë shtetërore, për objektin ndërtesë me sipërfaqe 170 m^2 dhe*** 77 m^2, ***nqs nuk paraqitet dokumentacion argumentues do të konsiderohet si si dëm i shkatuar ndaj shtetit.***
Sa vepruar në kundërshtim me pikën 3 neni 34, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ku përcaktohet:

"*Në asnjë rast regjistruesi nuk lejon ndryshimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme, që fshin të drejtat reale mbi të."*

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** Sh.A. me detyrë Regjistrues, D. H., me detyrë specialist jurist dhe R. Sh. me detyrë specialist hartograf.

- Referencë nr. 3008;
Me aplikim nr.1237, datë 12.06.2017, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të përfituar me Leje Legalizimi nr. 986489, datë 15.05.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibërdhe pajisja me certifikatë pronësie.
Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 10, faqe 38, është regjistruar me datë 12.04.2018, pasuria nr. 2/249-Nd, ndërtesë 1 kat me sipërfaqe ndërtimi 184.4 m^2, me funksion banimi, lëshuar certifikatë pronësie 16.04.2018, duke kaluar në pronësi të [redacted]
Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor, rezulton se me shkresën nr. 111, datë 30.05.2017, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër ka dërguar për regjistrim në ZVRPP Bulqizë, Lejen e legalizimit nr. 986489, datë 15.05.2017, sëbashku me dokumentacionin shoqërues.
Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor rezulton se mbi truallin që është ngritur objerkti i legalizuar rezulton i regjistruar në KPP, volum 7 , faqe 21, objekti ekzistues në pronësi shtet, ndërtesë me sipërfaqe 118 m^2.
Lidhur me këtë, me Urdhërin e Regjistruesit nr. 240, datë 17.07.2017, është urdhëruar që të sillet vërtetimi nga bashkia për prishjen e objektit, gjithashtu me shkresën nr. 3520, datë 31.07.2017, i

është kërkuar Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Dibër, plotësimin e dokumentacionit me deklaratën noterale për objektin e prishur. Në dokumentacionin gjendje në dosjen me referencë 3008, ndodhet edhe deklarata noterale datë 11.04.2018, ku poseduesi i lejes së legalizimit deklaron se ka ndërtuar objektin e ri mbi një objekt të rrënuar.
Nga ZVRPP Bulqizë, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Sa trajtuar, rezulton se lidhur me prishjen e pasurisë ndërtesë me sipërfaqe 118 m^2, që në KPP figuron në pronësi shtet, rezulton se nuk ka ndonjë akt administrativ të lëshuar nga organet përkatëse, apo vendim gjykate të formës së prerë, për tjetërsimin e objektit apo prishjen e tij, për rrejdhojë ***fshirja e të drejtës së pronësisë shtetërore, për objektin ndërtesë me sipërfaqe 118 m^2, nqs nuk paraqitet dokumentacion argumentues do të konsiderohet si si dëm i shkatuar ndaj shtetit.***
Sa vepruar në kundërshtim me pikën 3 neni 34, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ku përcaktohet:

"*Në asnjë rast regjistruesi nuk lejon ndryshimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme, që fshin të drejtat reale mbi të."*

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** Sh. A. me detyrë Regjistrues, D. H., me detyrë specialist jurist dhe R. Sh. me detyrë specialist hartograf.

- Referencë nr. 3011;
Me aplikim nr.1261, datë 20.06.2017, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të përfituar me Leje Legalizimi nr. 986853, datë 15.05.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër dhe pajisja me certifikatë pronësie.
Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 10, faqe 37, është regjistruar me datë 21.07.2018, pasuria nr. 2/252-Nd, ndërtesë 1 kat me sipërfaqe ndërtimi 91 m^2, me funksion banimi, lëshuar certifikatë pronësie 04.04.2018, duke kaluar në pronësi të [redacted]
Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor, rezulton se me shkresën nr. 111, datë 30.05.2017, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër ka dërguar për regjistrim në ZVRPP Bulqizë, Lejen e legalizimit nr. . 986853, datë 15.05.2017, sëbashku me dokumentacionin shoqërues.
Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor rezulton se mbi truallin që është ngritur objerkti i legalizuar rezulton i regjistruar në KPP, volum 7 , faqe 22, objekti ekzistues në pronësi shtet, ndërtesë me sipërfaqe 119 m^2.
Lidhur me këtë, me Urdhërin e Regjistruesit nr. 241, datë 17.07.2017, është urdhëruar që të sillet vërtetimi nga bashkia për prishjen e objektit, gjithashtu me shkresën nr. 3522, datë 31.07.2017, i është kërkuar Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Dibër, plotësimin e dokumentacionit me deklaratën noterale për objektin e prishur. Në dokumentacionin gjendje në dosjen me referencë 3008, ndodhet edhe deklarata noterale datë 11.04.2017, ku poseduesi i lejes së legalizimit deklaron se ka ndërtuar objektin e ri mbi një objekt të rrënuar.
Nga ZVRPP Bulqizë, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Sa trajtuar, rezulton se lidhur me prishjen e pasurisë ndërtesë me sipërfaqe 119 m^2, që në KPP figuron në pronësi shtet, rezulton se nuk ka ndonjë akt administrativ të lëshuar nga organet përkatëse, apo vendim gjykate të formës së prerë, për tjetërsimin e objektit apo prishjen e tij, për rrejdhojë ***fshirja e të drejtës së pronësisë shtetërore, për objektin ndërtesë me sipërfaqe 119***

m^2, nqs nuk paraqitet dokumentacion argumentues do të konsiderohet si si dëm i shkatuar ndaj shtetit.

Sa vepruar në kundërshtim me pikën 3 neni 34, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ku përcaktohet:

"*Në asnjë rast regjistruesi nuk lejon ndryshimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme, që fshin të drejtat reale mbi të.*"

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** Sh. A. me detyrë Regjistrues, D. H., me detyrë specialist jurist dhe R. Sh. me detyrë specialist hartograf.

- Referencë nr. 2974;

Me aplikim nr.824, datë 24.04.2017, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të përfituar me Leje Legalizimi nr. 986396, datë 22.07.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibërdhe pajisja me certifikatë pronësie.

Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 10, faqe 20, është regjistruar me datë 18.08.2017, pasuria nr. 2/276/5-Nd, shtesë anësore ndërtesë 2 kat(1 kat bodrum +1 kat mbi tokë) me sipërfaqe ndërtimi 135 m^2, me funksion social ekoenomik, lëshuar certifikatë pronësie 23.09.2017, duke kaluar në pronësi të [redacted]

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor, rezulton se me shkresën nr. 2671, datë 18.08.2016, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër ka dërguar për regjistrim në ZVRPP Bulqizë, Lejen e legalizimit nr. 986396, datë 22.07.2016, sëbashku me dokumentacionin shoqërues.

Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor gjendje në dosjen e audituar, rezulton se regjistrimi i pasurisë dhe përfitimi i kësaj pasurie me leje legalizimi, është kryer me shkelje dhe parregullsi, si vijon:

- Të dhënat e pasqyruar në lejen e legalizimit nuk përputhen me planimetrinë e kateve, pasi në lejen e legalizimit është përcaktuar ndërtesë 2 kat mbi tokë, ndërsa në planimetrinë e kateve përcaktohet objekti ndërtesë me 1 kat bodrum dhe 1 kat mbi tokë;
- Sipërfaqja e parcelës ndërtimore që do të miratohet me vkm përkatëse kalimi i pronësisë, rezulton se është përcaktuar më madhe se ajo takuese referuar 3 fishit të bazës së objektit, duke miratuar **më tepër 74.2 m^2**[479.2(sipërfaqja e miratuar)-405(3*135)(sipërfaqja takuese)], sa vepruar në kundërshtim me pikën 1/a neni17 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar.
- Duke ju referuar të dhënave në KPP, rezulton se parcela ndërtimore e miratruar në funksion të objektit të lëgalizuar, shtrihet mbi pasuritë: nr. 2/76/2, volum 9, faqe 133, e llojit "ledh" dhe mbi pasurinë nr. 2/72/2, volum 9, faqe 131, "terren sportiv", për rrjedhojë leje e legalizimit është miratuar në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Nga ZVRPP Bulqizë, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

Sa trajtuar, rezulton se regjistrimi i kësaj pasurie është në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi është miratuar më tepër parcela ndërtimore më sipërfaqe **74.2 m^2**, si dhe statusi juridik i parcelës ndërtimore nuk plotëson kërkesat ligjore, sa vepruar në ***sa vepruar*** në papajtueshmëri me, shkronjën "a" neni 25, me pikën 5 nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjin nr. ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar, dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** D. H., me detyrë Regjistrues dhe R. Sh. me detyrë specialist hartograf

- Referencë nr. 2979;

Me aplikim nr.890, datë 04.05.2017, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të përfituar me Leje Legalizimi nr. 986765, datë 20.03.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër dhe pajisja me certifikatë pronësie.
Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 10, faqe 16, është regjistruar me datë 05.06.2017, pasuria nr. 2/232-Nd, objekti ndërtesë 1 kat, me sipërfaqe ndërtimi 114 m^2, me funksion banimi, lëshuar certifikatë pronësie 07.06.2017, duke kaluar në pronësi të [redacted]
Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor, rezulton se me shkresën nr. 807, datë 07.04.2017, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër ka dërguar për regjistrim në ZVRPP Bulqizë, Lejen e legalizimit nr. 986765, datë 20.03.2017, sëbashku me dokumentacionin shoqërues.
Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor gjendje në dosjen e audituar, rezulton se regjistrimi i pasurisë dhe përfitimi i kësaj pasurie me leje legalizimi, është kryer me shkelje dhe parregullsi, si vijon:
- Të dhënat e pasqyruar në lejen e legalizimit nuk përputhen me passurinë e regjistruar në KPP, lidhur me numërin e pasurisë, pasi leje e legalizimit është miratuar për pasurinë me numër 2/233, zk 8612, ndërsa në KPP rezulton e regjistruar pasuria me numër 2/232, ndërsa nga nga ZVRPP Bulqizë nuk janë verifikuar elemntëtet e formës dhe përmbajtjes së aktit..
- Sipërfaqja e parcelës ndërtimore që do të miratohet me vkm përkatëse kalimi i pronësisë, rezulton se është përcaktuar më madhe se ajo takuese referuar 3 fishit të bazës së objektit, duke miratuar **më tepër 28 m^2**[370(sipërfaqja e miratuar)-342(3*114)(sipërfaqja takuese)], sa vepruar në kundërshtim me pikën 1/a neni17 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar.
- Duke ju referuar të dhënave në KPP dhe hartës treguese, rezulton se objekti i lëgalizuar, bie pjesërisht mbi pasurinë nr. 2/235, e cila rezulton e llojit "rrugë", për rrjedhojë leje e legalizimit është miratuar në kundërshtim me dispozitat ligjore përcaktuar në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 , i ndryshuar.
Nga ZVRPP Bulqizë, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Sa trajtuar, rezulton se miratimi i lejes së legalizimit dhe regjistrimi i kësaj pasurie, janë në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi është miratuar më tepër parcela ndërtimore më sipërfaqe **28 m^2**, si dhe ndërtesa e legalizuar bie mbi rrugë, sa vepruar në ***sa vepruar*** në papajtueshmëri me, shkronjën "a" neni 25, me pikën 5 nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjin nr. ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar, dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** V. H. me detyrë ish Regjistrues, D. H., me detyrë specialist jurist dhe R. Sh. me detyrë specialist hartograf.

- Referencë nr. 3068;
Me aplikim nr. 179, datë 05.02.2018, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të përfituar me Leje Legalizimi nr. 986107 datë 15.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër dhe pajisja me certifikatë pronësie.
Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 10, faqe 35, është regjistruar me datë 19.02.2018, pasuria nr. 2/427, objekti shtesë anësore dhe ngritje kati, ndërtesë 3 kat, me sipërfaqe ndërtimi të shtesës 193 m^2, sëbashku me objektin ekzistues volum 9, faqe 6, me sipërfaqe 124 m^2 dhe sipërfaqe totale 317 m^2, me funksion social ekonomik,, lëshuar certifikatë pronësie datë 15.03.2018, duke kaluar në pronësi të [redacted]. Në lejen e legalizimit është përcaktuar parcela ndërtimore me sipërfaqe 317 m^2, e cila do të kalojë në pronësi të poseduesit, sipas VKM-së përkatëse.

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor, rezulton se me shkresën nr. 217, datë 29.01.2018, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër ka dërguar për regjistrim në ZVRPP Bulqizë, Lejen e legalizimit nr. 986107, datë 15.01.2018, sëbashku me dokumentacionin shoqërues.
Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor gjendje në dosjen e audituar, rezulton se shtesa e objektit të legalizuar, është ndërtuar mbi pasuritë: nr. 2/386/2, volum 9, faqe 101, ndërtesë me sipërfaqe 28 m^2 dhe nr. 2/404, volum 8, faqe 191, ndërtesë me sipërfaqe 40 m^2, që figurojnë në pronësi të poseduesit të lejes së legalizimit. Gjithashtu është ndërtuar edhe mbi pasurinë nr. 2/10/2, volum 8, faqe 192, truall me sipërfaqe 64 m^2, i cili figuron në pronësi "shtet". Sipas deklaratës noterale datë 10.10.2017, të poseduesit të lejes së legalizimit, deklarohet se 2 ndërtesat në pronësi të tij janë prishur nga poseduesi, ndërsa për objektin në pronësi shtet, deklarohet se është gjetur i shembur.

Sa trajtuar, rezulton se regjistrimi i pasurisë dhe përfitimi i kësaj pasurie me leje legalizimi, është kryer me shkelje dhe parregullsi, si vijon:
- Sipërfaqja e parcelës ndërtimore që do të miratohet me vkm përkatëse kalimi i pronësisë, rezulton se është përcaktuar më madhe se ajo takuese për objektin shtesë anësore, duke miratuar miratuar si pjesë të parcelës ndërtimore edhe truallin mbi të cilin është ngritur objekti ekzistues me sipërfaqe 124 m^2, e cila nuk mund të përfitohet me leje legalizimi, pasi është trualli që zë objekti ekzistues dhe nuk mund të shërbejë si truall funksional për shtesë anësore të legalizuar, për rrjedhoje sipërfaqja prej **124 m^2**[313 m^2 (sipërfaqja e përfituar)-193 m^2 (sipërfaqja takuese)] është përfituar në kundërshtim me pikën 1/a neni17 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar.
Nga ZVRPP Bulqizë, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

Sa trajtuar, rezulton se lidhur me prishjen e pasurisë ndërtesë me sipërfaqe 64 m^2, që në KPP figuron në pronësi shtet, rezulton se nuk ka ndonjë akt administrativ të lëshuar nga organet përkatëse, apo vendim gjykate të formës së prerë, për tjetërsimin e objektit apo prishjen e tij, për rrejdhojë ***fshirja e të drejtës së pronësisë shtetërore, për objektin ndërtesë me sipërfaqe 64 m^2, nqs nuk paraqitet dokumentacion argumentues do të konsiderohet si si dëm i shkatuar ndaj shtetit.***
Sa vepruar në kundërshtim me pikën 3 neni 34, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ku përcaktohet:

"*Në asnjë rast regjistruesi nuk lejon ndryshimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme, që fshin të drejtat reale mbi të.*"

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** Sh. A. me detyrë Regjistrues, D. H., me detyrë specialist jurist dhe R. Sh. me detyrë specialist hartograf.

- Referencë nr. 2994;
Me aplikim nr.1016, datë 18.05.2017, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të përfituar me Leje Legalizimi nr. 986775, datë 23.03.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër dhe pajisja me certifikatë pronësie.
Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 10, faqe 15, është regjistruar me datë 31.05.2017, pasuria nr. 2/165-Nd, ndërtesë 1 kat me sipërfaqe ndërtimi 92.5 m^2, me funksion social ekonomik, lëshuar certifikatë pronësie 05.06.2017, duke kaluar në pronësi të [redacted]
Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor, rezulton se me shkresën nr. 452, datë 30.03.2017, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër ka dërguar për regjistrim në ZVRPP Bulqizë, Lejen e legalizimit nr. . 986775, datë 23.03.2017, sëbashku me dokumentacionin shoqërues.

Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor rezulton se mbi truallin që është ngritur objekti i legalizuar, rezulton i regjistruar në KPP, volum 6, faqe 85, objekti ekzistues në pronësi shtet, ndërtesë me sipërfaqe 82 m^2.
Në dokumentacionin gjendje në dosjen me referencë 2994, ndodhet edhe deklarata noterale datë 23.03.2017, ku poseduesi i lejes së legalizimit deklaron se ka ndërtuar objektin e ri mbi një objekt të rrënuar.
Nga ZVRPP Bulqizë, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Sa trajtuar, rezulton se lidhur me prishjen e pasurisë ndërtesë me sipërfaqe 82 m^2, që në KPP figuron në pronësi shtet, rezulton se nuk ka ndonjë akt administrativ të lëshuar nga organet përkatëse, apo vendim gjykate të formës së prerë, për tjetërsimin e objektit apo prishjen e tij, për rrejdhojë ***fshirja e të drejtës së pronësisë shtetërore, për objektin ndërtesë me sipërfaqe 82 m^2, nqs nuk paraqitet dokumentacion argumentues do të konsiderohet si si dëm i shkatuar ndaj shtetit.***
Sa vepruar në kundërshtim me pikën 3 neni 34, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ku përcaktohet:

"*Në asnjë rast regjistruesi nuk lejon ndryshimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme, që fshin të drejtat reale mbi të.*"

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** V. H. me detyrë Regjistrues, D. H., me detyrë specialist jurist dhe R. Sh. me detyrë specialist hartograf.

- Referencë nr. 2913;
Me aplikim nr. 1848, datë 23.12.2016, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të përfituar me Leje Legalizimi nr. 986385 datë 13.07.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër dhe pajisja me certifikatë pronësie.
Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 10, faqe 9, është regjistruar me referencë 2913, datë 05.01.2017, pasuria nr. 1/179-Nd, objekti ndërtesë 1 kat, me sipërfaqe ndërtimi të shtesës 106 m^2, me funksion të kombinuar social ekonomik,, lëshuar certifikatë pronësie datë 12.01.2017, duke kaluar në pronësi të [redacted] Në lejen e legalizimit është përcaktuar parcela ndërtimore me sipërfaqe 330 m^2, e cila do të kalojë në pronësi të poseduesit, sipas VKM-së përkatëse.
Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor, rezulton se me shkresën nr. 3434, datë 12.12.2016, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër ka dërguar për regjistrim në ZVRPP Bulqizë, Lejen e legalizimit nr. 986385, datë 13.07.2016, sëbashku me dokumentacionin shoqërues.
Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor gjendje në dosjen e audituar, rezulton se objekti i legalizuar, është ndërtuar mbi pasuritë: nr. , volum 5, faqe 86, ndërtesë me sipërfaqe 72 m^2.
Sa trajtuar, rezulton se regjistrimi i pasurisë dhe përfitimi i kësaj pasurie me leje legalizimi, është kryer me shkelje dhe parregullsi, si vijon:
- Sipërfaqja e parcelës ndërtimore që do të miratohet me vkm përkatëse kalimi i pronësisë, rezulton se është përcaktuar më e madhe se ajo takuese, referuar 3 fishit të bazës së objektit, duke miratuar **më tepër 12 m^2**[330(sipërfaqja e miratuar)-318(3*106)(sipërfaqja takuese)], sa vepruar në kundërshtim pikën 1/a neni17 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar.
Nga ZVRPP Bulqizë, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Sa trajtuar, rezulton se lidhur me prishjen e pasurisë ndërtesë me sipërfaqe 72 m^2, që në KPP figuron në pronësi shtet, rezulton se nuk ka ndonjë akt administrativ të lëshuar nga organet

përkatëse, apo vendim gjykate të formës së prerë, për tjetërsimin e objektit apo prishjen e tij, për rrejdhojë ***fshirja e të drejtës së pronësisë shtetërore, për objektin ndërtesë me sipërfaqe 72 m², nqs nuk paraqitet dokumentacion argumentues do të konsiderohet si dëm i shkatuar ndaj shtetit.***

Sa vepruar në kundërshtim me pikën 3 neni 34, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ku përcaktohet:

"*Në asnjë rast regjistruesi nuk lejon ndryshimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme, që fshin të drejtat reale mbi të."*

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** V. H. me detyrë Regjistrues, D. H., me detyrë specialist jurist dhe R. Sh. me detyrë specialist hartograf.

- Referencë nr. 0913; ZK 3694

Me aplikim nr. 1922, datë 21.11.2017, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi i pasurisë ndërtesë me sipërfaqe 622.8 m² të përfituar me Leje legalizimi nr. 986943, datë 10.08.2017 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër dhe pajisja me certifikatë pronësie.

Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 15, faqe 86, është regjistruar me datë 19.03.2018, pasuria nr. 1862-Ndndërtesë 1 kat me sipërfaqe 622.8 m², me funksion socila ekonomik, lëshuar certifikatë pronësie datë 19.03.2018, duke kaluar në pronësi të [redacted]

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor, rezulton se me shkresën nr. 1769, datë 20.09.2017, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër ka dërguar për regjistrim në ZVRPP Bulqizë, Lejen e legalizimit nr. 986943, datë 10.08.2017, sëbashku me dokumentacionin shoqërues.

Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor rezulton se mbi truallin që është ngritur objekti i legalizuar, rezulton i regjistruar në KPP, volum 8, faqe 164, ndodhet objekti ekzistues në pronësi shtet, ndërtesë me sipërfaqe 646 m².

Në dokumentacionin gjendje në dosjen me referencë 913, ndodhet edhe deklarata noterale datë 27.06.2017, ku poseduesi i lejes së legalizimit deklaron se ka ndërtuar objektin e ri mbi një objekt të rrënuar.

Nga ZVRPP Bulqizë, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

Sa trajtuar, rezulton se lidhur me prishjen e pasurisë ndërtesë me sipërfaqe 646 m², që në KPP figuron në pronësi shtet, rezulton se nuk ka ndonjë akt administrativ të lëshuar nga organet përkatëse, apo vendim gjykate të formës së prerë, për tjetërsimin e objektit apo prishjen e tij, për rrejdhojë ***fshirja e të drejtës së pronësisë shtetërore, për objektin ndërtesë me sipërfaqe 646 m², nqs nuk paraqitet dokumentacion argumentues do të konsiderohet si dëm i shkatuar ndaj shtetit.***

Sa vepruar në kundërshtim me pikën 3 neni 34, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ku përcaktohet:

"*Në asnjë rast regjistruesi nuk lejon ndryshimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme, që fshin të drejtat reale mbi të."*

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** Sh. A. me detyrë Regjistrues, D. H., me detyrë specialist jurist dhe R. Sh. me detyrë specialist hartograf.

- Referencë nr. 887; ZK 3694

Me aplikim nr. 1452, datë 15.08.2017, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të përfituar me Leje Legalizimi nr. 986923, datë 10.07.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër dhe pajisja me certifikatë pronësie.

Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 15, faqe 78, është regjistruar me datë 24.08.2017, pasuria nr. 262/2-Nd, ndërtesë 2 kat me sipërfaqe ndërtimi 142 m², me funksion

banimi, lëshuar certifikatë pronësie 30.08.2017, duke kaluar në pronësi të [redacted]

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor, rezulton se me shkresën nr. 1497, datë 31.07.2017, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër ka dërguar për regjistrim në ZVRPP Bulqizë, Lejen e legalizimit nr. . 986923 datë 10.07.2017, sëbashku me dokumentacionin shoqërues.
Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor rezulton se mbi truallin që është ngritur objekti i legalizuar, rezulton i regjistruar në KPP, volum 2, faqe 27, objekti ekzistues në pronësi shtet, ndërtesë me sipërfaqe 127 m^2.
Në dokumentacionin gjendje në dosjen me referencë 887, nuk ndodhet deklarata noterale lidhur me objektin ekzistues, mbi të cili është ndërtuar objekti i legalizuar.
Nga ZVRPP Bulqizë, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Sa trajtuar, rezulton se lidhur me prishjen e pasurisë ndërtesë me sipërfaqe 127 m^2, që në KPP figuron në pronësi shtet, rezulton se nuk ka ndonjë akt administrativ të lëshuar nga organet përkatëse, apo vendim gjykate të formës së prerë, për tjetërsimin e objektit apo prishjen e tij, për rrejdhojë ***fshirja e të drejtës së pronësisë shtetërore, për objektin ndërtesë me sipërfaqe 127 m^2, nqs nuk paraqitet dokumentacion argumentues do të konsiderohet si dëm i shkatuar ndaj shtetit.***
Sa vepruar në kundërshtim me pikën 3 neni 34, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ku përcaktohet:

"*Në asnjë rast regjistruesi nuk lejon ndryshimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme, që fshin të drejtat reale mbi të.*"

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** D. H. me detyrë Regjistrues, , me detyrë specialist jurist dhe R. Sh. me detyrë specialist hartograf.

- Referencë nr. 0920; ZK 3694
Me aplikim nr. 463, datë 25.04.2018, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të përfituar me Leje Legalizimi nr. 986846, datë 26.03.2018, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër dhe pajisja me certifikatë pronësie.
Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 15, faqe 89, është regjistruar me datë 10.05.2018, pasuria nr. 2309-Nd, ndërtesë 3 kat me sipërfaqe ndërtimi 102.9 m^2, me funksion banimi, lëshuar certifikatë pronësie 17.05.2018, duke kaluar në pronësi të [redacted]

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor, rezulton se me shkresën nr. 630, datë 10,04.2018, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër ka dërguar për regjistrim në ZVRPP Bulqizë, Lejen e legalizimit nr. . 986846, datë 26.03.2018, sëbashku me dokumentacionin shoqërues.
Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor rezulton se objekti i legalizuar dhe parcela ndërtimore me sipërfaqe ndërtimi 160 m^2, bien mbi pasurinë nr. 2309, volum 10, faqe 115, e cila rezulton e shpronësuar për interesa publike, sipas VKM nr. 876, datë 14.12.2011, pavarësisht se projekti nuk është realizuar, gjithsesi VKM-ja është në fuqi lidhur me shpronësimin e sipërfaqes së përcaktuar, mbi të cilën ndodhet edhe objkti i legalizuar, kjo e konfirmuar edhe me shkresën që Regjistyruesi i ZVRPP Bulqizë, dërguar Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Dibër.
Nga ZVRPP Bulqizë, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Sa trajtuar, rezulton se ***miratimi i lejes së legalizimit nr. nr. 986846, datë 26.03.2018*** dhe ***regjistrimi i pasurisë nr. 2309-Nd, ndërtesë 3 kat, është kryer në shkelje të dispozitave ligjore***, *pasi trualli i miratuar si parcelë ndërtimore mbi të cilin ndodhet objekti i legalizuar, rezulton i*

shpornësuar më parë me VKM përkatëse, ndërsa Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër nuk duhet të kryente legalizimin e objektit, si dhe nuk duhet të regjistrohej nga punonjësit e ZVRPP Bulqizë, shkronjën "a" neni 25, me pikën 5 nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar, ku përcaktohet:

Në shkronjën "a" neni 25, përcaktohet:

Regjistruesi, ose çdo grup i ngarkuar, kërkojnë që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen në bazë të kritereve të mëposhtëme:
a)pronësia dhe kufijtë e pasurive të paluajtëshme përcaktohen nga aktet e fitimit të pronësisë, sipas nenit 193 të Kodit Civil"

Në pikën 2 të nenit 45, përcaktohet:

"Regjistrimi i fitimit të pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme, sipas këtij neni, bëhet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pas plotësimit të kushteve të regjistrimit, të përcaktuara në shkronjën "h" dhe në paragrafin fundit të nenit 193 të Kodit

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** Sh. A. me detyrë Regjistrues, D. H., me detyrë specialist jurist dhe R. Sh. me detyrë specialist hartograf.

- Referencë nr. 0385; ZK 1763

Me aplikim nr. 729, datë 10.04.2017, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të përfituar me Leje Legalizimi nr. 986671, datë 15.01.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër dhe pajisja me certifikatë pronësie.

Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 8, faqe 215, është regjistruar me datë 20.04.2017, pasuria nr. 65/21/1-Nd, objekti ndërtesë 2 kat, me sipërfaqe ndërtimi 151 m^2, me funksion banimi, lëshuar certifikatë pronësie 01.05.2017, duke kaluar në pronësi të [redacted]

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor, rezulton se me shkresën nr. 202, datë 13.02.2017, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër ka dërguar për regjistrim në ZVRPP Bulqizë, Lejen e legalizimit nr. 986671, datë 15.01.2017, sëbashku me dokumentacionin shoqërues.

Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor gjendje në dosjen e audituar, rezulton se regjistrimi i pasurisë dhe përfitimi i kësaj pasurie me leje legalizimi, është kryer me shkelje dhe parregullsi, si vijon:

- Sipërfaqja e parcelës ndërtimore që do të miratohet me vkm përkatëse kalimi i pronësisë, rezulton se është përcaktuar më madhe se ajo takuese referuar 3 fishit të bazës së objektit, duke miratuar **më tepër 47 m^2**[5000(sipërfaqja e miratuar)-453(3*151)(sipërfaqja takuese)], sa vepruar në kundërshtim me pikën 1/a neni17 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar.

Nga ZVRPP Bulqizë, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

Sa trajtuar, rezulton se miratimi i lejes së legalizimit dhe regjistrimi i kësaj pasurie, janë në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi është miratuar më tepër parcela ndërtimore më sipërfaqe 47 **m^2**, ***sa vepruar*** në papajtueshmëri me, shkronjën "a" neni 25, me pikën 5 nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar, dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** V. H. me detyrë ish Regjistrues, D. H., me detyrë specialist jurist dhe R. Sh. me detyrë specialist hartograf.

- Referencë nr. 3073; ZK 8612

Me aplikim nr. 1697, datë 02.10.2017, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi i pasurisë së paluajtshme të përfituar me Leje Legalizimi nr. 986909, datë 05.07.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër dhe pajisja me certifikatë pronësie.
Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 10, faqe 39, është regjistruar me datë 07.05.2018, pasuria nr. 2/120+1-10-Nd, objekti aprtament, me sipërfaqe ndërtimi 117.3 m^2, me funksion banimi, lëshuar certifikatë pronësie 07.05.2018, duke kaluar në pronësi të [redacted]
Nga auditimi i dokumentacionit tekniko ligjor, rezulton se me shkresën nr. 1395, datë 12.07.2017, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër ka dërguar për regjistrim në ZVRPP Bulqizë, Lejen e legalizimit nr. 986909, datë 05.07.2017, sëbashku me dokumentacionin shoqërues.
Nga verifikimi i dokumentacionit ligjor gjendje në dosjen e audituar, rezulton se regjistrimi i pasurisë dhe përfitimi i kësaj pasurie me leje legalizimi, është kryer me shkelje dhe parregullsi, pasi nuk përputhet sipërfaqja totale e përcaktuar në lejen e legalizimit me atë të përcaktuar në planimëtritë e kateve dhe sipërfaqen faktike, pasi në lejen e legalizimit përcaktohet shtesë anësore me sipërfaqe **23.5 m^2**, për 3 katet ekzistuese dhe ngritje kati me sipërfaqe **117.5 m^2,** në total siperfaqja **187.7 m^2**[(3*23.5)+117.5]. Duke ju referuar planimetrive të kateve(3 katet), rezulton se është konsideruar si sipërfaqe ekzistuese për të tre katet sipërfaqja prej **38.7 m^2, duke miratuar shtesë anësore prej 23.5 m^2**, **për sejcilin kat,** por në fakt rezulton ekzistues vetëm kati përdhe me sipërfaqe **38.7 m^2,** i cili është regjistruar bazuar në leje ndërtimi, ndërsa për 2 katet e tjera nuk ka ndërtim ekzistues me sipërfaqe **38.7 m^2.** Gjithashtu sipërfaqja e ndërtimit dhe e parcelës ndërtimore prej **62.2 m^2,** të përcaktuar në lejen e legalizimit, nuk janë të sakta, pasi nga kjo, sipërfaqja prej **38.7 m^2,** i përket objektit ekzistues 1 kat të regjistruar me leje ndërtimi, ndërsa në lejen e legalizimit sipërfaqja e ndërtimit dhe e parcelës ndërtimore duhet të ishte **23.5 m^2**, *që i përket shtesës anësore që përfiton legalizimin.*
Nga ZVRPP Bulqizë, nuk janë plotësuar ***shtojca 2 dhe 3,*** veprim në papajtushmëri me pikën 5, neni 44, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Sa trajtuar, rezulton se miratimi i lejes së legalizimit,është në kundërshtim me dispozitat ligjore, *pasi është miratuar leje legalizimi për shtesë në objekt ekzistuese, por që në fakt nuk ekziston i regjistruar*, ndërsa nga punonjësit e ZVRPP nuk duhet të procedohej me regjistrimin e kësaj leje legalizimi, por duhet ti kërkohej Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër saktësimi i dokumentacionit ligjor dhe hartografik, ***sa vepruar*** në papajtueshmëri me, shkronjën "a" neni 25, me pikën 5 nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar, dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012
Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ***ngarkohet me përgjegjësi*** Sh. A. me detyrë ish Regjistrues, D. H., me detyrë specialist jurist dhe R. Sh. me detyrë specialist hartograf.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
Shkronjën "a" neni 25 dhe pikën 5 neni 45, të Ligjit 33, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtëshme";
Pikën 10.6, Kreu i II, të Regullorës nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar;
Me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale".

Lidhur sa trajtuar në faqet 75-88 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-Konstatimin nr. 10, datë 31.05.2019, janë paraqitur observacionet në rrugë elktronike dhe derguar me shkresen nr. 13.06.2019, të cilat kanë ardhur në KLSH bashkëlidhur me shkresën nr. 737/3, datë 04.07.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 207/3, datë 08.07.2019, të cilat janë përmbledhur nga Përgjegjësi i Zyrës dhe dërguar prej tij, ku sqarohet:

Lidhur me konstatimet që i përkasin referencave nr. 3092, 3070,2955 ZK.8612 , ku konstatoni se Regjistrimi i një ndërtese 1 kat me sip 86 m^2, kjo sipas lejes së legalizimit, nuk ka deklaratë per shembjen e ndertimit ekzistues. Për këtë sqarojmë se Pasuria në fjalë që është shembur dhe ndertuar me pas, ka nr. 2/305 dhe deklarata për shembjen është në dosjen në fjalë ka nr.1878 dt.5.10.2017(bashkëlidhur). Kjo deklaratë noteriale bazohet në "Udhëzimin nr. 4695 DT.31.5.2016" ..... .

*Ky udhezim është bashkëlidhur tek dokumentat sqaruese të këtij akt konstatimi. Në udhëzimin e mësipërm me termin "Objekt i shembur",përfshihen çdo lloj përkatesie juridike e objektit të shembur, sepse në këtë udhëzim nuk ka nënndarje të percaktuar veçmas kur objekti i shembur mund të jetë "Shtet", dhe veçmas kur objekti i shembur është në pronesi. Përveç kësaj,udhëzimi citon se deklarata për prishjen e ndërtimit ekzistues shërben si dokument që kërkohet nga aluizni dhe shërben për nxjerrjen e Aktit te Legalizimit nga ky institucion,kurse në ZRPP ai sherben si dokument shoqërues i lejes se legalizimit të percjelle në ZRPP nga Aluizni,.... . Zrpp nuk mban përgjegjësi për Aktet e Aluiznit në se ky institucion ka shkelur apo jo, pasi ajo është e detyruar t'i regjistroje këto akte , pas verifikimit sipas udhëzimit nr.2 dt.12.09.2012, si dhe në zbatim të nenit nr.3 të ligjit 33/2012 "Per regjistrimin e pasurive te paluajtshme" ku citohet :"dispozitat e këtij ligji zbatohen për regjistrimin e të gjitha pasurive të paluajtshme brenda teritorit të RSH,**bazuar në akte të fitimit të pronësisë,sipas kërkesave të paraqitura**".*

*Përsa i përket faktit se parcela ndërtimore e miratuar që ka kaluar në pronësi me VKM përkatese shtrihet mbi pasuri me emërtim 'Terren sportiv", arsyetojmë se nuk mund të jetë pergjegjësi e Zyrës se Regjistrimit nxjerrja e një Vendimi nga Këshilli i Ministrave, kurse përsa i përket regjistrimit të VKM-ve për parcelat ndërtimore me VKM është bërë bazuar në Udhëzimin "Për disa ndryshime dhe shtesa ne udhezimin nr.4695 dt.31.5.2016"per procedurat e hollesishme te regjistrimit dhe leshimit te certifikates per pasurite e legalizuara, pika 12 në të cilën midis te tjerave citohet: **"Kur marredheniet e pronesisë me truallin nuk eshte rregulluar ende, ZVRPP detyrohet që të kryejë regjistrimin e parcelës ndërtimore menjëhere pas miratimit të VKM-së "***

Lidhur me konstatimet që i përkasin referencave nr. 3074 dhe ref 3011 ZK.8612, Ref.3068, referencë nr. 2994, nr. 2913 dhe 913, konstatohen problemet të njejta si më sipër dhe observacioni është i njejtë.

Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr.2974, ZK 8612, ku ju konstatoni se

-Të dhenat e Pasqyruara ne Lejen e legalizimit nuk perputhen me planimetrite e kateve Ne lejen e legalizimit eshte percaktuar ndertese 2 kat mbi toke,ndersa ne planimetrine e kateve percaktohet objekti ndërtese me një kat bodrum dhe një kat mbi tokë.

Lidhur me këtë sqarojmë se percaktimi ne leje legalizimi " dy kat mbi toke" është përcaktuar për arsyen specifike që ka ky objekt ku kati i poshtëm (pra i përcaktuar si bodrum në planimetri) ,ka 3 faqe të zbuluara pra nuk janë nëntoke, kurse vetem një faqe nga ana e rruges për arsye disniveli mbulohet. Për këte arsye në Planimetri është quajtur bodrum sepse ndodhet nen nivelin e rruges Bulqize-peshkopi,por qe rreth 65% nuk mbulohet nga toka,sepse terreni ku është bere ndërtimi është skarpatë,pra me pjerrësi të madhe .

Konstatim tjeter tek kjo Referencë është:

-Duke ju referuar te dhenave ne KKP rezulton se parcela ndertimore e miratuar në funksion të objektit te legalizuar shtrihet mbi pasurite nr.2/76/2 v.9.fq.133 e llojit "Ledh" dhe mbi pasurine nr.2/72/2 vol. 9 fq.131 'Terren sportiv". Dhe per rrjedhoje leja e legalizimit është miratuar ne kundershtim me ligjin.

Lidhur me këtë përsërisim se Leja e legalizimit në fjalë nxjerrë nga Aluizni, nuk është Akt i nxjerre nga Zyra Jonë. Ajo në momentin aktual ka rregjistruar vetëm ndërtimin,sipas lejes se legalizimit,kurse për dy pasurite e sipercituara "Ledh" dhe "Terren Sportiv",që i përkasin parcelës ndërtimore, siç dhe i keni audituar në keto dy kartela, nuk janë kryer veprime sepse nuk ka VKM për parcelën ndërtimore, pra aktualisht janë "Shtet".

Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 2979, ZK 8612, ku ju konstatoni se se ka mosperputhje të numrave të pasurive 2/233 (të përdorur nga aluizni) dhe 2/232 (ku ka rënë pozicioni pas azhornimit të lejes se legalizimit),arsyetojme se regjistrimi e lejes se legalizimit ne

HTR bëhet me anë të dy metodave a)-me metodën e përputhjes ose b)-me metodën e koordinatave. Nga veprimet profesionale inxhinierike në zbatim të detyrave që përcakton rregullorja nr. 184 ka rezultuar se pozicioni i saktë i objektit të legalizuar është saktësisht aty ku është azhornuar në gjendjen e audituar,kurse konstatimi juaj se objekti bie mbi pasuri rruge, ka ardhur nga gabime teknike nga kompania që ka bërë matjet e kesaj Zone kad,të regjistruar ne vitin 1996, ku rruga që thoni nuk është e saktë si pozicion dhe për këtë jemi konsultuar edhe me fotot imazherike (ortofoton) e kësaj zone,ku siç del ky objekt nuk është ndërtuar mbi rruge. Hedhja gabim e pozicionit te objektit të legalizuar pra duke e azhornuar atë jasht rrugës që është gabim në hartë, vetëm me qëllim që mos të ndryshoje nr. i pasurisë nga ai që ka përdorur aluizni do të perbente mungese të plotë profesionalizmi dhe shkelje nga sektori i hartografisë Aluizni ka kerkuar te dhena per ate pasuri (2/233) dhe ne i kemi dhënë informacion për atë që ka kërkuar. Per veprimet jo te rregullta hartografike të bërë nga kompania ne vitin 1996, ne nuk mund të pergjigjemi por as nuk mund te vazhdonim serinë e gabimeve të metejshme duke azhornuar objektin ne fjalë në pozicion të gabuar.

Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 920, ZK 8612, ku ju konstatoni se eshte bere regjistrimi i nje objekti me leje legalizimi parcela ndertimore e të cilit bie mbi nje pasuri te shpronesuar, pavaresisht se projekti nuk është realizuar, gjithsesi Vkm-ja është ne fuqi. Lidhur me këtë ju kemi sqaruar edhe gjate kërkimit të shpjegimeve gjatë auditimit ku ju kemi bërë me dije se ZRPP nuk ka regjistruar parcelen ndertimore por objektin dhe deri tani nuk kemi ndonje VKM per parcelen ndertimore,por edhe sikur kjo VKM te dale nuk do te regjistrohet per arsye te mbivendosjes se VKM-se së regjistruar me përpara për shpronësim deri në daljen e nje VKM-je tjeter qe do te rrezoje VKM-në e shpronesimit per arsye se projekti nuk eshte realizuar ne terren,pra kjo sasi toke e shpronesuar ne fakt ekziston,por gjithashtu dhe pronari ne dijenine tone nuk e ka marre shpronesimin per kete rast.

Lidhur me konstatimet që i përkasin referencës nr. 920, ZK 8612, ku ju kemi dhënë shpjegimet tona gjatë auditimit ku kemi sqaruar se perfituesi i lejes së legalizimit në fjalë ka legalizuar një sipërfaqe ndërtimi kati i tretë (shtese kati) me siperfaqe 117,3 m2 ,por në këtë leje Legalizimi ka përfituar gjithashtu edhe tre shtesa me nga 23,5 m2 për 3 kate të tjera me poshtë :kati i dyte,kati i pare dhe kati përdhe.Këto shtesa nuk janë regjistruar për arsye se ishin shtesa të shtesave të mëparshme të dhëna me leje ndertimi,por që këto të fundit nuk figurojne të regjistruara.Pra regjistrimi i kësaj leje legalizimi është bërë në mënyrë të pjesshme duke regjistruar vetëm siperfaqen 117 ,3 m2 që i perket shtesës së katit të sipërm(kati i tretë)

Sqarimi i Grupit të auditimit:

Lidhur me observacionet e paraqitur, të sipërcituar, nuk merren në konsideratë pasi, nuk janë paraqitur argumente dhe prova të reja. Lidhur me pretendimet që i përkasin referencave nr. 3092, 3070,2955 ZK.8612 , ku ju pretndoni se qytetari përfitues ka paraqitur deklaratë për prishjen e objektit në pronësi "shtet", në përputhje me Udhëzimin nr. 4695, dt. 31.5.2016, sqarojmë se përsëri se pretendimi juaj nuk qëndron pasi në asnjë akt ligjor apo nën ligjor nuk thuhet se dikush mund të prishë ndërtesat në pronësi "shtet" dhe mbi të ndërtojë objektin e tij. Lidhur me pretendimet që i përkasin referencave nr. 3092, 3070,2955 ZK.8612 dhe për të gjitha praktikat e tjera, ku ku konstatohet e njëjta problematikë, arsyetimi është i njëjtë.

Lidhur me pretendimet që i përkasin referencës nr. 3074 ZK.8612, sqarojmë se pretendimi juaj nuk qëndron, pasi ne kemi konstatuar mos përputhje të dhënash në dokuemntet e dërguara nga ALUIZN-i, të cilat në fakt ekzistojnë, ndërsa ju nuk duhet të kryenit regjistrimin e lejes së legalizimit por duhet ti kërkonit konfirmimin e Drejtorisë së ALUZNI-t.

Lidhur me pretendimet që i përkasin referencës nr. 2979 ZK.8612, sqarojmë se pretendimi juaj nuk qëndron pasi ne kemi konstatuar mospërputhje të numërit të pasurive të lejes së legalizimit (nr. 2/233) me atë të regjistruar në KPP(NR. 2/232), ndërsa ju në observacionin tuaj nuk e argumentoni ka këtë mospërputhje, duke dhënë një arsyetim të papërshtatshëm dhe të panevojshëm. Ndërsa lidhur me konstatimin tonë se kjo bie mbi rrugë, pretendimi juaj se këto rrjedhin nga gabime gjatë hedhjes së zonës në sistem nga kompania, nuk qëndron si argument,

pasi ju e keni të përcaktuar në aktet nënligjore që të gjitha gabimet që e kanë origjinën nga regjistrimi fillestar në sisitem regjistrimi, paraprakisht duhet të bëhet korigjimi i tyre, gje të cilën ju nuk e keni bërë, për rrjedhojë konstatimet tona janë nxjerrë duke ju referuar dokumentacioni ligjor dhe atij hartografik që ju keni në administrim, mbi bazën e të cilit keni kryer veprimet përkatëse. Ky qëndrim i yni vlen edhe për praktikat e tjeera që kanë të njëjtën natyrë shkelje.
Si përfundim, lidhur me argumentet e paraqitura nga ana juaj, sqarojmë, se ne i kemi diskutuar gjatë auditimit në subjekt, për rrjedhojë në mungesë të fakteve dhe dokumentve të reja, konsatimet tona mbeten të pandryshuara.

Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **8 raste** që ju përkasin referencat : nr. 3092 dhe 3070, nr. 3074, nr. 3008, nr. 3011, nr. 2994, nr. 2913, ZK 8612 dhe nr. 887, nr. 913, ZK 3694, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme përfituar me leje legalizimi, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi* legalizimi është kryer mbi objekte që rezultojnë të regjistruara në KPP, në pronësi "shtet", për të cilat nuk ka ndonjë akt administrativ të lëshuar nga organet përkatëse, apo vendim gjykate të formës së prerë, për tjetërsimin e objektit apo prishjen e tij, për rrjedhojë regjistrimi i pasurive të legalizuara, ka sjellë si pasojë ***fshirjen e të drejtës së pronësisë shtetërore për*** pasuritë ndërtesë me sipërfaqe totale ***1498 m^2, e cila do të konsiderohet si dëm i shkatuar ndaj shtetit, në mungesë të dokumentaciot argumentues,*** sa vepruar **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25 dhe pikën 3 neni 34, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme"**.**
Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi në 8 raste** për pasuritë sipas referencave të sipërcituara, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor që argumenton fshirjen e pasurive ndërtesë me sipërfaqe totale 1498 m^2 në pronësi "shtet".

Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **6 raste** që ju përkasin referencat : nr. 3092 dhe 3070, nr. 2974, nr. 2979, nr. 3068, nr. 2913, ZK 8612 dhe nr. 0385, ZK 1763, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme përfituar me leje legalizimi, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi lejet e legalizimit kanë miratuar parcela ndërtimore,* me sipërfaqe më tepër se sipërfaqja takuese sa trefishi i sipërfaqes së bazës së objektit, ndërsa *nga ZVRPP Bulqizë, nuk janë verifikuar elementët e formës e përmbajtjes së Aktit Administrativ të Lejes së Legalizimit në lidhje me sipërfaqen e parcelës ndërtimore,* për rrjedhojë është miratuar në favor të poseduesëve të lejeve të legalizimit, më tepër ***trualli me sipërfaqe totale prej 524.2 m^2,*** sa vepruar në papajtushmëri me shkronjën"a" neni 25, nenin 49, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 17 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar dhe me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit"
Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi në 6 raste** për pasuritë sipas referencave të sipërcituara, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Gjithashtu në bashkëpunim me Sektorin e ALUIZNI-t, në Drejtorinë e ASHK Dibër, të ndiqen procedurat e lekujdimit me çmimin e tregut, për truallin e tepërt të përfituar padrejtësisht nga poseduesit e lejeve të legalizimit.
Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **1rast** me referencë nr. **0920,** ZK 3694, ka regjistruar në volum 15, faqe 89, pasurinë nr. 2309-Nd, ndërtesë 3 kat me sipërfaqe ndërtimi 102.9 m^2, me funksion banimi, përfituar me leje legalizimi, ***e cila është lëshuar në kundërshtim me dispoziatat ligjore****, pasi pasi trualli i miratuar si parcelë ndërtimore mbi të cilin ndodhet objekti i legalizuar, rezulton i shpornësuar më parë me VKM përkatëse*(pretendohet se nuk është objekt shpronësimi),

ndërsa Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër nuk duhet të kryente legalizimin e objektit, si dhe nuk duhet të regjistrohej nga punonjësit e ZVRPP Bulqizë, sa vepruar **në kundërshtim me** shkronjën "a" neni 25, me pikën 5 nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar dhe me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit"
Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 2309-Nd, volum 15, faqe 89, ZK 3694, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor apo konfirmimin zyrtar nga institucionet kompetente, që trualli nuk është objekt shpronësimi për interesa publike.
Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **1rast** me referencë nr. 3073, ZK 8612, ka regjistruar në volum 10, faqe 39, pasurinë nr. 2/120+1-10-Nd, apartament me sipërfaqe 117.3 m^2, me funksion banimi, përfituar me leje legalizimi, *duke mos zabtuar dispoziatat ligjore, pasi është miratuar leje legalizimi për shtesë në objekt ekzistuese, por që në fakt nuk ekziston i regjistruar*, ndërsa nga punonjësit e ZVRPP nuk duhet të procedohej me regjistrimin e kësaj leje legalizimi, por duhet ti kërkohej Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Dibër saktësimi i dokumentacionit ligjor dhe hartografik, ***sa vepruar*** në papajtueshmëri me, shkronjën "a" neni 25, me pikën 5 nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar, dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012.
Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 2/120+1-10-Nd, volum 15, faqe 39, ZK 8612, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

ZK 8611
Kartelat e pasurisë së paluajtshme, sipas volumeve dhe zonave kadastrale.
Dokumentacioni sipas inventarizimit bashkëlidhur referencave përkatëse, si dhe korrespondencat shkresore me institucionet përkatëse, etj.

- Referencë nr. 002409 **ZK 8611;**
Me kërkesë nr. 1792, datë 26.10.2017, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të legalizuara, për objektin sipas lejes së legalizimit nr. 986969 datë 31.08.2017 "Godinë e kombinuar 6 kate" pajisur me certifikatë pronësie datë 13.11.2017.
- Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 5, faqe 240, është regjistruar pasuritë nr2/20/4-ND2, në pronësi të [redacted]
ZVRPP Bulqizë ka ofruar shërbimi e kërkuar subjekti, në kushtet kur; Nga verifikimi i materialit hartografik dhe pozicionimit të pronës rezulton se objekti informal ***është hedhur në hartën e punës me konturet e kuqe dhe prek pjesërisht mbi pasurinë nr. 2/131 e llojit ndërtesë, pra krijohet mbivendosje kur behet azhurnimi në HTR të ZVRPP sipas hartës të përfunduar të ALUIZNIT.*** Veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", pika 5 e Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi znj. D. H. me detyrë ish/regjistruesë aktualisht specialiste.

Lidhur sa sipër trajtuar është mbajtur Akt-Konstatimi nr. 10, datë 31.05.2019, për të cilin nuk janë paraqitur observacione në fazën e hartimit të projekt raportit të auditimit, nga personat e cilësuar si përgjegjës.

Observacioni i paraqitur nga ZVASHK Bulqizë nr. 661 prot datë 13.06.2019, përgjegjësi sektorit Sh. A. në lidhje me aktkonstatimin dhe projektraportin e auditimit

Ref.2409 Zk.8611,Konstatimi ka te beje me faktin se leja e legalizimit ne emer te Arben çupit në HTR prek pjeserisht pasurine 2/131 e llojit "ndertese" .Lidhur me kete konstatim gjykojme se: Pas regjistrimit fillestar cdo veprim perditesimi pas regjistrimit fillestar sistematik, bëhet ne HTR e punes me ngjyre te dallueshme nga regjistrimi fillestar.Fakti qe regjistrimi i lejes se legalizimit ka atakuar pak nje ndertese te regjistruar me perpara ka ardhur nga gabimi i pozicionit te nderteses te regjistruar nga regjistrimi fillestar i kesaj zone kadastrale bërë në vitin 1996.Për të mos krijuar një mori me viza të korrigjuara ky objekt në Htr manuale nuk është lëvizur,por leja e legalizimit është regjistruar saktësisht në hartë aty ku duhet te jetë,pasi nuk mund te spostohej per shkak të një pasaktësie të një objekti afer tij,Rruga tjeter mund te ishte rregullimi me korrektues duke hequr vijat e teperta,por që në fakt përdorimi i korrektuesit është shkelje,kurse dixhitalisht është bërë rregullimi i pozicionit të gabuar nga regjistrimi fillestar i ndërtesës,në konsultim edhe me ortofoton përkatëse.

*Bashkelidhur keni fotot imazherike për sa më sipër si dhe fragment të hartës dixhitale të rregulluar të ndërteses ekzistuese dhe objektit të aluiznit të regjistruar sipas referencës së mësipërme. Ky rregullim i pozicionit të dy objekteve dixhitalisht në AutoCAD është bërë në kohën e përpunimit të dokumentacionit të Lejes se legalizimit,jo pas kontrollit të ushtruar nga institucioni juaj.Kjo për faktin se nga ana juaj janë kërkuar për verifikim vetëm përditesimet në hartat manuale ,por jo se si janë kryer këto në formatin inxhinierik Autocad,që në fakt në zyrën tonë në fillim këto përditsime kryhen dixhitalisht pastaj hidhen edhe manualisht.Në rastin konkret po të kryeshin rregulime pozicioni manualisht do të krijoheshin shume vija si dhe numra pasurish të korrigjuara(të zhvendosura),problem i cili është marrë parasysh tek harta dixhilale. Sa arsyetuam në lidhje me këtë,për rastin që flasim duhej të ishte kërkuar për sqarime të mëtejshme nga ana juaj se si është kryer ky veprin në HTR dixhitale pasi në Zyrën tonë**çdo veprim hartografik** është përditësuar në 3 formate:*

Dixhitale në Autocad, Manuale,Sistemin AlbSrep, për Zonat e ngarkuara në këtë sistem.

Sqarimi i grupit të auditimit. *Observacioni juaj nuk meret në konsideratë pasi:*

Nga verifikimi i materialit hartografik dhe pozicionimit të pronës rezulton se objekti informal është hedhur në hartën e punës me konturet e kuqe dhe prek pjesërisht mbi pasurinë nr. 2/131 e llojit ndërtesë, pra krijohet mbivendosje kur behet azhurnimi në HTR të ZVRPP sipas hartës të përfunduar të ALUIZNIT

Referenca 00781, ZK 2267 ''Krastë.

Sipas referencës 00781, datë 23.03.2019, është kryer regjistrimi në emër të [redacted] leje legalizimi nr. 987069, datë 08.01.2018, destinacioni "Banim", pasuria nr. 1/79-ND, vol. 4, f. 99, lëshuar certifikatë datë 13.04.2018, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 300.0 m^2, sipërfaqe e ndërtimit 292.00 m^2. Regjistrues Sh. A..

Nga auditimi u konstatua se kërkesa e poseduesit është bërë në datën 08.03.2018 me kërkesën nr 281. regjistrimi i pronës është bërë në datën 23.03.2018 duke tejkaluar afatin 10 ditor të regjistrimit të lejes së legalizimit. Kjo bie në kundërshtim me vendimin nr. 1095, datë 28.12.2015, *"Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet aluizni-t dhe zqrpp-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara"* pika III. PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË LEJES SË LEGALIZIMI T, **pika nr 13** "*regjistruesi, me paraqitjen e kërkesës, sipas pikës 10, të këtij vendimi, kryen, brenda 10 ditëve, regjistrimin e lejes së legalizimit".*

Sipas referencës 00780, datë 02.02.2018, është kryer regjistrimi në emër të [redacted] leje legalizimi nr. 987040, datë 08.11.2017, destinacioni "Banim", pasuria nr. 1/5-ND, vol. 4, f. 98, lëshuar certifikatë datë 15.02.2018, sipërfaqe e parcelës ndërtimore 200.0 m^2, sipërfaqe e ndërtimit 335.40 m^2. Regjistrues Sh. A..
Nga auditimi u konstatua se kërkesa e poseduesit është bërë në datën 19.01.2018 me kërkesën nr 117. regjistrimi i pronës është bërë në datën 02.02.2018 duke tejkaluar afatin 10 ditor të regjistrimit të lejes së legalizimit. Kjo bie në kundërshtim me vendimin nr. 1095, datë 28.12.2015, *"Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet aluizni-t dhe zqrpp-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara"* pika III. PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË LEJES SË LEGALIZIMI T, **pika nr 13** "*regjistruesi, me paraqitjen e kërkesës, sipas pikës 10, të këtij vendimi, kryen, brenda 10 ditëve, regjistrimin e lejes së legalizimit".*
Në inventarin e brendshëm të dosjes nuk disponohet certifikata e gjendjes familiare të poseduesit të objektit të legalizuar. Kjo bie në kundërshtim me vendimin nr. 1095, datë 28.12.2015, *"Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet aluizni-t dhe zqrpp-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara"* pika II. **"***PARAQITJA E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E LEJES SË LEGALIZIMIT***", pika 10 , "***Kërkesa për regjistrim paraqitet në ZVRPP nga ALUIZNI, brenda 5 ditëve nga data e miratimit të lejes së legalizimit, dhe shoqërohet me dokumentacionin, si më poshtë vijon*": ç) "***Kopje e certifikatës së gjendjes familjare të poseduesit, që disponon ALUIZNI, nga momenti i aplikimit për legalizim".***
Lidhur sa sipër trajtuar është mbajtur Akt-Konstatimi nr. datë 31.05.2019, për të cilin nuk janë paraqitur observacione në fazën e hartimit të projekt raportit të auditimit, nga personat e cilësuar si përgjegjës.

4.1- Auditim mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e objekteve me leje ndërtimi mbi troje publike dhe private, në zbatim të ligjit nr. 8405, datë 17.09.2008 "Për Urbanistikën" i ndryshuar , dhe ligjin 10119, datë 21.04,2009, i ndryshuar, për periudhën e adutimit dhe transaksioneve të kryera me këto prona.

Në zbatim të kësaj pike të programit të auditimit mbi procedurën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të përfituar sipas në bazë të në bazë të lejeve të ndërtimit në zbatim të ligjeve urbanistike", u përzgjodhën *20 referenca* në bazë rrisku, **ku** u konstatua se **4 raste**, janë regjistruar në kartelat e pasurisë së paluajtshme me të meta e mangësi, të cilat po i trajtojmë më poshtë:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
- Referencë nr. 3114; 2573
Me aplikim nr. 1185, datë 22.10.2018, [redacted] ka kërkuar regjistrimin e kontratës së shitjes së truallit nga Ministria e Financës dhe lëshimin e certifikatës së pronësie.
Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 9, faqe 154, me referencë nr. 3114, datë 19.10.2018, është regjistruar pasuria nr. 2/226/2, truall me sipërfaqe 66 m^2, lëshuar certifikatë pronësie me datë 23.10.2018.
Kjo pasuri truall është përfitua me kotratë shitje nr. 2027 Rep. , 1120 Kol. , datë 10.10.2018, me palë shitëse Drejoria e Drejtimit të Pronës Publike, si truall për objektin "shtesë anësore 1 kat+bodrum", i cili është ndërtuar mbi bazën e dokumentacionit urbanistik, dërguar nga Bashkia Bulqizë me shkresën nr. 267, datë 28.03.2013 dhe regjistruar në KPP, me referencë nr. 2573, datë10.04.2013, pasuria nr. 2/416, volum 9, faqe 153, ndërtesë 2 kat, me sipërfaqe të bazës 66 m^2, lëshuar certifikatë pronësie me datë 10.04.2013.
Nga auditimi i dokumentacionit të ndodhur në dosje rezulton se, regjistrimi i kësaj pasurie është bërë me të meta e parregullsi;

- Leja e ndërtimit është miratuar për ndërtimin e objektit në truall shtet dhe regjistrimi i objektit është bërë në mungesë të marërdhënieve me truallin, ndërsa nuk është llogaritur qiraja e përdorimit të truallit për periudhën 01.01.2013 deri më datë 10.10.2018(data e lidhjes së kontratës), e cila llogaritet në vlerën ***në vlerën 231,000 lekë***{70 muaj*[66 m^2(sipërfaqja që zë objekti)*50 lek/ m^2/muaj(vlera e qirasë për njësi)]}, konsiderohet e ardhur e munguar ***detyrim financiar i paarkëtuar,*** veprim në kundërshtim ne pikën 7, kreu IV, rregullores nr. 184, datë 08.04.1999, "Për Punen e Zyres se Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme".
- Leja e sheshit të ndërtimit që miraton kondicionet urbane(Formulari nr. 2, rezulton i pa nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Bulqizë në cilësinë e Kryetarit të KRRT-së.
- Projekti i zbatimit për ndërtimin e objektit, nuk është miratuar nga Titullari i bashkisë
- Trualli i tjetërsuar pasuria nr. 2/226/2 , volum 9, faqe 154 e llojit "truall", për sipërfaqen 66 m^2 rezulton se vjen nga ndarja e pasurisë nr.2/226, volum 6, faqe 114 e llojit "rrugë", me sipërfaqe 1103 m^2, e cila se me referencë nr. 2573, datë 10.04.213, ndahet ne volum 9, faqe 154, truall me sipërfaqe 66 m^2, dhe volum 9, faqe 155, nr. 2/226/1, rruge me sipërfaqe 1037 m^2, duke tjetërsuar pasurinë rrugë pa konfirmimin zyrtar nga institucionet përkatëse, lidhur me funksionin publik të kësaj pasurie, veprim **kundërshtim me** përcaktimet ligjore në pikën 3 neni 3, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit".

Sa trajtuar, rezulton se regjistrimi i pasurisë, ***është kryer me parregullsi dhe në mungesë të dokumentacionit urbanistik tekniko ligjor, si dhe në mungesë të marrëdhënieve më truallin***, ***sa vepruar*** në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, me pikën 2 nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe Regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar;

Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi,** sipas periudhave përkatëse që kane ushtruar detyrën, Sh. A., me detyrë Regjistrues, Bajram Çollaku, me detyrë ish Regjistrues, D. H. me detyrë specialist jurist dhe R. Sh., me detyrë specilist hartograf.

- Referencë nr. 2938; 2803

Me aplikim nr. 426, datë 27.02.2017, [redacted] ka kërkuar regjistrimin e kontratës së shitblerjes së pasurisë dhe lëshimin e certifikatës së pronësie.

Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 9, faqe 219, me referencë nr. 2938, datë 02.03.2017, është regjistruar pasuria nr. 2/33+2-25/1, aprtament me sipërfaqe me sipërfaqe 36 m^2, lëshuar certifikatë pronësie me datë 07.03.2017.

Kjo pasuri truall është përfitua me kotratë shitje nr. 271 Rep. , 107/2 Kol. , datë 15.02.2017, me palë shitëse [redacted] origjina e kësj pasurie rrjedh nga dokumentacionit urbanistik, dërguar nga Bashkia Bulqizë me shkresën nr. 988, datë 13.07.2015 dërguar leje shrytëzimi për shtesë kati, kati katërt, sipas lejes së dhënë me vendimin e KRRT-së nr.4, datë 10.12.2012, Bashkia Bulqizë, për "shtesë pallati"(anësore) 5 kat, për 5 qytetarët banorë të pallatit ekzistues. Kjo pasuri regjistruar në KPP, me referencë nr. 2803, datë 10.08.2015, lëshuar certifikatë pronësie me datë 12.08.2015.

Nga auditimi i dokumentacionit të ndodhur në dosje rezulton se, regjistrimi i kësaj pasurie është bërë me të meta e parregullsi;

- Leja e ndërtimit është miratuar për ndërtimin e objektit në truall shtet dhe regjistrimi i objektit është bërë në mungesë të marërdhënieve me truallin, dhe nuk është regjistruar fillimisht objekti bazë për të cilin është miratuar leja e ndërtimit dhe më pas duhet të regjistroheshin njësitë përbërëse të pallatit, si njësi të individualizuara, veprim në kundërshtim ne pikën 7, kreu IV, rregullores nr. 184, datë 08.04.1999, "Për Punen e Zyres se Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme".

- Mungon projekti i zbatimit për ndërtimin e objektit, që duhet të miratohej nga Titullari i bashkisë

Sa trajtuar, rezulton se regjistrimi i pasurisë apartament me sipërfaqe 36 m^2, ***është kryer me parregullsi dhe në mungesë të dokumentacionit urbanistik tekniko ligjor, si dhe në mungesë të marrëdhënieve më truallin***, ***sa vepruar*** në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, me pikën 2 nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe Regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar;

Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** V. H., me detyrë ish Regjistrues dhe R. Sh., me detyrë specilist hartograf.

- Referencë nr. 2934 dhe 2935; 2850; 1485

Me aplikim nr. 404 dhe nr. 405, datë 22.02.2017, [redacted] ka kërkuar regjistrimin e kontratës së shitblerjes së truallit nr, 308 Rep, 126/2, kol. , datë 21.02.2017, nga [redacted] dhe lëshimin e certifikatës së pronësie.

Me aplikim nr. 633, datë 18.04.2016, [redacted] ka kërkuar regjistrimin e kontratës së shitjes së truallit nga Ministria e Financës dhe lëshimin e certifikatës së pronësie.

Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 9, faqe 238, me referencë nr. 2850, datë 22.04.2016, është regjistruar pasuria nr. 2/429, truall me sipërfaqe 56.7 m^2, lëshuar certifikatë pronësie me datë 25.04.2016 dhe është tjetërsuar me referencë 2935, datë 28.02.,2017, tek [redacted], sipas kontratës së shitjes.

Kjo pasuri truall është përfituar me kotratë shitje nr. 2177 Rep. , 407 Kol. , datë 29.03.2016, me palë shitëse Drejoria e Drejtimit të Pronës Publike, si truall për objektin "dyqan artikujsh kozmetik", i cili është ndërtuar mbi bazën e dokumentacionit urbanistik, regjistruar në regjistrat hipotekor nr. 1368, datë 07.02.2002, më pas kaluar me referencë nr. 1485, datë 21.11.2013, ka kaluar në sistem regjistrimi në KPP, volum 8, faqe 224, pasuria nr, 2/414, ndërtesë 2 kat, me sipërfaqe të bazës 56.7 m^2, lëshuar certifikatë pronësie me datë 21.11.2013, e cila me referencë nr. 02934, datë 28.02.2017, është tjetërsuar tek [redacted], sipas kontratës së shitjes.

Nga auditimi i dokumentacionit të ndodhur në dosje rezulton se, regjistrimi i kësaj pasurie është bërë me të meta e parregullsi

- Leja e ndërtimit është miratuar për ndërtimin e objektit në truall shtet dhe regjistrimi i objektit është bërë në mungesë të marërdhënieve me truallin, ndërsa nuk është llogaritur qiraja e përdorimit të truallit për periudhën 01.01.2013 deri më datë 29.03.2016(data e lidhjes së kontratës), e cila llogaritet në vlerën ***në vlerën 110,565 lekë***{39 muaj*[56.7 m^2(sipërfaqja që zë objekti)*50 lek/ m^2/muaj(vlera e qirasë për njësi)]}, konsiderohet e ardhur e munguar ***detyrim financiar i paarkëtuar,*** veprim në kundërshtim ne pikën 7, kreu IV, rregullores nr. 184, datë 08.04.1999, "Për Punen e Zyres se Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme".
- Mungon dokumentacioni urbanistik ligjor, konkretisht: Leja e sheshit të ndërtimit që miraton kondicionet urbane(Formulari nr. 2, si dhe planimetria e sheshit të ndërtimit, miratuar nga Kryetari i Bashkisë Bulqizë në cilësinë e Kryetarit të KRRT-së.

-Kotrata e shitjes nr. 2177 Rep. , 407 Kol. , datë 29.03.2016, me palë shitëse Drejoria e Drejtimit të Pronës Publike, nuk ka identifikuar pasurinë truall të shitur, si dhe mungon plan vendosja e pronës së shitur bashkëlidhur kontratës.

- Trualli i tjetërsuar rezulton se prek 2 pasuri shtet: pasuria nr. 2/37 e llojit "truall", për sipërfaqen 17 m^2 dhe pasuria nr. 2/36, e llojit "rrugë", për sipërfaqen 39.7 m^2, duke tjetërsuar pasurinë rrugë pa konfirmimin zyrtar nga institucionet përkatëse, lidhur me funksionin publik të kësaj pasurie,

veprim **kundërshtim me** përcaktimet ligjore në pikën 3 neni 3, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit".
Sa trajtuar, rezulton se regjistrimi i pasurisë, ***është kryer me parregullsi dhe në mungesë të dokumentacionit urbanistik tekniko ligjor, si dhe në mungesë të marrëdhënieve më truallin***, ***sa vepruar*** në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, me pikën 2 nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe Regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar;
Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** V. H., me detyrë ish Regjistrues dhe R. Sh., me detyrë specilist hartograf.

- Referencë nr. 894; 121; zk 3694
Me aplikim nr. 1736, datë 10.10.2017, [redacted] ka kërkuar korrigjim gabimesh në kartelë dhe lëshimin e certifikatës së pronësie.
Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 13, faqe 199, me referencë nr. 256, datë 04.12.2016, është regjistruar pasuria nr. 1810/1, arë+truall me sipërfaqe 9600 m^2, nga e cila truall me sipërfaqe 396 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 396 m^2, më pas me referencë nr. 894, është bërë korigjimi i sipërfaqes së truallit nga sipërfaqja 396 m^2 sipërfaqe në sipërfaqen 4800 m^2, lëshuar certifikatë pronësie me datë 13.12.2017.
Origjina e pasurisë truall, rrjedh nga kontrata e shitjes nr. 5410 rep. , 744/1 kol. , datë 24.11.2006, pala blerëse [redacted] ka blerë nga [redacted] arë me sipërfaqe 9600 m^2, ku pala shitëse e ka përfituar pasurinë me AMTP nr. 26537, regjistrim fillestar në volum 8, faqe 110 arë me sipërfaqe 15440 m^2, e cila më pas me referencë nr. 121, datë 23.11.2006, është bërë ndryshim kufiri dhe ndryshim në sipërfaqe, duke ndryshuar nga arë me sipërfaqe 15440 m^2, në arë+truall me sipërfaqe 15710 m^2, nga e cila truall me sipërfaqe 300 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 245 m^2. Ndërsa rritja e sipërfaqes totale me 270 m^2(15710-15440), duke ju referuar edhe dokumentacionit hartografik, ka ndodhur pas pas ndryshimit të kufijve, kjo pasuri është zgjeruar duke kaluar në pasurinë 1811, zëri kadastral "rrugë".
Më pas pasuria nr. 1810 arë+truall me sipërfaqe 15710 m^2, nga e cila truall me sipërfaqe 300 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 245 m^2, është ndarë në 2 pasuri: nr. 1810/1, volum 13, faqe 199, arë me sipërfaqe 9600 m^2(sipër trajtuar) dhe pasuria nr. 1810/2, volum 13, faqe 200, arë+truall me sipërfaqe 15710 m^2, truall me sipërfaqe 300 m^2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 245 m^2, e cila me referencë 542, datë 21.11.2013, është tjetërsuar tek subjekti [redacted].
Rezulton se ***përfitimi i sipërfaqes prej 270 m^2, është kryer në mungesë të dokumentacionit të fitimit të pronësisë,*** duke tjetërsuar pasuri të llojit rrugë, sa **vepruar në kundërshtim me** neni 24, të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" , pikën 3 neni 3, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit". dhe Regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar.
Për veprimet e mos veprimet e konstatuara ***ngarkohet me përgjegjësi*** S. B. ish regjistrues dhe specialistet që kanë kryer veprimet.
Orogjina e regjistrimit të objektit '"Lokal shërbimi 3 kat", me sipërfaqe ndërtimi 396 m^2, rrjedh nga dokumentacionit urbanistik, dërguar nga Bashkia Bulqizë me shkresën nr. 735, datë 24.06.2009, dërguar leje shrytëzimi dhe dokumentacioni shoqërues, sipas lejes së dhënë me vendimin e KRRT-së nr. 1, datë 22.10.2007, Bashkia Bulqizë, për ndërtimin e objektit 3 kat , ndërtimit), planimetria e sheshit përcakton sipërfaqe ndërtimi 396 m^2 dhe sipërfaqe sheshi 4800 m^2.
Nga auditimi i dokumentacionit të ndodhur në dosje rezulton se, regjistrimi i kësaj pasurie është bërë me të meta e parregullsi;

- Nuk përputhet sipërfaqja e ndërtimit përcaktuar në formularin nr. 2, ku përcaktohet 1152 m^2, me sipërfaqen e ndërtimit përcaktuar në planimetrinë e sheshit të miratuar, ku përcaktohet 396 m^2, ndërsa referuar planimetrisë së katit përdhe është përcaktuar sipërfaqja 360 m^2(30x12);
- Korigjimi i sipërfaqes së truallit nga 396 m^2 në 4800 m^2, duke ndryshuar zërin kadastral nga arë në truall, është kryer në shkelje të dispoziatve ligjore, përcaktohet se sipërfaqja takuese në funksion të ndërtesave llogaritet sa trefishi i sipërfaqes së gjurmës së ndërtimit

Sa trajtuar, rezulton se regjistrimi i pasurisë ***është kryer me parregullsi dhe në mospërpurputhje të dhënahs të përcaktuara në dokumentacionin urbanistik***, ***sa vepruar*** në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, me pikën 2 nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe Regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar;

Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuar më sipër **ngarkohet me përgjegjësi** D. H. me detyrë ish Regjistrues.

Lidhur sa trajtuar në faqet 91-95 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-Konstatimin nr. 11, datë 31.05.2019, janë paraqitur observacionet në rrugë elktronike dhe derguar me shkresen nr. 13.06.2019, të cilat kanë ardhur në KLSH bashkëlidhur me shkresën nr. 737/3, datë 04.07.2019 dërguar nga subjekti, marrës KLSH me nr. 207/3, datë 08.07.2019, të cilat janë përmbledhur nga Përgjegjësi i Zyrës dhe dërguar prej tij, ku sqarohet:

*Lidhur me konstatimet që i përkasin referencave nr. 3114 dhe 2573, ZK 8612, ku ju konstatoni se leja e ndertimit është bërë në mungesë të marrëdhenieve me truallin. Në lidhje me këtë konstatim gjykojme se sipas urdhërit te ZQ.nr.173 dt.12.3.2013,**udhëzohet që për keto raste kur në dokumentat e lejes se ndertimit mungojne marrdheniet me truallin regjistrohet leja e ndërtimit si akt Administrativ,duke bërë shenimin në seksionin përkates të KPP**,(seksioni"D") dhe 'Pershkrim i veçante" duke shprehur faktin se nuk ka marrëdhënie me truallin, Zyra jone keto shenime i ka bërë në momentin e regjistrimit të ndërtimit(Këtë Urdhër e kemi bashkëlidhur observacionit tonë. .... ..Kurse marrëdhëniet me truallin janë krijuar dhe ka kaluar në pronesi të pronarit të ndërtimit lidhur me këtë bëjmë me dije gjithashtu se edhe nga auditimi tekniko –ligjor i zhvilluar në periudhën 30 Janar-1 Shkurt 2013, nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të P.P.,nuk ka patur vërejtje në lidhje me regjistrimet e këtij lloji (pra të ndertimit),(ky raport ju është vënë në dispozicion edhe grupit tuaj të auditimit). Pronari në fjalë më pas ka ushtruar të drejtën e blerjes se truallit tek Ministria e Financave dhe këtë të drejte nuk mund ta ushtronte pa pasur të regjistruar ndërtimin.... .*

Kurse përsa i përket faktit që konstatoni se gjatë regjistrimit të sipërfaqes së dhënë me Min e Fin kjo siperfaqe ka prekur pasurine rrugë, pa konfirmim Zyrtar për këtë fakt, kemi gjykuar se konfirmimi zyrtar është leja e sheshit dhe dhe planimetria sheshit të ndërtimit, dokumenta të firmosura dhe vulosura nga kryetari i Bashkisë. Sa me sipër ,mendojme se për konstatimet e përshkruara në referencat e mësipërme, nuk është ezauruar ndonjë shkelje nga ana jonë. Gjithashtu,konstatimi juaj ne këtë referencë se leja e sheshit (form nr.2)rezulton i pa nënshkruar nga k/bashkise pas verifikimit në lidhje me faktin e konstatuar,konkludojmë ky dokument ka vulen e Bashkise, dhe konstatimi i mungesës së firmës ka qenë një gabim njerëzor që është kaluar pa u parë nga ana jonë në momentin regjistrimit dhe pranimit të dokumentave,(por gjithsesi është i vulosur,po ashtu të gjitha dok.e tjera janë të firmosura dhe vulosura), gabim i cili do të riparohet duke dërguar shkresë për rikonfirmim Bashkisë Bulqizë. Bashkëlidhur dërgojmë kopjen e dy kartelave për dy pasurite e audituara për ndërtimin vol.5 fq.153 dhe v.5.fq.154 ku është bërë regjistrimi i truallit blerë nga Min e Fin. si dhe Urdhërin e sipërpërmendur të ZQ..

Lidhur me konstatimin që nuk është llogaritur qeraja e përdorimit të truallit për periudhën 01.03.2013 deri në 10.10.2018 (datë e lidhjes së kontrates me MF, ju sjellim faktin se pagesa e

qerasë për përdorimin e truallit bëhet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore dhe është dokument që dorezohet pranë MF e cila nuk bën kontraten e shitjes se truallit, pa u bërë me parë kjo pagesë.
Lidhur me konstatimet që i përkasin referencaës nr. 2938 dhe 2803, ZK 8612, ku ju konstatoni se është bërë regjistrimi i lejes së ndërtimit pa marrdhenie me truallin, observacioni është si në rastin me sipër ,kurse përsa citoni se projekti i zbatimit për ndërtimin nuk është miratuar nga bashkia, gjykojmë se regjistrimi i kesaj shtese pallati është trajtuar si regjistrimi i një leje ndërtimi të trajtuar në observacionin tonë me sipër,dhe është bërë pronar i truallit për pjesën takuese sipas kontratës me Min. e Financave. Në këtë referencë nuk ka një projekt për 5 katet por secili pronar më vete është pajisur me leje ndërtimi për pjesën e tij dhe i kanë paraqitur në kohe të ndryshme dokumentat për regjistri2m dhe per ndertesen. Por gjithsesi,qëndron konstatimi juaj sepse me paraqitjen e lejes se parë të ndërtimit pavaresisht se jane paraqitur ne periudha të ndryshme, duhej të kërkohej projekti i të gjithe shtesës për 5 katet. Lidhur me këtë konstatim Zyra jonë do të procedojë duke i kërkuar bashkisë dokumentat e shtesës, sipas konstatimit tuaj duke vendosur edhe kufizimin përkates në këtë kartelë.
Lidhur me konstatimet që i përkasin referencaës nr. 894, ZK 8612, ku ju konstatoni se Leja e ndertimit nga bashkia është miratuar në truall shtet, gjykojmë se në fillim poseduesi i lejes së ndertimit e ka regjistruar ndertimin në përputhje me disponimet dhe sqarimet që dhamë në referencat 3114 dhe 2573 në fillim të këtij Akt-konstatimi. Në fillim sipas dokumentave ne ref.122 (akt shitblerje) ka fituar pasurinë nr.1810/1 me siperfaqe 9600 m^2, më pas nëpërmjet dokumentave në ref.256, ka bërë regjistrimin e objektit me leje ndertimi dhe të truallit sipas lejes së sheshit në tokë të tij (pas.1810/1).Ndërsa për referencën në fjalë,sqarojme se pronari nepermjet aplikimit 1736 ka kerkuar qe siperfaqja e sheshit te ndertimit te korigjohet sepse sipas tij lejen e sheshit të dhënë në formularin nr.2 ai ka 4800 m2. Në mbështetje të kërkesës se tij duke verifikuar përsëri formularin nr.2,si dhe duke patur parasysh se në momentin e Aplikimit ai dispononte dhe certifikaten e pronësisë për pjesën e sheshit të ndërtimit që pretendonte por në këtë certifikatë zeri kad. ishte "Are", Zyra jone procedoi duke kërkuar konfirmimin e ketij institucioni (bashkisë), me anë të shkresës nr. 5951 Prot.,dt.6.12.20017, për të ndryshuar zërin kadastal për pjesen e sheshit nga "Arë " në "Truall, në përputhje me ligjin nr.8402 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe ligjin nr. 8405 dt.17.9.1998 "Për urbanistikën". Pas konfirmimit të marrë nga bashkia nr.4694/1 dt.6.12.2017 dhe në mbështetje të aplikimit të tij të sipërcituar,me urdhërin e regjistruesit nr.105 dt.7.12.2017,proceduam me ndryshimin e Zërit kad.,për këtë sipërfaqe.(Bashkëlidhur formulari nr. 2,shkresa e ZVRPP-Bulqize nr.5951 Prot., dt. 6.12.2017,shkresa e Bashkise Bulqizë nr.4694/1 dt.6.12.2017,Urdheri i regjistruesit nr.105 Dt.7.12.2017).

Sqarimi i Grupit të auditimit:
Lidhur me observacionet e paraqitur, të sipërcituar, nuk merren në konsideratë pasi, nuk janë paraqitur argumente dhe prova të reja, konkretisht:
Lidhur me argumentet që i përkasin referencës nr. 3114 dhe 2573, ZK 8612, sqarojmë se konstatimet tona lidhen kryesisht me mungesën e elementeve kryesorë në aktin administrativ(leja e sheshit dhe projekti i zbatimit) , për të cilët ju nuk keni keni paraqitur dokumente të reja argumentuese
Lidhur me argumentet që i përkasin referencës nr. 2938 dhe 2803, ZK 8612, në observacionin tuaj pranoni konstatimin tonë, ku sqaroni se do të procedoni duke marrë masat përkatëse.
Lidhur me argumentet që i përkasin referencës nr. 894, ZK 8612, sqarojmë se konstatimet tona lidhen kryesisht me mosërputhje dhe pasaktësi të dhënash që pasqyrojnë dokumentet e paraqitura për regjistrimin e pasurisë dhe mos argumentimi i miratimit të një sheshi me sipërfaqe totale 4800 m^2, mbi të cilin është ndërtuar objekti me sipërfaqe të gjurmës prej 396 m^2, ndërsa duke ju referuar kondicioneve urbane përcaktuar në vendimin e KRRT-së Bashkia Bulqizë(Formulari nr. 2), këtë sipërfaqe për shesh ndërtimi e ka miratuar , si truall në funksion të

objektit me sipërfaqe ndërtimi 1152 m^2, e cila gjithsesi nuk përputhet me sipërfaqe ndërtimi prej 396 m^2, përcaktuar në planimetrinë e sheshit të miratuar.
Lidhur me argumentet e paraqitura nga ana juaj, sqarojmë ne i kemi diskutuar gjatë auditimit në subjekt, në mungesë të fakteve dhe dokumentve të reja, konsatimet tona mbeten të pandryshuara.

Gjetje: ZVRPP Bulqizë në 3 **raste** sipas referencave nr. 3114, 2573, 2938 dhe nr. 2935, 2934, ZK 8612, ka regjistruar pasuritë e paluajtshmë bazuar në dokumentacionin urbanistik, rezulton se regjistrimi ***është kryer me parregullsi dhe në mungesë të dokumentacionit urbanistik tekniko ligjor, si dhe në mungesë të marrëdhënieve me truallin***, ***sa vepruar*** në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, me pikën 2 nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe Regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar;
Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi në 3 raste,** për pasuritë e regjistruara sipas referencave të sipërcituara, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor
Gjetje : ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka regjistruar sipas referencës nr. 0894, pasurinë **nr.** 1810/1, volum 13 faqe 199, arë+truall me sipërfaqe 9600 m^2, nga e cila truall me sipërfaqe 4800 m^2 dhe ndëtesë 3 kat me sipërfaqe të bazës 396 m^2, ZK 3694, bazuar në dokumentacionin urbanistik,
rezulton se regjistrimi i pasurisë ***është kryer me parregullsi dhe në mospërpurputhje të dhënash të përcaktuara në dokumentacionin urbanistik***, ***sa vepruar*** në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, me pikën 2 nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe Regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar;
Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Bulqize të marrë masa, në bazë të pikës "1" neni 5 dhe pikës 1 neni 59, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispoziatat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr.** 1810/1, volum 13, faqe 199, ZK 3694, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Gjetje: ZVRPP Bulqizë në 2 **raste** sipas referencave nr. 3114 dhe nr. 2935, 2934, ZK 8612, ka regjistruar pasuritë e paluajtshmë bazuar në dokumentacionin urbanistik, rezulton se regjistrimi ***është kryer në mungesë të dokumentacionit urbanistik tekniko ligjor,*** ndërsa nuk është llogaritur qiraja e përdorimit të truallit, ***në vlerën totale 341,560 lekë,*** llogaritur:
- Për regjistrimin e pasurisë nr. 2/226/2, truall me sipërfaqe 66 m^2, volum 9, faqe 154, duke mos llogaritur qiranë e përdormit të trualli, për periudhën 01.01.2013 deri më datë 10.10.2018(data e lidhjes së kontratës), e cila llogaritet në vlerën ***në vlerën 231,000 lekë***{70 muaj*[66 m^2(sipërfaqja që zë objekti)*50 lek/ m^2/muaj(vlera e qirasë për njësi)]}, konsiderohet ***detyrim financiar i paarkëtuar, përfituar padrejtësisht nga*** [redacted]
- Për regjistrimin e pasurisë nr. 2/429, truall me sipërfaqe 56.7 m^2, volum 9, faqe 238, duke mos llogaritur qiranë e përdormit të trualli, për periudhën 01.01.2013 deri më datë 29.03.2016(data e lidhjes së kontratës), e cila llogaritet në vlerën ***në vlerën 110,565 lekë***{39 muaj*[56.7 m^2(sipërfaqja që zë objekti)*50 lek/ m^2/muaj(vlera e qirasë për njësi)]}, konsiderohet ***detyrim financiar i paarkëtuar, përfituar padrejtësisht nga*** [redacted]
Vepruar në kundërshtim ne pikën 7, kreu IV, rregullores nr. 184, datë 08.04.1999, "Për Punen e Zyres se Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme".

Rekomandim: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi në 2 raste,** për pasuritë e regjistruara sipas referencave të sipërcituara, si dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimit financiar të përfituar padrejtësisht, si më poshtë:
1. [redacted], për mos lekujdimin e qirasë së truallit me sipërfaqe **66 m²**, llogaritur **në vlerën *231,000 lekë;***
2. [redacted] për mos lekujdimin e qirasë së truallit me sipërfaqe **56.7 m²**, llogaritur **në vlerën *110.560 lekë;***

Zona kadastrale 3444-Shupenzë

Nga auditimi i dokumentacionit me zgjedhje ***zona kadastrale 3444-Shupenzë*** mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e objekteve me leje ndërtimi mbi troje publike dhe private, në zbatim të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar dhe ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, për periudhën janar 2017 deri me 31.12.2018 në zbatim të programit të auditimit "***nr. 207/1, datë 01.04.2019***", mbas shqyrtimit të dokumentacionit të përzgjedhur sipas KPP provizore sipas volumit nr. 1, faqet 1, 2, 3, 5, 8, 9 dhe 34, 36, 37, 38 dhe 40 në lidhje me veprimet e kryera për regjistrimin e pasurive përfituar në zbatim të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar dhe ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar ***dhe ligjit 33/2012 "Per regjistrimin r Pasurisë Palujtshme u konstatua:***
Nga ana e ZVRPP Bulqizë nuk rezulton të jenë zbatuar përcaktimet ligjore evidentuar në ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, Udhëzimin nr. 3, datë 03.10.2012 "Kriteret dhe proçedurat për regjistrimin e lejeve të ndërtimit" dhe Udhezimin nr. 1, datë 13.04.2016 dhe ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar ***per pasuri të përfikuara me leje ndertimi sipas percatimeve ligjore në zbatim të ligjit nr. 33/2012 "Per regjistrimin Pasurisë Palujtshme"*** referuar neneve 23, 34, 48, 49, 59, 60, të këtij ligji.
Duke i analizuar me hollësisht refencat e përzgjedhuara sipas ***pasqyrës nr. 4, ZK 3444 Shupenzë*** Bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi u konstatua:
1. Sipas refencës nr. 0073, datë 05.03.2017 rezulton të jetë regjistruar pasuria ***235/1, v1, faqe 1, zona kadastrale 34444,*** Fshati Shupenzë në KPP provizore ndërtesë me ***sipërfaqe 200 m2*** bazuar në regjistrin hipotekor nr. 2, datë 02.04.1999 në emër të [redacted]
Inventari datë 05.03.2014 në 05.03.2014 nëshkruar nga specialisti B.H .
Sipas aplikimit nr. 1092, dat 03.03.2014 është bërë ndrim emri bazuar në vertetimitn nr. 1, datë 03.03.2014 ku evidentohet që ndrimi i emrit është bërë sipas ***vendimit nr. 12, datë 05.10.2017*** por ky vendim nuk rezulton bashkëlidhur në dosje, ***në kundërshtim me regulloren nr. 184, datë 08.04.1999 "Transaksioni i ndryshimit të emrit" pika 2.***
Sipas referencës nr. 0091, Aplikim nr. 1138, datë 20.05.2017 bërë rivlerësim pasurie sipas formularit për vlerësim nëshkruar nga ***D. H.*** bazuar vetëm në një ***leje ndërtimi fotokopje*** lëshuar në emër të [redacted] ***sipas VKRT nr. 136, datë 13.06.1995 Komuna Shupenzë dhe VKB dhe VKB nr. 27, datë 10.05.1995 në të cilen nuk evidentohet asnje e dhënë.*** Ndërsa sipas KPP Provizore evidentohet regjistrimi në emër të [redacted] ***dhe nuk është në emër të*** [redacted] sikurse evidentohet ***sipas hipotekës nr. 2, datë 02.04.1999.***
Edhe sipas ***referencës nr. 0090, aplikim 1139, datë 30.05.2017*** regjistruar ***p. 331/1/1, v.1, faqe 3 ZK 3444*** në KPP Provizore sipas rivlersimit të bërë, sipas formularit vlerësimit nëshkruar nga ***D. H..*** Ndërsa sipas KPP Provizore evidentohet regjistrimi në emër të [redacted] dhe nuk është në në emër të [redacted]. Regjistrimi i këtyre pasurive është bërë bazuar vetëm në lejen e ndërtimit dhe ***pa pasur të dhëna tjera si leje sheshi, aktkolaudim, aktet e kontrollit prevendiv situacion dhe pa u percaktuar mardhëniet e truallit në kundershtim me piken 12, te***

rregullores datë 08.04.1999 " Per pasuiritë e palujtshme të fituara sipas ligjeve të ubanistikes në varësi tësi të viteve, konkretisht për ndërtime të kryera në kryera në vitet 1995-1998 , për regjistrim kërkohet:

-Plan vendosja e miratuar nga KRT, Leja ndertimit origjinale miratuar nga KRT, Akti i kolaudimit, kontrata e shitjes truallit nga Këshilli i Rrethit dhe Projekti të cilat nuk gjenden në dosje.

Sipas refenca nr. 0104, aplikim nr. 582, datë 18.05.2018 është bëre regjistrimi i kontratës hipotekore nr. 3308/1228, datë 12.05.2018 Hua e marë nga [redacted] duke vendosur hipotekë ligjore pasuirinë ***235/1, v.1, faqe 1, zona kadastrale 34444, ndertesë Fshati Shupenzë ndersa trualli regjistruar shtet dhe në seksionin D të pasurisë truall për 200 m2*** vendosur shënimi që në në ketë truall ndodhet ***ndërtesa 235/1, v.1, faqe 1.*** Hipoteka ligjore vendosur sipas vërtetimeve hipotekore nr. 2 dhe 3 nëshkruar nga ***Sh. A. dhe per ndertesën me siperfaqe 60 m2 nuk rezulton të kete dokumentacion të plotë tekniko ligjor.*** Në HTR hedhur vendodhja nga ***R. Sh..***

Nuk rezulton të kete dokumentacion kalim pronësie ***nga*** [redacted] mbasi i gjithë dokumentacioni është në emër të [redacted]

Sikurse evidentohet ***nuk rezulton të jenë verifikuar elementët e formës e të përmbajtjes së dokumentacionit për pasurinë e regjistruar në mungesë të dokumentacionit pronësisë,*** veprim në papajtueshmëri me pikën 2-3, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit"

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligjin_8045,, dattë 19.07.1998, me ndryshime
Ligjin nr.33/2012, datë 29.04.2012, nenet 24-25
Rregulloren 184, datë 08.04.1999.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Sh. A. me detyrë Regjistrues

D. H. me detyrë Ish-regjistruese-Juriste.
R. Sh. me detyrë Hartograf.

2. Sipas refencës nr 0008, datë 09.09.2012 rezulton të jetë regjistruar pasuria ***139/5, v.1, faqe 8, zona kadastrale 34444, Fshati Shupenzë*** në KPP provizore ndërtesë me sipërfaqe ***65 m2*** në emer të [redacted] dhe me refemcën ***nr. 0094, datë 14.10.2017 sipas Aplikimit nr. 1724, datë 10.06.2017 regjistruar*** në emër të trashtrashëgimtareve [redacted] ***sipas deshmise nr. 1881/849/1, datë 06.10.2017.***

Inventari datë 05.03.2014 në 05.03.2014 nëshkruar nga K. J.

Sipas Alikimit nr. 3109, dhe 3110, (aplikuese [redacted] kerkuar regjistrimi i pasurisë ndërtesë për ***65 m2*** dhe në dosje gjendet ***procesverbali i kolaudimit datë 09.09.2002, për Farmaci,*** plan-lanvendosja e miratuar KRT-ja Bulqizë, HTR provizore, Leje shfrytëszimi, Leje ndertimi nr. 2, datë 07.06.1998, vendimi nr. 14, datë 19.05.1998, kërkesa per leje, dhe vëretimi Hipotekor vetëm për ndërtesën lëshuar me datë 08.10.2002 ***nga A. H.***

Sikurse evidentohet rezulton që kjo pasuri të jetë regjistruar në emër të [redacted]**.** me ***refencën nr. 0094, datë 14.10.2017*** dhe nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua të ***mos ketë mardheniet e truallit, në kundershtim me ligjin nr. 33/2012 "Per regjistrimin e pasurive të palujtshme perfituar nga Ligji i Urbanistikes nr. 8405, datë 17.9.1998, i ndryshuar***

Regjistrimi i këtyre pasurive është bëre bazuar në lejen e ndërtimit, aktkolaudim, leje sheshi etj. ***pa u percaktuar mardhëniet e truallit në kundershtim me piken 12, te rregullores datë 08.04.1999*** " Per pasuritë e palujtshme të fituara sipas ligjeve të ubanistikes në varësi të si të viteve, dhe për ndërtime të kryera në kryera në vitet 1995-1998 , për regjistrim kërkohet ndër të tjera edhe mardhëniet e pronësisë së truallit me kontratë qiraje apo me kontratë shitje, veprim i kryer në papajtueshmëri me pikën 2-3, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e

elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit"

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
Ligjin_8045,, dattë 19.07.1998, me ndryshime
Ligjin nr.33/2012, datë 29.04.2012, nenet 24-25.
Rregulloren 184, datë 08.04.1999.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
Asllan Halili me detyrë ish-Regjistrues
D. H. me detyrë Ish-regjistruese-Juriste.
R. Sh. me detyrë Hartograf.

<u>3. Me refencën nr. 0095, 08.11.2017,</u> aplikim nr. 1800, datë 26.10.2017(D. H.) regjistruar pasuria nr. 241-D ndertesë v.1, faqe 37 në emer të [redacted] ***etj.*** në KPP provizore pasuria ndërtesë sipas ***lejes së legalizimit nr. 90986, datë ...20017 në emër të*** [redacted] ***etj..Godinë Sociale ekonomike për sipërfaqe ndërtimi 227.3 m2, ndërsa parcela ndërtimore 350 m2.***

Me shkresën nr. 1587, datë 05.10.2017 dërguar për regjistrim dokumentacioni sipas lejes së legalizimit ***nr. 90986, datë ...20017 në emër të*** [redacted] ***etj..Godinë Sociale ekonomike për sipërfaqe ndërtimi 227.3 m2, ndërsa parcela ndërtimore 350 m2 dhe*** gjatë verifikimit të dokumentacionit nuk u konstatuan shkelje të dispoztave ligjore, ndërsa për truallin janë bërë shënimet në seksionin E të KPP provizore.

<u>4.Me refencën nr. 0099, datë 27.03.2018,</u> aplikim nr. 344, datë 29.03.2018(D. H.) regjistruar pasuria ***nr. 184/7-D ndërtesë v.1, faqe 38 në emër të*** [redacted] ***etj.*** në KPP provizore sipas lejes së Ndërtimit, dokumentacionit dërguar nga KQ Dibër me shkresë nr. 57/4, datë 14,02.2018 me ***siperfaqe sheshi 240 m2 dhe siperfaqe ndertimi 95 m2, godinë 1 kat.*** Dokumentacioni rezulton i plotësuar në zbatim të ligjit të Urbanistikë i ndryshuar dhe në zbatim të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar dhe ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit". Në kete praktikë regjistrimi nuk evidentohen mardhëniet e pronësë me truallin, ***në kundershtim me dispozitat ligjore të situara me sipër, duke u Regjistruar Pasuria në mungesë të dokumentacionit pronësisë, pa u percaktuar mardhëniet e truallit në kundërshtim me piken 12, të rregullores datë 08.04.1999*** " Për pasuritë e palujtshme të fituara sipas ligjeve të ubanistikes në varësi tësi të viteve", veprim në papajtueshmëri me pikën 2-3, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
Ligjin_8045,, dattë 19.07.1998, me ndryshime
Ligjin nr.33/2012, datë 29.04.2012, nenet 24-25
Rregulloren 184, datë 08.04.1999.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
Sh. A. me detyrë ish-Regjistrues
D. H. me detyrë Ish-regjistruese-Juriste.
R. Sh. me detyrë Hartograf.

(***Trajtuar më hollësisht në aktkonstatimin nr. 18, datë 31.05.2019 zona kadastrale 3444 dhe Projektraportin e auditimit dërguar me shkresën nr737/1, datë 04.07.2019 dhe protokolluar në KLSH me nr.207/3, datë 08.07.2019).***

<u>Komente dhe shpjegime nga subjekti i Audituar:</u> *Subjekti i Audituar* ***Sh. A.(me detyrë pergjegjës sektori) sipas shkresës nr. 661, datë 13.06.2019*** *ka bërë komente dhe shpjegime në lidhje me problematikat e trajtuara në akt konstatimin nr. 18, datë 31.05.2019 per pasuritë e regjistruara sipas* ***refencave 0073, 0091, 0090 dhe 0104 në emer të*** [redacted] *me*

pretendimin se nuk kuptoj se çdo me thënë leje provizore, dhe nga është marrë ky dokument, nuk thuhet se per cilën dosje bëhet fjalë duke arsyetuar se këto doje nuk kanë shkelje të dispozitave ligjore. Ndërsa për pasuritë e regjistruara pa mardhëniet me truallin subjekti shpjegon se regjistrimet janë bërë në kuadrin e sistemit hipotekor, sipas kërkesave sporadike dhe do të zbardhen në kohën e kontraktimit me kmpaninë private për hedhjen në sistem. Duke sqaruar për mardhëniet me truallin ju kemi përcjellë shkresën e zyrës qëndrore nr. 754/2, datë 21.02.2009(urdhri nr. 606, datë21.08.2009) "Për regjistrimin e objekteve me leje ndertimi të dhëna pas datës 10.08.1991 duke hapur KPP per truallin dhe duke vendosur kufizim deri në krijimin e mardhënieve me truallin.

Qëndrimi i grupit të auditimit *në lidhje me komentin dhe shpjegimet e Subjekti i Audituar* ***Sh. A.(me detyrë pergjegjës sektori) sipas shkresës nr. 661, datë 13.06.2019*** *për problematikat e trajtuara në akt konstatimin nr. 18, datë 31.05.2019 per pasuritë e regjistruara sipas* ***refencave 0073, 0091, 0090 dhe 0104 në emer të*** [redacted] ***Gentjan Osmanit sipas referencave 0008 dhe 0094,*** *me pretendimin se nuk kuptoj se çdo me thënë leje provizore, dhe nga është marrë ky dokument, nuk thuhet se per cilën dosje bëhet fjalë duke arsyetuar se këto doje nuk kanë shkelje të dispozitave ligjore dhe se pasuritë e regjistruara pa mardhëniet me truallin janë bërë në kuadrin e sistemit hipotekor, sipas kërkesave sporadike dhe do të zbardhen në kohën e kontraktimit me kompaninë private për hedhjen në sistem, bëjme me dije se leje provizore është leje e përkohshme me afat dhe dosjet per të cilat bëhet fjalë lidhen me refencat e përcaktuara* ***në pasqyrën nr 4,(0073, 0091, 0090 dhe 0104, dhe në emër*** [redacted] *bashkëlidhur këtij Raporti perfundimtar auditimi. Duke sqaruar për mardhëniet me truallin edhe sipas me shkresës derguar nga ZQRPP nr. 754/2, datë 21.02.2009(urdhri nr. 606, datë21.08.2009, saktësoj se Regullorja bazë 184, datë 08.04.1999, për pasuritë e përfituara me lejeve të ndertimit sipas viteve përcakton dhe mardhëniet me truallin. Për rrjedhojë përsa komentohet e shpjegohet nga subjekti ka argumentim dhe mbështetje ligjore, per rjedhojë nuk meren në konsideratë.*

Gjetje nga auditimi pika 4: (Aktkonstatimi 18, datë 31.05.2019).

Gjetje nga Auditimi 4: Nga Zyra Vendore ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë), nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes të pasurisë, regjistruar në emër të [redacted] sipas ***referencave 0073, 0091, 0090 dhe 0104, dhe në emër të*** [redacted] ***sipas referencave 0008 dhe 0094, dhe në emër të*** [redacted] ***sipas refencës nr. 0099, të perfituara nga Ligji i Urbanistikes nr. 8405, datë 17.09.1998 me ndryshimet e mëvonshme*** duke regjistruar Pasuritë në mungesë të dokumentacionit tekniko ligjor dhe pa u percaktuar mardhëniet e truallit në kundershtim me piken 12, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 " Për pasuritë e palujtshme të fituara sipas ligjeve të ubanistikes në varësi tësi të viteve, veprim në papajtueshmëri me pikën 2-3, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".

Rekomandim: Zyra Vendore ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë), Përgjegjësi i Zyrës të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2014 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara në emër të [redacted] sipas ***referencave 0073, 0091, 0090 dhe 0104, në emër të*** [redacted] ***sipas referencave 0008 dhe 0094, dhe në emër të*** [redacted] ***sipas refencës nr. 0099, të përfituara nga Ligji i Urbanistikes nr. 8405, datë 17.09.1998 me ndryshimet e mëvonshme*** deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor të urbanistikës dhe përcaktimin e marëdhënieve të pronësisë së truallit (me qira apo shitje), ***në zbatim të pikës 12, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999.***

- Referencë nr. 02382/2075, ZK 8611;

Me kërkesë nr. 1292, datë 29.06.2017, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi kontrat shitje, bashkim ndarje pasurie etj, me palë shitëse Ministria e Financave, drejtoria e drejtimit të pronës publike .

- Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 5, faqe 236, është regjistruar pasurinë nr. 1/196/1 truall me sipërfaqe 152 m2 dhe objekt 152 m2 në pronësi të [redacted] etj, pasuri e cila vjen nga volum 5 faqe 165, pasuria nr. 1/169 –ND, regjistruar sipas aplikim nr. 798 datë 21.10.2013, objekt 152 m2 pa truall sipas formularëve nr. 2 dhe nr. 4, ku në formularin nr. 2 sipërfaqja e sheshit është përcaktuar 320 m2, ndërsa sipas kontratë shitblerje që është realizuar mbi bazën e këtij dokumentacioni sipërfaqja e truallit të blerë është 152 m2.
ZVRPP Bulqizë ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***nuk përputhet sipërfaqja e sheshit të ndërtimit e përcaktuar në formularin nr. 2 e cila është 320 m2 dhe kontratës së shitblerjes e cila është 152 m2, duke regjistruar më pakë në kartela një sipërfaqe prej 168 m2.***
Veprime këto në papajtueshmëri me "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25,pikën 1 neni 48, neni 59 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 "Për Urbanistikën", i ndryshuar, nenin 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruesit "Për rregullimin e veprimtarisë për regjistrimin e ndërtimeve të reja në bazë të funksionimit të ri të KRRT-ve" dhe pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Për veprimet ngarkohen me përgjegjësi, z. V. H. me detyrë ish/regjistrues, dhe znj. D. H. me detyrë specialiste.

- Referencë nr. 02362/2056 ZK 8611;
Me kërkesë nr. 964, datë 12.05.2017, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi kontratë shitje, bashkim ndarje pasurie etj, me palë shitëse Ministria e Financave, drejtoria e drejtimit të pronës publike .
- Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 5, faqe 154, është regjistruar pasurinë nr. 1/13/1 truall me sipërfaqe 260 m2 në pronësi të [redacted] etj, ndërtesa e cila vjen nga volum 5 faqe 153, pasuria nr. 1/195 –ND me sipërfaqe 221.4 m2, regjistruar sipas aplikim nr. 667 datë 26.09.2013, sipas formularëve nr. 2 dhe nr. 4, ku në formularin nr. 2 sipërfaqja e sheshit është përcaktuar 260 m2, ndërsa sipërfaqja e ndërtimit 1060.77 m2.
ZVRPP Bulqizë ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***nuk përputhet sipërfaqja e ndërtimit e përcaktuar në formularin nr. 2 e cila është 1060.77 m2 me planimetrinë e sheshit të ndërtimit e cila është 221.4 m2. Në lartësinë e përgjithshme të përcaktuar numri maksimal i kateve është 2 ndërsa numri i kateve mbi tokë është 3 dhe nën tokë 1, pra ka mospërputhje të të dhënave dhe kondicioneve urbane, ndërsa në prerjen tërthore të objektit paraqitet 4 kate mbi tok dhe një nën tokë .***
Veprime këto në papajtueshmëri me "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25,pikën 1 neni 48, neni 59 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 "Për Urbanistikën", i ndryshuar, nenin 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruesit "Për rregullimin e veprimtarisë për regjistrimin e ndërtimeve të reja në bazë të funksionimit të ri të KRRT-ve" dhe pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Për veprimet ngarkohen me përgjegjësi, z. E. K. me detyrë ish-regjistrues, z. V. H. me detyrë regjistrues dhe znj. D. H. me detyrë specjaliste.

- Referencë nr. 02462 ZK 8611;
Me kërkesë nr. 801, datë 11.07.2018, nga [redacted] është kërkuar regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja .

- Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 6, faqe 7, është regjistruar pasurinë nr. 2/20/7 objekt 152 m2 në pronësi të [redacted] etj.
ZVRPP Bulqizëë ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***nuk përputhen konturet e gjurmës së ndërtimit të përcaktuar në planimetrinë e sheshit të ndërtimit të miratuar me planin e rilevimit të përgatitur nga inxhinieri i licencuar dhe e miratuar nga autoriteti përgjegjës. Në dosje mungon planimetria e sheshit të ndërtimit me kondicionet urbane si dhe projekti i miratuar.***
Veprime këto në papajtueshmëri me "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25,pikën 1 neni 48, neni 59 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 "Për Urbanistikën", i ndryshuar, nenin 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruesit "Për rregullimin e veprimtarisë për regjistrimin e ndërtimeve të reja në bazë të funksionimit të ri të KRRT-ve" dhe pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Për veprimet ngarkohen me përgjegjësi, z. Sh. A. me detyrë ish/regjistrues, dhe znj. D. H. me detyrë specjaliste.

- Referencë nr. 02093 ZK 8611;
Me kërkesë nr. 105, datë 18.01.2018, nga [redacted] është kërkuar lëshim kopje kartele, hipotek ligjore leshim dublikat etj .
- Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 5, faqe 166, është regjistruar pasurinë nr. 2/143/ND objekt 202.78 m2 në pronësi të [redacted] etj, regjistruar sipas aplikim nr. 703 datë 21.01.2014, objekt 202.78 m2 pa truall sipas formularëve nr. 2 dhe nr. 4, ku në formularin nr. 2 sipërfaqja e sheshit është përcaktuar 320 m2, ndërsa sipas kontratë shitblerje që është realizuar mbi bazën e këtij dokumentacioni sipërfaqja e truallit të blerë është 152 m2.
ZVRPP Bulqizë ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***nuk përputhet sipërfaqja e sheshit të ndërtimit e përcaktuar në formularin nr. 2 e cila është 320 m2 dhe kontratës së shitblerjes e cila është 152 m2, duke regjistruar më pakë në kartela një sipërfaqe prej 168 m2.***
Veprime këto në papajtueshmëri me "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25,pikën 1 neni 48, neni 59 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 "Për Urbanistikën", i ndryshuar, nenin 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruesit "Për rregullimin e veprimtarisë për regjistrimin e ndërtimeve të reja në bazë të funksionimit të ri të KRRT-ve" dhe pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit".
Për veprimet ngarkohen me përgjegjësi, z. V. H. me detyrë ish/regjistrues, dhe znj. D. H. me detyrë specialiste.

- Referencë nr. 0090/0072/45/46/47 ZK 1754
Me kërkesë nr. 1290, datë 09.11.2018, [redacted] ka kërkuar korrigjim gabimesh në kartelë, kopje fragment harte, kopje kartele dhe certifikatë pronësie. Me kërkesë nr. 259, datë 01.02.2017, [redacted] ka kërkuar regjistrim kalim pronësie me an të ligjit vendim gjykate apo akti administrativ, leje ndërtimi miratuar me vendimin nr. 3 datë 03.12.2010, kontratës koncesionare nr. 810 rep, nr. 141 kol datë 17.04.2008 ndryshuar me aktin nr. 676 rep. Nr. 225 kol datë 06.07.2017 pajisur me certifikatë pronësie datë 12.03.2018.
- Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 3, faqe 206, është regjistruar pasurinë nr. 643 objekt central elektrik me sipërfaqe totale 21702 m2 ndërtesë 300 m^2.

ZVRPP Bulqizë ka regjistruar pasurinë e paluajtshme në kushtet kur: ***Në dosje mungon "Leja e sheshit të ndërtimit", kondicionet urbane, "Leja e përdorimit" akti i lejimit të përdorimit dhe/ose zënies së tokës apo strukturës së zhvilluar, për të cilin është kryer punimi, "aktet e kontrollit" të cilat vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes, "Oponenca teknike" për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, "Projektin dhe kushtet urbanistike" të miratuara. Mungojne mardhenjet me truallin(shtet dhe/ose privat) ku vendoset dhe bie objekti sipas planimetrisë së sheshit të ndërtimit të miratuar. Nuk është përllogaritur saktë dhe është paguar më pak nga ana e subjektit, pagesa 1 për qind të vlerës së investimit që do të kryejë sipas preventivit të objektit.*** *Ky fond depozitohet për llogari të financimit të studimeve urbanistike në pushtetin vendor. Pagesa bëhet menjëherë në seksionin e financës së këshillit të qarkut apo qytetit të kategorisë së parë me autorizim të sekretarisë teknike të KRRT-së. Dokumenti i lejes së ndërtimit jepet pasi është bërë depozitimi i dokumentit të pagesës në dosjen e objektit.*
Në dosje mungon përllogaritja e këtij detyrimi, në dosje administrohet nxjerrje llogarie të këtij subjekti, ku për llogari të ish/Komunës Martanesh më datë 30.11.2010 ka derdhur taks ndikimi në infrastukturë nga ndërtimet e reja në vlerën 1.197.390 lekë, ndërsa përllogaritja sipas nenit 51 ligji nr. 8405 dhe neni 27 i ligjit nr. 9632,*:*
- Vlera e objekti sipas preventivit 731.513.571 x 0.1 %= 731.514 lekë taks ndikimi në infrastukturë.
- Vlera e objekti sipas preventivit 731.513.571 x 1 %= 7.315.135 (SUP) lekë- 1.197.390 lekë të paguara= 6.117.745 lekë Tarifë për sutudimet urebanistike dhe/ose për planet e detajuara vendore (1% e vlerës së investimit) *të pa argumentuara nëse janë paguar apo jo. Nuk është bërë hedhja e objektit në hartën e punës (planshetë).* etj. Veprime këto në papajtueshmëri me pikën 1 neni 48, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" i ndryshuar, nenin 6 dhe 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, Neni 51 Ligji nr. 8405, datë 17.9.1998 "Për Urbanistikën", i ndryshuar me nenin 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, " Për sistemin e taksave vendore ", i ndryshuar, neni 27.
Për veprimet ngarkohen me përgjegjësi, z. Sh. A. me detyrë ish/regjistrues, dhe znj. D. H. me detyrë specjaliste.

- Referencë nr. 0020 ZK 2826
Me kërkesë nr. 590, datë 20.03.2017, [redacted] ka kërkuar regjistrim kontrat shitblerja, fragment harte kopje kartele certifikatë pronësie. Kontratës koncesionare nr. 10332 rep, nr. 3320 kol datë 09.09.2013 ndryshuar me aktin nr. 184 rep. Nr. 65 kol datë 10.03.2017 regjistruar datë 20.06.2017.
- Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 1, faqe 14, është regjistruar pasurinë nr. 14 seksioni (D) sipërfaqe totale 1275 m2 ndërtesë 215 m^2, truall 235 m2 dhe 1400 m2 tubacion presjoni, seksioni (C) pronësi Shtet me sipërfaqe 50291 m2 kullotë. Volum 2 faqe 60 pasuria nr. 301 , e llojit pyll+kullotë (Central Elektrik) sipërfaqe 15151 m^2 seksioni (D) regjistruar datë 08.08.2017 [redacted] kontratë koncesioni, seksioni (C) Pronësi shteti.
Me urdhrin e regjistruesit nr. 196, datë 29.03.2017 është vendosur ndalimi i veprimeve me argumentin se dokumentat nuk janë origjinale dhe mungon i gjithë dokumentacioni teknik.
ZVRPP Bulqizë ka regjistruar pasurinë e paluajtshme në kushtet kur: ***Nuk ka urdhër për heqjen e kufizimit dhe ndalimit të veprimeve. Në dosje mungon: Mardhenjet me truallin(shtet dhe/ose privat) ku vendoset dhe bie objekti sipas planimetrisë së sheshit të ndërtimit të miratuar.***

Mungon "Leja e sheshit të ndërtimit", kondicionet urbane, "Leja e përdorimit" akti i lejimit të përdorimit dhe/ose zënies së tokës apo strukturës së zhvilluar, për të cilin është kryer punimi, "aktet e kontrollit" të cilat vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes, "Oponenca teknike" për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve. Nuk është bërë hedhja e objektit në hartën e punës (planshetë). **etj.** Veprime këto në papajtueshmëri me pikën 1 neni 48, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" i ndryshuar, nenin 6 dhe 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, Neni 51 Ligji nr. 8405, datë 17.9.1998 "Për Urbanistikën", i ndryshuar me nenin 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit". Për veprimet ngarkohen me përgjegjësi, z. V. H. me detyrë ish/regjistrues, dhe znj. D. H. me detyrë specialiste.

Lidhur sa sipër trajtuar është mbajtur Akt-Konstatimi nr. 4, datë 31.05.2019, për të cilin nuk janë paraqitur observacione në fazën e hartimit të projekt raportit të auditimit, nga personat e cilësuar si përgjegjës.

Observacioni i paraqitur nga ZVASHK Bulqizë nr. 661 prot datë 13.06.2019, përgjegjësi sektorit Sh. A. në lidhje me aktkonstatimin dhe projektraportin e auditimit

*Ref.2075 Zk.8611,Konstatohet nga ana juaj se : ne kartelenvol.5 fq.236,eshte regjistruar nje siperfaqe trualli 152 m2 pronarit [redacted] (siperfaqe e fituar me Ministrine e financave),por qe kjo siperfaqe ne cilesimin tuaj eshte me e vogel se ajo qëështë përcaktuar në formularin nr.2 të sheshit të ndertimit.Lidhur me kete konstatim gjykojme se bazuar ne ligjin 33/2012 neni 3 per "fushen e zbatimit"te ketij ligji citohet se:"dispozitat e këtij ligji zbatohen për regjistrimin e të gjitha pasurive të paluajtshme brenda teritorit të RSH,**bazuar në akte të fitimit të pronësisë,sipas kërkesave të paraqitura".** Në kuptim të këtij neni Zyra e regjistrimit në këtë rast ka regjistruar një akt fitimi pronësie konkretisht Akt shitblerje me Min e Fin,.akt ne të cilin përcaktohet qartë se sipërfaqja e truallit që ka shitur ky institucionështë 152 m2 dhe nuk ka shitur 320 m2. Në këtë rast ZRPP,nuk ka regjistruar të dhënat nga formulari i sheshit të ndërtimit ,dokument që ka shërbyer vetëm si e dhënë jo e regjistrueshmekur është regjistruar ndërtimi në një dosje tjetër të mëparshme,por ka regjistruar aktin në fjalë sipas aplikimit nr.1292 dt.29.6.2017 që është kontrata e shitjes me Min e Fin..Duhet të përmendim edhe një fakt tjetër se sipërfaqja e sheshit të ndërtimit në lejen e sheshit është ajo e kohës kur është bërë projekti,pra siperfaqe e përkohshme në funksion të ndërtimit të objektit ku parashikohet sipërfaqe edhe për lëvizjen e mjeteve,hapsirë për punime,skela etj.dhe pas mbarimit të ndërtimit mund të ndryshojë duke e çuar një pjesë të kësaj sipërfaqeje në gjendjen e mëparshme.Min e Fin.,nuk ka shitur sheshin e ndërtimit të dhënë dikur për realizimin e ndërtimit, por ka shiturtruallin nën ndërtim aktualisht me ndonjë sipërfaqe funksionale aktuale,ose dhe pa siperfaqe funksionale,tëverifikuar ndoshta me matje me specialistin e saj në terren në momentin që ka realizuar Aktin e shitjes. Sa arsyetuam më lart ZRPP ,nuk paragjykon sasinë e sipërfaqes që ka shitur ky institucion,nëushtrim të kopetencave tëveta.*

Ref.2362/2056 Zk 8611,pronar [redacted],problemi është njejtë me sa më sipër sa i përket sipërfaqes se shitur nga ministria e financave.Kurse përsa i përket cilësimit se ka mosperputhje të siperf. së ndërtimit tëpërcaktuar në formularin 2 (1060,77 m2), me atë në planimetrine e sheshit e cila është 221,4 m2,sqarojmë se 221,4 m2 është siperfaqja në plan e katit përdhe,(që pasqyrohet në HTR) kurse 1066,77 m2 që jepet në formularin 2 (regjistruar në kartelë tek rubrika përshkrim i veçantë), është shuma totale e siperfaqes se të gjitha kateve që sipas dokumentacionit në këtë dosje është 3 kate mbi tokë +bodrum.

Ref 2462 ZK.8611,pronar [redacted] sipas përcaktimit të bërë nga ana juaj "nuk përputhen konturet e gjurmës së ndërtimit të përcaktuar në planimetrinë e sheshit me planin e rilevimit".
Për rastin në fjalë bëjmë me dije se Zyra jonë e konstatoi këtë problem në kohën e përpunimit të dokumentacionit dhe vendosi korespondencë me bashkinë e cila nga ana e saj për problemet që ka patur planimetria e sheshit,dërgoi me shkrese percjellse nr.3060 Prot,dt19.9.2018,dokumentin "plan rilevimi" (bashkëlidhur),në të cilin përcaktohet qartë ndertimi ku konstatohet se ka përputhje të plotë me planimetritë e kateve si dhe sheshi i ndërtimit. Dokumenti që ju thoni pra planimetria e sheshit e dorzuar në kohen e aplikimit nuk u mor në konsiderate me sjelljen e dokumentit "plan rilevimi" të vulosur dhe firmosur nga bashkia i cili kishte të saktatë dhënat e nevojshme që na duheshin për regjistrim dhe kishte përputhje edhe me planimetritë dhe dokumentat e tjera në këtë dosje. Bashkëlidhur keni shkresën e mësiperme dhe planin e rilevimit.
Ref.02093 Zk.8611 pronar [redacted],konstatimi nga ana juaj është si referenca e pare (2075) e ketij Akt konstatimi ,(pra qe min e fin ka shitur sip. më të vogel se ajo e percaktuar lejen e sheshit) dhe observacioni ynëështë i tënjejtës natyrë.
Ref.0090/72/45/46/47,në lidhje me konstatimet për kontraten e konçesionit [redacted] [redacted]për sa u përket problemeve që shtroni në lidhje me mungesen e dokumentacionit që citoni bëjmë me dije se për këto lloj kontratash nuk ka ndonjë kuadër ligjor qoftë në ligjin 33/2012, ku nuk ka ndonje nen për regjistrimin e tyre,po ashtu nuk ekziston as një akt nënligjor për mënyren e regjistrimit dhe as dokumentat e domosdoshme që duhet të pranohen për regjistrim,megjithë insistimet tona të vazhdueshme pranë Zyrës Qëndrore për një udhëzim të saktë se si do veprohet konkretisht.I vetmi dokument që disponojmë në lidhje me koncesionet është shkresa nr.4123/1 dt.30.04.2014 (bashkelidhur),"Për unifikimin e praktikave për regjistrimin e kontratave të koncesioneve",ku në mënyrë të përcipte sqarohet vetëm se:këto kontrata regjistrohennë seksionin "D" të kartelës si dhe përcaktimi se: "në ZVRPP duhet që të paraqitet përveç kontrates dhe projekti i zbatimit i miratuar nga Autoriteti Kontraktues,i cili është kusht i demosdoshem per vijimin e procedurave te regjistrimit".(kjo shkresëështë bashkëlidhur)Në vijim të kësaj shkrese sqarohet se në zonat jo në sistem regjistrimi i kontratës merr nje numër ,kurse për Zonat në sitem merr disa numra sipas identifikimit që do të bëhet. Pra sa më sipër në këtë udhëzim nuk përmenden fare dokumentat që ju citoni .Pra sipas këtij udhëzimi për koncesionet duhen si dokumenta pranimikontrata,projekti teknik dhe miratimi i tij..Dhe ne këto dokumenta kemi kërkuar..Në kartelën që ju bëni fjalëështë regjistruar kjo kontrate vetëm si kontratë ashtu siç sqarohet në shkresën e sipërcituar dhe një siperfaqe e përgjithshme që ka në dokumentet teknike,pa cilësuar të dhëna të tjera të hollësishme si për ndërtimin ashtu dhe për kanalet, rrugët ,dekantuesit qëpërfshihen në këtë koncesion etj,për faktin që përmendëm me sipër në kushtet e një vakumi të plotë ligjor. (Bashkëlidhur kartela provizore dhe shkresa e mësipërme e ZQ.),po kështu edhe për "[redacted]ref.0020.
Bashkelidhur shkresa e Zyres Qendrore Tirane nr.4123 date 30.04.2014.

Sqarimi i grupit të auditimit: Observacioni juaj nuk meret në konsideratë pasi:
- Në lidhje me [redacted] nuk përputhet sipërfaqja e sheshit të ndërtimit e përcaktuar në formularin nr. 2 e cila është 320 m2 dhe kontratës së shitblerjes e cila është 152 m2, duke regjistruar më pakë në kartela një sipërfaqe prej 168 m2.
- Në lidhje me [redacted] nuk përputhet sipërfaqja e ndërtimit e përcaktuar në formularin nr. 2 e cila është 1060.77 m2 me planimetrinë e sheshit të ndërtimit e cila është 221.4 m2. Në lartësinë e përgjithshme të përcaktuar numri maksimal i kateve është 2 ndërsa numri i kateve mbi tokë është 3 dhe nën tokë 1, pra ka mospërputhje të të dhënave dhe kondicioneve urbane, ndërsa në prerjen tërthore të objektit paraqitet 4 kate mbi tok dhe një nën tokë .
- Në lidhje me [redacted] nuk përputhen konturet e gjurmës së ndërtimit të përcaktuar në planimetrinë e sheshit të ndërtimit të miratuar me planin e rilevimit të përgatitur nga inxhinieri i licencuar dhe e miratuar nga autoriteti përgjegjës. Në dosje mungon planimetria e sheshit të ndërtimit me kondicionet urbane si dhe projekti i miratuar.

- Në lidhje me [redacted] nuk përputhet sipërfaqja e sheshit të ndërtimit e përcaktuar në formularin nr. 2 e cila është 320 m2 dhe kontratës së shitblerjes e cila është 152 m2, duke regjistruar më pakë në kartela një sipërfaqe prej 168 m2.
- Në lidhje me "[redacted] Në dosje mungon "Leja e sheshit të ndërtimit", kondicionet urbane, "Leja e përdorimit" akti i lejimit të përdorimit dhe/ose zënies së tokës apo strukturës së zhvilluar, për të cilin është kryer punimi, "aktet e kontrollit" të cilat vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes, "Oponenca teknike" për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, "Projektin dhe kushtet urbanistike" të miratuara. Mungojne mardhenjet me truallin(shtet dhe/ose privat) ku vendoset dhe bie objekti sipas planimetrisë së sheshit të ndërtimit të miratuar. Nuk është përllogaritur saktë dhe është paguar më pak nga ana e subjektit, pagesa 1 për qind të vlerës së investimit që do të kryejë sipas preventivit të objektit. Në dosje mungon përllogaritja e këtij detyrimi, në dosje administrohet nxjerrje llogarie të këtij subjekti, ku për llogari të ish/Komunës Martanesh më datë 30.11.2010 ka derdhur taks ndikimi në infrastukturë nga ndërtimet e reja në vlerën 1.197.390 lekë, ndërsa përllogaritja sipas nenit 51 ligji nr. 8405 dhe neni 27 i ligjit nr. 9632,:
Vlera e objekti sipas preventivit 731.513.571 x 0.1 %= 731.514 lekë taks ndikimi në infrastukturë. Vlera e objekti sipas preventivit 731.513.571 x 1 %= 7.315.135 (SUP) lekë- 1.197.390 lekë të paguara= 6.117.745 lekë Tarifë për sutudimet urebanistike dhe/ose për planet e detajuara vendore (1% e vlerës së investimit) të pa argumentuara nëse janë paguar apo jo. Nuk është bërë hedhja e objektit në hartën e punës (planshetë). etj.
- Në lidhje me [redacted] Nuk ka urdhër për heqjen e kufizimit dhe ndalimit të veprimeve. Në dosje mungon: Mardhenjet me truallin(shtet dhe/ose privat) ku vendoset dhe bie objekti sipas planimetrisë së sheshit të ndërtimit të miratuar. Mungon "Leja e sheshit të ndërtimit", kondicionet urbane, "Leja e përdorimit" akti i lejimit të përdorimit dhe/ose zënies së tokës apo strukturës së zhvilluar, për të cilin është kryer punimi, "aktet e kontrollit" të cilat vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes, "Oponenca teknike" për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve. Nuk është bërë hedhja e objektit në hartën e punës (planshetë). etj.

5. Auditim mbi procedurën e ndjekur për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga vendime gjyqësore të formës së prerë.

Nga auditimi i dokumentacionit me zgjedhje në ZVRPP Bulqizë në lidhje me pranimin dhe regjistrimin e dokumentacionit Zona Kadastrale 3444(shupenzë), për pasuritë e përfituara në zbatim të VKM nr. 608, datë 05.09.2012, sipas shkresës nr. 5400/3, date 20.09.2012 "Për zbatimin e VKM 608, datë 5.9.2012 dhe ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", për periudhën nga data 01.01.2017 deri me datë 31.12.2018, në bazë të programit të auditimit ***nr. 207/1, datë 01/04/2019*** në lidhje me përcaktimin e proçedurës së kalimit të pronësisë së pasurisë palujtshme për objekte të ndërtuara deri me datë 10.08.1991 dhe të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte të fitimit të pronësisë, mbajtur në datë 31/05/2019, u konstatua:
Nga ana e ZVRPP Bulqizë nuk rezulton të jenë zbatuar përcaktimet ligjore evidentuar në ***VKM nr. 608, datë 05.09.2012 dhe ligjin nr. 33/2012*** "Për regjistrimin r Pasurisë Palujtshme, në lidhje me proçeduren e kalimit të pronësisë së pasurisë palujtshme për objekte të ndërtuara deri me datë 10.08.1991 dhe të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte të fitimit të pronësisë ku percaktohet që:

"ZVRPP Regjistron në përputhje me nenet 24, 25 të ligjit 33.2012 mbas verifikimit të dokumentacionit për pasurinë nëse plotesohen kushtet per regjistrim ***sipas pikës 4-5 të VKM nr. nr. 608, datë 05.09.2012(objekti është i ndërtuar deri me datë 10.08.1991, trualli ështe fizikisht i lirë dhe i pa zëne, objekti e trualli të mos jenë regjistruar në regjistra publik ose të jenë regjistruar por nuk kanë akt fitimi pronësie dhe të ketë dokument zyrtar nga OQV që provon se ndërtimi është bëre para dareë 10.08.1991).*** *Kur pasuria nuk figuron e regjistruar në ZVRPP në regjistra publik ose nuk ka aktfitim pronësie verifikohet ligjshmëria e dokumentacionit të paraqitur bëhet verifikimi në teren sipas pikës 6, dhe në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit, Institucioni i autorizuar bën afishimin brenda 45 diteve dhe pas këtij afati nga Institucioni i autorizuar merr vendim, dhe dosja e plotë me dokumentacionin përkatës, relacioni i përcillet KQ duke njoftuar subjektin kërkues i cili brenda 30 ditëve duhet të shprehet, nëse jo, konsiderohet i miratuar kalimi i pronë dhe brenda 30 ditësisë i percillet ZVRPP për regjistrim.....vendimi dhe dokumentacioni i plotës i njësuar me origjinalin sipas pikës 8.*

Për sa konstatuar nga auditimi me zgjedhje i dokumentacioni për zonën kadastrale 3444, fshati Shupenzë, Bulqizë, në lidhje me zbatimin e përcaktimeve ligjore të bëra në ***VKM nr. 608, datë 05.09.2012, sipas shkresës nr. 5400/3, date 20.09.2012 "Për zbatimin e VKM 608, date 5.9.2012 dhe bazuar në kërkesat e neneve 24-25 të ligjit 33/2012 më konkretisht regjistrimi i dokumentacionit sipas refencave paraqitet si më poshtë:***

1.Me Referencë nr. 0098, datë 12.03.2018, aplikim nr. 1919, datë 21.11.2017***(D. H.)*** është regjistruar ***pasuria nr. 200/2 për truall 80 m2 dhe ndërtim 48,95 m2 v. 1, faqe 37(kartela provizore) në emër të*** [redacted] pa u plotësuar urdhër për regjistrim nga ***ish-Regjistruesi D. H..*** Nuk ka HTR Provizore nga ZVRPP për pasurinë 200/2, v.1,faqe 37.

Sipas plan-rilevimit përgatitur nga Flamur Bulku, miratuar nga K/Bashkisë Melaim Damzi dhe Kryetari i fshatit evidentohet sipërfaqe ***trualli 80 m2 dhe ndërtesë 48.95*** sikurse evidentohet edhe në KPP(ptrovizore). Në KPP nuk ka nëshkrime për lëshimin e certifikates .

Inventari datë ...qershor 2018 dhe nuk ka nëshkrimin e specialistit dhe arkivistit.

Në zbatim të ***pikës 8 të VKM nr. 608, datë 05.09.2012,*** bazuar në shkresën ***nr. 5400/3, date 20.09.2012 "Për zbatimin e VKM 608, date 5.9.2012*** dhe në kërkesat e neneve 24-25 të ligjit 33/2012 Institucioni i Autorizuar, Bashkia Bulqizë me shkresën ***nr. 4379, datë 10.11.2017***([redacted] ka dërguar në ish-ZVRPP Bulqizë dosjen e plotë ***të pa njësuar*** dhe vendimin për subjektin ***Riza Daçi nr. 86/1, datë 21.09.2017*** protokolluar ZVRPP nr. 5805, datë 14.11.2017për kalimin në pronësi të objektit, në mungesë të vendimit të KQ, në zbatim të VKM 608, date 5.9.2012.

Dosja e dërguar sipas shkresës nr. nr. 4379, datë 10.11.2017 përmban:

1.Vendimin nr. 86/1, datë 21.09.2017 për dosjen nr. 8, datë 21.09.2017 shqyrtuar nga Bashkia me të dhënat:

a.-Kërkesa nga [redacted] ***nr. 2563, datë 05.07.2017*** e cila mbështetet në rrethanat kur objektit i ka përfunduar Karabinaja dhe mbulesa para vitit 1991.Trualli rezulton i lirë nga ndërtimet pa leje dhe nuk ka kërkesa të tjera për ndërtim. Saktësimi i kufijve u krye në teren dhe është hartuar Plan Rilevimi dhe objekti aktualisht përdoret nga përfituesi.

b.-Ligji i zbatueshëm: Ligji 139/2015 "Për Qeverisjen Vendore" neni 64 "Detyrat dhe kopetencat e kryetarit të Bashkisë" si dhe VKM mr. 608, datë 05.09.2012.

c. Konkluzioni: Kërkesa e paraqitur nga përfituesi [redacted] i plotëson kushtet për tu pranuar dhe është vendosur: ***Kalimi në pronësi ndërtesë 1 kat dhe truall ZK 3444 me sipërfaqe 80 m2, nga e cila ndërtim 48.95 m2 në emer*** [redacted]

2.Relacion teknik datë 06.08.2017 nga Arshi Begiri permban:

a- Kërkesa nga [redacted] ***sipas pikës 5 të VKM nr. 608, datë 05.09.2012*** për siperfaqen 80 m2 dhe truall per 48.95 ZK 3444 Shupenzë. Nuk është bërë regjistrimi fillestar për zonën dhe ky objekt nuk ka nr. Pasurie.

b-Dokumentacioni bashkëlidhur kërkesës është në perputhje me pikën 5 të VKM nr. 608, 05.09.2012.

c. Verifikimi në teren: nga verifikimi në teren Objekti është ndërtuar karabina dhe mbuluar para datës 10.08.1991.

-Madhësia e sipërfaqes është sipas dispozitave ligjore në fuqi.

-Truallit në objekt dhe truallit funksional i mungon akti i fitimit të pronësisë dhe të patrajtuara nga Legjislacioni përkatës KKKP, Legalizimit dhe ndertimet pa leje.

-.Kufizimet në teren përputhen sipas planit të Rilevimit

-Kërkesa e paraqitur i plotëson kriteret sipas VKM nr. VKM nr. 608, datë 05.09.2012.

<u>3.Kërkesa e z.Riza Daçi nr.2563, datë 05.07.2017</u> për truall 80 m2 nga e cila ndertim 48.95 m2, Tel.0682448104).

-Plan Rilevimi përg. nga [redacted] miratuar nga K/Bashkisë dhe K/Fshatit.

-Çertifikatë familjare lëshuar me datë20.06.2017 per gjendjen datë 10.08.1991.

-Vërtetim datë 05.07.2017 për përbërjen familjare datë 10.08.1991 sipas regjistrit Vlashaj nr. 3, faqe 34 nga Administratori [redacted] dhe Përgj. Gj.Civ. [redacted].

-Faturë e thjeshte tatimore nr. 10, datë 16.06.2017(Pagese shpenz. Plane Rilevimi).

-*Vertetim njësisë kopje me origjinalin datë 21.06.2017* ***të vërtetimit datë 31.05.2003 me anë të të cilit vërtetohet se objekti privat për prodhim varrezash i ndërtuar nga [redacted] Shupenzë kufizohet Lindje: [redacted], Perrëndim rruga Tiranë-Peshkopi dhe jugu: Ish zyrat e ndërmarjes Ruga Ura.***

-Vërtetim datë 12.07.2017 nga K/Fshatit [redacted] dhe Admistratori [redacted] që objekti i prodhimit të varrezave është në zotërim të [redacted] dhe është ndërtuar para datë 10.08.1991.

-Vertetim nga ZVRPP nr. 1238, datë 12.06.2017 nga V. H. ish-regjistrues që ZVRPP nuk kryen veprime në ZK 3444 mbasi nuk ka perfunduar regjistrimi fillestar, ndërsa për pasurinë Repart Prodhimi varrezash nuk ka kërkesa per regjistrim të veçantë dhe nuk rezulton i regjistruar ky objekt.

-Faturë arkëtimi nr. 1, datë 08.11.2017 në vlerën 200000 lekë nga [redacted] " Të ardhura nga Kalimi i pronësisë".

-Faturë aplikimi RFZ Bank në vleren prej 10275 lekë.

-Faturë aplikimi Bashki në vleren prej 10000 lekë

-Planimetria e objektit dhe planvendosja e objektit Repart-Prodhimi e qytetarit [redacted] me siprëfaqe ndertimi 48.95 m2 hartuar nga [redacted].

<u>4-Evidencë e gjykatës së Lartë-</u> çeshtje civile dorëzuar nga [redacted] regjistruar 16.10.2014.

-Padi për konflik pronësie me objekt ***"Pushimi i cënimit të pronësisë dhe mospërsëritjen e tij"*** me paditës [redacted] ***dhe i paditur*** [redacted]

-Kthyer përgjigje me shkresn nr. 1128, datë 27.03.2017 "Kthim përgjigje" ***z.*** [redacted] kundrejt shkresës 1128, datë 23.03.2017 duke njoftuar regjistrimin e çështjes civile në Gjykatën e Lartë me padites [redacted]

<u>5.Informacioni nga subjektet:</u>

-Kërkesë nr. 2720, datë 13.07.2013, nga Bashkia drejtuar ***ZVRPP, ATP*** dhe Drejtorisë së ***ALUIZNI-t*** për objekte ndërtuar deri datë 10.08.1991 ***pa akt fitimi pronësie*** ([redacted]

-Me shkresën nr. 6976/1, datë 24.07.2013 kthyer përgjigje nga ATP Tiranë dhe konfirmon se referuar arkivës diçitale nuk rezulton të ketë vendim të KKP në emër të [redacted] ndërsa informacioni nuk mund të jetë i plotë mbasi ATP është në proces inventarizimi dhe diçitalizimi([redacted]

-Me shkresën nr. 1803, pa datë, kthyer përgjigje nga ALUIZN-i Dibër duke dërguar vetëm vendimin nr. 10, datë 26.09.2017 duke përjashtuar nga proçedurat e Legalizimit objektin Repart

Prodhimit të Varrezave të qytetarit [redacted] sipas dosjes mbasi është dëshmuar nga vetë subjekti ndërtues objekti ndërtuar para viteve 90 sipas dosjes nr. 1, datë 14.08.2006 dhe nuk ka asnjë dokumentt tjetër bashkëlidhur(ortofoto etj.)([redacted]

-Me shkresën nr. 3740, datë 01.08.2017 kthyer përgjigje nga ZVRPP Bulqizë ku konfirmohet se në ZK 3444 nuk është filluar proçedura e regjistrimit fillestar, nuk ka regjistra pasurish dhe HTR prandaj informacioni i kërkuar nuk mundësohet (V. H.).

Nuk ka shkresë nga zyra e gjendjes civile për gjendjen familjatre deri me datë 10.08.1991.

6. Nuk rezulton të ketë procesverbal dhe relacion me komision të krijuar nga Bashkia për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga [redacted] në lidhje me ***truallin 80 m2 dhe ndërtimin 48,95 m2.***

Përsa evidentohet më sipër rezulton të mos jenë zbatuar proçedurat e regjistrimit të pasurive dhe truallit funksional ndërtuar para datës 10.08.1991, ***në kunddërshtim me VKM nr. 608, datë 05.09.2012.***

Kanë kaluar afatet 10 ditore për kthimin e përgjigjeve nga institucionet përkatëse në zbatim të pikës 6, shkronja "a" e VKM 608, datë 05.09.2012. Nuk evidentohet fakti nëse trualli është i zënë apo i lirë fizikisht.

Nuk evidentohet fakti që është bërë Afishimi i të dhënave ***për një afat 45 ditë nga verifikimi i të dhënave. Nuk rezulton të ketë dokument zyrtar nga OQV që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991, në kundërshtim me pikën 5 të VKM nr. 608, datë 05.09.2012,*** informacioni i dërguar nga ALUIZNI për statusin e objektit nuk dokumenton faktin që objekti rezulton i ndërtuar para datës 10.08.1991, ***mbasi është bazuar në dëshmin e subjektit të interesuar dhe bashkëlidhur nuk ka ortofoto për dokumentimin e objektit***. Vendimi Bashkisë për pranimin e kërkesës dhe kalimin në pronësi si dhe dokumentacioni i dosjes së inventarizuar ***i pa njesuar*** rezulton të jetë dërguar në Këshillit Qarkut ***me shkresën nr. 3823, datë 04.10.2017dhe nuk është njoftuar kërkuesi sipas kërkesës së bërë*** [redacted] ***në kundërshtim me pikën 6, të VKM 608, datë 05.09.2012.***

- Sipas kriterit të përcaktuar ***të pikës 7 të VKM nr. 608, datë 05.09.2012*** rezulton që Këshilli Qarkut nuk është shprehur me vendim.

- Nuk rezulton të ketë dokument zyrtar nga Pushteti Vendor që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991, në kundërshtim me pikën 5 të VKM nr. 608, datë 05.09.2012.

Dokumentacioni i dosjes dërguar në ZVRPP ***është fotokopje dhe nuk ka vulat dhe firmat nga Bashkia për njesimin e dokumentacionit,*** në kunddërshtim me procedurat e përcaktuara nga VKM 608, datë 05.09.2012, pika 8.

Nga data e regjistrimit të kërkesës nr 2563, datë 05.07.2017 deri më marrjen e vendimit nga Bashkia për kalimin në pronësi nr. 86/1, datë 21.09.2017 ***kanë kaluar afërsisht 3 muaj, në kundërshtim me Pikën 6, të VKM 608, datë 05.09.2012,*** për verifikimin e dokumentacionit sipas pikës 4, dhe njëkohësisht ***nuk janë afishuar të dhënat brenda 45 ditëve nga marrja e vendimit. Nuk disponohet nga subjekti asnjë lloj dokument pronësie*** sikurse leje sheshi, preventiv, situacion, aktdorëzimi, aktkontroll punimesh, e dokumentacion, si dhe dokument që provon pronësinë e objektit, ndertimin e tij dhe të truallit të asaj kohe sipas ligjit të urbanuistikës nr. 7693, datë 07.06.1993 dhe nuk disponohet akt fitimi pronësie si leje ndertimi apo KSHB.

Përsa evidentuar nga ZVRPP Bulqizë është regjistruar ***pasuria nr. 200/2, v.1, faqe 37 sipas refencës 0098, datë 12.03.2018,*** mbas verifikimit të dokumentacionit dhe vendimit të derguar me shkresën nr. 4379, datë 10.11.2017, duke kaluar afati 10 ditor në zbatim të pikës 9 të VKM 608, datë 05.09.2012. Kjo pasuri nr. 200/2 është hedhur në HTR nr. 34-89-(110-D) p.200/2 si regjistrim provizor mbasi zona nuk është futur në sistem.

Për këtë pasuri të regjistruar sipas refencës ***nr. 0098 dhe 103 në emër të*** [redacted] nga ana e ish-regjistrueses ***D. H.*** është plotësuar ***urdhri nr. 262, datë 27.12.2017*** për ndalimin e veprimeve deri në momentin e marjes së vendimit nga gjykata sipas ankesës së ***z.*** [redacted]
dhe është vendosur kufizimi në KPP sipas ***referencës 0101, ndërsa sipas refencës nr. 0102 regjistruar kufizim sipas sigurimit të padisë nr. 2843, datë 12.06.2018.***
Sikurse evidentohet rezulton që sipërfaqja prej ***80 m2 truall dhe ndërtim 48.95*** të jetë përfituar nga subjekti [redacted] pa pasur dokumentacionin e duhur ligjor provues për ndërtimin e objektit para datës 10.08.1991, ***në kunddërshtim me procedurat e përcaktuara nga VKM 608, datë 05.09.2012, në papajtueshmëri me pikën "iii" shkronjës "b" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".***
Nga ana e subjektit [redacted] paraqitur vendimi i gjykatës nr. 1607 i aktit, vendimi 1317 datë 31.01.2017 me paditës [redacted] dhe i paditur ***Bashkia Bulqizë në mungesë ZVRPP Bulqizë.***
Me objekt: "detyrimin e palës paditur Bashkia Bulqizë" marjen në shqyrtim të kërkeses [redacted] sipas dokumentacionit përkatës dhe nuk detyron bashkinë për të marë vendimin për kalimin në pronësi të objektit në favor të [redacted].
Me shkresën nr. 1957/3, datë 22.2.2018 nga Prokuroria e rrethit gjyqësor Dibër është kërkuar nga ZVRPP Bulqizë informacion, dhe praktika e dokumentave për p. 200/1, për sipërfaqen 87 m2 në emër të shtetasit [redacted] ***dhe praktikën e dokumetave të shtetasit*** [redacted] ***me sipërfaqe 80 m2 dhe ndërtim 48.95 m2*** të cilat i janë dërguar nga ZVRPP Bulqizë me shkresën nr. 3061/1, datë 25.10.202018 nëshkruar nga Sh. A. dhe është në proces.
Me shkresën nr. 678, datë 16.03.2018 nga ZVRPP Bulqizë z. Sh. A. i është kërkuar ZQRPP (Drejtorisë Juridike) interpretim ligjor në lidhje me regjistrimin fillestar të objektit perfituar nga [redacted] sipas ***VKM 608, datë 05.09.2012 dhe ZQRPP me shkresën nr. 507/2, datë 01.03.2018, kundrejt shkresës nr. 507/1, datë 08.02.2018 dhe 507/6, datë 29.03.2018 ka bërë me dije se vendimi nr. 51, datë 26.01.2009 "Pushim cënim pronesie dhe mospërsëritje e tij në të ardhmen"nuk është objekt regjistrimi".***
Sipas vendimit të gjykatës së rrethit Gjyqësor Bulqizë me nr. 60, datë 18.06.1998 me kërkues [redacted] dhe palë e interesuar ***Komuna Shupenzë*** me objekt: ***Vërtetim Fakti Juridik*** rezulton se objekti(lokal) ka përfunduar së ndërtuari në vitin 1993. Ky objekt rezulton të jetë përdorur nga kërkuesi për prodhim varrezash dhe gjykata ka çmuar që ti njihet pronësia me vërtetim fakti juridik një siperfaqe 3 faqe anësore dhe 1/3 e faqes nga jugu që evidenton ***një objekt me tre faqe muri dhe pa mbulesë, në kundershtim me shkronja "a" të pikës 4 të VKM 608, datë 05.09.2012, ndërsa trualli ku ndodhet ky ndërtim i vitit 1993 ka lidhje me parcelën tek varrezat me siperfaqe 3555 m2 që i është njohur*** [redacted] ***sipas VKKKP Bulqizë me nr. 117, datë 05.09.1995, parcelë mbi të cilën shtrihen dhe objekte të tjera ndër të cilat dhe objekti i njohur me fakt juridik sipas Vendimit nr. 60, datë 18.06.1998 (i cili nuk regjistrohet)*** [redacted] ***përfunduar së ndërtuari në vitin 1993.***
Për sa më sipër arrihet në konkluzionin:
Nga ZVRPP nuk rezulton të jenë zbatuar proçedurat e percaktuara në VKM nr. VKM 608, datë 05.09.2012, në papajtueshmëri me pikën "iii" shkronjës "b" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".
Pasuria 200/2, v.1,faqe 37. është regjistrruar pa u plotësuar urdhër per regjistrim nga ish-Regjistruesi D. H.. Nuk ka HTR Provizore nga ZVRPP. Në KPP nuk ka nënshkrime për lëshimin e certifikatës.
Nuk disponohet nga subjekti asnjë lloj dokument pronësie sikurse leje sheshi, preventiv, situacion, aktdorëzimi, aktkontroll punimesh, e dokumentacion, si dhe dokument që provon pronësinë e truallit të asaj kohe sipas ligjit të urbanuistikës nr. 7693, datë 07.06.1993 dhe nuk disponohet akt fitimi pronësie si leje ndertimi apo KSHB.

Nuk janë zbatuar afatet, nuk ështtë evidentuar fakti i publikimit 45 ditor.

Sipas vendimit të gjykatës së rrethit Gjyqësor Bulqizë me nr. 60, datë 18.06.1998 me kërkues [redacted] dhe palë e interesuar Komuna Shupenzë me objekt: ***Vërtetim Fakti Juridik rezulton*** se objekti(lokal) ka përfunduar së ndërtuari në vitin 1993. Ky objekt rezulton të jetë përdorur nga kërkuesi për prodhim varrezash dhe gjykata ka çmuar që ti njihet pronësia me vërtetim fakti juridik për sipërfaqe: ***3 faqe anësore dhe 1/3 e faqes nga jugu,*** që evidenton ***një objekt me tre faqe muri dhe pa mbulesë, në kundërshtim me shkronja "a" të pikës 4 të VKM 608, datë 05.09.2012.***

- Nuk rezulton të ketë dokument zyrtar nga Pushteti Vendor që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991, ***në kundërshtim me pikën 5 të VKM nr. 608, datë 05.09.2012***.

Dokumentacioni i dosjes dërguar në ZVRPP është fotokopje dhe ***nuk ka vulat dhe firmat nga Bashkia për njesimin e dokumentacionit, në kunddërshtim me procedurat e përcaktuara nga VKM 608, datë 05.09.2012, pika 8.*** Sikurse evidentohet në dosje nga subjekti kërkues dhe Bashkia nuk kanë plotësuar dokumentacionin në zbatim të VKM nr. 608, datë 05.09.2012.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
në kërkesat e neneve 24-25 të ligjit 33/2012 "Për Regjistrimin e pasurisë së Palujtshme",
VKM nr. 608, datë 05.09.2012 dhe shkresën nr. 5400/3, date 20.09.2012 "Për zbatimin e VKM 608, datë 05.09.2012 "Për përcaktimin e proçedurës së Kalimit të Pronësisë të Pasurive të Palujtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre , kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Sh. A. me detyrë ish-Regjistrues

D. H. me detyrë ish-Regjistruese

Rakip Shera me detyrë hartograf.

(Trajtuar më hollësisht në Aktkonstatimin nr. 20, datë 31.05.2019 zona kadastrale 3444 dhe Projektraportin e audtimit dërguar me shkresën nr. 737/1, datë 04.07.20192019 dhe protokolluar në KLSH me nr. 207/3, datë 08.07.2019).

Komente dhe shpjegime nga subjekti i Audituar: *Subjekti i Audituar* ***Sh. A.(me detyrë pergjegjës sektori) sipas shkresës nr. 661, datë 13.06.2019*** *ka bërë komente dhe shpjegime në lidhje me problematikat e trajtuara në akt konstatimin nr. 20, datë 31.05.2019 për pasurinë e regjistruara sipas* ***Referencës nr. 0098, datë 12.03.2018,*** *me pretendimin se është bashkia Institucioni i autorizuar që ka përgjegjësinë të kryejë proçeduren për kalim pronësie në zbatim të* ***VKM nr. 608, datë 05.09.2012****, ndërsa ZVRPP në zbatim të pikës 9 të VKM nr. 608, datë 05.09.2012 verifikon vetem elementët formal të vendimit paraqitur për regjistrim, ndërsa në zbatim të pikës 11, nëse ZVRPP gjatë verifikimit konstaton praktika abuzive të institucionit paraqet menjëhere kallzim në prokurorinë kopetente dhe me shkresën nr. ish-ZVRPP Bulqizë me shkresën nr. 3061/1, datë 25.10.2018 e ka dërguar dosjen e plotë e nësuar në prokurori.*

Qëndrimi i grupit të auditimit *në lidhje me komentin dhe shpjegimet e Subjekti i Audituar* ***Sh. A.(me detyrë pergjegjës sektori) sipas shkresës nr. 661, datë 13.06.2019*** *për problematikat e trajtuara në akt konstatimin nr. 20, datë 31.05.2019 për pasurin e regjistruar sipas* ***Referencës nr. 0098, datë 12.03.2018, në emër të*** [redacted] sipas proçedurave të përcaktuara ***nga VKM nr. 608, datë 05.09.2012***, me pretendimin se ***Institucioni i autorizuar*** është përgjegjës per zbatimin e ***proçedurave dhe se nga ana e ish-ZVRPP*** *verifikohen vetem elementët formal të vendimit nuk qëndron per faktin se po të ishte kështu dërgohej në ZVRPP vetem vendimi dhe jo e gjith dosja dhe dosja në prokurori është derguar sipas kërkesës së prokurorisë dhe jo sipoas konstatimit nga ZVRPP, dhe sipas nenit 11, të VKM nr. 608, datë 05.09.2012 Institucioni duhet të ishte kallzuar në prokurori bazuar në verifikimin e dokumuntacionit në dosje. Për rjedhojë pretendimet e paraqitura nuk meren në konsideratë, mbasi nuk kanë as argumentim dhe mbështetje ligjore.*

Gjetje nga auditimi 5*: Nga Zyra Vendore ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë** nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes të pasurisë, regjistruar Pasuria ***200/2, v.1, faqe 37 për truall 80 m2 dhe ndërtim 48.95 në emër të [redacted] dhe nuk rezulton të jenë zbatuar proçedurat e percaktuara në VKM nr. VKM 608, datë 05.09.2012, në papajtueshmëri me pikën "iii" shkronjës "b" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

Pasuria 200/2, v.1,faqe 37, është regjistrruar pa u plotësuar urdhër për regjistrim nga ***ish-Regjistruese D. H..*** Nuk ka HTR Provizore nga ZVRPP. Në KPP nuk ka nënshkrime për lëshimin e certifikatës.

Nuk disponohet nga subjekti ***asnjë lloj dokument pronësie sikurse leje sheshi, preventiv, situacion, aktdorëzimi, aktkontroll punimesh, e dokumentacion, si dhe dokument që provon pronësinë e truallit të asaj kohe sipas ligjit të urbanuistikës nr. 7693, datë 07.06.1993 dhe nuk disponohet akt fitimi pronësie si leje ndertimi apo KSHB.***

Sipas vendimit të gjykatës së rrethit Gjyqësor Bulqizë me nr. 60, datë 18.06.1998 me kërkues [redacted] dhe palë e interesuar Komuna Shupenzë me objekt: ***Vërtetim Fakti Juridik rezulton*** se objekti(lokal) ka përfunduar së ndërtuari në vitin 1993. Ky objekt rezulton të jetë përdorur nga kërkuesi per prodhim varrezash dhe gjykata ka çmuar që ti njihet pronësia me vërtetim fakti juridik për siperfaqe per 3 faqe anësore dhe 1/3 e faqes nga jugu që evidenton ***një objekt me tre faqe muri dhe pa mbulesë, në kundërshtim me shkronja "a" të pikës 4 të VKM 608, datë 05.09.2012.***

- Nuk rezulton të ketë dokument zyrtar nga Pushteti Vendor që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991, ***në kundërshtim me pikën 5 të VKM nr. 608, datë 05.09.2012***.

Dokumentacioni i dosjes dërguar në ZVRPP është fotokopje dhe nuk ka vulat dhe firmat nga Bashkia për njësimin e dokumentacionit, në kunddërshtim me procedurat e përcaktuara nga ***VKM 608, datë 05.09.2012, pika 8.*** Sikurse evidentohet në dosje nga subjekti kërkues dhe Bashkia nuk është plotësuar dokumentacioni në zbatim të VKM nr. 608, datë 05.09.2012, ***në kundërshtim me kërkesat e neneve 24-25 të ligjit 33/2012 "Për Regjistrimin e pasurisë së Palujtshme".***

Rekomandimi: Zyra Vendore ASHK (ish-ZVRPP) Bulqizë), Përgjegjësi i Zyrës të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara në emër të ***Riza Daçit sipas refencës nr. nr. 0098, datë 12.03.2018 në kundërshtim me proçedurat e percaktuara nga VKM 608, datë 05.09.2012,*** pa asnjë lloj dokument pronësie sikurse leje sheshi, preventiv, situacion, aktdorëzimi, aktkontroll punimesh, e dokumentacion, si dhe dokument zyrtar që provon pronësinë e truallit të asaj kohe sipas ligjit të urbanuistikës nr. 7693, datë 07.06.1993 dhe nuk disponohet akt fitimi pronësie si leje ndertimi apo KSHB.

Per regjistrimin e kësaj pasurie në mënyrë abuzive në zbatim të VKM nr. 608, datë 05.09.2012, kërkojmë bazuar në dispozitat ligjore fshirjen e regjistrimit dhe ti kërkohet bashkisë Bulqizë rishqyrtimi edhe një herë i kërkesës së qytetarit [redacted] dhe në rast të mos shqyrtimit nga Bashkia ***të kërkohet kallzim në zbatim të pikës 11, VKM nr.608, datë 05.09.2012.***

6. Regjistrimi i pasurive Publike të transferuara dhe Administrimi i tyre.

- (Për auditimin e regjistrimin e pasurive publike të transferuara, administrimi i tyre, kontratat e qerve apo nënqerave")

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit ***nr. 207/1, datë 01.04.2019*** u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Regjistrat e Kartelave të Pasurive të Paluajtshme, VKM-të, "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Bulqizë dhe ish komunave, të Qarkut të Dibrës", listat e pronave dhe pasurive bashkëlidhur

Korrespondenca shkresat e Bashkisë Bulqizë drejtuar ZVRPP Bulqizë, për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të transferuara me VKM.

Mbi bazën e dokumentacionit të shqyrtuar më sipër rezulton se për pronat e transferuara në pronësi apo përdorim të Bashkisë Bulqizë dhe ish komunave që mbulon kjo bashki, janë miratuar sipa këtyre VKM-ve:

VKM –së nr. 5, datë 04.05.2013 "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Bulqizë, të Qarkut të Dibrës";

VKM –së nr. 809, datë 06.10.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish Komunës Zerqan, të Qarkut të Dibrës";

VKM –së nr. 480, datë 30.05.2013 "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish Komunës Fushë Bulqizë, të Qarkut të Dibrës";

VKM –së nr. 903, datë 21.12.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish Komunës Trebisht, të Qarkut të Dibrës";

VKM –së nr. 160, datë 27.02.2013 "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish Komunës Ostren, të Qarkut të Dibrës";

VKM –së nr. 523, datë 30.06.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish Komunës Martanesh të Qarkut të Dibrës";

VKM –së nr. 483, datë 30.05.2013 "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish Komunës Zerqan, të Qarkut të Dibrës";

VKM –së nr. 567, datë 14.07.2010 "Për transferimin e rezervuarëve dhe skemave ujitëse përkatëse, nga Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në pronësi të Njësive të Qeverisjes Vendore dhe për një ndryshim në Vendimin e KM nr. 1157, datë 25.11.2009"

VKM –së nr. 915, datë 11.11.2015 "Për transferimin në pronësi nga Këshillat e Qarqeve te bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe te aseteve të luajtshme dhe të paluajtshmetë ndërmarrjeve të mirmbajtjeve të këtyre rrugëve"(kalon në pronësi objekti i zyrave të sektorit Martanesh 2 zyra+2 kapanone, sektori Bulqizë 3 zyra +2 kapanone)

VKM –së nr. 433, datë 18.05.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish Komunave, pika 9/b, kalimin në pronësi godinën e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor"

VKM –së nr. 366, datë 18.05.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pronave të paluajtshme shtetërore të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe për një ndryshim në Vendimin e KM nr. 1691, datë 10.10.2007"

Sipas këtyre VKM-ve, kanë kaluar në pronësi ose përdorim të Bashkisë Bulqizë dhe ish komunave, grupe pronash të llojit:

Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e arsimit; ***në total 57 pasuri,*** *kryesisht shkolla dhe kopshte fëmijësh*;

Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik; ***në total 23 pasuri,*** *kryesisht qendra shëndetësore*;

Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative; ***në total 10 pasuri,*** *kryesisht objekte ndërtesa që përdoreshin nga ish komunat*;
Prona që përdoren për realizimin e veprimtareve social kulturore e sportive; ***në total 3 pasuri***;
Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik; ***në total 4 pasuri***;
Prona që përdoren në fushën e shërbimit social ***në total 2 pasuri***;
Prona për shërbimin funeral; ***në total 63 pasuri***;
Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit(toka jo produktive)(ne pronësi); ***në total 95 pasuri,*** *përcaktuar sipërfaqja përkatëse për çdo pasuri*;
Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit(toka produktive) ***në total 97 pasuri,*** *përcaktuar sipërfaqja përkatëse për çdo pasuri*;
dhe Prona troje të lira e hapësira publike(ne përdorim); ***në total 54 pasuri,*** *përcaktuar sipërfaqja përkatëse për çdo pasuri*;
Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit(truall+ndërtesë) ***në total 8 pasuri,***
Prona që përdoren në fushën e pyjeve dhe kullotave, ***në total 2317 pasuri***, *përcaktuar sipërfaqja përkatëse për çdo pasuri*;
Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile, ***në total 13 pasuri,kryesisht ndërtesa;***
-Sistemi i kanalizimeve të ujrave të bardha dhe të zeza dhe infrastrukturë vendore(rrugë vendore, lulishte, trotuare, sheshe) ***në total 133 pasuri***
Prona me funksion në fushën e bujqësisë(rezervuarëve dhe skemave ujitëse); ***në total 11 pasuri, kryesisht rezervuar;***
Sa trajtuar, nga verifikimi i dokumentacionit në ZVRPP Bulqizë, rezulton se nga Bashkia Bulqizë është aplikuar për regjistrimin dhe pajisjen me certifikatë pronësie vetëm për këto pasuri:
- Shkolla 9 vjeçare, Qyteti i Ri, Bulqizë, rezulton pajisur me certifikatë pronësie;
- Shkolla 9 vjeçare, Fshati Godvi, Bulqizë, rezulton pajisur me certifikatë pronësie;

- Qendra Kulturore, Bulqizë, rezulton pajisur me certifikatë pronësie;
- Fusha e Sportit, Qyteti Bulqizë, rezulton pajisur me certifikatë pronësie;
- Godina e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, rezulton pajisur me certifikatë pronësie;
- Godina e PMNZSH-së, Bulqizë, rezulton pajisur me certifikatë pronësie;

Për pasutitë e tjera të transferuara me VKM-të përkatëse, në pronësi apo përdorim të Bashkisë Bulqizë, rezulton se nuk është aplikuar pranë ZVRPP Bulqizë, për regjistrimin e tyre, nga njësitë e qeverisjes vendore, duke mos krijuar mundësinë e shfrytëzimit të tyre, nga Bashkia Bulqizë, me preteksin se regjistrimi i tyre ka kosto të pa përballueshme nga buxheti i Bashkisë Bulqizë.

Lidhur sa trajtuar në faqet 112-114 të Projekt Raportit të Auditimit dhe në Akt-Konstatimin nr. 15, datë 31.05.2019, nuk janë paraqitur observacione nga subjekti.
Gjetje: ZVRPP Bulqizë nuk ka bashkëpunuar me Bashkinë Bulqizë, lidhur me regjistrimin e pasurive të transferuara tek pushteti vendor, sipas VKM-ve përkatëse, ku rezulton se nga Bashkia Bulqizë nuk është aplikuar për regjistrimin e këtyre pasurive, mos regjistrimi i të cilave ka sjellë mos administrimin dhe pamundësinë e shfrytëzimit të resurseve, që paraqesin pasuritë e llojit pyje, kullota, sisteme vaditje, toka bujqësore, etj, për rrejdhojë nuk janë përmbushur detyrimet ligjore për administrimin dhe përdorimin me efikasitet të këtyre pasurive.
Rekomandim: Zyra Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa dhe ti kërkojë Bashkisë Bulqizë, po të jetë nevoja të njoftojë edhe instancat e larta, për të bërë mundur aplikimin dhe regjistrimin e pasurive të transferuara tek Bashkia Bulqizë, sipas VKM-ve përkatëse.

ZK 3511;

Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit mbi regjistrimin e **pasurive e transferuara, administrimi i tyre, kontratat e qerave dhe/ose shitjeve**, të ndryshuar, u konstatua se pasuritë e

paluajtshme, janë ndarë dhe janë regjistruar në kartelat e pasurisë së paluajtshme duke lëshuar certifikata pronësi me të meta e mangësi sipas pasqyrës më poshtë:

- Referencë nr. 0038/004/0697, ZK 3511;
Me aplikim nr. 771, datë 02.07.2018, z. [redacted] ka kërkuar regjistrimit kontratës së shitjes nr. 3302 rep dhe nr. 908 kol datë 19.06.2018 pala shitëse [redacted] sha, me objekt : shesh me sipërfaqe 9900 m2 dhe shesh me sipërfaqe 1400 m2.
- Në kartelat e pasurive të paluajtshme (KPP) volum 1, faqe 1, është regjistruar pasuria nr. 1 shesh me sipërfaqe 9900 m2 në pronësi [redacted], seksioni (D) i kartelës sipas referencë 002 datë 15.06.2012 në administrim [redacted] sha kaluar pronësi me referencë nr 0697 datë 13.07.2015 [redacted] sha. (KPP) volum 1, faqe 2, është regjistruar pasuria nr. 2 shesh me sipërfaqe 1400 m2 në pronësi [redacted], seksioni (D) i kartelës sipas referencë 002 datë 15.06.2012 në administrim [redacted] sha kaluar pronësi me referencë nr. 0004 datë 18.12.2015 [redacted] sha.
Kartelat ***janë të pa vulosura dhe nënshkruara nga regjistruesi, numri i zonës kadastrale dhe indeksi hartës të korrigjuara dhe shënuara me laps***.
Regjistrimi i pasurive të paluajtshme të shoqërive tregtare, të krijuara nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore është bërë në kushtet ***kur mungon: Urdhri i Ministrit te Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Vendimi i Gjykatës për regjistrimin e përsonit juridik, Statuti i Shoqërisë Tregtare, Kontrata midis themeluesve, Plan-vendosja***.
Në dosje mungon Urdhri i Ministrit të Financave nr. 95, datë 15.12.1995 për transfortmimin e ndërrmarrjes [redacted] në shoqëri aksjonere.
Në kartelat e pasurive të paluajtshme këto dy pasuri janë regjistruar me zërin kadastral Shesh, ndërsa në planrilevimet e përgatitura nga [redacted] bëhet fjalë për dy objekte njëri me sipërfaqe objekti 9900 m2 dhe spërfaqe të përgjithshme 13850 m2 dhe tjetri objekt me sipërfaqe prej 1400 m2 gjithashtu në shkresën me nr. 53/3 datë 30.11.2011 që [redacted] i drejtohet ZVRPP Bulqizë mbi plotësimin e kërkesave për objektet e zonës Lucane Krastë Batër cilësohen si objekte ndërtimore industrial, ***duke mos u përputhur lloji pasurisë ndërmjet kontratave të shitblerjes, listës së inventareve, plan-rilevimet të subjektit në likujdim dhe hartën e punës ku janë bërë shënimet me laps Objekte dhe hedhur në të dy objekte me konture të zeza***, pajisur me vërtetim hipotekor datë 11.02.2013.
- Në kontratën e shitjes nr. 2030 rep. Nr. 971 kol datë 09.06.2015 me pal shitëse "[redacted] "sha përfaqësuar likuidator [redacted], pala blerëse [redacted]sha, objekti shesh depozitim kromi 9900 m2, ***nuk përputhet zona kadastrale pasi në të është përcaktuar 2267 Krastë ndërsa në kartelë shënuar Lujcane korrigjuar me laps 3511 Krastë, por në fakt kjo zonë i takon Stavecit, indeksi hartës korrigjuar nga 183-A në 176-A. Në kontratë dhe autorizimin e Ministrit të linjës nr. 8935/4 datë 07.1.2015 është likuidator [redacted] ndërsa në genplanin e paraqitur është [redacted] Në raport vlerësimin numër 6358/1 prot datë 22.09.2014 sipërfaqet prej 9900 m^2 dhe 1400 m^2 përcaktohen si truall dhe vlerën ndërtimore, gjithashtu mungon planrilevimi***.
- Në kontratën e shitjes nr. 7774 rep. Nr. 3581 kol datë 18.11.2015 me pal shitëse "[redacted]sha përfaqësuar likuidator [redacted] pala blerëse "[redacted]sha, objekti impiant seleksionimi 1400 m2, ***nuk përputhet zona kadastrale pasi në të është përcaktuar Lucne zonë e cila nuk ekziston në listën e zonave të ZVRPP Bulqizë, ndërsa në kartelë ZK 3511 korrigjuar me laps ndërsa në listë kjo zonë quhet Stavec, indeksi hartës korrigjuar nga 183-A në 176-A gjithashtu mungon planrilevimi. Në procesverbalin e ankandit datë 23.10.2015 sipërfaqja prej 1400 m2 paraqitet në llojin truall me vlerën përkatëse, pajisur me vërtetim hipotekor datë 17.01.2015.***
- Në kontratën e shitjes nr. 3302 rep. Nr. 908 kol datë 19.06.2018 me pal shitëse "[redacted] sha, pala blerëse [redacted] me objekt: shesh me sipërfaqe 9900 m^2 dhe shesh me sipërfaqe 1400 m2, zonat kadastrale të këtyre dy pasurive nuk përputhen me kontratat e mëpërshme lidhur ndërmjet shitësve dhe blerësve sa kemi trajtuar më sipër. ***Për këto dy pasuri me sipërfaqe 9900 m2 dhe 1400 m^2 ekziston një tjetër kontrat qiraje lidhur midis*** [redacted]

[redacted] shpk nr. 5284 rep, nr. 2316 kol, datë 14.07.2016 për në periudhë 5 vjeçare deri më datë 01.09.2021, ku në pikën 13 të kontratës parashikohet se ndryshime ose shtesa të kontratës janë të vlefshme vetëm në rast se bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga të dy palët, ***pra mes këtyre palëve nuk ka akt të nënshkruar dhe pëlqim nga qiramarrësi për shitjen e kësaj prone dhe të drejtave reale tek pala blerëse [redacted].*** Veprime këto në papajtueshmëri me pikën a neni 25, pika 2 neni 45 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me pikën 2 dhe 3 të VKM nr .553, Date 28.8.1998 "*Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme të Shoqërive Tregtare, të Krijuara nga Transformimi i Ndërmarrjeve Shtetërore*". Veprime këto në papajtueshmëri me pikën a neni 25, pika 2 neni 45 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me pikën 2 dhe 3 të VKM nr .553, Date 28.8.1998 "*Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme të Shoqërive Tregtare, të Krijuara nga Transformimi i Ndërmarrjeve Shtetërore*".

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. E. K. me detyrë ish-regjistruese, z. Bajram Sallaku me detyrë ish-regjistruese z. V. H. me detyrë ish-regjistruese dhe z. Sh. A. me detyrë ish-regjistruese.

Lidhur sa sipër trajtuar është mbajtur Akt-Konstatimi nr. 3, datë 28.05.2019, për të cilin nuk janë paraqitur observacione në fazën e hartimit të projekt raportit të auditimit.

Observacioni i paraqitur nga ZVASHK Bulqizë nr. 661 prot datë 13.06.2019, përgjegjësi sektorit Sh. A. në lidhje me aktkonstatimin dhe projektraportin e auditimit

-Aplikimi nr.771 dt.2.7.2018,

-Konstatimi i pare,nga ana juaj per këtë dosje është se kartela është e pavulosur dhe nr. ZK të shënuara me laps,..Ne lidhje me këtë fakt arsyetojme se zona gjeografike ku ndodhet kjo pasuri nuk eshte kryer procesi i regjistrimit fillestar sistematik,regjistruesi firmos dhe vulos kartelat pas perfundimit te procedures perfundimtare te regjistrimit fillestar qe eshte afishimi publik 45-ditor.Kjo kartele e cila aktualisht ka statusin "provizore",do te firmoset dhe vuloset nga regjistruesi ne qofte se ne periudhen e afishimit nuk do te kete ankesa.Kurse shenimet me laps kane ardhur sepse nuk ishte e qarte se kujt ZK-je (aktualisht siç thame jo e azhornuar) i perkiste kjo pasuri.

-Konstatimi i dyte,nga ana juaj për këtë dosjeështë se mungojne Urdheri i Ministrit te Ekonomise Publike dhe privatizimit,Vendimi i gjykates,Statusi i shoqerise,Kontrata midis themeluesve,plan vendosja.Pas verifikimeve në arkive për këto referenca rezulton se keto dokumenta meqenese Albkromi ka patur shume prona, janë të depozituara ne nje dosje me nr.ref . 2556/5,ZK.8612 (qyteti i vjeter bulqize),dhe per arsye voluminoze nuk eshte vendosur fotokopja e tyre per çdo dosje. Bashkelidhur ketij observacioni ne ref.2556/5 ZK.8612,gjenden midis te tjerave edhe dokumentat e mesipërme që shpreheni se mungojne ne regjistrimin e pronave te "Albkrom": Urdher i ish-Ministrit [redacted] nr.99 date 15.12.1995 Akt themelimi i shoqerise dt.18.1.1996 Vendim per regjistrimin si person Juridik nr.14014 dt.29.2.1996 Statusi i shoqerise (10 flete) Ekstrakt i regjistrit Tregtar (4 flete).

Sa i përket Zerit kadastral që ju thoni se duhej të ishte "objekt" dhe jo shesh gjykojme se eshte shkruajtur ne kartele 'Shesh" bazuar ne formularin e inventarizimit,i cili eshte i firmosur dhe vulosur nga nje komision i tërë që ka bërë inventarin e aseteve te Albkromit dhe në këtë inventar jepet shumë qartëse funksioni i tij është shesh depozitim kromi...Gjithashtu vlen te permendim dhe faktin se cilesimi qe behet ne plan rilevimi si "objekt",ka kuptim të pergjithshem si psh. fjala "Aset",pra nuk perfaqson zerin kadastral, ose siç quhet edhe nje koncesion qe ne kuptimin e pergjithshem se bashku me kanalet veprat e marrjes dekantimit,sheshet,rruget etj qe perfshihen ne kete koncesion quhen me nje fjale te vetme me termin "objekt",por edhe sepse sipas rregullores 184 si dhe ligjeve 7843 dt.13.7.1994 dhe 33/2102 'Per regjistrimin e PP", plani i rilevimit është nje dokument i cili permban tregues teknik si siperfaqja, pozicioni gjeografik nëpërmjet koordinatave ,përmasat e prones,kufitaret,etj. dhe nuk eshte ekskluzivitet i ketij dokumenti lloji i pasurise...Ky tregues percaktohet nëpërmjet dokumentit ligjor siç thamë me

lart,pra formularit të inventarizimit. Por jo vetëm kaq,sepse në rregulloren 184 dt.8.4.1999 (faqja pa numer e katra nga fundi) jepet lista e plotë e Zërave kadastrale të detyrueshme për zbatim në Zyrat e regjistrimit.Në këtë listë nuk gjendet ndonjë Zë kad "objekt",dhe as ka ndonjë kartelë në të gjithe volumet që disponohen me këtë Zë kad..Kurse aty sqarohet (rregullorja), se kush quhet "shesh" ku shprehimisht në piken 12 të kesaj liste në kllapa(bashkelidhur kjo flete është pas këtij observacioni) cilësohet se me Zë kad."shesh" quhen sheshi ,parku,lulishtet,etj..I vetmi opsion ndryshe ishte qe Zeri kadastral të shkruhej "ndërtesë",por ky Zë nuk ishte i pasqyruar as në formular të inventarizimit ,as në plan rilevimi ,por perveç kesaj në rregullore zëri "ndërtesë",nuk ka hapsira për interpretime të tjera pra nuk cilesohet ne kllapa se ketu mund te futet edhe një shesh për grumbullim kromi. Përveç sa thamë më sipër,duhet të kemi parasysh dhe faktin se formulari i inventarizimit të ketyre pronave të Albkromit është bërë në kohën e daljes se VKM-se nr.346 dt.01.06.2004"për inventarizimin e pronave të albkrom",kohë në të cilen është përpiluar dokumenti i inventarizimit,në të cilin përcaktohet qartë Zëri kad,kurse plani i rilevimit është pergatitur në vitin 2012,kur ky institucion ka kërkuar regjistrimin e aseteve të tij,pra 8 vjet me vonë,kohe gjatë së ciles mund të jenë bërë ndryshime të këtij sheshi nga gjendja fillestare,si psh mund të jete rrethuar prona me mur,etj ,dhe inxhinieri privat ka bërë një dokument teknik(plan rilevimi), sipas gjendjes faktike.Por bërja e një muri rrethues nuk justifikon që ZR-ja të ndryshoje llojin e pasurisë,nga ai i përcaktuar në dokumentet ligjore.

Sqarimi i grupit të auditimit: Observacioni juaj nuk meret në konsideratë pas:
Në lidhje me plotësimin dhe administrimin e informacionit në kartelat e pasurive të paluajtshme, përcaktohen qartë në rregulloren 184 dhe udhëzimi i zyrës qendrore edhe në regjistrimet sporadike, konsiderohet i mirqënë kontrolli teknik ligjor i dokumentacionit dhe kalimi në sistemin e ri, kështuqë kartelat duhen nënshkruar dhe vulosur nga regjistruesi që të marë formën e kërkuar nga ligji, në të kundërt konsiderohet e pa vlefshme.
Ju citoni se bashkëlidhur ndodhet dokumentacioni por në fakt janë vetëm fotokopje praktikës mbi të cilën kemi dhën opinionin e mësipërm shkresa harta dhe kthim përgjigje.
Pra mungon: Në dosje mungon Urdhri i Ministrit të Financave nr. 95, datë 15.12.1995 për transfortmimin e ndërrmarrjes [redacted] në shoqëri aksjonere.
Nuk përputhet lloji pasurisë ndërmjet kontratave të shitblerjes, listës së inventareve, plan-rilevimet të subjektit në likujdim dhe hartën e punës ku janë bërë shënimet me laps Objekte dhe hedhur në të dy objekte me konture të zeza, pajisur me vërtetim hipotekor datë 11.02.2013.
Nuk përputhet zona kadastrale pasi në të është përcaktuar 2267 Krastë ndërsa në kartelë shënuar Lujcane korrigjuar me laps 3511 Krastë, por në fakt kjo zonë i takon Stavecit, indeksi hartës korrigjuar nga 183-A në 176-A. Në kontratë dhe autorizimin e Ministrit të linjës nr. 8935/4 datë 07.1.2015 është likuidator [redacted] ndërsa në genplanin e paraqitur është [redacted]. Në raport vlerësimin numër 6358/1 prot datë 22.09.2014 sipërfaqet prej 9900 m^2 dhe 1400 m^2 përcaktohen si truall dhe vlerën ndërtimore, gjithashtu mungon planrilevimi.
- Në kontratën e shitjes nr. 7774 rep. Nr. 3581 kol datë 18.11.2015 me pal shitëse "[redacted] "sha përfaqësuar likuidator [redacted], pala blerëse [redacted], objekti impiant seleksionimi 1400 m2, nuk përputhet zona kadastrale pasi në të është përcaktuar Lucne zonë e cila nuk ekziston në listën e zonave të ZVRPP Bulqizë, ndërsa në kartelë ZK 3511 korrigjuar me laps ndërsa në listë kjo zonë quhet Stavec, indeksi hartës korrigjuar nga 183-A në 176-A gjithashtu mungon planrilevimi. Në procesverbalin e ankandit datë 23.10.2015 sipërfaqja prej 1400 m2 paraqitet në llojin truall me vlerën përkatëse, pajisur me vërtetim hipotekor datë 17.01.2015. Për këto dy pasuri me sipërfaqe 9900 m2 dhe 1400 m^2 ekziston një tjetër kontrat qiraje lidhur midis "[redacted] dhe Shoqëria "[redacted]" shpk nr. 5284 rep, nr. 2316 kol, datë 14.07.2016 për në periudhë 5 vjeçare deri më datë 01.09.2021, ku në pikën 13 të kontratës parashikohet se ndryshime ose shtesa të kontratës janë të vlefshme vetëm në rast se bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga të dy palët, pra mes këtyre palëve nuk ka akt të nënshkruar dhe pëlqim nga qiramarrësi për shitjen e kësaj prone dhe të drejtave reale tek pala blerëse [redacted]

7. Mbi përputhshmërinë e aktivitetit financiar. Përdorimi efektiv i fondeve të buxhetit. Shkaqet e tejkalimeve dhe mosrealizimeve. Shkaqet e tejkalimeve dhe mosrealizimeve. Njerrja e përgjegjësive për deviacionet. Rakordimet që janë kryer me degën e thesarit për arkëtimet nga legalizimet. Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë marrdhëniet e punës(Pagat dhe shpërblimet). Administrimi, ruajtja, dokumentimi dhe qarkullimi i aseve dhe aktiveve. Prokueimet i fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime.

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje përputhshmërisë dhe aktivitetit financiar, organizimin e subjektit, kuadri ligjor i përdorur mbi sistemin dhe procesin kontabël, kompjuterizimi, mbi raportimin e pasqyrave financiare për gjendjen e subjektit, llojet e shërbimeve të kryera prej tij, llojet e transaksioneve dhe sistemet e konrollit që funksionojnë, përdorimitn efektiv të fondeve buxhetore, rakordimet me degën e thesarit, zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë mardhëniet e punës dhe pagat, administrimin, ruajtjen, dokumenttimin dhe qarkullimin e aseteve dhe aktiveve, prokurimin e fondeve publike për mallra, ndërtime e shërbime nga subjekti Zyra vendore Regjistrimit Pasurisë Palujtshme Bulqizë, në bazë të programit të auditimit nr. 207/1, datë 01.04.2019, pika 7-të për periudhën 01.01.2017 deri me datë 31.12.2018 u konstatua :
Zyra Vendore e Pasurisë Palujtshme Bulqizë e ka kryer veprimtarinë e saj për ***vitet 2017 e 2018 organizuar si një njësi e varësisë nga Zyra Qendrore e Pasurisë Palujtshme Tiranë,*** ndërsa Pasqyrat Financiare të përgatitura nga ZVRPP Bulqizë janë pjesë e bilancit të konsoliduar të të gjithë Sistemit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe janë miratuar nga ZQRPP(Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme), përkatësisht sipas ***shkresës nr. 2246/30 prot datë 30.03.2018.***
Auditimi është fokusuar në dy drejtime kryesore*:në dy drejtime kryesore*
a) Mbi organizimin dhe mbajtjen e Kontabilitetit, azhornimin, regjistrimet kronologjike të transaksioneve në ditar dhe librat e kontabilitetit. Bilanci kontabël dhe dhënia e opinionit për saktësinë dhe vërtetësinë e posteve të tij dhe pasqyrave financiare.
b) Analiza e gjendjes dhe dinamikave të debi-kredive. Rakordimi i llogarive sintetike e analitike.
Nga auditmi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, sipas auditimit të pasqyrave financiare pasqyrave finaciare të vitit 2017 dhe 2018 konstatohet se në ***Zyrën Vendore të ASHK Bulqizë (ish-ZVRPP)***
-Kontabiliteti i subjektit mbahet në formë manuale jo me program, regjistrime me dore dhe veprimet rezultojnë të jenë regjistruar në kontabilitet, në mënyrë kronologjike e sistematike, në ditar dhe llogaritë përkatëse.
-Pasqyrat financiare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri gjendjen financiare dhe pasurore dhe janë evidentuar e paraqitur në përputhje me standardet kontabile, ka analizë të debi-kredive për çdo regjistrim është shkruar origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimeve ekonomike ose të ngjarjes. Mbahet cikli kontabël si: hapja e librave (regjistrimi në ditar dhe në librin e madh), përqëndrimi i dokumentave justifikues, analiza e fakteve kontabile, regjistrimi në ditar i dokumentave justifikues, mbartja e regjistrimeve nga ditari në librin e madh, hartimi i bilancit vërtetues, kryerja e inventarizimeve, regjistrimet për përcaktimin e rezultatit, hartimi i bilancit përfundimtar.
Struktura e llogarive e hartuar dhe veprimet janë kryer mbi bazën e standardeve kombëtare të kontabilitetit, të miratuar me VKM nr. 783, datë 22.11.2006, "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël" dhe VKM nr. 248, datë 10.04.1998, "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001, konform ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, Udhëzimit nr.10, datë 27.02.2008, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, vendore dhe

njësitë që varen prej tyre si dhe njësive të zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj", i ndryshuar.

Analiza totale e bilancit dhe pasqyrave financiare. Gjendja e debi-kredive, ecuria, dinamika dhe masat e marra për uljen e tyre.

Nga auditimi dhe analiza totale e pasqyrave financiare dhe i gjendjes se debi-kredive u krye për dy periudhat e raportimit financiar, periudha nga 01 janar 2017 deri 31 dhjetor 2017 dhe periudha 01 janar 2018 deri 31 dhjetor 2018 dhe nga auditmi u konstatua:

Për vitin 2017.

Pasqyrat financiare janë të plotësuara sipas standardeve kombëtare të kontabilitetit, planit kontabël dhe Udhëzimit te Ministrise së Financave nr. 23 date 22.12.2017 "Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2017". Bilanci është hartuar nga specialisti i financës ***z.Alfred BALLA dhe është miratuar nga ZQRPP (Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme), sipas shkresës nr. 2246/30 prot datë 30.03.2018.***

Vlera kontabile e aktiveve qëndrueshme të trupëzuara për ***4,258,935 lekë,*** e paraqitur në Bilanc rezulton e rakorduar me gjendjen e inventarit të fundit të vitit më datë 31.12.2017, bërë me komision sipas urdhrit për ngritjen e tij nr. 108, datë 15.12. 2017 në zbatim të nenit 6, germa "e" e ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Për menaxhimin Finaciar dhe Kontrollin dhe Udhëzimit nr. 30, date 27.12.2011 "Per menaxhimin e Aktiveve të në Njësitë e sektorit Publik.

Amortizimi rezulton të jete llogaritur në përputhje me normat e amortizimit sipas legjislacionit në fuqi ***VKM nr, 401, datë 23.10.1989*** për ***Llog.212"Ndërtime e Konstruksione"me 1% të vleres prej 3,693,541 lekë, Llog. 214 "Instalime teknike,makineri, pajisje, vegla pune me 25% të vlerës 902,415 lekë dhe Llog.218 "Inventar ekonomik me 3% të vleres prej 1,129,817 lekë, në total llogaritur në vlerën prej 1,466,838 lekë sikurse evidentuar në Bilanc,*** sipas pasqyrave të llogaritjes amortizimit me komision.

Aktivet qarkulluese sipas Bilancit evidentohen në vlerën ***723,620 lekë.***

Nga e cila :

Klasa 3-"Gjendje inventari" në bilanc evidentohet në vlerën ***92,452 lekë,*** e rakorduar me gjendjen e inventarit të fundit të vitit më datë 31.12.2017 bërë me komision sipas urdhrit për ngritjen e tij nr. 108, datë 15.12. 2017 në zbatim të nenit 6, germa "e" e ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Për menaxhimin Finaciar dhe Kontrollin dhe Udhëzimit nr. 10, date 27.12.2011 "Për menaxhimin e Aktiveve të në Njësitë e sektorit Publik.

Klasa IV-të II.Kërkesë arkëtimi mbi debitorët, paraqitet në vlerën 556,001 lekë nga e cila Llog. 4342 " Të tjera operacione me shtetin (debitor) në vlerën ***203,501 lekë,*** e cila përfaqëson detyrimet e shtetit dhe llogaria dhe ***Llog. 468 "Debitore të ndryshëm"*** në vlerën ***352,500 leke,*** të kuadruara me analizën e llogarive.

Klasa V-të-III-Llogaritë financiare, paraqiten në vlerën ***75,167 lekë.***

TOTALI I PASIVIT me 31.12.2017, paraqitet në vlerën ***4,982,555 lekë*** e cila përbëhet nga:

A.Fonde të veta paraqitet në vleren ***4,351,387 lekë***, shumë e cila përfaqëson ***Llog.101 "Fondet bazë"*** po në të njejtën vlere.

B.Detyrimet në vlerën ***631,160 lekë*** e cila përbëhet nga ***llogarite e klasës 4 shumat e së cilës*** rakordojne me analizat e llogarive përkatëse evidentuar në pasqyrat bashkëlidhur pasqyrave të Bilancit.

Shpenzimet e ushtrimit të vitit 2017, përfaqësohen nga ***shpenzimet e shfrytëzimit (I-III)- klasa 6,*** që në shumë totale janë ***3,732,467 lekë*** të klasifikuara sipas zërave perkatës me analiza t perkatëse.

Klasa 7-Të ardhura të shfrytezimit (I-VI), për vitin 2017, sipas të dhënave të paqyrave financiare evidentohen në vlerën ***6,736,821 lekë,*** dhe përfaqëson llogaritë e klasave 7 dhe 8(totalin e operacioneve për vitin 2017), mbasi gjatë vitit 2017 nuk ka kryerje të veprimeve në llogaritë 82-84.

Duke analizuar të dhënat e evidentuara në pasqyrat financiare, saktësinë dhe vërtetësinë e tyre bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion për veprimatrinë e kryer gjatë vitit 2017 u konstatua:

-Vlera totale e aktivit për vitin 2016 dhe 2017 përkatësisht në vlerat 5,321,242 dhe 4,982,555 është e njejtë me vleren e pasivit të kuadruara.

Vlerat e llogarive të paraqitura në postet e bilancit kontabël të krahasuara me informacionin që jepet në pasqyra, anekse, formati 4, për shpenzimet dhe burimet për investime (nuk rezulton të ketë shpenzime proces për transferime kapitale), ***formati 5 për lëvizjen Cash kuadron me situacionet e shpenzimeve për vitin 2017,*** për fondet nga buxheti dhe shpenzimet e thesarit, me formatin 3/2 "Të ardhura të ushtrimit" për të ardhurat tatimore dhe jo tatimore dhe transferuar, dhe formatin 8, për lëvizjen e fondeve. Totali i shpenzimeve për paga personeli të përhershëm e të përkohshëm (pasqyra 3/1 në postet përkatëse) është i barabartë me totalin e fondit të pagave në pasqyrën e punonjësve dhe të fondit të pagave (kolona 5, formati 9).

Amortizimi i aktiveve qëndrueshme të trupëzuara është llogaritur sipas normave të amortizimit të përcaktuara në VKM nr. 401, datë 23.10.1989. Në kontabilitet, ai është pasqyruar në pasiv të bilancit si fond dhe në aktiv si pakësim të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara e rakorduar kjo shumë, me formatin 7 të pasqyrës së bilancit.

Për vitin 2018.

Nga auditimi i bilancit dhe pasqyrave financiare të vitit 2018 të hartuar për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2018, të subjektit Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Bulqizë, rezultoi se pasqyrat financiare janë të plotësuara sipas standardeve kombëtare të kontabilitetit, planit kontabël dhe Udhëzimit te Ministrise Udhëzimit te Ministrise së Financave nr. 8 date 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit te pasqyrave financiare në njësitë vendore e të përgjithshme", (pika 26).

Pasqyrat Financiare janë hartuar nga specialisti i financës ***z.A. B.***dhe dërguar për miratim ZQRPP (Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme), ***sipas shkresës nr. 819, prot datë 20.02.2019, dhe miratuar nga ZQRPP sipas shkresës nr. 1623, date 11.04.2019*** me të dhënat si mëposhtë:

Aktivet Afat Shkurtra evidentohen në vlerën 6, 001.688 **lekë,** e cila përbëhet nga:

Klasa 21-Aktive të qëndrueshme, Klasa V-Mjete monetare, ekuivalent i tyre, Klasa III-Gjendje Inventarit Qarkullues, Klasa IV-të Llogari të Arkëtueshme(që përbëhet nga llogaria 468-Debitorë të ndryshëm dhe 4342-Operacione me shtetin)

Sipas të dhënave në pasqyrat financiare të vitit 2018 Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara, që janë paraqitur me vlerën kontabile në shumën ***4,596,770 lekë rezultojnë të rakorduara*** me gjendjen e inventarit më datë 31.12.2018 nëshkruar nga komisjoni i inventarizimit ngritur nga ish-ZVRPP sipas urdhrit nr. 97, datë 21.12.2018.

Amortimi është llogaritur sipas pasqyrave të komisioni të ngritur për një vlerë gjithsej ***2,184,275 (363,813+1,466,838)*** dhe sipas udhëzimit ***nr. nr. 8 date 09.03.2018 "Për procedurat e pergaditjes, paraqitjes dhe raportimit te pasqyrave financiare ne njësite vendore e te pergjithshme", (pika 26),*** konstatohet se vlera e aktiveve është paraqitur ***me vlerën neto,*** në zbatim të këtij udhëzimi për njësitë e qeverisjes së Përgjithshme. Në rastin konkret për vitin 2018 vlera aktiveve ***6, 001.688*** **lekë** e cila paraqet vleren neto.

Inventari Qarkullues evidentohet në vlerën ***141,313*** që përbëhet nga ***Klasa 31 –Materiale dhe Klasa 32-Inventari imët dhe shumat e tyre rakordojnë*** me inventarin e datës 31.12.2018, nëshkruar nga komisjoni I inventarizimit ngritur nga ZVRPP me nr, 97, datë 21.12.2018.

Klasa IV- Llogari të Arkëtueshme evidentohen në vleren 789,327 lekë që perbëhet nga ***llog. 4342 " Të tjera operacione me shtetin (debitor) në vlerën 436,827 lekë, dhe llog.468 "Debitore te ndryshem"*** në vlerën ***352,500 leke,*** vlerë e cila kuadron me analizen e kësaj llogarie dhe i përket firmës "Alba Marmi" për detyrimin ***352,500 lekë*** si detyrim i mbartur nga vitet e mëparshme.

TOTALI I PASIVIT me 31.12.2018, paraqitet në vlerën ***6,001,688 lekë, e cila*** përbëhet nga ***Fondet e veta në vlerën 4,738,083 lekë (A-B 6,001,688 lekë-1,263,605 = 4,738,083 lekë),*** vlerë e cila përfaqëson ***Llog.101 Fondet bazë*** në të njëjtën vlerë ***4,738,083 lekë.***

C.Detyrimet në shumën 1,263,605 lekë e cila përfaqësohet nga llogarite e klasës 4, llogaritë 401-408(Furnitorë), 420(personeli, 431(Detyrime tatim-taksa), 4341(të tjera op[eracione me shtetin), 436(Sigurime shëndetësore), 435(sigurime shoqërore) dhe llogaria 45 "Mardhënie me institucinet brenda dhe jashtë sistemit) dhe vlerat e tryre rakordojnë me analizat e llogarive perkatëse.

Shpenzimet e ushtrimit te vitit 2018, përfaqësohen nga shpenzimet***(B) Klasa 6*** në vlerën gjithsej ***4,777,777 leke,*** që i përket zërave sipas llogarisë 60(shpenzime korente që është e barabartë me shpenzimet e shfrytëzimit), që perbëhet nga llogaria 600, 601, 6001,6010, 602,6020,6022, 0024 dhe llogaria 63(ndryshimi e gjendjeve me minus.

Të ardhurat(A)-për vitin 2018 përfaqësohen nga të ardhurat (A)Klasa 7 dhe evidentohen në vlerën ***4,777,777 lekë,*** të cilat përbëhen nga ***llogaria 702*** "Tatim mbi pasurinë", ***nga llogaria 711***"Shërbimet administrative dhe të ardhura sekondare", që përfaqësohet nga ***llog 7111*** "Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh" në vlerën neto ***4,063,269 lekë që rezulton nga diferenca e të ardhruave të realizuar sipas akt-rakordimit progresiv Janar –dhjetor 2018 evidentuar në vleren 5,182,400 lekë + 556,000 (transsfertë e dëguar nga ZQRPP) dhe gjithsej evidentohet në vlerën prej 5,738,400 lekë, së ciles zbritet vlera 1,675,131(transferta të realizuara për ZQRPP) dhe rezulton e ardhur neto e realizuar e vitit raportues në vlerën 4,063,269 sikurse evidentohet në pasqyrat financiare, llog 7115 "Gjoba dhe kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime" në vlerën 527,400 lek(Aplikim me vonesë për regjisrime me vonesë VGJ, dëshmi trashëgimie dhe AMTP)*** dhe "Grantet" korente", ***klasa 72,*** në vlerën ***233,326 lekë,*** e cila i përket zërit "grant korent i brendshem" nga NJQP ***-llog 720,*** është rezultat i diferencës ***llog.7205*** në vlerën ***436,827 lekë*** "Finacim shtesë për të ardhurat e krijuara Brenda sistemit që përfaqëson detyrimet e muajit dhjetor 2018, të kaluara në muajin Janar 2019, ndërsa të tjera ***llogaria 7020-*** perfaqëson grande korente në ***vlerën 203,501***(detyrim i muajit Dhjetor 2017 kaluar në janar 2018.

Totali i te ardhurave gjithesej 6,149,270 leke, përfaqëson Llog klasave 7-8(totalin e operacioneve për vitin 2018), mbasi gjatë vitit 2018 nuk janë kryer veprime në ***llog 82.84,*** mbasi ato nuk evidentohen në bilancin e vitit 2018, bazuar ***në udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 dhe sqarimet pëkatëse të degës thesarit, mbasi të dhënat e periudhës raportuese paraqiten në vlerën neto.***

Sipas aneksit nr. 4, të Bilancit, " Shpenzimet për investime dhe Burimet për investimet", për vitin ushtrimor 2018, ***nuk rezulton të ketë teprica në çelje dhe as veprime ne debi*** për transanksione, ***mbasi bilanci i konsoliduar përpilohet nga ZQRPP*** dhe invesimet ndiqen dhe evidentohen në Pasqyrat finaciare përpiluar nga ZQRPP.

Nga analiza e bërë bilancit të vitit 2018, rezulton si më poshtë:

Totali i aktivit është i barabartë me totalin e pasiveve të bilancit kontabël për vitin ushtrimor dhe për ushtrimin e mëparshëm.

Totali i pasiveve të shpenzimeve 3/1 për ***4,777,777 lekë*** është i barabartë me totalin e pasqyrës së të ardhurave të funksionit, formati 3/2 nnë vlerën ***4,777,777 lekë*** të analizuara si më lart. Vlerat e e llogarive të paraqitura në postet e bilancit kontabël korespondojnë me informacionin që jepet në pasqyra, anekse, formati 4 për shpenzimet dhe burimet për investime (nuk ka shpenzime proces për transferime kapitale), formati 5 për lëvizjen Cash kuadron me situacionet e shpenzimeve për vitin 2018 për vlerën prej ***474,278 lekë***(tepricë e likujditeteve në fund të vitit ushtrimor Totali i shpenzimeve për paga personeli të përhershëm e të përkohshem ***3,627,470 (pasqyra 3/1 në postet përkatëse)*** është i barabarte me totalin e fondit te pagave në pasqyrën e nr. të punonjesve dhe të fondit të pagave (kolona5, formati 9).

Amortizimi i aktiveve qëndrueshme të trupëzuara është llogaritur sipas normave të amortizimit të përcaktuara në VKM nr. 401, datë 23.10.1989. Amortimi është llogaritur sipas pasqyrave të komisioni të ngritur për një vlerë gjithsej ***2,184,275 (363,813+1,466,838)*** dhe sipas udhëzimit

nr. 8 date 09.03.2018 "Për procedurat e pergaditjes, paraqitjes dhe raportimit te pasqyrave financiare në njësitë vendore e të përgjithshme", (pika 26), konstatohet se vlera e aktiveve është paraqitur me vlerën neto, në zbatim të këtij udhëzimi për njësitë e qeverisjes së Përgjithshme. Në rastin konkret për vitin 2018 vlera aktiveve paraqet vlerën neto.

Mbi Organizimin dhe Mbajtjen e Kontabilitetit, mbi gjendjen e Debi-Kredive.

ZVRPP Bugizë është e organizuar dhe funksionon si njësi e varësisë nga ZQRPP nga e cila miratohet buxheti për nevojat e kësaj zyre.

Kjo zyrë ka vijuar aktivitetin në vitin 2017 me strukturë prej 5 punonjes me një fond 2,942,422 lekë nga të cilët 1 drejtues, 3 specialist me arsim të Lartë dhe nje punonjës teknik, ndërsa për vitin 2018 ZVRPP struktura përbëhet nga 6 punonjës me një fond prej ***3,627,470 lekë*** nga të cilët, 1 drejtues dhe 5 specialistë. ***Emërimi dhe percaktimi i nivelit të pagave rezulton të jetë miratuar nga ZQRPP me shkresat perkatese.***

Sipas dokumentacionit në lidhje me zbatimin e proçedurave të prokurimit publik me vlerë të vogël në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik"***është konstatuar që, për vitin 2017-2018 të jenë kryer 5 proçedura prokurimi me një vlerë nën 100,000 lekë në çdo rast që rezultojnë të jenë parashikuar në buxhetin e miratuar per ZVRPP Bulqizë.***

Nga autoriteti Kontraktor janë zhvilluar 5 proçedura prokurimi me vlerë të vogël gjithsej në vlerën 338780 lekë dhe nuk janë konstatuar mangësi në plotësimin e dokumentacionit.

Për vitet 2017 dhe 2018 rezulton të jenë kryer inventaret fizik me komisjone të ngritura sipas urdhrit nr, 97, datë 21.12.2018 dhe urdhrit nr. 108, datë 15.12. 2017, ***në zbatim të nenit 6, germa "e" e ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Për menaxhimin Finaciar dhe Kontrollin dhe Udhëzimit nr. 30, daë 27.12.2011 "Për menaxhimin e Aktiveve të Njësive të sektorit Publik dhe nuk kanë rezultuar diferenca,***

Në vijim të auditimit të Pasqyrat financiare të plotësuara nga subjekti nga ZVRPP Bulqizë për vitet 2017 dhe 2018 në lidhje me hartimin e pasqyrave financiare rezulton të jenë zbatuar standardet e kolntabilitetit bazuar në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, VKM nr.783, datë 22.11.2006, "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël", UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për proçedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare e vjetore në Njësitë e Qeverisjes Pergjithshme dhe Udhëzimit nr. 39, datë 24.12.2018 "Për proçedurat e mbylljes së llogarive vjetore të Buxhetit" për vitin 2018, pika 34 dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se,veprimet janë të regjistruara në kontabilitet, në mënyrë kronologjike e sistematike manuale, Janë bërë regjistrimet në ditar dhe në llogari i të gjithë veprimeve dhe fakteve ekonomike.

Pasqyrat financiare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri gjendjen financiare dhe pasurore dhe janë evidentuar e paraqitur në përputhje me standardet kontabile, ka analizë të debi-kredive. Për çdo regjistrim është shkruar origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimeve ekonomike ose të ngjarjes.

Sikurse evidentohet më siper arrihet në konkluzionin që:

Veprimtaria e këtij subjekti ështe kryer bazuar në buxhetet e derguara nga ZQRPP sipas ***shkresave nr. 16, datë 05.01.2017, per buxhetin e vitit 2017 në vlerën 5,204 mijë lekë dhe 9131, datë 29.12.2017, per buxhetin e vitit 2018 në vlerën 5,077 mijë lekë, duke planifikuar vetem shpenzime per paga dhe shpenzime operative.***

- Është mbajtur kontabilitet, është bërë hapja e librave (regjistrimi në ditar dhe në librin e madh), është bërë përqëndrimi i dokumentave justifikues, analiza e fakteve kontabile, janë bëre regjistrimet në ditar të dokumentave justifikues, janë kryer veprimet e mbartjes së regjistrimeve nga ditari në librin e madh, përpiluar Bilanci, janë kryer inventarizimet, janë kryer regjistrimet për shpenzimet dhe të ardhurat si njësi e varesisë, hartuar bilanci përfundimtar nga ish-ZVRPP Bulqizë si Njësi e Qeverisjes së Përgjithshme në varësi të ish-ZQRPP e cila përpilon dhe Bilancin

Përfundimtar Përmbledhës të Konsoliduar bazuar në ligjin për kontabilitetin ***nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" me ndryshimet e mëvonshme, UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për proçedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare e vjetore në Njësitë e Qeverisjes Pergjithshme dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".***

Gjatë auditmit nuk u konstatuan shkelje standardesh, apo dispozitave ligjore përsa i perket shpenzimeve të kryera sipas sipas të dhënave të llogarisë 602 dhe dhe shpenzimeve per paga apo evidentimin dhe xhirimin e te ardhurave subjektit në qender(ish-ZQRPP), të dhënat e pasqyruara në pasqyrat financiare janë të drejta, të sakta dhe nuk ka devijacione apo mashtrime në të dhëna për sa është audituar.

(Trajtuar në aktkonstatimin e mbajtur me nr. 16, datë 31.05.2019 dhe Projektraportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 737/1, datë 04.07.2019 dhe protokolluar në KLSH me nr. 207/3, datë 08.07.2019).

Gjetje nga auditimi pika 7(Aktkonstatimi nr. 16, datë 31.05.2019).

Gjetje nga Auditimi: Zyra vendore ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë në pasqyrat finaciare të vitit 2017 dhe 2018 evidentohet nje vlere debitore prej ***352500 lekë*** sipas llogarisë ***468 "Debitore te ndryshem"*** vlerë e cila kuadron me analizen e kesaj llogarie dhe i përket firmës "Alba Marmi" por nuk argumentohet çfar detyrimi është. Ky detyrim ekziston i mbartur në vite, por nuk është arkëtuar për shkak të mungesës së adresës të subjektit [redacted] ***" shpk.***

Rekomandimi: Zyra vendore ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë, ***Përgjegjësi i Zyrës*** të marë masa për arkëtimin e detyrimit duke kërkuar adresën e subjektit në Drejtorin Rajonale Tiranë ku është i regjistruar dhe zhvillon aktivitet subjekti, duke i bërë me dije detyrimin e subjektit ndaj ***Zyrës Vendore të ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë.***

8. Të ndryshme dhe trajtimi i indiceve të ardhura nga qytetarë në KLSH

Bazuar në kërkesë-ankesën e qytetarit [redacted] Njësia Administrative Shupenzë –Bulqizë protokolluar në KLSH me nr. 318, datë 13.05.2018, në lidhje me regjistrimin e pasurisë në favor të [redacted] nr. 200/2, datë 12.03.2018, zona kadastrale 3444-Shupenzë në mënyrë abuzive nga ZVRPP sipas dokumentacionit të paraqitur së bashku me vendimin të Bashkisë u auditua dokumentacioni i regjistrimit të kësaj pasurie dhe në përfundim rezultoi se kjo pasuri është regjistruar në shkelje të VKM nr. 608, datë 05.09.2012 duke mos u zbatuar proçedurat e percaktuara në VKM nr. 608, datë 05.09.2012, në papajtueshmëri me pikën "iii" shkronjës "b" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

Pasuria 200/2, v. 1, faqe 37 është regjistrruar pa u plotësuar urdhër për regjistrim nga ish-Regjistruese D. H.. Nuk ka HTR Provizore nga ZVRPP. Në KPP nuk ka nënshkrime për lëshimin e certifikatës.

Nuk disponohet nga subjekti asnjë lloj dokument pronësie sikurse leje sheshi, preventiv, situacion, aktdorëzimi, aktkontroll punimesh, e dokumentacion, si dhe dokument që provon pronësinë e truallit të asaj kohe sipas ligjit të urbanuistikës nr. 7693, datë 07.06.1993 dhe nuk disponohet akt fitimi pronësie si leje ndertimi apo KSHB.

Nuk janë zbatuar afatet, nuk ështtë evidentuar fakti i publikimit 45 ditor.

Sipas vendimit të gjykatës së rrethit Gjyqësor Bulqizë me nr. 60, datë 18.06.1998 me kërkues [redacted] dhe palë e interesuar Komuna Shupenzë me objekt: ***Vërtetim Fakti Juridik rezulton*** se objekti(lokal) ***ka përfunduar së ndertuari në vitin 1993.*** Ky objekt rezulton të jetë përdorur nga kërkuesi për prodhim varrezash dhe gjykata ka çmuar ***që ti njihet pronësia me vërtetim fakti juridik që siperfaqe 3 faqe anësore dhe 1/3 e faqes nga jugu që evidenton një objekt me tre faqe muri dhe pa mbulesë, në kundërshtim me shkronja "a" të pikës 4 të VKM 608, datë 05.09.2012.***

- Nuk rezulton të ketë dokument zyrtar nga Pushteti Vendor që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991, ***në kundërshtim me pikën 5 të VKM nr. 608, datë 05.09.2012***.

Dokumentacioni i dosjes dërguar në ZVRPP është fotokopje dhe nuk ka vulat dhe firmat nga Bashkia për njesimin e dokumentacionit, ***në kunddërshtim me procedurat e përcaktuara nga VKM 608, datë 05.09.2012, pika 8.*** Sikurse evidentohet nga subjekti kërkues dhe Bashkia nuk është plotësuar dokumentacioni në zbatim të VKM nr. 608, datë 05.09.2012, duke regjistruar pasurinë duke regjistruar pasurinë në kundërshtim me dispozitat ligjore të këtij vendimi.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:
në kërkesat e neneve 24-25 të ligjit 33/2012 "Për Regjistrimin e pasurisë së Palujtshme",
VKM nr. 608, datë 05.09.2012 dhe shkresën nr. 5400/3, date 20.09.2012 "Për zbatimin e VKM 608, datë 05.09.2012 "Për përcaktimin e proçedurës së Kalimit të Pronësisë të Pasurive të Palujtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre , kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre". Kjo pasuri nuk duhet të ishte perfituar sipas me VKM nr. 608, datë 05.09.2012, ***mbasi nuk ka dokumentacion që provon që ky objekt figuron i ndertuar para datës 10.08.1991 dhe nuk ka asnjë lloj dokumenti zyrtar që provon këtë.*** Kjo pasuri është perfituar në mënyre abuzive si për truallin edhe ndërtimin, për të cilën mbajnë pergjegjësi punonjesit e ***ish-ZVRPP dhe të Bashkisë Bulqizë***.

(Trajtuar në aktkonstatimin e mbajtur me nr. 20, datë 31.05.2019 dhe Projektraportin e auditimit pika 5 e programit, dërguar me shkresën nr. 737/1, datë 04.07.20192019 dhe protokolluar në KLSH me nr. 207/3, datë 08.07.2019).

<u>Gjetje nga auditimi 8</u>: Nga Zyra Vendore e ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes të pasurisë, për pasurië ***200/2, v.1, faqe 37 me sipërfaqe trualli 80 m2 dhe ndërtim 48.95 në emër të*** [redacted] duke mos u zbatuar proçedurat e percaktuara në ***VKM nr. VKM 608, datë 05.09.2012,*** në papajtueshmëri me pikën "iii" shkronjës "b" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

Nuk disponohet nga subjekti asnjë lloj dokument pronësie sikurse leje sheshi, preventiv, situacion, aktdorëzimi, aktkontroll punimesh, e dokumentacion, si dhe dokument që provon pronësinë e truallit të asaj kohe sipas ligjit të urbanuistikës nr. 7693, datë 07.06.1993 dhe nuk disponohet akt fitimi pronësie si leje ndertimi apo KSHB. Objekti i ndertuar sipas vërtetimit të faktit juridik nr. 60, datë 18.06.1998 me kërkues [redacted] ka perfunduar në vin 1993, dhe nuk ka lidhje me ndertimin para datës 10.08.1991, ***në kundërshtim me shkronja "a" të pikës 4 të VKM 608, datë 05.09.2012.***

- Nuk rezulton të ketë dokument zyrtar nga Pushteti Vendor që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991, ***në kundërshtim me pikën 5 të VKM nr. 608, datë 05.09.2012***.

Dokumentacioni i dosjes dërguar në ZVRPP është fotokopje dhe nuk ka vulat dhe firmat nga Bashkia për njësimin e dokumentacionit, në kunddërshtim me procedurat e përcaktuara nga ***VKM 608, datë 05.09.2012, pika 8.*** Sikurse evidentohet në dosje nga subjekti kërkues dhe Bashkia nuk është plotësuar dokumentacioni në zbatim të VKM nr. 608, datë 05.09.2012, ***në kundërshtim me kërkesat e neneve 24-25 të ligjit 33/2012 "Për Regjistrimin e pasurisë së Palujtshme".***

Rekomandim: Nga KLSH ti kthehet përgjigje ankuesit [redacted] kundrejt kërkesë-ankesës së protokolluar në KLSH me nr. ***nr. 318, datë 13.05.2018,*** duke e vënë në dijeni në lidhje me shkeljet e konstatuara nga KLSH dhe për rekomandimet drejtuar insitucioneve përkatëse në lidhje me regjistrimin e ***pasurisë 200/2, në emër*** [redacted]

2- ankesë e qytetarit [redacted]**,** fshati Shupenzë, Bashkia Bulqizë

Në lidhje me trajtimin dhe orientimin e ankesave të bëra nga qytetarët, të drejtat reale dhe regjistrimin apo mos regjistrimin në përputhje apo kundërshtim me ligjin pran KLSH kanë ardhur një sur ankesash/kërkesa si trajtuar më poshtë:

Me date 01.10.2017 është depozituar denoncim për përvetim prone toke shtet ne fshatin Shupenzë Bashkia Bulqizë 2100 m^2 ne ZK 3444.
Denoncimi bazohet ne dokumenta e paraqitura nga denoncuesi si më poshtë:
1. Vendim nr. 147 datë 17.12.1996 për kthim dhe kompensim pronash, Genplani (kopje).
2. Vërtetim nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës Këshilli i Qarkut Dibër datë .13.04.2013 (kopje)
3. Vërtetim Këshilli i Rrethit Bulqizë dt. 03.14.1994 e noterizuar dt. 18.09.1995 (kopje)
4. Kërkesë drejtuar ZVRPP Bulqizë dt .14.04.2017 Informacion statusi juridik (kopje)
5. Vërtetim Komuna Shupenzë dt. 27.02.2009 (kopje)
6. Deklaratë banorëve te fshatit Shupenzë dt. 09.04.1994 (kopje)
7. Vendim Gjykata e rrethit Bulqizë objekt lëshimi i dëshmis së trashigimis dt. 14.06.2000 (kopje)
8. Deklaratë me shkrim dore nga ekspert te pyetur nga gjykata , dt. 21.12.2000 (kopje)
9. Deklarat Personale dt. 19.09.2015(kopje)
10. Vendim Gjykata e rrethit Bulqizë dt. 26.12.2000 (kopje)
11. Proces Verbal dt. 09.12.2001 (kopje)
12. Vërtetim nga dokumentat hipotekor Zvrpp Bulqizë dt. 15.02.2001 (kopje)
13. Vendim Gjykata e rrethit Dibër dt. 14.11.2008 (kopje)
14. Vendim Gjykata Dibër për kthim padie dt. 15.04.2009 (kopje)
15. Vendim Gjykata e rrethit Diber dt .28.01.2016 (kopje)
16. Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit të Teritorit Bashkia Bulqizë lënda Pezullim deklarate paraprake dt 30.05.2017 (kopje)
17. Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit te Territorit Bashkia Bulqizë lënda Heqja e Pezullim deklarate paraprake dt 16.08.2017 (kopje)
18. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes se Territorit lënda: për informacion nr1684/4 dt 13.09.2017
19. Proces verbal për konstatim kundërvajtje Bashkia Bulqizë e noterizuar dt .18.09.2017 (kopje)
20. Agjencia Shtetërore e Kadastrave Tirane Kthim përgjigje Z. [redacted] për dijeni ZVRPP Bulqizë.
Në ASHK është paraqitur dhe administruar ne Nr. 2552 Prot., date 26.03.2018, k rkese e shtetasit [redacted], i cili paraqet denoncim ne lidhje me Vendimin nr. 147, dt. 17.12.1996 te K.K P Bulqizë dhe ne favor te trashëgimtareve [redacted]
Nga ana e shtetasit [redacted] informohemi se, nga ana e tij është iniciuar kallëzim ne prokurori si dhe është vijuar me trajtim te çështjes pranë Gjykatës se Shkalles se Pare te Rrethit Dibër, si dhe në Gjykatën e Apelit. Gjithashtu nga shqyrtimi i shkresës Nr. 3446/Prot, date 11.09.2017, rezulton të jetë e regjistruar pranë Gjykatës se Larte, për trajtim gjykimi civil me pale [redacted] ne cilësinë e palës se paditur dhe [redacted] në cilesinë e palës paditëse, me objekt: Detyrimin e te paditurit te liroje e dorëzoje truallin si dhe te paguaje te ardhurat nga përdorimi i sendit".
Sa me sipër, çështja është për hetim ne Prokurorinë e Rrethit Dibër, dhe ne proces gjyqësor me pale z. [redacted], për zgjidhjen e mosmarrëveshjes të parashtruar, dhe gjykimi i mësipërm civil, ka te njëjtët pale dhe objekt me këtë procedim administrativ te iniciuar nga ana e z. [redacted]
Për problemat e trajtuar më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr. 1, datë ***27/05/2019***

Observacioni i paraqitur nga ZVASHK Bulqizë nr. 661 prot datë 13.06.2019, përgjegjësi sektorit Sh. A. në lidhje me aktkonstatimin dhe projektraportin e auditimit
Ne lidhje me ankuesin [redacted],kundër [redacted] fshati Shupenze,siç del nga pershkrimi juaj çeshtja është në prokurori,kurse ankesa e tij,në menyre të përmbledheur nuk ka të bëjë me veprimet e Zyrës tonë ,por me pakenaqësitë e Z. [redacted],në lidhje me Vendimin nr.147 dt.17.12.1996 të ish KKKP-Bulqizë,ku sipas Z. [redacted] ,ky vendim i ka dhënë padrejtesisht [redacted] ,nje pronë e cila sipas [redacted] nuk ka qenë [redacted] por prone publike dhe siç thamë me siper çeshtja është nëhetem te prokurorise.

Sqarimi i grupit të auditimit: Observacioni juaj nuk meret në konsideratë pasi:
Sa me sipër, çështja është për hetim ne Prokurorinë e Rrethit Dibër, dhe ne proces gjyqësor me pale z. [redacted], për zgjidhjen e mosmarrëveshjes të parashtruar, dhe gjykimi i mësipërm civil, ka te njëjtët pale dhe objekt me këtë procedim administrativ te iniciuar nga ana e z. [redacted].

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1- Gjetje: ZVRPP Bulqize në **1 rast**, me referencës nr. 3060, ka regjistruar pasuri të paluajtshme *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi* dokumentacioni i origjinës së fitimit të pronësisë ***nuk është origjinal, rezulton fotokopje i panoterizuar*** dhe i pa konfirmuar nga institucioni që e ka lëshuar aktin administrativ(ATP). Gjithashtu regjistrimi i pasurisë ***truall me sipërfaqe 174 m²***, është kryer në kundërshtim me Vendimin e KKKP-së Bulqizë nr.7, datë 08.03.1994, i cili shprehet për njohje të pronësisë mbi truallin dhe jo për kthim fizik të tij, ***për rrjedhojë nuk duhet të procedohej me regjistrimin e pasurisë,*** sa vepruar në ***papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", UKM nr.2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe pikën 3 të vendimit të KKKP-së Bulqizë nr.7, datë 08.03.1994 *(Trajtuar në faqet 13-16, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 1: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë 2/117/3, volum 10, faqe 32, ZK 8612, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

Brenda muajit Tetor 2019

2- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **5 raste** që i përkasin ZK 3694, fshati Vajkal, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme për poseduesit e AMTP-ve përkatëse, me referencat: nr.0943, nr.0954, nr.0840, nr.0872, nr.0868, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, lidhur me* regjistrimin e pasurive truall+ndërtesë në zonat urbane të fshatrave, pasi ka ndodhur regjistrimi i pasurive truall+ndërtesë, duke kaluar truallin me sipërfaqe totale prej ***1810 m²***, si dhe pasuritë ndërtesë me sipërfaqe totale ***948 m²,*** nga të cilat ***në 3 raste,*** *janë regjistruar për të njëjtën familje 2 e më shumë pasuri truall dhe ndërtesë,* në pronësi të poseduesve të AMTP-ve, ku rezulton se ***mungon dokumentit ligjor "Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", që shërben si Titull Pronësie;*** sa vepruar **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", VKM nr.432, datë 14.08.1995"Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit", i shfuqizuar dhe Urdhrin e Kryeregjistruesit nr.411, datë 14.05.2013 *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 2: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për në **5 rastet e sipërcituara dhe në të gjitha rastet e ngjashme**, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Nëntor 2019

3- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **4 raste,** që ju përkasin referencave: nr. 504, nr. 687, nr. 0943, ZK 3694 dhe nr. 415, ZK 1763, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme për poseduesit e AMTP-ve përkatëse, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore*, pasi është regjistruar në favor të poseduesve të

AMTP-ve një sipërfaqe toke në total prej ***5790 m²,*** më tepër se sipërfaqja takuese sipas AMTP-së përkatëse, sa vepruar **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25 dhe pikën 2 neni 45, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe VKM nr. 994, datë 09.12.2015"Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP) *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 3: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **4 rastet e sipërcituara**, të veçojë e regjistrojë "shtet" sipërfaqet e përfituara padrejtësisht, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe zbatimin e procedurave sipas VKM nr.994, datë 09.12.2015

Brenda muajit Nëntor 2019

4- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në 2 **raste**, ju përkasin referencave: nr. 0840, ZK 3694 dhe nr. 376 ZK 1763, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme për poseduesit e AMTP-ve, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore*, pasi AMTP-të rezultojnë të korrigjuara, ***duke rritur fiktivisht sipërfaqen takuese dhe përfituar më tepër 5520 m²,*** ndërsa punonjësit e ZVRPP nuk duhet të kryenin veprime deri në konfirmimin zyrtar nga institucionet përkatëse, lidhur me vlefshmërinë ligjore të këtyre akteve, sa vepruar **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25 dhe pikën 2 neni 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe VKM nr. 994, datë 09.12.2015"Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP) *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 4: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastren"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **2 rastet e sipërcituara**, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe zbatimin e procedurave sipas VKM nr.994, datë 09.12.2015.

Brenda muajit Nëntor 2019

5- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **8 raste**, sipas referencave: nr. 017, 016, nr. 687, nr. 0943, nr. 840, nr. 872, nr. 859, nr. 868, ZK 3694 dhe nr. 0178, nr. 0173, ZK 1532, ka regjistruar pasuri të paluajtshme dhe ka kryer transaksione, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore*, pasi për një trung familjar janë lëshuar 2 e më shumë AMTP, duke shkelur kriterin e ndarjes së tokës sipas normës për frymë të çdo fshati, dhe ndarë tokë në mënyrë të pa barabartë, për rrjedhojë nga regjistrimi i tyre ***kanë përfituar më tepër në total tokë me sipërfaqe 89800 m²,*** se sipërfaqja takuese sipas normës për frymë, bazuar në përbërjen familjare me datë 01.08.1991, sa vepruar **në papajtueshmëri** me pikën 2 neni 3, të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" dhe në pikën 2, të VKM-së nr. 255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës", e ndryshuar, me ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 5: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **8 rastet e sipërcituara** deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr.994, datë 9.12.2015, si dhe të dërgojë AMTP-të përkatëse, për vlerësim dhe shqyrtim ligjor nga institucionet përkatëse kompetente.

Brenda muajit Nëntor 2019

6- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **2 raste**, sipas referencave nr. 0166 dhe nr. 0178, ZK 1532, ka regjistruar pasuri të paluajtshme dhe ka kryer transaksione, *në favor* të poseduesit të AMTP-së me referencë nr. 2020, zk 1081, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi rezulton* se ***zëri kadastral që përmban AMTP-ja përkatëse, është "moçalishte", duke u regjistruar në KPP tokë arë*** me

sipërfaqe totale ***19500 m²***, ndërsa ZVRPP Bulqizë, nuk duhet të procedonte me regjistrimin e pasurive përkatëse, por duhet ti drejtohej KVVTP pranë Prefekturës së Qarkut Dibër, për të konfirmuar vlefshmërinë ligjore të AMTP-ve(ky konstatim vlen edhe për AMTP-të e tjera që i përkasin Fshatit Dragua), veprim **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25, nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 2, të ligjit nr.9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore " dhe me germën "d" pika 1, të VKM nr.994, datë 09.12.2015"Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP)" *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandim 6: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **2 rastet e sipërcituara** dhe në çdo rast që konstatohet në vijimësi, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr.994, datë 9.12.2015, **si dhe të dërgojë AMTP-të përkatëse, për vlerësim dhe shqyrtim ligjor nga institucionet përkatëse kompetente.**

Brenda muajit Nëntor 2019

7- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në 6 **raste** sipas referencave nr. 0173, nr. 092, nr. 105, nr. 101, nr. 097 dhe nr. 086, ZK 1532, ka regjistruar *pasuri në favor* të poseduesve të AMTP-ve përkatëse, ku konstatohet se në këto raste AMTP-të ***nuk mund të shërbejnë si Titull Pronësie, pasi*** pasuritë e regjistruara nuk janë të llojit "***tokë bujqësore***", për rrjedhojë në kundërshtim me dispozitat ligjore është tjetërsuar pasuria "shtet" me sipërfaqe totale ***18500 m²,*** që në KPP dhe regjistrat përkatës figuron e ***llojit***: ***"pyll", "truall" "livadh" dhe "kullotë",*** për të cilat në të gjitha rastet janë lëshuar certifikata pronësie ***për tokë arë***, ndërsa ZVRPP Bulqizë , nuk duhet të procedonte me regjistrimin e pasurive përkatëse, deri në konfirmimin zyrtar nga institucionet përkatëse, veprim **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25, nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 2, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore ", nenin 3, të ligjit nr. 8337, datë 30.04.1998 '"Për Kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave" dhe nenin 3, të ligjit nr. 7501, datë 17.09.1991 "Për tokën", të ndryshuar dhe germën "b" pika 5, të UKM nr. 994, datë 09.12.2015"Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP)" *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandim 7: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën"**, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë në **6 rastet e sipërcituara** dhe në çdo rast që konstatohet në vijimësi, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr.994, datë 9.12.2015, **si dhe të dërgojë AMTP-të përkatëse, për vlerësim dhe shqyrtim ligjor nga institucionet përkatëse kompetente.**

Brenda muajit Nëntor 2019

8- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **2 raste**, ka regjistruar pasuri të paluajtshme sipas AMTP nr. 26322, ZK 8612, qyteti Bulqizë dhe AMTP nr. 26640, ZK 1532, Fshati Dragua, të cilat ***janë lëshuar për persona që nuk janë përfitues të tokës,*** pasi nuk janë brenda juridiksionit që ushtron detyrën Komisioni i Ndarjes së Tokës në Fshat, kjo e vërtetuar me certifikatën e përbërjes familjare datë 1.08.1991, veprim **në papajtueshmëri me** pikën 2 neni 3, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, nenin 25/a, të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe pikën 2, të VKM-së nr.255 "Për Kriteret e ndarjes së tokës", e ndryshuar, përsa i përket regjistrimit të pasurive tokë bujqësore të ndara me ligjin nr. 7501, datë

19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 8: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë e regjistruara sipas AMTP-ve: AMTP nr. 26322,(lëshuar në Fshatin Vajkal) regjistruar në ZK 8612 dhe AMTP nr. 26640, ZK 1532, Fshati Dragua, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave sipas VKM nr.994, datë 9.12.2015, si dhe të dërgojë AMTP-të përkatëse, për vlerësim dhe shqyrtim ligjor nga institucionet përkatëse kompetente.

Brenda muajit Nëntor 2019

9- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **2 raste**, sipas referencave: nr.504, nr.0943, ZK 3694, ka regjistruar pasuri të paluajtshme sipas AMTP-ve, ***në mungesë të dokumentacionit teknik ligjor,*** pasi mungon certifikata e përbërjes së trungut familjar m0 datë 01.08.1991, veprim në papajtueshmëri me germën "d" pika 1, të UKM nr.994, datë 09.12.2015"Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi(AMTP) *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 9: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasuritë e regjistruara sipas AMTP-ve, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe në zbatimin e procedurave përkatëse.**

Brenda muajit Nëntor 2019

10- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **2 raste**, sipas referencave: nr. 016, nr. 017, ZK 3694, ka regjistruar pasuri të paluajtshme nr. 2012/1, *arë me sipërfaqe 5312 m^2*(e tjetërsuar) dhe nr. 2012/2, volum 13, faqe 152, ZK 3694, *arë me sipërfaqe 1856 m^2, në shkelje të dipoziatve ligjore,* pasi regjistrimi i pasurive është kryer ***në mungesë të dokumentacionit që shërben si Titull Pronësie,*** **Sa vepruar në papajtueshmëri** me nenin 24, të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, Rregulloren nr.184, datë 08.04.1999 *(Trajtuar në faqet 16-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 10: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 2012/2, volum 13, faqe 152, ZK 3694, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor që shërben për fitimin e pronësisë.

Brenda muajit Nëntor 2019

11- Gjetje: ZVRPP Bulqizë, nuk ka krijuar një bashkëpunim dhe komunikim të vazhdueshëm ndërmjet ZVRPP Bulqize dhe Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Dibër, për rrjedhojë nuk ka informacion të plotë, lidhur me procedurën e ndjekur për shqyrtimin e vlerësimin e ligjshmërisë së AMTP-ve, deri në përfundim të procesit. Gjithashtu *nuk është vendosur masë kufizimi në asnjë rast, për pasuritë e regjistruara me amtp, për të cilat vendimet shprehen për gjendjen në proces shqyrtimi, deri në marrjen e formës së prerë të vendimeve gjyqësore dhe për ato që* KVVTP Prefekti Qarkut Dibër ka dërguar në ZVRPP Bulqizë, *pra nuk është vendosur kufizim në KPP(seksionin "E")**,** gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit, veprime këto **në kundërshtim me** ligjin nr.* ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", neni 74 dhe nenet 45, 59 neni 60, me vetë Vendimet e Gjykatave dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", të ndryshuar*(Trajtuar në faqet 8-68, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 11: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të rrisë bashkëpunimin dhe të kërkojë informacion të vazhdueshëm, nga institucionet përkatëse që kanë në kompetencë shqyrtimin e vlerësimin e ligjshmërisë së AMTP-ve, si dhe të kufizohen veprimet për pasuritë e përfituara me AMTP, *të cilat janë në proces shqyrtimi, deri në përfundimin e këtij procesi.*

Brenda muajit Nëntor 2019

12- Gjetje: ***Zyra vendore e ASHK(ish-ZVRPP)Bulqizë*** ka regjistruar pasuri bazuar në bazë të AMTP nr. 6463, pasuritë nr. 1200/4, v. 4, faqe 40 dhe p. 1200/1, v. 4, faqe 37 në kushtet e mungesës së AMTP në favor të subjektit privat [redacted] dhe në kushtet e mungesës së dokumentacionit ligjor të truallit dhe objekteve, si dhe ka regjistruar transaksione, duke regjistruar KSHB nr. 428/176, datë 23.03.1999 me shitës [redacted] etj. dhe Blerës [redacted] në kundërshtim me dispozitat ligjore të përcaktuara nga ligji 7501, datë 19.07.1991, i ndryshuar, me ligjin nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurisë së Paluajtshme" dhe rregulloren e ZRPP nr.184, datë 08.04.1999 si dhe me dispozitat ligjore të përcaktuara nga VKM nr. 994, datë 05.09.2012 *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 12: ***Zyra vendore e ASHK(ish-ZVRP), përgjegjësi i Zyrës*** të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2014 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara, të evidentuara sipas refencave ***0003, 0004, 0005, 0007 dhe AMTP nr. 6463, zona Kadastrale 3947*** si pasuri të përfituara padrejtësisht në kushtet e mungesës së dokumentacionit ligjor të truallit dhe objekteve, si dhe në kushtet e regjistrimit të KSHB nr. 428/176, datë 23.03.1999 me shitës [redacted] në mungesë të origjinës së pronësisë duke i kërkuar njëkohësisht OQV, Bashkisë Bulqizë vënien në dispozicion e ***AMTP 6463 Origjinale,*** duke njoftuar subjektet e tjera DAMT e subjektin përfitues të AMTP, ***në zbatim të pikës 2 të VKM nr. 994, datë 09.12.2012 "kur pasuria figuron e regjistruar në ZVRPP", shkronjat a,b,c,ç dhe d.***

Brenda muajit Nëntor 2019

13- Gjetje: ***Zyra vendore e ASHK(ish-ZVRPP)Bulqizë*** ka regjistruar në emër të [redacted] ***9050 m2*** bazuar në AMTP nr. 12151, datë 10.08.1994 dhe një sipërfaqe prej ***7797 m2*** përfituar në zbatim të VKM nr. 253, datë 06.03.2013, pika 1 dhe 3 për përdoruesit faktik të tokës bujqësore, duke përfituar [redacted] një sipërfaqe ***mbi normë 2989 m2, në kundërshtim me dispozitat ligjore të përcaktuara nga ligji 7501, datë 19.07.1991 dhe me dispozitat ligjore të përcaktuara nga VKM nr. 994, datë 05.09.2012, në ligjin Nr. 10/201 'Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008,"Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, neni 1, duke ndryshuar nenin 17, pika 1/1. Regjistruar p. 988, v. 4, faqe 238 Pemtore -Truall gjithsej 898 m2, nga e cila truall 250 m2 dhe ndërtesë 192 m2 sipas AMTP nr. 1251, datë 10.8.1994*** në favor të [redacted], në kundërshtim me dispozitat ligjore e përcaktuara nga ***VKM nr. 159, datë 21.03.2006(fletore zyrtare nr. 26, faqe 871), nenin 193 të kodit civil, shkresën e ZQRPP nr. 3191, datë 11.05.2012, VKM nr. 159, datë 21.03.2006 dhe mbas hyrjes në fuqi.***

Regjistruar pasuri në emër të [redacted] pasuri Tokë Bujqësore sipas akteve ***1,2,3,4,5 dhe 6 në zbatim të VKM nr. 253, datë 06.03.2013 pika 1 dhe 3*** për përdoruesit faktik të tokës bujqësore sipas ***referencave nr. 0007, 0008, 0009, 0010, 0011, 0012*** dhe aktet rezultojnë të nënshkruara nga punonjës të tjerë ***në kapërcim të kompetencave që jep ligji për nënshkrimin e titujve të pronësisë, në emër të kryetarit të Bashkisë.***

Nga ana e ZVRPP Bulqizë nuk rezulton të jenë kryer saktësimet për pasuritë e regjistruara, për mospërputhjen e sipërfaqes përcaktuar në AMTP dhe sipërfaqes sipas LN. Nuk ka deklaratë noteriale për zbritjen e sipërfaqes më tepër sipas LN për ***4808 m2(13,858 m2 -.9050 m2)***, se kujt sipërfaqe do ti zbritet duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2012 "kur pasuria figuron e regjistruar në ZVRPP", shkronjat a,b,c,ç dhe d. *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 13: ***Zyra Vendore ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë, Përgjegjësi i Zyrës*** të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2014 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara, të evidentuara sipas referencave ***nr. 0007, 0008, 0009, 0010, 0011, 0012 si pasuri të nënshkruara nga punonjës të tjerë për aktet 1,2,3,4,5,6 dhe jo nga vete kryetari i Bashkisë dhe të kufizohet për sipërfaqen 2989 m2, e përfituar më tepër si sipërfaqe mbi normë, në kundërshtim me Nr. 10/2019"Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008,"Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, neni 1, për ndryshime në nenin nenin 17, pika 1/1, njëkohësisht ti kërkohet bashkisë*** saktësimi i pasurive të regjistruara, për mospërputhjen e sipërfaqes përcaktuar në AMTP dhe sipërfaqes sipas LN, diferencës ***4808 m2(13,858 m2-9050 m2)***, duke njoftuar subjektet e tjera DAMT e subjektin përfitues të AMTP, ***në zbatim të pikës 2 të VKM nr. 994, datë 09.12.2012 "kur pasuria figuron e regjistruar në ZVRPP", shkronjat a,b,c,ç për pasuritë evidentuar me AMTP dhe LN referencat për pasuritë sipas AMTP nr. 12151, datë 10.08.1994, evidentuar sipas regjistrave nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe*** 7, ***zona Kadastrale 2155-Klenje-Bulqizë.***

Brenda muajit Nëntor 2019

14- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur ***AMTP nr.***2641 ***është lëshuar dhe i përket ZK 3694 Vajkal (rurale) dhe është regjistruar në ZK8611 Bulqizë e re (urbane). Gjithashtu është ndryshuar zëri kadastral pronave që i shërbejnë një interesi publik nga Shesh në Arë***. Veprim në papajtueshmëri me shkronjën "e" neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", shkronjën "ç" pika 2.2, të VKM Nr. 994, datë 09.12.2015"Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr.2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 14: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr.** 1/14/3 **volum 5 faqe 173,** volum 5 faqe 169 pasuria nr. 1/13/3 e llojit shesh me sipërfaqe 1645, volum 5 faqe 171 pasuria nr.1/14/1 e llojit shesh me sipërfaqe 195, volum 5 faqe 155 pasuria nr.1/13/2 e llojit shesh, volum 4 faqe 11 pasuria nr. 1/13 e llojit shesh **ZK 8611, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Nëntor 2019

15- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur ***AMTP nr.*** 117 ***është lëshuar dhe i përket ZK 3694 Vajkal (rurale) dhe është regjistruar në ZK8611 Bulqizë e re (urbane).*** Veprim në papajtueshmëri me shkronjën "e" neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", shkronjën "ç" pika 2.2, të VKM Nr. 994, datë 009.12.2015"Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 15: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë**

volum 5, faqe 209, pasuria nr. 1/191, volum 5 faqe 208 pasuria nr. 1/190 **ZK 8611, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Nëntor 2019

16- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur ***AMTP nr.***26723 ***i mungon nënshkrimi i kryetarit të komisionit të tokës në fshat si dhe nënshkrimi i përfituesit, gjithashtu është korrigjuar numri i aktit .*** Veprim në papajtueshmëri me shkronjën "e" neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", shkronjën "ç" pika 2.2, të VKM Nr.994, datë 09.12.2015"Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr.2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 16: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë** volum 1, faqe 67, pasuria nr. 67, volum 7 faqe 190 nr. 67/1 **ZK 1660, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Nëntor 2019

17- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur ***AMTP nr.*** 26729 ***ka korrigjime në përmbajtjen e saj, janë korrigjuar sipërfaqja totale dhe numri i aktit.*** Veprim në papajtueshmëri me shkronjën "e" neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", shkronjën "ç" pika 2.2, të VKM Nr.994, datë 09.12.2015"Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr.2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 17: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë** volum 2, faqe 112, pasuria nr. 357, volum 7 faqe 211 pasuria nr.357/1 **ZK 1660 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Nëntor 2019

18- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur nuk është bërë bilanci i sipërfaqes totale që përmban ***AMTP nr.*** 26729 ***me sipërfaqen e LN duke përfituar 1708 m^2 më tepër se akti i fitimit të pronësisë.*** Veprim në papajtueshmëri me shkronjën "e" neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", shkronjën "ç" pika 2.2, të VKM Nr. 994, datë 09.12.2015"Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr.2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 18: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të

paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë** volum 3, faqe 118, nr. 608 **ZK 1660, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Nëntor 2019

19- Gjetje: Ish/ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit, në kushtet kur nuk është bërë bilanci i sipërfaqes totale që përmban ***AMTP nr.*** 26798 ***duke regjistruar me tepër nëpër kartela se akti sipërfaqen prej 7312 m² më tepër se akti i fitimit të pronësisë.*** *Gjithashtu më datë 01.08.1991 sipas certifikatës familjare përbëhej nga 2 pjesëtar dhe norma takuese për frymë ka* ***qenë 2220 m², që i takonte në total 4440 m², ndërsa AMTP është plotësuar me 16546 m².*** Veprim në papajtueshmëri me shkronjën "e" neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", shkronjën "ç" pika 2.2, të VKM Nr. 994, datë 09.12.2015"Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 19: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë** volum 6, faqe 4, pasuria nr.1220, volum 5 faqe 222 pasuria nr.1190, volum 5 faqe 224 pasuria nr. 1192, volum 5 faqe 249 nr. 1215 **ZK 1660, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Nëntor 2019

20-Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **1 rast**, që i përket referencës nr.00332, ZK Peladhi, ka regjistruar pasuri të llojit "arë" **me sipërfaqe totale prej** 2.467. **m²,** sipas AMTP-së nr. 9406, datë 10.07.2017, me kontratën noteriale të dhurimit me nr.1218, datë 10.07.2017, shtetases gjermane [redacted]. ZVRPP Bulqizë ka vazhduar me procedurën e regjistrimit të parcelës "Arë" në favor të shtetases gjermane Silvana Kala Shupen, në kundërshtim me ligjin Nr.8337, datë 30.4.1998 "*Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave*", **Neni 4** "*Kalimi i së drejtës së pronësisë <u>të tokës Bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave nuk iu njihet personave fizikë dhe **juridikë të huaj**"</u>*. Personat fizikë dhe juridikë të huaj gëzojnë të drejtën e marrjes së saj me qira deri në 99 vjet *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 20: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën",**bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 11/4, vol. 6, f. 36, lëshuar certifikatë datë 27.07.2017, **deri në plotësimin me dokumentacionin e vlefshëm ligjor.**

Brenda muajit Nëntor 2019

21- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **3 raste,** që i përkasin referencave nr. <u>00340</u>, <u>00342 dhe 00343</u> ZK Peladhi, ka regjistruar pasuri të llojit "arë" me sipërfaqe totale prej 1747 , 550 dhe784 m^2 sipas AMTP-së nr. AMTP me nr 25, 26 dhe 27. ZRPP Bulqizë ka vazhduar me procedurën e regjistrimit të parcelës "Arë" në favor të shtetasit [redacted] dhe [redacted]. ZVRPP Bulqizë pa saktësuar numrin e AMTP-ve të arkivuara në ZVRPP Bulqizë dhe sipërfaqen totale të regjistruar në KPP për subjektin [redacted] ka vazhduar procedurën e regjistrimit të pasurisë dhe pajisjes së subjektit [redacted] me certifikatë pronësie sipas kërkesës së bërë në datë 27.09.2019. *ZVRPP Bulqizë nuk duhet të bënte regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk duhet të lëshonte certifikatë pronësie, por duhet të*

saktësonte numrin e AMTP-ve të arkivuara në ZVRPP Bulqizë dhe sipërfaqen totale të regjistruar në KPP. Këto pasuri janë përfituar padrejtësisht mbi normën për frymë me dokumentacion të pakonfirmuar nga Prefektura Dibër, veprime këto në kundërshtim me Nenit 23, 45, 59, 74 të ligjit 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme", ligjin nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", të ndryshuar, pikën 3 dhe 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 21: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, **të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë** nr 325/15, vol. 5, fq. 28, nr 49/8, vol. 6, fq. 47, zk. 2898, dhe nr pasurie 236/10, vol. 6, fq. 49, **të llojit arë deri në plotësimin me dokumentacionin e vlefshëm ligjor.**

Brenda muajit Nëntor 2019

22- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **2 raste**, që i përkasin referencave nr. **00319, 200 dhe 00328** në emër të [redacted] **dhe 00306, 223 dhe 00321, ZK 2898 ''Peladhi" në emër të** [redacted] ZK Peladhi, ka regjistruar pasuritë me nr. 215/1, vol. 3, fq. 60, zk. 2898, me sip. 3240 m2 dhe me nr. 59/5, vol. 1, fq. 162, zk. 2898, me sip. 200 m2 e llojit arë. Mbi këto pasuri është lëshuar një urdhër për kufizimin e tyre me arsyen se AMTP-të me nr.9419 dhe AMTP nr 9431 janë "*korrigjuar dhe me shtesa*" Ky urdhër pasqyrohet në regjistrin hipotekor në seksionin e kufizimeve dhe në të është shënuar me kryq shenja "***Ndalim***". Sipas referencave hipotekore me nr 0319 dhe me nr 0306 mbi këto pasuri të kufizuara janë kryer veprime të mëtejshme, në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" Neni 59 **"Regjistrimi i kufizimeve",** pika 1. "*Regjistruesi lëshon urdhër për regjistrimin e kufizimit në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë së paluajtshme, me ose pa kërkesën e personit të interesuar"* dhe pika 2. "*Ky urdhër ndalon veprimet me këtë pasuri të paluajtshme.* Sipas referencave hipotekore me nr.0328 dhe nr.0321 datë 25.05.2017 mbi këtë pasuri është hequr kufizimi dhe janë kryer veprime të mëtejshme *(Trajtuar në faqet 16-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 22: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", **të vendosë masë kufizimi për pasurite e mësipërme dhe të ndalojë veprimet mbi pasuritë e kufizuara, dhe raste të tilla si këto të mësipërmet ku janë kryet veprime mbi pasuritë e kufizuara dhe më vonë janë hequr kufizimet mbi këto pasuri të mos përsëriten më në të ardhmen.**

Brenda muajit Nëntor 2019

23- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 2 raste** sipas referencave 00780 dhe 00781 datë 02.02.2018,ka kryer regjistrimi në emër të [redacted], leje legalizimi nr. 987040, datë 08.11.2017, destinacioni "Banim"dhe datë 23.03.2019, ka kryer regjistrimi në emër të [redacted] leje legalizimi nr. 987069, datë 08.01.2018, destinacioni "Banim". Nga auditimi u konstatua se kërkesa e poseduesit është bërë në datën 08.03.2018 me kërkesën nr 281. regjistrimi i pronës është bërë në datën 23.03.2018 duke tejkaluar afatin 10 ditor të regjistrimit të lejes së legalizimit. Kjo bie në kundërshtim me vendimin nr. 1095, datë 28.12.2015, *"Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara"* pika III, **pika nr 13** "*regjistruesi, me paraqitjen e kërkesës, sipas pikës 10, të këtij vendimi, kryen, brenda 10 ditëve, regjistrimin e lejes së legalizimit" (Trajtuar në faqet 70-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 23: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, për të plotësuar standardet e kërkuara duke bërë të mundur që praktikat e përfunduara të përfundohen brenda afateve ligjore.

Brenda muajit Nëntor 2019

24- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **1 rast**, ka regjistruar pasurinë nr. 2/129+1-14, apartament me sipërfaqe 56 m^2, volum 10, faqe 14, ZK 8612, të përfituar nga privatizmi si palë shitëse Bashkia Bulqizë, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi* regjistrimi është kryer ***në mungesë të dokumentacionit që shërben si titull pronësie,*** sa vepruar në ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" ligjin nr. 9321, datë 05.11.2004 "Për privatizimin e objekteve shtetërore e banesave", UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit", VKM nr. 97, datë 03.02.2008 "Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992" *(Trajtuar në faqet 62-69, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 24: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 2/129+1-14, volum 10, faqe 14, ZK 8612, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor që shërben për fitimin e pronësisë.**

Brenda muajit Nëntor 2019

25- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **2 raste**, ka regjistruar pasuritë: nr. 2/129+1-6, apartament me sipërfaqe 60 m^2, volum 3, faqe 236 dhe nr. 1/161+2-8, apartament me sipërfaqe 83 m^2, volum 2, faqe 69, ZK 8612, të përfituar nga privatizimi, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi* regjistrimi është kryer ***në mungesë kontratës së privatizimit(formulari nr. 3), që shërben si dokument bazë për fitimin e pronësisë,*** sa vepruar në ***në papajtueshmëri me*** shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjin nr.7652, datë 23.12.1992", "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar, UKM nr.2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 62-69, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 25: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** në **2 raste**, për pasuritë: nr. 2/129+1-6, volum 3, faqe 236 dhe nr. 1/161+2-8, volum 2, faqe 69, ZK 8612, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor që shërben për fitimin e pronësisë.**

Brenda muajit Nëntor 2019

26- Gjetje: ***Nga Zyra vendore e ASHK(ish-ZVRPP)Bulqizë*** nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes të pasurisë ***nr. 184/6, v. 1, faqe 40,*** regjistruar në emër të [redacted] sipas referencës ***nr.0085,*** përfituar nga ligji e Privatizimit ***nr. 7512, date 10.08.1991*** me ndryshimet e mëvonshme. Sikurse evidentohet, është regjistruar njësia e privatizuar ***për 21.4 m^2 pa u përcaktuar më pare marrëdhëniet e pronësisë,*** me kontratë qiraje apo kontratë shitje, si dhe nuk rezulton të jete paguar qira trualli nga koha e privatizimit të objektit dhe pas, në zbatim të rregulloren nr.184, datë 08.04.1999, Kreu IV-të pika 7 për regjistrimin e pasurive përfituar nga zbatimi i ligjit nr.7512, datë 10.08.1991 i ndryshuar dhe VKM në zbatim te tij ku kërkohet KSHB ndërmjet AKP dhe blerësit për objektin, Kontratë për marrëdhëniet me truallin, planvendosja dhe akti i dorëzimit të objektit *(Trajtuar në faqet 62-69, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 26: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë), të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2014 "Për Kadastrën", bazuar në

shkeljet e konstatuara, **të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë e regjistruar *nr. 184/6, v. 1, faqe 40,*** evidentuar sipas ***referencës 0085*** **deri në përcaktimin e marrëdhënieve të truallit për objektin e privatizuar me kontratë qiraje apo kontratë shitje**.

Brenda muajit Nëntor 2019

27- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka kryer veprime në (KPP) ***duke lëshuar certifikata pronësie mungon origjina e kësaj prone kontrata e shitblerjes, gjithashtu nga ana e specialistit nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***. Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr.184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr.7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës se regjistrimit te pasurive te paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr.2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit *(Trajtuar në faqet 62-69, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 27: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të marrë masa për kufizimin e pronës për të mos kryer veprime të paligjshme** për pasurinë nr. 2/86+1-7, volum 1, faqe 136, ZK 8611, **deri në përfundim të rivlerësimit të dokumentacionit, që ka shërbyer për fitimin e pronës.**

Brenda muajit Nëntor 2019

28- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka kryer veprime në (KPP) ***duke lëshuar certifikata pronësie mungon origjina e kësaj prone kontrata e shitblerjes, gjithashtu nga ana e specialistit nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***. Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr.184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës se regjistrimit te pasurive te paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr. 2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit *(Trajtuar në faqet 62-69, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 28: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 2/86+4-48, volum 1, faqe 178, ZK 8611 **i për të mos kryer veprime**, **deri në përfundim të rivlerësimit të dokumentacionit që ka shërbyer për fitimin e pronës.**

Brenda muajit Nëntor 2019

29- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka kryer veprime në (KPP) ***duke lëshuar certifikata pronësie mungon origjina e kësaj prone kontrata e shitblerjes, gjithashtu nga ana e specialistit nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***. Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr.184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr.7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës se regjistrimit te pasurive te paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr.2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit *(Trajtuar në faqet 62-69, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 29: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të

kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 2/86+5-66, volum 1, faqe 196, ZK 8611, **deri në përfundim të rivlerësimit të dokumentacionit, që ka shërbyer për fitimin e pronës.**

Brenda muajit Nëntor 2019

30- Gjetje: Ish/ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka kryer veprime në (KPP) ***duke lëshuar certifikata pronësie mungon origjina e kësaj prone kontrata e shitblerjes, gjithashtu nga ana e specialistit nuk është bërë verifikimi nëse prona në fjalë rrjedhin nga tituj pronësie të pronarit të fundit të saj, të regjistruar më parë në regjistër***. Veprime këto në papajtueshmëri me pikat 8.1, kreu IV të Rregullores Nr.184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7, datë 07.01.2000 "Për punën e zyrës se regjistrimit te pasurive te paluajtshme" paragrafi i 2 dhe i 3 i pikës nr. 2 të Udhëzim Këshillit Të Ministrave Nr. 2, Datë 12.09.2012 Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit *(Trajtuar në faqet 62-69, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 30: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 2/52+1-3, volum 3, faqe 149, ZK 8611, **deri në përfundim të rivlerësimit të dokumentacionit, që ka shërbyer për fitimin e pronës.**

Brenda muajit Nëntor 2019

31- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **8 raste** që ju përkasin referencat: nr.3092 dhe 3070, nr.3074, nr. 3008, nr.3011, nr. 2994, nr. 2913, ZK 8612 dhe nr.887, nr.913, ZK 3694, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme përfituar me leje legalizimi, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi* legalizimi është kryer mbi objekte që rezultojnë të regjistruara në KPP, në pronësi "shtet", për të cilat nuk ka ndonjë akt administrativ të lëshuar nga organet përkatëse, apo vendim gjykate të formës së prerë, për tjetërsimin e objektit apo prishjen e tij, për rrjedhojë regjistrimi i pasurive të legalizuara, ka sjellë si pasojë ***fshirjen e të drejtës së pronësisë shtetërore për*** pasuritë ndërtesë me sipërfaqe totale ***1498 m^2, e cila do të konsiderohet si dëm i shkaktuar ndaj shtetit, në mungesë të dokumentacionit argumentues,*** sa vepruar **në papajtueshmëri** me shkronjën "a" neni 25 dhe pikën 3 neni 34 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" *(Trajtuar në faqet 70-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 31: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi në 8 raste** për pasuritë sipas referencave të sipërcituara, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor që argumenton fshirjen e pasurive ndërtesë me sipërfaqe totale 1498 m^2 në pronësi "shtet".**

Brenda muajit Nëntor 2019

32- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **6 raste** që ju përkasin referencat : nr.3092 dhe 3070, nr. 2974, nr. 2979, nr. 3068, nr. 2913, ZK 8612 dhe nr. 0385, ZK 1763, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme përfituar me leje legalizimi, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi lejet e legalizimit kanë miratuar parcela ndërtimore,* me sipërfaqe më tepër se sipërfaqja takuese sa trefishi i sipërfaqes së bazës së objektit, ndërsa *nga ZVRPP Bulqizë, nuk janë verifikuar elementët e formës e përmbajtjes së Aktit Administrativ të Lejes së Legalizimit në lidhje me sipërfaqen e parcelës ndërtimore,* për rrjedhojë është miratuar në favor të poseduesve të lejeve të legalizimit, më tepër ***trualli me sipërfaqe totale prej 524.2 m^2,*** sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën"a" neni 25, nenin 49, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 17 të

ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar dhe me pikën 5, të UKM nr.2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 70-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandim 32: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi në 6 raste** për pasuritë sipas referencave të sipërcituara, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Gjithashtu në bashkëpunim me Sektorin e ALUIZNI-t, në Drejtorinë e ASHK Dibër, të ndiqen procedurat e lekujdimit me çmimin e tregut, për truallin e tepërt të përfituar padrejtësisht nga poseduesit e lejeve të legalizimit.**

Brenda muajit Nëntor 2019

33- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **1rast** me referencë nr.0920, ZK 3694, ka regjistruar në volum 15, faqe 89, pasurinë nr. 2309-Nd, ndërtesë 3 kat me sipërfaqe ndërtimi 102.9 m^2, me funksion banimi, përfituar me leje legalizimi, ***e cila është lëshuar në kundërshtim me dispozitat ligjore****, pasi trualli i miratuar si parcelë ndërtimore mbi të cilin ndodhet objekti i legalizuar, rezulton i shpronësuar më parë me VKM përkatëse*(pretendohet se nuk është objekt shpronësimi), ndërsa Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Dibër nuk duhet të kryente legalizimin e objektit, si dhe nuk duhet të regjistrohej nga punonjësit e ZVRPP Bulqizë, sa vepruar **në kundërshtim me** shkronjën "a" neni 25, me pikën 5 nenin 45, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar dhe me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 70-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandim 33: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 2309-Nd, volum 15, faqe 89, ZK 3694, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor apo konfirmimin zyrtar nga institucionet kompetente, që trualli nuk është objekt shpronësimi për interesa publike.**

Brenda muajit Nëntor 2019

34- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në **1rast** me referencë nr.3073, ZK 8612, ka regjistruar në volum 10, faqe 39, pasurinë nr. 2/120+1-10-Nd, apartament me sipërfaqe 117.3 m^2, me funksion banimi, përfituar me leje legalizimi, *duke mos zbatuar dispozitat ligjore, pasi është miratuar leje legalizimi për shtesë në objekt ekzistuese, por që në fakt nuk ekziston i regjistruar*, ndërsa nga punonjësit e ZVRPP nuk duhet të procedohej me regjistrimin e kësaj leje legalizimi, por duhet ti kërkohej Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Dibër saktësimi i dokumentacionit ligjor dhe hartografik, ***sa vepruar*** në papajtueshmëri me, shkronjën "a" neni 25, me pikën 5 nenin 45, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale", i ndryshuar, dhe pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 *(Trajtuar në faqet 70-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandim 34: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi** për pasurinë nr. 2/120+1-10-Nd, volum 15, faqe 39, ZK 8612, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Nëntor 2019

35- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka ofruar shërbimi e kërkuar subjekti, në kushtet kur; Nga verifikimi i materialit hartografik dhe pozicionimit të pronës rezulton se objekti informal ***është hedhur në hartën e punës me konturet e kuqe dhe prek pjesërisht mbi pasurinë nr.2/131 e llojit ndërtesë, pra krijohet mbivendosje kur behet azhurnimi në HTR të ZVRPP sipas hartës të përfunduar të ALUIZNIT.*** Veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 45 të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", pika 5 e Udhëzimit nr.2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 70-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 35: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr.** 2/20/4-ND2 volum 5, faqe 240**, ZK 8611, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Nëntor 2019

36- **Gjetje:** ZVRPP Bulqizë në **3 raste** sipas referencave nr. 3114, 2573, 2938 dhe nr. 2935, 2934, ZK 8612, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme bazuar në dokumentacionin urbanistik, rezulton se regjistrimi ***është kryer me parregullsi dhe në mungesë të dokumentacionit urbanistik tekniko ligjor, si dhe në mungesë të marrëdhënieve me truallin***, ***sa vepruar*** në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, me pikën 2 nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me pikën 5, të UKM nr.2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe Rregulloren nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar *(Trajtuar në faqet 87-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 36: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi në 3 raste,** për pasuritë e regjistruara sipas referencave të sipërcituara, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Nëntor 2019

37- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka regjistruar sipas referencës nr. 0894, pasurinë **nr.** 1810/1, volum 13 faqe 199, arë+truall **me sipërfaqe 9600 m^2,** nga e cila truall me sipërfaqe 4800 m^2 dhe ndërtesë 3 kat me sipërfaqe të bazës 396 m^2, ZK 3694, bazuar në dokumentacionin urbanistik, rezulton se regjistrimi i pasurisë ***është kryer me parregullsi dhe në mos përpurputhje të dhënash të përcaktuara në dokumentacionin urbanistik***, ***sa vepruar*** në papajtueshmëri me shkronjën "a" neni 25, me pikën 2 nenin 45, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me pikën 5, të UKM nr.2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" dhe Rregulloren nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar *(Trajtuar në faqet 87-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 37: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës "1" neni 5 dhe pikës 1 neni 59, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të**

nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 1810/1, volum 13, faqe 199, ZK 3694, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Nëntor 2019

38- Gjetje: ***Nga Zyra vendore e ASHK(ish-ZVRPP)Bulqizë*** nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes të pasurisë, regjistruar në emër të [redacted] sipas ***referencave 0073, 0091, 0090 dhe 0104, dhe në emër të*** [redacted] ***sipas referencave 0008 dhe 0094, dhe në emër të*** [redacted] ***sipas referencës nr. 0099, të përfituara nga ligji i Urbanistikes nr.8405, datë 17.09.1998 me ndryshimet e mëvonshme*** duke regjistruar Pasuritë në mungesë të dokumentacionit tekniko ligjor dhe pa u përcaktuar marrëdhëniet e truallit në kundërshtim me piken 12 të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 " Për pasuritë e paluajtshme të fituara sipas ligjeve të urbanistikes në varësi të viteve, veprim në papajtueshmëri me pikën 2-3 të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 87-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 38: ***Zyra Vendore ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë), Përgjegjësi i Zyrës*** të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2014 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara në emër të [redacted] sipas ***referencave 0073, 0091, 0090 dhe 0104, në emër të*** [redacted] ***sipas referencave 0008 dhe 0094, dhe në emër të*** [redacted] ***sipas referencës nr. 0099, të përfituara nga Ligji i Urbanistikes nr. 8405, datë 17.09.1998 me ndryshimet e mëvonshme*** deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor të urbanistikës dhe përcaktimin e marrëdhënieve të pronësisë së truallit (me qira apo shitje), ***në zbatim të pikës 12, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999.***

Brenda muajit Nëntor 2019

39- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***nuk përputhet sipërfaqja e sheshit të ndërtimit e përcaktuar në formularin nr. 2 e cila është 320 m^2 dhe kontratës së shitblerjes e cila është 152 m^2, duke regjistruar më pakë në kartela një sipërfaqe prej 168 m^2.*** Veprime këto në papajtueshmëri me "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25, pikën 1 neni 48, neni 59 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe me nenin 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për Urbanistikën", i ndryshuar, nenin 79 të ligjit nr.10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruesit "Për rregullimin e veprimtarisë për regjistrimin e ndërtimeve të reja në bazë të funksionimit të ri të KRRT-ve" dhe pikën 2 paragrafi 2 të UKM nr.2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 87-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 39: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr.** 1/196/1 volum 5, faqe 236 **ZK 8611, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Nëntor 2019

40- Gjetje: Ish/ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***nuk përputhet sipërfaqja e ndërtimit e përcaktuar në formularin nr. 2 e cila është 1060.77 m^2 me planimetrinë e sheshit të ndërtimit e cila është 221.4 m^2. Në lartësinë e përgjithshme të***

përcaktuar numri maksimal i kateve është 2 ndërsa numri i kateve mbi tokë është 3 dhe nën tokë 1, pra ka mospërputhje të dhënave dhe kondicioneve urbane, ndërsa në prerjen tërthore të objektit paraqitet 4 kate mbi tok dhe një nën tokë . Veprime këto në papajtueshmëri me "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25,pikën 1 neni 48, neni 59 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për Urbanistikën", i ndryshuar, nenin 79 të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, pikën 1 të Urdhrit nr.6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruesit "Për rregullimin e veprimtarisë për regjistrimin e ndërtimeve të reja në bazë të funksionimit të ri të KRRT-ve" dhe pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr.2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 87-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 40: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr.** 1/13/1 volum 5, faqe 154 **ZK 8611, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Nëntor 2019

41- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***nuk përputhen konturet e gjurmës së ndërtimit të përcaktuar në planimetrinë e sheshit të ndërtimit të miratuar me planin e rilevimit të përgatitur nga inxhinieri i licencuar dhe e miratuar nga autoriteti përgjegjës. Në dosje mungon planimetria e sheshit të ndërtimit me kondicionet urbane si dhe projekti i miratuar.*** Veprime këto në papajtueshmëri me "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25,pikën 1 neni 48, neni 59 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe me nenin 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për Urbanistikën", i ndryshuar, nenin 79 të ligjit nr.10119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, pikën 1 të Urdhrit nr. 6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruesit "Për rregullimin e veprimtarisë për regjistrimin e ndërtimeve të reja në bazë të funksionimit të ri të KRRT-ve" dhe pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr.2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 87-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 41: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr.** 2/20/7 volum 6, faqe 7 **ZK 8611, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Nëntor 2019

42- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka ofruar shërbimin e kërkuar në kushtet kur: ***nuk përputhet sipërfaqja e sheshit të ndërtimit e përcaktuar në formularin nr.2 e cila është 320 m^2 dhe kontratës së shitblerjes e cila është 152 m2, duke regjistruar më pakë në kartela një sipërfaqe prej 168 m^2.*** Veprime këto në papajtueshmëri me "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25,pikën 1 neni 48, neni 59 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe me nenin 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën", i ndryshuar, nenin 79 të ligjit nr.10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", të

ndryshuar, pikën 1 të Urdhrit nr.6 datë 21.01.2001 të Kryeregjistruesit "Për rregullimin e veprimtarisë për regjistrimin e ndërtimeve të reja në bazë të funksionimit të ri të KRRT-ve" dhe pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 87-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandim 42: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr.** 2/143/ND volum 5, faqe 166**, ZK 8611, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Nëntor 2019

43- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka regjistruar pasurinë e paluajtshme në kushtet kur ***në dosje mungojnë: "Leja e sheshit të ndërtimit", kondicionet urbane, "Leja e përdorimit" akti i lejimit të përdorimit dhe/ose zënies së tokës apo strukturës së zhvilluar, për të cilin është kryer punimi, "aktet e kontrollit" të cilat vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes, "Oponenca teknike" për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, "Projektin dhe kushtet urbanistike" të miratuara.***

Mungojnë marrëdhëniet me truallin(shtet dhe/ose privat) ku vendoset dhe bie objekti sipas planimetrisë së sheshit të ndërtimit të miratuar.

Nuk është përllogaritur saktë dhe është paguar më pak nga ana e subjektit, pagesa 1 për qind të vlerës së investimit që do të kryejë sipas preventivit të objektit. Ky fond depozitohet për llogari të financimit të studimeve urbanistike në pushtetin vendor. Pagesa bëhet menjëherë në seksionin e financës së këshillit të qarkut apo qytetit të kategorisë së parë me autorizim të sekretarisë teknike të KRRT-së. Dokumenti i lejes së ndërtimit jepet pasi është bërë depozitimi i dokumentit të pagesës në dosjen e objektit. **Në dosje mungon përllogaritja e këtij detyrimi**, në dosje administrohet nxjerrje llogarie të këtij subjekti, ku për llogari të ish/Komunës Martanesh më datë 30.11.2010 ka derdhur taks ndikimi në infrastrukturë nga ndërtimet e reja në vlerën 1.197.390 lekë, ndërsa përllogaritja sipas nenit 51 ligji nr. 8405 dhe neni 27 i ligjit nr. 9632:

- Vlera e objekti sipas preventivit 731.513.571 x 0.1 %= **731.514 lekë** taks ndikimi në infrastrukturë.
- *Vlera e objekti sipas preventivit 731.513.571 x 1 %= 7.315.135 (SUP) lekë- 1.197.390 lekë të paguara=* ***6.117.745 lekë*** Tarifë për studimet urbanistike dhe/ose për planet e detajuara vendore (1% e vlerës së investimit) *të pa argumentuara nëse janë paguar apo jo.* ***Nuk është bërë hedhja e objektit në hartën e punës (planshet)***. etj. Veprime këto në papajtueshmëri me pikën 1 neni 48, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" i ndryshuar, nenin 6 dhe 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, Neni 51 ligji nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën", i ndryshuar me nenin 79 të ligjit nr.10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr.2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore ", i ndryshuar, neni 27 *(Trajtuar në faqet 87-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandim 43: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë**

nr. 643 volum 3, faqe 206**,** ZK 1754, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor si dhe konfirmimin e pagesës së taksave nga organi kompetent Bashkia Bulqizë.**

Brenda muajit Nëntor 2019

44- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** ka regjistruar pasurinë e paluajtshme në kushtet kur: ***Nuk ka urdhër për heqjen e kufizimit dhe ndalimit të veprimeve. Në dosje mungon:*** Marrëdhëniet me truallin(shtet dhe/ose privat) ku vendoset dhe bie objekti sipas planimetrisë së sheshit të ndërtimit të miratuar. Mungon "Leja e sheshit të ndërtimit", kondicionet urbane, "Leja e përdorimit" akti i lejimit të përdorimit dhe/ose zënies së tokës apo strukturës së zhvilluar, për të cilin është kryer punimi, "aktet e kontrollit" të cilat vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes, "Oponenca teknike" për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve. Nuk është bërë hedhja e objektit në hartën e punës (planshet). etj. Veprime këto në papajtueshmëri me pikën 1 neni 48, të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" i ndryshuar, nenin 6 dhe 13, të ligjit nr 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, Neni 51 ligji nr. 8405, datë 17.9.1998 "Për Urbanistikën", i ndryshuar me nenin 79 të ligjit nr.10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr.2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit" *(Trajtuar në faqet 87-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 44: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 14** volum 1, faqe 14**, nr.** 301**volum 2 faqe 60 ZK 2826, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Nëntor 2019

45- Gjetje: Nga ZVRPP Bulqizë nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes të pasurisë, regjistruar Pasuria 200/2, v. 1,faqe 37 për truall 80 m2 dhe ndërtim 48.95 në emër të [redacted] dhe nuk rezulton të jenë zbatuar procedurat e përcaktuara në VKM nr. VKM 608, datë 05.09.2012, në papajtueshmëri me pikën "iii" shkronjës "b" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

Pasuria 200/2, v. 1,faqe 37, është regjistruar pa u plotësuar urdhër për regjistrim nga Regjistruesi D. H.. Nuk ka HTR Provizore nga ZVRPP. Në KPP nuk ka nënshkrime për lëshimin e certifikatës.

Nuk disponohet nga subjekti ***asnjë lloj dokumenti pronësie, si: leje sheshi, preventiv, situacion, aktdorëzimi, aktkontroll punimesh, e dokumentacion, si dhe dokument që provon pronësinë e truallit të asaj kohe sipas ligjit të urbanistikës nr. 7693, datë 07.06.1993 dhe nuk disponohet akt fitimi pronësie si leje ndërtimi apo KSHB.***

Sipas vendimit të gjykatës së rrethit Gjyqësor Bulqizë me nr. 60, datë 18.06.1998 me kërkues [redacted] dhe palë e interesuar Komuna Shupenzë me objekt: ***Vërtetim Fakti Juridik rezulton*** se objekti(lokal) ka përfunduar së ndërtuari në vitin 1993. Ky objekt rezulton të jetë përdorur nga kërkuesi për prodhim varrezash dhe gjykata ka çmuar që ti njihet pronësia me vërtetim fakti juridik për sipërfaqe për 3 faqe anësore dhe 1/3 e faqes nga jugu që evidenton ***një objekt me tre faqe muri dhe pa mbulesë, në kundërshtim me shkronja "a" të pikës 4 të VKM 608, datë 05.09.2012.***

- Nuk rezulton të ketë dokument zyrtar nga Pushteti Vendor që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991, ***në kundërshtim me pikën 5 të VKM nr. 608, datë 05.09.2012***.

Dokumentacioni i dosjes dërguar në ZVRPP është fotokopje dhe nuk ka vulat dhe firmat nga Bashkia për njehsimin e dokumentacionit, në kundërshtim me procedurat e përcaktuara nga VKM 608, datë 05.09.2012, pika 8. Sikurse evidentohet në dosje nga subjekti kërkues dhe Bashkia nuk është plotësuar dokumentacioni në zbatim të VKM nr. 608, datë 05.09.2012, ***në kundërshtim me*** kërkesat e neneve 24-25 të ligjit 33/2012 "Për Regjistrimin e pasurisë së Paluajtshme" *(Trajtuar në faqet 103-109, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 45: Zyra Vendore ASHK Bulqizë, Përgjegjësi i Zyrës të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2014 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, **të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara në emër të** [redacted] ***sipas referencës nr.0098, datë 12.03.2018*** **pa asnjë lloj dokument pronësie sikurse leje sheshi, preventiv, situacion, aktdorëzimi, aktkontroll punimesh, e dokumentacion, si dhe dokument zyrtar që provon pronësinë e truallit të asaj kohe sipas ligjit të urbanistikës nr.7693, datë 07.06.1993 dhe nuk disponohet akt fitimi pronësie si leje ndërtimi apo KSHB.**

Per regjistrimin e kësaj pasurie në mënyrë abuzive në zbatim të VKM nr. 608, datë 05.09.2012, kërkojmë bazuar në dispozitat ligjore fshirjen e regjistrimit dhe ti kërkohet bashkisë rishqyrtimi edhe nje here i kërkesës së qytetarit Riza Daçi, në rast të mos shqyrtimit nga Bashkia të kërkohet kallëzim në zbatim të pikës 11 të VKM nr.608, datë 05.09.2012.

Brenda muajit Nëntor 2019

46- Gjetje: ZVRPP Bulqizë nuk ka bashkëpunuar me Bashkinë Bulqizë, lidhur me regjistrimin e pasurive të transferuara tek pushteti vendor, sipas VKM-ve përkatëse, ku rezulton se nga Bashkia Bulqizë nuk është aplikuar për regjistrimin e këtyre pasurive, mos regjistrimi i të cilave ka sjellë mos administrimin dhe pamundësinë e shfrytëzimit të resurseve, që paraqesin pasuritë e llojit pyje, kullota, sisteme vaditje, toka bujqësore, etj, për rrjedhojë nuk janë përmbushur detyrimet ligjore për administrimin dhe përdorimin me efikasitet të këtyre pasurive *(Trajtuar në faqet 109-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 46: Zyra Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa dhe ti kërkojë Bashkisë Bulqizë, po të jetë nevoja të njoftojë edhe instancat e larta, për të bërë mundur aplikimin dhe regjistrimin e pasurive të transferuara tek Bashkia Bulqizë, sipas VKM-ve përkatëse.

Brenda muajit Nëntor 2019

47- Gjetje: ZVRPP Bulqizë **në 1 rast** në kartelat e pasurive të paluajtshme (KPP) volum 1, faqe 1, është regjistruar pasuria nr. 1 shesh me sipërfaqe 9900 m^2 në pronësi [redacted], seksioni (D) i kartelës sipas referencë nr. 002, datë 15.06.2012 në administrim "[redacted] sha kaluar pronësi me referencë nr 0697 datë 13.07.2015 "[redacted] sha. (KPP) volum 1, faqe 2, është regjistruar pasuria nr. 2 shesh me sipërfaqe 1400 m^2 në pronësi Almedn Skënderaj, seksioni (D) i kartelës sipas referencë nr. 002, datë 15.06.2012 në administrim "[redacted] sha kaluar pronësi me referencë nr. 004, datë 18.12.2015 "[redacted] sha. Kartelat ***janë të pa vulosura dhe nënshkruara nga regjistruesi, numri i zonës kadastrale dhe indeksi hartës të korrigjuara dhe shënuara me laps***.

a- Regjistrimi i pasurive të paluajtshme të shoqërive tregtare, të krijuara nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore është bërë në kushtet ***kur mungon: Urdhri i Ministrit te Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Vendimi i Gjykatës për regjistrimin e personit juridik, Statuti i Shoqërisë Tregtare, Kontrata midis themeluesve, Plan-vendosja***.

Në dosje mungon Urdhri i Ministrit të Financave nr. 95, datë 15.12.1995 për transfortmimin e ndërmarrjes [redacted] ***në shoqëri aksionere***.

b- Në kartelat e pasurive të paluajtshme këto dy pasuri janë regjistruar me zërin kadastral Shesh, ndërsa në planrilevimet e përgatitura nga [redacted] bëhet fjalë për dy objekte njëri me sipërfaqe objekti 9900 m^2 dhe sipërfaqe të përgjithshme 13850 m^2 dhe tjetri objekt me sipërfaqe prej 1400 m^2 gjithashtu në shkresën me nr. 53/3 datë 30.11.2011 që Albkrom i drejtohet ZVRPP Bulqizë mbi plotësimin e kërkesave për objektet e zonës Lucane Krastë Batër cilësohen si objekte ndërtimore

industrial, ***duke mos u përputhur lloji pasurisë ndërmjet kontratave të shitblerjes, listës së inventareve, plan-rilevimet të subjektit në likuidim dhe hartën e punës ku janë bërë shënimet me "laps" Objekte, hedhur në hartën e punës të dy objekte me konture të zeza***, pajisur me vërtetim hipotekor datë 11.02.2013.

c- Në kontratën e shitjes nr. 2030 rep. Nr. 971 kol datë 09.06.2015 me pal shitëse "[redacted]sha përfaqësuar likuidator [redacted], pala blerëse "[redacted]sha, objekti shesh depozitim kromi 9900 m^2, ***nuk përputhet zona kadastrale pasi në të është përcaktuar 2267 Krastë ndërsa në kartelë shënuar Lujcane korrigjuar me laps 3511 Krastë, por në fakt kjo zonë i takon Stavecit, indeksi hartës korrigjuar nga 183-A në 176-A. Në kontratë dhe autorizimin e Ministrit të linjës nr. 8935/4 datë 07.1.2015 është likuidator [redacted] ndërsa në genplanin e paraqitur është Fejzi Lila. Në raport vlerësimin numër 6358/1 prot datë 22.09.2014 sipërfaqet prej 9900 m^2 dhe 1400 m^2 përcaktohen si truall dhe vlerën ndërtimore, gjithashtu mungon planrilevimi***.

d- Në kontratën e shitjes nr.7774 rep., Nr.3581 kol datë 18.11.2015 me palë shitëse "[redacted]sha përfaqësuar likuidator Mentor Spahiu, pala blerëse "Zyka Grup"sha, objekti impiant seleksionimi 1400 m2, ***nuk përputhet zona kadastrale pasi në të është përcaktuar Lucne zonë e cila nuk ekziston në listën e zonave të ZVRPP Bulqizë, ndërsa në kartelë ZK 3511 korrigjuar me laps ndërsa në listë kjo zonë quhet Stavec, indeksi hartës korrigjuar nga 183-A në 176-A gjithashtu mungon planrilevimi. Në procesverbalin e ankandit datë 23.10.2015 sipërfaqja prej 1400 m^2 paraqitet në llojin truall me vlerën përkatëse, pajisur me vërtetim hipotekor datë 17.01.2015.***

e- Në kontratën e shitjes nr. 3302 rep. Nr. 908 kol datë 19.06.2018 me palë shitëse "[redacted]ha, pala blerëse [redacted], me objekt: shesh me sipërfaqe 9900 m^2 dhe shesh me sipërfaqe 1400 m2, zonat kadastrale të këtyre dy pasurive nuk përputhen me kontratat e mëparshme lidhur ndërmjet shitësve dhe blerësve sa kemi trajtuar më sipër. ***Për këto dy pasuri me sipërfaqe 9900 m^2 dhe 1400 m^2 ekziston një tjetër kontratë qiraje lidhur midis "[redacted] dhe Shoqëria [redacted]" shpk nr. 5284 rep, nr. 2316 kol, datë 14.07.2016 për në periudhë 5 vjeçare deri më datë 01.09.2021,*** ku në pikën 13 të kontratës parashikohet se ndryshime ose shtesa të kontratës janë të vlefshme vetëm në rast se bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga të dy palët, ***pra mes këtyre palëve nuk ka akt të nënshkruar dhe pëlqim nga qiramarrësi për shitjen e kësaj prone dhe të drejtave reale tek pala blerëse [redacted].*** Veprime këto në papajtueshmëri me pikën a neni 25, pika 2 neni 45 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me pikën 2 dhe 3 të VKM nr .553, Date 28.8.1998 "*Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme të Shoqërive Tregtare, të Krijuara nga Transformimi i Ndërmarrjeve Shtetërore*". Veprime këto në papajtueshmëri me pikën a neni 25, pika 2 neni 45 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me pikën 2 dhe 3 të VKM nr .553, Date 28.8.1998 "*Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme të Shoqërive Tregtare, të Krijuara nga Transformimi i Ndërmarrjeve Shtetërore*" *(Trajtuar në faqet 109-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 47: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 1 volum 1 faqe 1, nr. 2 volum 1 faqe 2 ZK 3511, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Brenda muajit Nëntor 2019

48- Gjetje*:* ***Nga Zyra Vendore e ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë në pasqyrat financiare të vitit 2017 dhe 2018*** evidentohet një vlerë debitor prej ***352500 lekë*** sipas llogarisë ***468 "Debitore të ndryshëm"*** e cila kuadron me analizën e kësaj llogarie dhe i përket subjektit [redacted] shpk i pa argumentuar, i mbartur nga vitet e mëparshëm i pa arkëtuar për shkak të mungesës së adresës së subjektit"[redacted]***shpk****(Trajtuar në faqet 115-120, të Këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 48: ***Zyra vendore ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë, përgjegjësi i Zyrës*** të marrë masa për arkëtimin e detyrimit duke kërkuar adresën e subjektit në Drejtorin Rajonale Tatimore Tiranë ku është i regjistruar dhe zhvillon aktivitet subjekti, duke i bëre me dije detyrimin e subjektit pranë Zyrës Vendore të ASHK Bulqizë..

Brenda muajit Nëntor 2019

49- Gjetje*:* ***Nga Zyra Vendore e ASHK(ish-ZVRPP) Bulqizë*** nuk janë verifikuar elementet e formës dhe të përmbajtjes të pasurisë, për pasuritë ***200/2, v. 1, faqe 37 me sipërfaqe trualli 80 m2 dhe ndërtim 48.95 në emër të*** [redacted]**,** duke mos u zbatuar procedurat e përcaktuara në ***VKM nr. VKM 608, datë 05.09.2012,*** në papajtueshmëri me pikën "iii" shkronjës "b" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012"Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

Nuk disponohet nga subjekti ***asnjë lloj dokument pronësie sikurse leje sheshi, preventiv, situacion, aktdorëzimi, aktkontroll punimesh, e dokumentacion, si dhe dokument që provon pronësinë e truallit të asaj kohe sipas ligjit të urbanistikës nr. 7693, datë 07.06.1993 dhe nuk disponohet akt fitimi pronësie si leje ndërtimi apo KSHB. Objekti i ndërtuar sipas vërtetimit të faktit juridik nr. 60, datë 18.06.1998*** me kërkues [redacted] ***ka përfunduar në vitin 1993, dhe nuk ka lidhje me ndërtimin para datës 10.08.1991, në kundërshtim me shkronja "a" të pikës 4 të VKM 608, datë 05.09.2012.***

- Nuk rezulton të ketë dokument zyrtar nga Pushteti Vendor që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991, ***në kundërshtim me pikën 5 të VKM nr. 608, datë 05.09.2012***.

Dokumentacioni i dosjes dërguar në ZVRPP është fotokopje dhe nuk ka vulat dhe firmat nga Bashkia për njësimin e dokumentacionit, në kundërshtim me procedurat e përcaktuara nga ***VKM 608, datë 05.09.2012, pika 8.*** Sikurse evidentohet në dosje nga subjekti kërkues dhe Bashkia nuk është plotësuar dokumentacioni në zbatim të VKM nr. 608, datë 05.09.2012, ***në kundërshtim me kërkesat e neneve 24-25 të ligjit 33/2012 "Për Regjistrimin e pasurisë së Paluajtshme".*** *(Trajtuar në faqet 120-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 49: Nga KLSH ti kthehet përgjigje ankuesit [redacted] kundrejt kërkesë-ankesës së protokolluar në KLSH me nr. **nr. 318, datë 13.05.2018,** duke e vënë në dijeni në lidhje me shkeljet e konstatuara nga KLSH dhe për rekomandimet drejtuar institucioneve përkatëse në lidhje me regjistrimin e **pasurisë 200/2, në emër të** [redacted]

Brenda muajit Nëntor 2019

B. TË ARDHURA TË MUNGUARA NGA MOS LIKUJDIMI I QIRASË SË TRUALLIT

1- Gjetje: ZVRPP Bulqizë në 2 **raste** sipas referencave nr. 3114 dhe nr. 2935, 2934, ZK 8612, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme bazuar në dokumentacionin urbanistik, rezulton se regjistrimi ***është kryer në mungesë të dokumentacionit urbanistik tekniko ligjor,*** ndërsa *mungon dokumentacioni konfirmues përkatës që vërteton shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga qiraja e përdorimit të truallit,* duke shkaktuar ***shkelje të disiplinës financiare, si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit, në vlerën totale 341,560 lekë,*** e pa likuiduar, nga subjektet, si më poshtë:

- Për regjistrimin e pasurisë nr. 2/226/2, truall me sipërfaqe 66 m^2, volum 9, faqe 154, duke mos llogaritur qiranë e përdorimit të trualli, për periudhën 01.01.2013 deri më datë 10.10.2018(data e lidhjes së kontratës), e cila llogaritet në vlerën ***në vlerën 231,000 lekë***{70 muaj*[66 m^2(sipërfaqja që zë objekti)*50 lek/ m^2/muaj(vlera e qirasë për njësi)]}, konsiderohet ***detyrim financiar i pa arkëtuar, përfituar padrejtësisht nga*** [redacted]***;***
- Për regjistrimin e pasurisë nr. 2/429, truall me sipërfaqe 56.7 m^2, volum 9, faqe 238, duke mos llogaritur qiranë e përdorimit të trualli, për periudhën 01.01.2013 deri më datë 29.03.2016(data e lidhjes së kontratës), e cila llogaritet në vlerën ***në vlerën 110,565 lekë***{39 muaj*[56.7

m^2(sipërfaqja që zë objekti)*50 lek/ m^2/muaj(vlera e qirasë për njësi)]}, konsiderohet ***detyrim financiar i pa arkëtuar, përfituar padrejtësisht nga [redacted];***
Vepruar në kundërshtim ne pikën 7, kreu IV, rregullores nr.184, datë 08.04.1999, "Për Punën e Zyres se Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme". *(Trajtuar në faqet 87-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
Rekomandim 1: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Bulqizë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr.111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi në 2 raste,** për pasuritë e regjistruara sipas referencave të sipërcituara, deri në paraqitjen e dokumentacionit që vërteton shlyerjen e këtij detyrimi financiar, për subjektet si më poshtë:
1. **[redacted],** për mos lekujdimin e qirasë së truallit me sipërfaqe **66 m^2**, llogaritur **në vlerën *231,000 lekë;***
2. **[redacted]** për mos lekujdimin e qirasë së truallit me sipërfaqe **56.7 m^2**, llogaritur **në vlerën *110.560 lekë;***

Brenda muajit Nëntor 2019

IV- KONKLUZIONE DHE OPINIONI AUDITIMIT

Nga auditimi i përputhshmërisë mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, (INTOSAI-t), Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualet e Auditimit të Përputhshmërisë, i kryer në Zyrën Vendore ASHK(ish ZVRPP) Bulqizë, rezultuan devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi(kriteret), konkretisht:
- Aktiviteti i instuticionit nuk ka qenë plotësisht efektiv në drejtim çështjeve që lidhen me vlerësimin e procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për regjistrim, veçanërisht në vlerësimin e përmbajtjes së dokumentacionit paraqitur për kryerje transaksionësh, regjistrime trojesh, regjistrime me leje legalizimi, regjistrime të ndërtimeve me leje ndërtimi, regjistrime me Aktet e Marrjes së Tokës Në Pronësi(AMTP) dhe transaksione ndryshimi pronësor, etj.
- Pamjaftueshmërinë në përmbushje të funksioneve si një institucion që ka impakt të lartë social dhe ndikon direkt në vlerësimin dhe opinionin e qytetarëve për qeverisjen e vendit. Auditimet më të shpeshtë dhe periodike do të ndikonin direkt në rritjen e mirëmenaxhimit të njësisë publike dhe mangësitë e evidentuara do të ishin minimizuar nga punonjësit e administratës së këtij institucioni.
- Janë regjistruar pasuri të paluajtshme dhe janë kryer transaksione, *duke mos zbatuar kërkesat ligjore,* pasi është shkelur kriteri i ndarjes së tokës sipas normës për frymë të çdo fshati, për rrejdhojë nga regjistrimi i tyre *kanë përfituar më tepër tokë* se sipërfaqja takuese sipas normës për frymë, bazuar në përbërjen familjare me 1.08.1991, sa vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", i ndryshuar.
- *Nuk është bashkëpunuar me Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Dibër, lidhur me konfirmimin zyrtar të statusit të parcekave ndërtimore të miratuara,* ndërsa nga ZVRPP Bulqizë është proceduar duke regjistruar dhe certefikuar pronësinë për posedusesit e lejeve të legalizimit, të cilat janë ndërtuar mbi objekte që figurojnë në pronësi "shtet", të regjistruara në KPP.
- Janë kryer regjistrime me *shkelje të dispozitave ligjore,* pasi *mungon dokumentacioni tekniko ligjor,* konkretisht: mungon akti i fitimit të pronësisë mbi truallin; *mungon kofirmimi* zyrtar nga instutucionet përkatëse, lidhur me shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga përdorimi i truallit në pronësi "shtet", gjithashtu marrëdhëniet me truallin nuk janë sipas ligjit, etj.

- Janë kryer regjistrime të pasurive të përfiruara me AMTP, me *shkelje të dispozitave ligjore, pasi janë regjistruar pasuri që nuk janë të llojit tokë bujqësore, për të cilat AMTP-ja nuk mund të shërbejë si Titull Pronësie.*
Mangësitë dhe shkeljet e konstatuara më sipër Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur të KLSH, janë të rëndësisë materiale për devijimet e konstatuara në disa raste nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, te cilat justifikojnë dhënien e ***një Opinioni të kualifikuar me rezervë*** *për të cilin japim opinionin dhe për përmirësimin e gjendjes i është rekomanduar Zyrës Vendore ASHK(ish ZVRPP) Bulqizë marrja e masave përkatëse*

Pjesë e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi janë Akt Konstatimet e mbajtura në subjekt të protokolluara dhe të dorëzuara në ZVASHK Bulqizë, si më poshtë:

Akt konstatimi nr. 1, datë 27.05.2019, Lidhur me ankesa nga qytetari;
Akt konstatimi nr. 2, datë 28.05.2019, regjistrimi i pasurive me kontrata privatizimi nga EKB;
Akt konstatimi nr. 3, datë 29.05.2019, lidhur me regjistrimin e pronave publike të transferuara;
Akt konstatimi nr. 4, datë 30.05.2019, Regjistrim sipas Lejeve të ndërtimit;
Akt konstatimi nr. 5, datë 30.05.2019, regjistrimin me Leje Legalizimi;
Akt konstatimi nr. 6, datë 31.05.2019, regjistrimin e tokës bujqësore të përfituar nga ligji nr.7501, datë 19.07.1991 "Për tokën";
Akt konstatimi nr. 7, datë 31.05.2019, regjistrimin e tokës bujqësore të përfituar nga ligji nr.7501, datë 19.07.1991 "Për tokën" ZK 2898;
Akt konstatimi nr. 8, datë 31.05.2019, regjistrimin e tokës bujqësore të përfituar nga ligji nr.7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", ZK 2267;
Akt konstatimi nr. 9, datë 31.05.2019, Regjistrimin e tokës bujqësore të përfituar nga ligji nr.7501, datë 19.07.1991 "Për tokën";
Akt konstatimi nr 10, datë 31.05.2019, regjistrimin me Leje Legalizimi;
Akt konstatimi nr 11, datë 31.05.2019, Regjistrim sipas Lejeve të ndërtimit;
Akt konstatimi nr. 12, datë 31.05.2019, regjistrimi i pasurive me kontrata privatizimi;
Akt konstatimi nr. 13, datë 31.05.2019, regjistrimin e Vendimeve të KKKP--ve;
Akt konstatimi nr. 14, datë 31.05.2019, regjistrimin e Vendimeve të KKKP--ve;
Akt konstatimi nr. 15, datë 31.05.2019, lidhur me regjistrimin e pronave publike të transferuara;
Aktkonstatimi nr. 16, datë 31.05.2019, aktiviteti financiar i ZVRPP Bulqizë;
Aktkonstatimi nr. 17, datë 31.05.2019, zk 2155 Klenje AMTP;
Aktkonstatimi nr. 18, datë 31.05.2019 zk.3444, Regjist. pasurive përfituar me leje ndertimi;
Aktkonstatimi nr. 19, datë 31.05.2019. zk.3444Regjistrim pasurive përfituar me Privatizim;
Aktkonstatimi nr. 20 ZK 31.05.2019 zk.3444 Regjistrim pasurive përfituar me VKM 608;
Aktkonstatimi nr. 21 , datë 31.05.2019 zk 3947 Regjistrim pasurive përfituar me AMTP;.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT